1925-2015

90 Vjet KLSH

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT VJETOR I PERFORMANCËS

shqip-anglisht

KLSH

2014

ALSAI

EUROSAI

Experentia mutua
Omnibus prodest

INTOSAI

ISBN: 978-9928-159-39-7
Seria: botime KLSH 14/2015/49

Tiranë, 2015

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS, KLSH 2014

(shqip-anglisht)

Tiranë, 2015

Titulli:

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS, KLSH 2014

(shqip-anglisht)

Përgatitën botimin:

Armanda BEGAJ

Irena ISLAMI

Materiali në anglisht u përgatit nga:

Ina SOKOLI, Kristi ANASTASI, Alkida LLAKAJ,

Aulona JONUZI, Redina KARAPICI, Idlir DERVISHI, Blerin SHKURTI

Redaktoi materialin në anglisht:

Dëshira HUQI

Seria e botimeve KLSH

14/2015/49

©Copyright KLSH

ISBN: 978-9928-159-39-7

Shtypur në shtypshkronjën “Onufri”

Tiranë, 2015

PËRMBAJTJA	Faqe
PJESA e I-rë	
Mesazh i Kryetarit të KLSH-së	5-7
Misioni dhe Vizioni i KLSH-së	9-10
Performanca 2014 e KLSH-së, në përputhje me Standardet e INTOSAI-t – Diskutimi i Kryetarit të KLSH-së në Komisionin për Ekonominë dhe Financat në Kuvendin e Shqipërisë	11-30
Korrespondencë me Kuvendin e Shqipërisë	31-32
RAPORTI MBI VEPRIMTARINË E KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT PËR VITIN 2014	
1. Veprimtaria audituese dhe dobia e rezultateve	33-34
2. Gjetjet kryesore të auditimeve	35-88
3. Burimet dhe përdorimi i tyre	89-105
4. Bashkëpunimi ndërinstitucional	106-118
5. Vlerësime	119-128
6. Veprimtaritë social-kulturore	129-134
7. Fokusi drejt së ardhmes: Perspektiva dhe sfida 2015	135-138
8. Analiza e realizimit të buxhetit të KLSH-së, për vitin 2014	139-144
Pasqyrat financiare vjetore të vitit ushtrimor 2014	145-152
Njësitë publike të audituara nga KLSH gjatë vitit 2014	153-159
Korrespondencë me Kuvendin e Shqipërisë	161-163
Mbi statusin e zbatimit të Planit të Veprimit për Rekomandimet e Rezolutës së datës 26 Qershor 2014, të Kuvendit të Shqipërisë	165-190

Diskutime të deputetëve në Komisionin për Ekonominë dhe Financat në Kuvendin e Shqipërisë	191-246
Projektrezolutë për vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2014	247-254
Korrespondencë me Kuvendin e Shqipërisë	255-256
SHTOJCA	
Evidenca e shkeljeve financiare me dëm ekonomik, 2014	257-274
Evidenca e Kallëzimeve Penale 2014	275-284
Evidenca e shqyrtimit të ankesave dhe kërkesave 2014	285
Pasqyrimi në media i Analizës Vjetore dhe i Raportit të Performancës së KLSH-së, për vitin 2014	287-290
Lista e shkrimeve të stafit të KLSH-së, të botuara në shtypin e shkruar, gjatë vitit 2014	291-298
Fjalori i shkurtimeve	299-303
PJESA e II-të	
Message of the ALSAI Chairman	5-7
Mission and Vision of ALSAI	9-10
ALSAI Performance Report for 2014, in compliance with INTOSAI Standards - The speech of ALSAI`s Chairman, Mr. Bujar LESKAJ in the Parliamentary Economic and Financial Committee	11-30
AL-SAI Performance Report	31-131

MESAZH I KRYETARIT TË KLSH-së

Viti 2014 ka përfaqësuar për KLSH vitin e dytë të zbatimit të Strategjisë së tij të Zhvillimit 2013-2017, të bazuar në drejtimet kryesore strategjike të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t, strategji e cila synon sjelljen e veprimtarisë audituese të institucionit në parametrat e institucioneve të zhvilluara simotra të Bashkimit Evropian, në respektim të plotë të mandatit kushtetues të KLSH dhe të pritshmërive të Kuvendit dhe qytetarëve.

Në tërësi, nisur nga sasia dhe cilësia e auditimeve të kryera, nga gjetjet dhe rekomandimet e dhëna, nga përpjekjet për të luftuar korrupsionin dhe abuzimin me fondet publike, viti 2014 përfaqëson vitin e konsolidimit të reformave të ndërmarra gjatë viteve 2012-2013 dhe vit në të cilin institucioni ka fituar ne mënyrë më të plotë fizionominë e një institucioni modern të auditimit suprem publik, me qasje evropiane.

Filozofia e re e punës ka synuar zbatimin rigoroz të standardeve profesionale të fushës ISSAI, duke realizuar shkëputjen përfundimtare të KLSH nga tradita shumëvjeçare e një strukture të orientuar për nga inspektimi financiar, në një trupë auditimi që kërkon shtimin e vlerës së parasë publike të shpenzuar për investime dhe shërbime ndaj qytetarëve, duke u përqendruar në auditimin e mirëfilltë financiar dhe në auditimin e performancës, pa harruar investimin në teknologji dhe në dijet për realizimin e auditimeve të teknologjisë së informacionit.

Auditimet tona për vitin 2014 janë përzgjedhur mbi bazën e analizës së riskut dhe kanë synuar rritjen e thellësisë së gjetjeve të auditimit dhe dobishmërisë së rekomandimeve, duke e parë institucionin e audituar në funksionimin e tij në sistem. KLSH ka vënë theksin në plotësimin e rekomandimeve të auditimeve të mëparshme, duke kërkuar rritjen e nivelit të përgjegjshmërisë dhe transparencës së menaxhimit të institucioneve të audituara.

Në dhjetor 2014, në një kohë që përkon afërsisht me miratimin e Rezolutës së Dytë të Kombeve të Bashkuara, kushtuar forcimit dhe mbështetjes së institucioneve supreme të auditimit dhe organizatës së tyre INTOSAI, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin e ri organik të KLSH, tërësisht në përputhje me standardet e INTOSAI-t, duke zbatuar rekomandimet e Progres Raporteve të Bashkimit Evropian dhe duke i siguruar institucionit bazën për një modernizim të plotë të aktivitetit të tij auditues.

Gjatë vitit 2014, KLSH ka rritur dhe konsoliduar më tej hapat e ndërmarrë në vitet 2012 dhe 2013 për një transparencë të plotë me publikun dhe qytetarët, nëpërmjet njoftimeve për shtyp, botimeve të tij, editorialeve të shkruara nga audituesit në shtypin shqiptar dhe realizimit të Konferencës së Tretë Shkencore për Auditimin Publik.

Institucioni ka konsoliduar bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë si DG-Budget, SIGMA dhe institucionet simotra evropiane, por edhe me profesoratin shqiptar, me organizatat profesionale të vendit dhe me shoqërinë civile, drejt një qasjeje të re gjithëpërfshirëse, ku këta partnerë, krahas aktiviteteve të përbashkëta, japin kontribut edhe në procesin e vetëvlerësimit të institucionit dhe në rritjen e integritetit të tij. KLSH ka përqafuar qasjen IntoSAINT të organizatës INTOSAI, të vetëvlerësimit të integritetit, duke synuar rritjen e integritetit jo vetëm brenda tij, por edhe kufizimin dhe parandalimin e korrupsionit në institucionet që ai auditon, nëpërmjet vetëvlerësimit të integritetit.

Viti 2014 shënoi edhe konsolidimin e investimit në kapacitetet audituese, duke qenë viti i tretë radhazi i arritjeve të treguesve perëndimorë në ditët e trajnimeve në vit për auditues, nisur nga një bazë e papërfillshme e trashëguar nga vitet e mëparshme.

Të gjitha këto arritje dhe tregues janë vetëm fillimi i qasjes së re, për një auditim sa më cilësor, në shërbim të qytetarit, të orientuar drejt shëndoshjes së plotë të financave publike dhe rritjes së përgjegjshmërisë dhe transparencës në përdorimin e fondeve publike. Është siguruar një bazë e mirë për reformim të mëtejshëm, e konsoliduar gjatë vitit 2014, por për plotësimin e sfidave të mësipërme, KLSH ka

nevojë për një bashkëpunim sa më efektiv me Kuvendin, me institucionet e tjera të pavarura që luftojnë për mirëqeverisjen publike dhe kundër korrupsionit, me Qeverinë, shoqërinë civile dhe qytetarin.

Falenderim i veçantë

Në cilësinë e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe në emër të të gjithë trupës së audituesve dhe punonjësve mbështetës në institucion, falenderoj në mënyrë të veçantë z. Erion Braçe, Kryetar i Komisionit të Kuvendit për Ekonominë dhe Financat, si dhe deputetët e të gjitha partive politike anëtarë të këtij Komisioni për ndihmën, mbështetjen dhe sugjerimet e tyre tejet të vlefshme në procesin e diskutimit dhe miratimit të ligjit të institucionit, si edhe mbështetjen dhe mirëkuptimin e treguar sa herë që KLSH ka raportuar në Komision gjatë vitit 2014 dhe 2015.

Kjo ndihmë dhe mbështetje e vyer, në linjë me kërkesat e dy Rezolutave të OKB-së të viteve 2011 dhe 2014, për forcimin dhe mbështetjen e institucioneve supreme të auditimit, krahas inkurajimit dhe nxitjes së audituesve për të rritur profesionalizmin e tyre dhe përpjekjet për të kontribuar më me efektshmëri në mirëqeverisjen publike dhe në thellimin e luftës ndaj korrupsionit, përbën vlerë për Kontrollin e Lartë të Shtetit në sfidat e viteve të ardhshme, që synojnë modernizimin e plotë, duke realizuar tërësisht objektivat e Strategjisë së Zhvillimit 2013-2017 të KLSH-së (rishikuar për periudhën 2015-2017), si dhe duke respektuar pritshmëritë e Kuvendit dhe të qytetarëve në misionin e tij kushtetues, si institucion suprem i auditimit publik në Shqipëri.

Bujar LESKAJ

MISIONI DHE VIZIONI i KLSH-së

I përkushtuar në përmbushjen e misionit të tij kushtetues dhe me vizion të qartë drejt së ardhmes, KLSH prezanton profilin e tij si Institucion i pavarur në shërbim të qeverisjes së mirë dhe publikut.

***Misioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit është**:*

Informimi i publikut dhe i Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me përdorimin e burimeve me ekonomicitet, efektivitet dhe efiçiencë nga pushteti qendror e lokal dhe nga njësi të tjera publike, si dhe nxitja e përgjegjeshmërisë në të gjithë sektorin publik, në përputhje me praktikat më të mira të BE dhe me standartet ndërkombëtare të INTOSAI, duke kontribuar per qeverisjen e mirë, nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.

***Vizioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit shpalos**:*

Aspiratat tona, qëllimet që do të arrijmë dhe objektivat që duhet të përmbushim në të ardhmen duke synuar që të jetë një trupë profesionale që i kontribuon shtimit dhe kursimit të vlerës së parave publike, duke dhënë siguri mbi llogaritë financiare të përdoruesve të tyre dhe duke ndihmuar në përmirësimin e menaxhimit të Qeverisë e të enteve të tjera publike nëpërmjet auditimit, duke fituar në këtë mënyrë besim të plotë tek qytetarët shqiptarë dhe të audituarit.

- *Si veprojmë: ne rrisim aftësitë profesionale dhe etikën e punës së audituesve tanë, në një qasje pozitive të orientuar nga të mësuarit, duke përmirësuar në vijimësi marrëdhëniet tona të ngushta me palët e interesit: Kuvendin, qytetarët, partnerët e tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë.*

- *Jemi të përkushtuar që jo vetëm të ofrojmë informacion cilësor mbi përdorimin e fondeve publike, por edhe të ndihmojmë institucionet e audituara prej nesh që të përmirësojnë sistemet e tyre të menaxhimit financiar, duke i shtuar vlerë të ndjeshme shërbimeve që ofrojnë.*

- *Jemi të angazhuar që të ndihmojmë në fuqizimin e qeverisjes së mirë në administratën publike të vendit dhe t'i përgjigjemi me seriozitetin maksimal pritshmërive të Kuvendit dhe të qytetarëve.*

PERFORMANCA 2014 E KLSH-së,

NË PËRPUTHJE ME STANDARDET E INTOSAI-t

Diskutimi i Kryetarit të KLSH-së, z. Bujar LESKAJ mbajtur në mbledhjen e Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit, më 15.07.2015.

Të nderuar deputetë të Komisionit të Ekonomisë,

Matja e performancës së një institucioni publik ka rëndësi parësorë për të vlerësuar kontributin e institucionit, si dhe për t'i garantuar atij një zhvillim të qëndrueshëm në të ardhmen. Ky proces merr peshë edhe më të madhe, kur parashtrohet përpara Komisionit të Ekonomisë së Kuvendit.

Në Kongresin e fundit të INTOSAI-t, INCOSAI 21 në Pekin, në tetor 2013, një version pilot i Dokumentit Standard të Matjes së Performancës së një institucioni suprem auditimi (SAI) u prezantua dhe u shpërnda, duke u kthyer prej atëherë gradualisht format pune për çdo SAI të zhvilluar, që paraqet performancën e tij përpara partnereve kryesore. Në respekt të rekomandimit Tuaj, herës së fundit që paraqita raportin e performancës së KLSH, si dhe në zbatim të direktivës së Kongresit INCOSAI 21 të INTOSAI-t dhe të orientimit të Kongresit Young EUROSAI për inovacionin, që në Hagë vitin e kaluar na sfidonte të gjithëve se "kur ka qenë hera e fundit që keni bërë një gjë për herën e parë?", si KLSH jemi përpjekur të përgatisim një raportim sa më të qartë, të strukturuar dhe të vlefshëm për vlerësimin Tuaj, për punën tonë, mbi bazën e këtij Dokumenti Standard dhe qasjes IntoSAINT (auditimi i vetëvlerësimit).

Matja e standardizuar e performancës së një SAI siguron një bazë objektive për të treguar lidhjen e tij të vazhdueshme me Parlamentin, qytetarët dhe veprimtarët e tjerë. Kjo matje synon të vlerësojë kontributin e SAI-ve në menaxhimin financiar publik, në qeverisjen e mirë dhe llogaridhënien, si dhe në përpjekjet për të luftuar korrupsionin. Një matje e tillë e performancës, e punës së bërë, i jep mundësinë SAI-t për të qenë organizate model, duke u udhëhequr nga promovimi i transparencës dhe llogaridhënies, përmes raportimit publik të performancës së tij.

Përdorimi i dokumentit pilot të matjes së performancës, edhe pse i rekomanduar nga Kongresi i fundit i INTOSAI-t, është fakultativ. Vendimi për t'ju nënshtruar një vlerësimi të tillë i takon drejtuesit të SAI-t. Vlerësimi mund të kryhet si një vetëvlerësim nga vetë SAI, si një vlerësim i kolegëve nga një tjetër SAI apo organ i INTOSAI-t, ose si një vlerësim nga konsulentë të jashtëm, donatorë apo ekspertë të tjerë. Ne e kemi vlerësuar sipas kësaj metode dhe sipas qasjes IntoSAINT, ndërkohë që kemi kërkuar vlerësim nga SAI-t partnere të zhvilluara dhe shumë shpejt këtë vlerësim do ta kemi. Jemi të hapur dhe mirëpresim çdo vlerësim ose vërejtje që mund të vijë nga Ju.

Matja e performancës nëpërmjet dokumentit pilot jep një pasqyrë të të gjitha fushave më të rëndësishme të aktivitetit dhe rezultateve të një SAI. Ajo përfshin si proceset e brendshme të institucionit (mënyrën e organizimit, zbatimin e rregullores së brendshme, zhvillimin e burimeve njerëzore, etj.), ashtu si dhe komunikimet me jashtë (partneritetet, komunikimin me qytetarët dhe publikun, etj.) dhe rezultatet.

Për këtë arsye, raportimin para Jush e kemi menduar në tri boshte kryesore:

- Në dhënien e treguesve të ecurisë së institucionit,
- Në ballafaqimin me rekomandimet Tuaja të qershorit 2014, dhe
- Në analizën SWOT e sfidat e së ardhmes për KLSH-në, në zbatimin e IntoSAINT.

Dokumenti standard të cilit i jemi referuar synon të masë performancën e SAI-t kundrejt standardeve ISSAI dhe praktikave të tjera më të mira të përcaktuara nga INTOSAI, si dhe kundrejt kornizave ligjore të brendshme që lidhen me SAI-n. Shtrirja e tij e standardizuar dhe matjet objektive të performancës në formën e treguesve, e bëjnë atë të përshtatshëm edhe për krahasimin e performancës së aktivitetit të KLSH në intervale të dhëna kohe.

Dokumenti standard ka një grup prej 22 treguesish për të matur performancën e SAI-ve kundrejt praktikave më të mira ndërkombëtare në shtatë fusha:

(1) Performanca e SAI-ve,
(2) Pavarësia dhe Korniza Ligjore,
(3) Strategjia për Zhvillimin Organizativ,
(4) Standardet e Auditimit dhe Metodologjia,

(5) Menaxhimi dhe Strukturat Mbështetëse,
(6) Burimet Njerëzore dhe Komunikimi, si dhe
(7) Menaxhimi i Palëve të Interesuara.

Duke i përshtatur me mjedisin dhe kushtet tona specifike, si dhe për t'i bërë sa më të drejtpërdrejtë dhe të kuptueshëm, si KLSH kemi përshtatur 13 tregues kryesore që janë:

1. Auditimet dhe ecuria e tyre;
2. Dëmi ekonomik i zbuluar dhe dobishmëria;
3. Rekomandimet me impakt të lartë;
4. Numri i rekomandimeve;
5. Niveli i zbatimit të rekomandimeve;
6. Kallëzimet penale;
7. Auditimet e performancës;
8. Zhvillimi i burimeve njerëzore;
9. Kontrolli i cilësisë;
10. Transparenca dhe komunikimi;
11. Aftësia për partneritet (me partnerë vendas dhe të huaj);
12. Botimet dhe kërkimi shkencor;
13. Përmirësimi i metodologjisë dhe instrumenti IntoSAINT.

Kemi gjykuar se në tërësi, për këta tregues do të ishte më e udhës të japim shifra të konsoliduara, për periudhën janar 2014-qershor 2015, duke qenë së raportojmë pas gjysmës së parë të vitit 2015 dhe ky konsolidim i shërben Kuvendit (dhe jo vetëm atij) për të matur dhe vlerësuar ecurinë e institucionit deri në momentin e raportimit, duke i krahasuar me periudhën dyvjeçare 2012-2013 dhe me një grupim të tretë, periudhën katërvjeçare vitet 2008, 2009, 2010 dhe 2011. Çdo tregues sasior shoqërohet me grafikët përkatës të ilustruar.

I. Treguesit kryesorë të performancës së KLSH janar 2014-qershor 2015

1. Auditimet

Për vitin 2014, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kryer 160 auditime, ose 10.5 % më shumë se viti 2013. Për periudhën 6 mujore të 2015, numri i auditimeve shkon në 71.

Auditimet e përputhshmërisë dhe ato të performancës shënojnë rritje përkatësisht me 11 % dhe 33 %, duke e krahasuar vitin 2014 me vitin 2013, ndërsa si numër në total për periudhën janar 2014-qershor 2015, janë përkatësisht 191 dhe 11 auditime. Edhe pse në një numër ende të vogël, por të nisur nga një bazë e papërfillshme në vitin 2011, në vitet 2012-2013 janë realizuar 10 auditime performance dhe për periudhën 2014 - gjashtëmujori i parë 2015 janë realizuar 13 të tilla, duke njohur një rritje të ngadaltë por të sigurtë gjatë tre viteve të fundit.

2.a. Dëmi ekonomik i zbuluar

Nga auditimet e ushtruara përgjatë periudhës janar 2014 - gjashtëmujori i parë 2015, janë zbuluar:

A. Parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera**, me dëm ekonomik të përgjithshëm** **në shumën totale prej 27 889 456 mijë lekë** (për vitin 2014, në shumën 11 198 404 mijë lekë dhe për gjashtëmujorin e parë 2015, në vlerën 16 691 052 mijë lekë).

B. Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në perfomancën e subjekteve të audituara, në shumën e përgjithshme prej **20 483 919 mijë lekë** (për vitin 2014, në shumën 13 293 014 mijë lekë dhe për gjashtëmujorin e parë 2015, në vlerën 7 190 905 mijë lekë).





Nga një analizë krahasuese të periudhave katërvjeçare 2008-2011 me periudhën trevjeçare 2012-2014 konstatohet se dëmi ekonomik i zbuluar për periudhën tre vjeçare 2012-2014 është rreth dy herë më i madh se vlera e dëmit të zbuluar për periudhën e katër viteve së bashku 2008, 2009, 2010, 2011.





2.b. Dobishmëria

Treguesi i dobisë së rezultateve të auditimit, i cili vë në raport shpenzimet buxhetore të KLSH me sasinë e fondeve të kërkuara për zhdëmtim nga KLSH, një nga treguesit kryesore të performancës se SAI-eve të zhvilluara sot në botë, paraqitet për periudhën janar 2014-qershor 2015 për çdo një lek të shpenzuar për institucionin e KLSH **janë kërkuar për t'u zhdëmtuar mesatarisht 78 lekë në Buxhetin e Shtetit**.

Nga një analizë krahasuese, konstatohet: për vitet 2009, 2010, 2011, për një lek të shpenzuar nga buxheti i KLSH janë kërkuar për zhdëmtim **27 lekë**, për vitet 2012 dhe 2013 janë kërkuar **52 lekë**, që do të thotë **25 lekë** më shumë krahasuar me periudhën 2009-2011. Për periudhën 2014 - gjashtë mujori i parë 2015 për një lek të shpenzuar nga buxheti i shtetit janë kërkuar për zhdëmtim **77.5 lekë**, që do të thotë **25.5 lekë** (shifër kjo e konsiderueshme duke pasur parasysh qe i referohemi vetëm gjashtë mujori të parë të 2015-s) më shumë krahasuar me periudhën paraardhëse 2012-2013.





3. Rekomandimet më impakt të lartë për periudhën janar 2014-qershor 2015

3.1. Në përmbushjen e detyrimit kushtetues për paraqitjen në Kuvend të Raportit "Mbi ekzekutimin e buxhetit te shtetit te vitit te kaluar financiar", në vijim të rekomandimeve të dhëna nga KLSH si në vitin 2012 dhe 2013, ne Tetor 2014 i paraqitem Kuvendit rekomandimin për ndërmarrjen e të gjitha masave për hartimin e një rregulli fiskal, i cili të synojë në reduktimin e nivelit të borxhit publik në një periudhë të përcaktuar kohore dhe sigurimin e një qëndrueshmërie afatgjatë të borxhit publik, nëpërmjet përgatitjes dhe paraqitjes se një iniciative ligjore për

vendosjen në Kushtetutë dhe në Ligjin "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të indikatorit të borxhit publik ndaj PBB-së, në nivelin 60 % dhe arritjen e këtij niveli ne terma afat afatgjate.

Po kështu, në funksion të promovimit të një qëndrueshmërie dhe kredibiliteti të financave publike, të përmirësimit të planifikimit të performancës fiskale, të projeksioneve makroekonomike dhe parashikimeve buxhetore; kemi rekomanduar ndërmarrjen e nismës ligjore për ngritjen e një Këshilli Fiskal, i cili duhet të gëzojë statusin e një institucioni publik të pavarur dhe të ketë një pavarësi operacionale shumë strikte e rigoroze nga politika.

3.2. Për fuqizimin e ligjit "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i cili rezulton me një rezistencë të ulët, kemi rekomanduar që shqyrtimi i ndryshimeve të parashikuara në Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020 të ligjit "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe miratimi i tij në Kuvend të bëhet me një shumicë të cilësuar parlamentare.

3.3. Në kushtet e përgjegjësisë financiare të ulët të zyrtarëve publik, i kemi rekomanduar Kuvendit hartimin e ligjit "Për përgjegjësinë materiale", në të cilin të trajtohet përgjegjësia financiare e punonjësve të njësive publike (zyrtarët e lartë dhe punonjësit e të gjithë niveleve) për dëmet ekonomike të shkaktuara qëllimisht apo nga neglizhenca, gjatë ose në lidhje me procesin e ekzekutimit të detyrave zyrtare.

3.4. Në drejtim të përcaktimit në Ligjin Organik të Buxhetit të përdorimit të të ardhurave nga privatizimi, në vijim të rekomandimit të dhënë gjatë vitit 2013 në kuadrin e rishikimit të Ligjit Organik të Buxhetit, i kemi rekomanduari Kuvendit që në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të përcaktohet që të ardhurat nga privatizimet të përdoren së pari dhe kryesisht për të ulur borxhin publik, ku 50% të jetë kufiri i poshtëm, dhe pjesa tjetër prej 30 % të përdoret për financimin e investimeve kapitale si dhe 20% për dëmshperblimin ligjor të ish të përndjekurve politikë.

3.5. Duke qene se vlerësimi i veprimtarisë së strukturave të auditimit të brendshëm në sektorin publik përbën një prej objektivave kryesore të veprimtarisë tonë, përgjatë vitit 2014 kemi dhëne një sërë rekomandimesh që synojnë përmirësimin e kuadrit rregullator ligjor me impakt konsolidimin dhe modernizimin e sistemeve të

menaxhimit financiar dhe kontrollit, dhe të auditimit të brendshëm në sektorin publik.

3.6 Nga auditimi në Bankën e Shqipërisë, bazuar në konstatimet mbi mënyrën e administrimit të Bankës, nevojës emergjente për përmirësime të cilat në vetvete varen edhe nga mënyra e funksionimit të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës e kemi konsideruar të rëndësishme mirëqeverisjen brenda këtij organi duke rekomanduar ndër të tjera që të *saktësohen më mirë detyrat funksionale të Këshillit Mbikëqyrës dhe administratorëve të Bankës me synimin për të shmangur dualizmin e funksioneve, konfliktin e kompetencave dhe për të siguruar një nivel të dëshirueshëm llogaridhënie, transparence dhe mbikëqyrjeje. Transformimin e funksionit të Inspektorit të Përgjithshëm në një Komitet Auditimi të përbërë nga tre anëtarë, të zgjedhur nga Kuvend duke synuar kështu rritje të pavarësisë dhe rritje të efektshmërisë së këtij funksioni*. Kemi rekomanduar *rishikimin e ligjit, në frymën e minimizimit të riskut potencial të abuzimit me pavarësinë dhe shmangies së konfliktit të interesit që evidentohet në praktikat e trajtimit të burimeve njerëzore si dhe kërkesën për një transparencë të detyrueshme ligjore lidhur me këtë aspekt. Kemi nënvizuar, që çdo ndryshim i ligjit organik të Bankës së Shqipërisë duhet të realizohet në bashkëpunim dhe konsultim të ngushtë me Fondin Monetar Ndërkombëtar, me Bankën Botërore dhe me Bankën Qendrore Evropiane.*

3.7 Nga auditimi mbi marrëveshjet hidrokarbure u konstatua se lidhjet e ndërsjella difektoze rregullatore, institucionale ndërmjet MEI, AKBN dhe Albpetrol sh.a., kanë kontribuar në krijimin e një trekëndëshi për pasimin e përgjegjësive institucionale duke ndikuar në dështimin e plotë të misionit mbikëqyrës të procesit të administrimit të pasurive natyrore e ato hidrokarbure në veçanti. Konstatuam ndryshime të Planeve të Zhvillimit kohë mbas kohe, treguesit ekonomiko–financiar të arritur nga veprimtaria e kompanisë kanë patur mospërputhje, krahasuar me parashikimet e miratuara në Planet Afatgjatë të Zhvillimit (PZH) si dhe Planet dhe Buxhetet e Punës vjetore (PP&B). Në rast se nuk do të kishim ndryshim të Planeve të Zhvillimit, Planeve të Punës dhe Buxhetit të kryer, Shteti Shqiptar do të kishte përfituar deri në fund të vitit 2014, përveç rentës minerare prej 199,4 milion USD edhe një shumë prej afro 504.55 milion USD, vetëm nga kompania kryesore që vepron në këtë fushë. Nga auditimi rezultoi se konfirmimet e AKBN-së (përgjatë vitit 2012-2013) për përjashtim nga Akciza dhe t.v.sh. të gazoilit 10 PPM dhe 1000 PPM, janë marrë në kundërshtim me sasitë e planifikuara në Programet e Punës dhe Buxhetit, në kundërshtim me përqindjen e përdorimit gazoilit si hollues, teorikisht i

pranuar në këto raste, në mungesë të një dokumentacioni të plotë dhe argumentues, duke sjellë një dëm të vlerësuar për buxhetin e shtetit në shumën 11 miliardë lekë.

Procesi monitorues i institucioneve përkatëse shtetërore (MEI, AKBN dhe Albpetrol sh.a.), në drejtim të monitorimit të të gjithave operacioneve teknike, konform planeve të miratuara dhe rezultateve financiare të lidhura me aktivitetin hidrokarbur, ka qenë pothuajse inekzistent, duke u mjaftuar vetëm me vëzhgime vizuale, sporadike, pa u orientuar në kontrollin ligjor, financiar dhe teknikо-shkencor të implementimit të këtyre marrëveshjeve. Pikërisht, inekzistenca e këtij monitorimi institucional, duke mos kryer siç duhet detyrat dhe funksionet e ngarkuara me ligj, ka çuar në mospërfitimin e shtetit gjatë gjithë këtyre viteve të pjesës që i takon sipas marrëveshjeve përkatëse me kompanitë koncensionare. Dhe kjo në një kohë që sasia e naftës që është nxjerrë deri më sot, në vendburime të caktuara, ka qenë aq e madhe sa i ka çuar këto vendburime në fazën e tyre shteruese ose siç cilësohet në gjuhën teknike, në fazë Depliti.

Nisur nga këto konstatime kemi kërkuar ringritjen e Institutit Shkencor të Naftës, si një institut i mirëfilltë shkencor i cili të mbështesë të gjitha vendimmarrjet e lidhura me zhvillimet e sektorit të hidrokarbureve në vendin tonë si dhe të bashkëpunojë me Kuvendin dhe Qeverinë lidhur me hartimin e strategjive afatmesme dhe afatgjatë të zhvillimeve në këtë sektor duke bërë dhe rolin e oponentit teknik gjatë negocimit të marrëveshjeve, shqyrtimit të propozimeve dhe zhvillimit të operacioneve hidrokarbure, si dhe orientues dhe oponencë e kërkimeve shkencore që lidhen me burimet hidrokarbure. Nga ana tjetër nga ne janë rekomanduar edhe masa organizative (7 të tilla) të cilat në gjykimin tonë janë të karakterit imediat. Ato kanë vlerë vetëm po të kombinohen me fillimin e menjëhershëm të punës nga ana e MEI dhe institucioneve më të larta të shtetit si Kuvendi e Kryeministria, për hartimin e miratimin e ndryshimeve ligjore të propozuara. Kemi theksuar se këto masa organizative nuk janë shteruese por që gjykohen të domosdoshme për kohën.

3.8 Nga auditimi i Institutit të Sigurimeve Shoqërore kemi konstatuar defektet e skemës së sigurimeve shoqërore lidhur me realizimin e të ardhurave duke çuar në rritje të subvencionioneve buxhetore nga viti në vit. Kjo situatë ka çuar në thellim të deficitit të skemës së pensioneve deri në masën 622 miliardë lekë (fundi i vitit 2013), si pasojë e mosrealizimit të numrit të kontribuesve të programuar, numrit të ulët të kontribuesve për një subjekt si dhe numrit të lartë të punonjësve me pagë minimale. Nga ana tjetër detyrimet kontributive të papaguara nga subjektet juridik

dhe fizikë rezultojnë të jenë rreth 10 miliardë lekë. E cilësojmë këtë fakt pasi rritja e detyrimeve mbart një problem të madh social, duke nënkuptuar një numër të konsiderueshëm kontribuesish të pasiguruar, të cilët përjashtohen nga të qenit subjekt i ligjit të sigurimeve shoqërore. Marrëdhënia difektoze me Drejtoritë e Tatimeve reflektohet në numrin e lartë të listëpagesave të padorëzuara, dhe pamundësinë për të siguruar informacionin në kohë reale. *Në këto kushte e kemi përkrahur dhe inkurajuar ndërhyrjet në Ligjin për Sigurimet shoqërore, shoqëruar kjo me marrjen e masave shtrënguese në detyrimin e subjekteve publike për derdhjen e detyrimeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, faktorë që do të përmirësonin situatën për deficitin e lartë të konstatuar. Vëmendje dhe ndërhyrje kemi kërkuar edhe në Marrëveshjen e lidhur me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, sidomos për mënyrën dhe kohën e sigurimit të informacionit.*

4. Numri i rekomandimeve

Rritje ka pësuar numri i rekomandimeve në të gjitha kategoritë, si ato për ndryshime në legjislacion, për masa organizative, masa administrative, disiplinore dhe ato për zhdëmtim dëmi. Në tërësi, vetëm për vitin 2014, KLSH ka prodhuar 882 rekomandime më shumë se një vit më parë. Ndonëse ky tregues nuk jep shkallën e efektivitetit dhe të cilësisë në punën rekomanduese, ai mat sasinë e punës së kryer.





5. *Zbatimi i Rekomandimeve*

Niveli i zbatimit të rekomandimeve përfaqëson një tregues shumë të rëndësishëm për të matur efektivitetin e një SAI. Ky nivel për vitin 2014 (zbatimi i rekomandimeve të këtij viti ende nuk mund të përcaktohet) është rreth 70 % dhe përfaqëson një shifër të krahasueshme me performancën e SAI-ve të zhvilluara. Shqetësim përben për ne niveli i ulët i zbatueshmërisë së masave të propozuara nga ne për largim nga detyra apo nga shërbimi civil për zyrtare të lartë të Shtetit, që është shprehje e antikulturës së pandëshkueshmërisë, e cila qëndron ende e ngulitur në administratën tonë publike dhe duhet luftuar pa asnjë kompromis.

6. Kallëzimet penale

Kallëzimet penale përbejnë një tregues të rëndësishëm të luftës ndaj korrupsionit dhe shfaqjeve që rrezikojnë standardet e qeverisjes së vendit.

Për periudhën janar 2014 - qershor 2015, kallëzimet penale kanë qenë 67 kallëzime. Janë kallëzuar zyrtare të rangut të lartë dhe të mesëm të administratës publike. KLSH ka rritur cilësinë e përgatitjes së dosjeve për kallëzim penal dhe ka shkurtuar kohën e përgatitjes së kallëzimeve. Krahasuar me periudhën dy vjeçare 2012-2013, kallëzimet për periudhën 2014-gjashtë mujori i parë 2015 përfaqësojnë 87% të vlerës, krahasuar me periudhën katër vjeçare 2008-2011, kallëzimet janë rritur me 1.3 herë më shumë.


Kallëzimet Penale
nr.
000/lekë
250
200
150
100
50
0
6000000
5000000
4000000
3000000
2000000
1000000
0
2008, 2009, 2010, 2011
2012, 2013
2014 dhe 6-mujori i parë 2015
Numri i Kallëzimeve Penale 52 48 67
Persona te Kallëzuar Penalisht 134 219 223
Dëmi i shkaktuar në Kallëzimet Penale 4162724 2532750 5402347


Kallëzimet Penale në vite
nr.
000/lekë
160
140
120
100
80
60
40
20
0
6000000
5000000
4000000
3000000
2000000
1000000
0
2008
2009
2010
2011
12
2013
2014
6 mujori 2015
Numri i Kallëzimeve Penale 32 9 5 6 40 38 41 26
Persona te Kallëzuar Penalisht 81 27 13 13 125 94 149 76
Dëmi i shkaktuar në Kallëzimet Penale 1793382 1912434 89251 367657 1366689 1166061 5069494 332853


Kallëzime Penale
80
60
40
20
0
2008, 2009, 2010, 2011
2012, 2013
2014 dhe 6-mujori i parë 2015
Kallëzime Penale 52 48 67

7. Auditimet e performancës

Gjatë vitit 2014 dhe gjysmës së parë të vitit 2015, veprimtaria audituese reflektoi vijimësinë e filozofisë menaxheriale, sipas së cilës auditimi i performancës do të vijojë të jetë një nga shtyllat e zhvillimit dhe modernizimit të KLSH-së.

Për këtë periudhë u hodhën hapa të rëndësishëm në raport me vitet paraardhëse, duke reflektuar një rritje të numrit të Auditimeve të Performancës. Në fokus të veprimtarisë audituese ka qenë adresimi nga institucioni i KLSH-se të çështjeve jetike dhe të rëndësishme për taksapaguesin, jo thjesht në aspektin mediatik, afatshkurtër apo për të kënaqur interesat e ngushta të grupeve të interesit, por në drejtim të rritjes së mirëqenies, përmirësimit të parametrave të shërbimeve publike dhe interesave të gjera të popullatës.

Për vitin 2014, auditimet e performancës janë:

- "Performanca e KESH sh.a.", në drejtim të liberalizimit të tregut të energjisë elektrike;
- "Performanca e shërbimit bibliotekar kombëtar", në drejtim të hapësirave fizike në dobi të lexuesit, librit dhe bibliotekës;
- "Siguria rrugore", e orientuar nga përdoruesi i rrugës si element kyç i kësaj sigurie;
- "Performanca e RTSH-së", me fokus projektin e digjitalizimit institucional;
- "Censusi 2011", për të vlerësuar nivelin e saktësisë së këtij projekti;
- "Menaxhimi i pajisjeve mjekësore spitalore në QSUT";
- "Shërbimi parashkollor", me fokus cilësinë e shërbimit në çerdhet dhe kopshtet e Tiranës;
- "Laboratori kimik doganor".

Këtyre tetë temave të auditimeve të performancës për vitin e kaluar u shtohen edhe 3 auditime të evaduara për këtë vit dhe tre të tjera që janë në mbyllje e sipër, duke dëshmuar për një rritje të ngadaltë, por të sigurtë të këtij sektori në KLSH.

8. Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të INTOSAI-t, KLSH synon të ruajë dhe të zhvillojë një fuqi audituese dinamike, duke përfshirë nxitjen dhe lehtësimin e stafit duke u krijuar mundësi për promovimin dhe për integrimin e stafit ekzistues

ashtu dhe atij të ri. Për këtë qëllim gjatë vitit 2014 dhe në gjysmën e parë të vitit 2015 janë zhvilluar 8 testime dhe janë miratuar 30 vendime për ngritje në kategori, krahasuar me vitin 2013, gjatë së cilit u zhvilluan 3 testime dhe janë realizuar 23 ndryshime në kategori, duke ju dhënë në këtë mënyrë mundësinë zhvillimit të karrierave profesionale brenda institucionit, nëpërmjet konkurrimit. Ndërkohë që numërohen 6 raste të uljes në kategori.

9. Kontrolli dhe sigurimi i cilësisë

Çdo vit ushtrimor, kërkojmë vlerësimin e kontrollit të cilësisë së punës audituese, nëpërmjet të cilit një numër i caktuar i dosjeve (për vitin 2014 janë shqyrtuar 20 % e tyre) shqyrtohen nga një grup ekspertësh të jashtëm dhe brenda institucionit, me qëllim identifikimin e dobësive dhe marrjen e masave për përmirësime të mëtejshme në cilësinë e auditimit. Kontrolli i sigurimit të cilësisë, bazuar në ISSAI 40, synon të garantojë një përmirësim të vazhdueshëm të punës audituese, që konfirmon faktin se institucioni në procesin audites zbaton standardet kombëtare dhe ato ndërkombëtare të auditimit. Pikërisht për këto arsye, sigurimi i cilësisë ka qenë dhe mbetet në vazhdimësi objektiv kryesor i veprimtarisë së KLSH. Risi e vitit 2015 ishte angazhimi i shqyrtimit të dosjeve tërësisht nga eksperte të jashtëm të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, me profesionalizëm dhe paanësi të plotë.

10. Transparenca dhe komunikimi

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka trajtuar gjatë 2014, 394 ***letra dhe ankesa,*** për probleme të ndryshme, nga të cilat 170 ***rezultuan jashtë kompetencave dhe juridiksionit të institucionit.*** Nga 224 kërkesa dhe ankesa në kompetencë të KLSH, 121 prej tyre janë verifikuar dhe u është dhënë përgjigja përkatëse, ndërsa 103 janë në procesin e verifikimit.

Gjatë 2014, shtypi i shkruar ka pasqyruar raportet dhe deklaratat tona për shtyp me një numër prej 867 artikuj, njoftime, editorialë dhe komente analitike, përkundrejt 690 gjithsej përgjatë 2013, ose 26% më shumë. Për gjashtë mujorin e parë të vitit 2015 shtypi i shkruar ka paraqitur punën dhe aktivitetet e KLSH-së me 285 materiale, duke informuar dhe sensibilizuar opinionin publik për rezultatet e auditimeve të ushtruara nga KLSH dhe aktivitetet e ndryshme lidhur me veprimtarinë e KLSH-së, si marrëveshjet me institucione homologe, brenda dhe

jashtë vendit, me shoqatat e profesionistëve të fushës së financave dhe të auditimit, organizatat e shoqërisë civile aktive në luftën kundër korrupsionit, etj. Institucioni ka rritur praninë e audituesve në median e shkruar, me qëllim rritjen e transparencës së punës audituese për publikun e gjerë. Gjatë vitit 2014, audituesit tanë kanë qenë të pranishëm pothuajse në të gjitha gazetat e vendit me qarkullim kombëtar me 134 shkrime, të shkruara nga 51 audites, përkundrejt 124 shkrimeve në vitin 2013 të 42 audituesve. Gjatë periudhës janar-qershor 2015, 38 audites të KLSH kanë kontribuar me 62 shkrime.

11. Aftësia për partneritet (me partnerë vendas dhe të huaj)

Kemi kërkuar bashkëpunim konkret me strukturat e auditimit të brendshëm në Ministrinë e Financave, në bazë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të 8 majit 2012, mes Ministrisë së Financave dhe KLSH, kemi thelluar bashkëpunimin me Autoritetin e Konkurrencës, me Institutin e Administratës Publike, si dhe me shoqatat e shoqërisë civile, me të cilat KLSH ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi ne vitet 2012-2013.

Institucioni ka vazhduar dhe thelluar bashkëpunimin me organizatat INTOSAI dhe EUROSAI, si dhe me SAI-t partnere si SAI i Polonisë, Turqisë, Kroacisë, Sllovenisë, ZAP-i i Kosovës, SAI i Austrisë dhe SAI-t e vendeve të tjera ballkanike, duke lidhur dhe marrëveshjeve të reja bashkëpunimi. Risi e vitit 2014 ka qenë nisja dhe thellimi i bashkëpunimit me ECA, Gjykatën Europiane të Audituesve ose SAI i Bashkimit Evropian. KLSH ka përfituar nga përvoja më e mirë e një prej institucioneve më prestigjioze të auditimit publik evropian dhe në botë. Për herë të parë, audites të KLSH-së janë pjesë përbërëse e strukturave të Gjykatës Evropiane të Audituesve, duke përfituar nga programet e internshipit të këtij institucioni të drejtën për të kontribuar pranë departamenteve dhe drejtorive të ndryshme të ECA-s.

12. Botimet dhe kërkimi shkencor

Në përputhje me Nenin 12 te ISSAI 1, Deklarata e Limës mbi të drejtën e SAI-t për t'i bërë publike gjetjet e tij, si dhe në përputhje me Parimin 4, pika 1 dhe 3 të ISSAI 12 "Vlerat dhe përfitimet e SAI-ve: të bësh diferencën në jetën e qytetarëve" mbi të drejtën e SAI-ve për të përdorur mjetet e duhura të komunikimit, institucioni ka

realizuar 14 botime të KLSH-së (kundrejt një fondi modest) për vitin 2014 dhe 6 botime për gjysmën e parë të vitit 2015. Botimet e vitit 2014 janë:

1. Analiza vjetore e punës 2013;
2. Performanca e KLSH-së 2013 (shqip/anglisht);
3. Revista "Auditimi Publik" nr. 6,7, 8 (shqip/anglisht);
4. Audituesit e KLSH në shtypin e përditshëm, janar-qershor 2014, volumi i II-të;
5. Konferenca e Tretë Shkencore e KLSH-së*, "Auditimi Kombëtar në Shërbim të Qeverisjes Kombëtare";*
6. 60 Vjet INTOSAI, 50 Vjet Sekretariat i Përgjithshëm;
7. Numri special i INTOSAI Journal për Kongresin e Pekinit;
8. Standardet INTOSAI mbi mjedisin (ISSAI 5110-5140);
9. Etika në SAI dhe në Institucionet e tjera Publike;
10. IntoSAINT;
11. ISSAI 5220 dhe Kodi i Transparencës Fiskale;
12. Auditimi mjet për një qeverisje më të mirë: rasti i Shqipërisë.

Botimet e gjysmës së parë të vitit 2015 janë:

1. Konferenca e III-të Shkencore (botimi në gjuhën angleze);
2. Revista "Auditimi publik" nr. 9 (shtator-dhjetor 2014);
3. Standardet e GAO-s;
4. Analiza vjetore, 2014;
5. Indikatorët e Performancës;
6. Manuali i Departamentit te Auditimit të Performancës.

Në vijim të traditës pozitive të krijuar nga KLSH gjatë tre viteve të fundit, në 29-30 tetor 2014 u organizua në Tiranë, Konferenca e Tretë Shkencore e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Kjo konferencë strukturoi, thelloi dhe konsolidoi më tej natyrën e saj kërkuese shkencore, hulumtuese e të dhënies së rekomandimeve, duke shtjelluar temën e saj qendrore: ***Auditimi kombëtar në shërbim të qeverisjes kombëtare***.

Përmirësimi i cilësisë së menaxhimit të financave publike, si një mjet për të optimizuar arritjen e objektivave kombëtarë të zhvillimit strategjik, u prezantua si sfida kryesore në shumë vende. Konferenca dha tezën se, duke përmirësuar proceset dhe institucionet buxhetore, cilësia e financave publike rritet, ndërkohë që eficienca, efektiviteti dhe transparenca përbëjnë sot tre objektivat themelorë të buxhetimit modern.

13. Përmirësimi i metodologjisë dhe Instrumenti i vetëvlerësimit IntoSAINT

Në kuadrin e përpjekjeve të bëra gjatë dekadave të fundit, në nivel global për zhvillimin e institucioneve, sistemeve dhe mekanizmave për promovimin e integritetit dhe parandalimin e korrupsionit në sektorin publik, KLSH ka adoptuar metodologjinë e vetëvlerësimit të integritetit në Institucionet Supreme të Auditimit (IntoSAINT), e konsideruar si një nga metodat inovative dhe të efektshme, me impakt rritjen e pritshmërive në zhvillimin e politikave të integritetit.

KLSH zhvilloi analizën vjetore nën frymën e vetëvlerësimit, e cila ofroi një pamje mjaft reale të performancës së arritur nga KLSH gjatë vitit 2014, duke pasqyruar krahas arritjeve dhe identifikimin e fushave vunerabël, vlerësimin e maturisë së kontrolleve dhe fokusin drejt së ardhmes.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) *aplikon qasjen* sipas se cilës përmirësimi i qeverisjes publike arrihet nëpërmjet rritjes së transparencës dhe përgjegjshmërisë, duke luftuar me efektshmëri korrupsionin, si brenda institucionit, ashtu dhe tek institucionet publike që KLSH auditon.

Lufta parandaluese, krijimi i mjedisit me integritet të lartë, është arma më e mirë për të goditur korrupsionin.

Zbatimi i IntoSAINT gjatë analizës vjetore 2014 të KLSH, u realizua në bashkëpunim me pedagogët dhe studentët e Universitetit Shtetëror “Ismail Qemali” të Vlorës (risia e dytë e procesit), si dhe të shumë ekspertëve, analistëve dhe profesorëve të njohur nga shoqëria civile e vendit(risia e tretë), që garantuan paanshmërinë dhe transparencën e plotë të analizës.

Konkluzionet dhe rekomandimet e rezultuara nga procesi i aplikimit të instrumentit IntoSAINT paraqiten si vijon:

Konkluzion i përgjithshëm

1. Në analizën e faktorëve që u realizua nëpërmjet IntoSAINT, si metodologji vetëvlerësimi dhe vetëdiagnostifikimi. Konkludohet se aplikimi i këtij instrumenti **rezulton tepër i dobishëm** në drejtim të matjes së nivelit të maturisë së kontrolleve të përgjithshme dhe të integritetit në veçanti qasje e cila thekson trajtimin e çështjeve jo thjesht **si pengesa** por më tepër si **mundësi** për të fokusuar zhvillimet drejt së ardhmes.

2. Rezultatet e arritura treguan **për një përmbushje të kënaqshme të objektivave**, por të analizuara nën frymën IntoSAINT, ato nxorën në pah vështirësi dhe fusha vunerabël, të cilat në raportin e vetëvlerësimit janë trajtuar me kujdes duke u analizuar nën dritën e perspektivës, duke u mbështetur fort në çfarë kemi bërë mirë, por nga ana tjetër reflektojnë rritjen e përpjekjeve se si mund ta çojmë dhe më përpara zhvillimin e këtij institucioni.

Politikat Menaxheriale Institucionale

3. KLSH si institucioni më i lartë auditues në vend, ka përgjegjësinë për të qenë transparent dhe profesional ndaj publikut të gjerë për të vlerësuar e më pas raportuar mbi shkallën e përgjegjshmërisë që qeveria dhe organet e saj kanë treguar në përdorimin e parave publike, proces ky që ka në thelb të çështjes integritetin. Në funksion sa më sipër nga aplikimi i qasjes IntoSAINT rezultoi se KLSH **ka hartuar, vendosur dhe zbaton politika** që i shërbejnë përmbushjes së detyrimeve të saj kushtetuese dhe të cilat i monitoron dhe i përditëson në vijimësi duke reflektuar në to praktikat më të mira të fushës.

4. Nga procesi i vetëvlerësimit rezultoi se **"cilësia e auditimit"** mbetet një element nga më të rëndësishmit në përmbushjen e këtyre përgjegjësive, ndaj zbatimi në pajtueshmëri të plotë të ISSAI 40 sipas të cilit "*SAI duhet të vendosë politika dhe procedura të projektuara për të nxitur një kulturë të brendshme e cila pranon se cilësia është esenciale për të gjithë punën e vet*", tregon angazhimin real të këtij institucioni në drejtim ***të politikave institucionale me fokus në cilësi***.

5. Rezultatet e aplikimit të IntoSAINT nxorën në pah stilin dhe filozofinë e menaxhimit "Tone at the Top" sipas të cilit ky Institucion në tre vitet e fundit është menaxhuar në mënyrë strategjike, ku vendimet janë marrë nën optikën e realizimit

dhe impakteve afatgjatë, duke vlerësuar dhe trajtuar me efektivitet risqet dhe trajtimin e tyre nën fokusin e mundësisë së zhvillimit për të ardhmen. Sa më sipër konkludohet se objektivat e vendosur në Strategjinë e Zhvillimit për periudhën 2013-2017, janë në interpretim në përputhje të plotë të Objektivave Strategjikë të INTOSAI-t të përshtatura këto me kushtet dhe fazën e zhvillimit të KLSH.

Frekuenca e aplikimit të Instrumentit IntoSAINT

6. Vetëvlerësimi i integritetit nëpërmjet aplikimit të instrumentit IntoSAINT **do të jetë i përhershëm** dhe do të aplikohet në mënyrë periodike (çdo fund viti), në nivel institucional dhe individual pasi vetëm duke u trajtuar në këtë mënyrë do të arrihen rezultate e pritshme dhe të kërkuara për mbajtjen e **një niveli të lartë integriteti** në institucionin e KLSH-së dhe krijimin e profilit të audituesit profesional dhe me integritet jo vetëm brenda institucionit por edhe ne optiken e palëve të treta – parlamentit, medias dhe publikut.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 961/3 Prot. Tiranë, më 13.03.2015

Z. Ilir META

KRYETAR I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

TIRANË

Lënda: *Dërgim raporti*

Në zbatim të kërkesave të nenit 164, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë" dhe nenit 31, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", bashkëlidhur ju dërgojmë raportin "Mbi veprimtarinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2014".

Bujar LESKAJ

KRYETAR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
K R Y E T A R I

Nr. 96/3 **Prot.** **Tiranë, më** 13.03 **2015**

Z. Erjon BRAÇE
KRYETAR I KOMISIONIT TË EKONOMISË DHE FINANCAVE NË KUVEND

TIRANË

Lënda: *Dërgohet: "Raport mbi veprimtarinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2014".*

Në zbatim të kërkesave të nenit 164, të "Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë", nenit 31, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", bashkëlidhur Ju dërgojmë raportin " Mbi *veprimtarinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2014*".

Sjellim në vëmendje se Ecuria e Planit të Veprimit të Zbatimit të Kërkesave të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 26 Qershor 2014, do Ju paraqitet disa ditë përpara raportimit në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

Bujar LESKAJ
KRYETAR

RAPORTI

MBI

VEPRIMTARINË E KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT

PËR VITIN 2014

1. VEPRIMTARIA AUDITUESE DHE DOBIA E REZULTATEVE

Viti 2014 mund të konsiderohet viti vazhdimësisë nëpërmjet konsolidimit të reformës institucionale në funksion të përmbushjes së objektivit kushtetues dhe ligjor të sigurimit të llogaridhënies publike. Gjithë veprimtaria audituese e KLSH-së reflekton më së miri dhe është produkt i ndryshimeve të thella rrënjësore në drejtim të implementimit të kërkesave të standardeve ndërkombëtare gjate ushtrimit të veprimtarinë audituese.

Për vitin 2014, Kontrolli i Lartë i Shtetit, ***nga 159 auditime të planifikuar për evadim, në fakt ka ushtruar dhe ka vijuar me përgatitjen e materialeve për 192 auditime***, (19 auditime janë të mbartura nga viti 2013) nga të cilat **160 auditime** janë të përfunduar e të evaduar, **4** janë të përfunduar si proces auditimi në subjekt, por të paevaduar, dhe **28** janë në proces auditimi.

Nga auditimet e ushtruara përgjatë vitit 2014 janë zbuluar:

A. Parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera**, me dëm efektiv të përgjithshëm në shumën totale prej 11 198 404 000 lekë.**

B. Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në perfomancën e subjekteve të audituara, në shumën e përgjithshme prej **13 293 014 000 lekë.**

Shpenzimet buxhetore për vitin 2014 të KLSH-së rezultojnë **295 240 mijë lekë.**

Indikatori i dobisë së rezultateve të auditimit, si një nga treguesit më domethënës të performancës së institucioneve supreme te auditimit, për vitin 2014 rezulton se për çdo një lek të shpenzuar për institucionin e KLSH-së **janë kërkuar për tu**

zhdëmtuar 38 lekë. Ky indikator në harkun kohor të 5 viteve 2010-2014 rezulton si me poshtë:

Grafiku nr. 1



Nga një analizë krahasuese konstatohet: për vitet 2010-2011, për një lek të shpenzuar nga buxheti i shtetit janë kërkuar për zhdëmtim **19 lekë** ndërsa për vitet 2012 dhe 2013, 2014 për çdo një lek të shpenzuar është kërkuar për zhdëmtim **mesatarisht 47.3 lekë ose rreth 28 lekë më shumë për çdo vit**.

2. GJETJET KRYESORE TË AUDITIMEVE

2.1 Auditimet në nivel institucional

Përgjatë vitit 2014 KLSH realizoi në fakt 160 auditime duke përmbushur në këtë mënyrë targetin e auditimeve të planifikuara në fillim viti madje edhe duke e tejkaluar atë.

Treguesi i realizimit në fakt të auditimeve në harkun kohor të shtatë viteve (2008-2014) rezulton:

Grafiku nr. 2



Nga analiza referuar llojit të auditimeve situata në dy vitet e fundit rezulton:

Tabela nr. 1

Nr	PËRSHKRIMI	2014	2013
1.	Auditime përputhshmërie	131	118
2.	Auditime financiare	12	21
3.	Auditime performance	8	6
4.	Auditim tematik	9	8

Sikurse konstatohet ka një rritje të ndjeshme të auditimeve të përputhshmërisë dhe të auditimeve të performancës përkatësisht 11% dhe 33%, në përmbushje të objektivit strategjik dhe vjetor që ka të bëjë me konsolidimin e auditimeve të përputhshmërisë dhe rritjen e auditimeve të performancës.

Drejtimet kryesore të veprimtarisë audituese të ushtruar nga KLSH për vitin 2014 janë:

- Zbatimi i dispozitave ligjore në fushën ekonomike, financiare, fiskale e kontabël, me synim identifikimin e gjendjes reale, të metat apo parregullsitë e mundshme në menaxhimin dhe përdorimin e fondeve publike, dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e menaxhimit të financave publike.

- Respektimi i dispozitave dhe i procedurave ligjore në kryerjen e veprimeve financiare, në fushën e të ardhurave dhe shpenzimeve, duke u fokusuar ne veçanti në auditimin e ligjshmërisë në prokurimin e fondeve publike, si dhe në auditimin e shpenzimeve kapitale me burim të brendshëm dhe të huaj financimi.

- Rregullshmëria dhe korrektësia e mbajtjes së dokumentacionit financiar dhe atij kontabël.

- Zbatimi i kërkesave të përcaktuara ligjore mbi paraqitjen e llogarive vjetore për raportimet buxhetore nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

- Funksionimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe organizimin e funksionimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik.

- Kryerja e auditimeve të performancës si një prioritet i veprimtarisë audituese të KLSH-së e orientuar drejt praktikave më të mira të fushës.

Rezultatet përfundimtare të auditimeve të kryera dhe masat e rekomanduara për përmirësimin e gjendjes për çdo subjekt të audituar, u janë dërguar të gjithë subjekteve të audituara dhe, në disa raste të veçanta edhe institucioneve të tyre drejtuese.

Gjykuar në rëndësinë apo peshën që kanë zënë gjetjet në kontekstin e përdorimit të fondeve buxhetore, raportet dhe masat e rekomanduara u janë dërguar edhe institucioneve më të larta drejtuese të shtetit. Me rezultatet e auditimeve dhe masat e rekomanduara është njohur edhe publiku i gjerë, nëpërmjet përdorimit të formave të ndryshme të komunikimit e të informimit.

Veprimtaria audituese e KLSH-së e strukturuar sipas institucioneve rezulton:

Tabela nr. 2

Nr.	Përshkrimi	2014
1	Ministritë dhe institucionet qendrore	41
2	Institucionet e administratës së qeverisjes vendore dhe njësi të tjera në nivel vendor	63
3	Drejtoritë dhe degët e tatim-taksave e të doganave	23
4	Institucionet financiare dhe shoqëritë me kapital të përbashkët shtetëror	18
	Njësitë dhe projektet me financime të huaja	9
5	Subjekte të mbrojtjes së mjedisit	6

Nga analiza e peshës specifike ndaj totalit të auditimeve të kryera përgjatë vitit 2014 rezulton se, auditimet në institucionet e administratës së qeverisjes vendore dhe njësi të tjera në nivel vendor zënë përqindjen më të lartë (39%); në ministritë dhe institucionet qendrore (26%); në drejtoritë e degët e tatim-taksave e të doganave (14%); në institucionet financiare dhe shoqëritë me kapital të përbashkët shtetëror (11%); në njësitë dhe projektet me financime të huaja (6%) dhe në subjektet të mbrojtjes së mjedisit (4%).

Grafiku nr. 3



2.1.1 *Gjetjet kryesore sipas fushave të veprimtarive të audituara*

Për parregullsitë dhe shkeljet financiare me dëm ekonomik në të ardhurat **në vlerën 3 355 769 mijë lekë** dhe **në shpenzimet 7842 635 mijë lekë** të pasqyruara në raportet e auditimit të evaduar gjatë 2014, ***KLSH ka rekomanduar zhdëmtimin e dëmit të shkaktuar në masën 98.9% të tij.***

Për të metat dhe shkeljet e konstatuara për çdo subjekt të audituar, në bazë të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, KLSH ka lënë detyra për zbatim, duke njoftuar edhe institucionet apo strukturat përkatëse, si dhe ka bërë publike rezultatet e auditimeve në median e shkruar dhe atë elektronike.

Struktura e dëmit ekonomik sipas fushave ku është konstatuar për vitet 2013 dhe 2014 rezulton:

000/lekë ***Tabela nr. 3***

Nr.	Struktura	2013	%	2014	%
1	Nga tatim taksat	125 820	1	278 789	2.6
2	Nga shitja e pasurisë dhe dhënia e objekteve me qira dhe me koncesion të pronës shtetërore	11 992 177	79	2 135 450	19
3	Nga doganat	377 141	2	941 530	8.5
4	Në fushën e pagave	59 775	0	75 621	1.1
5	Në fushën e shpërblimeve	9 868	0	12 080	0
6	Në shpenzimet operative	57 208	0	185 933	1.6
7	Në prokurimet publike	354 099	2	678 118	6
8	Në urbanistikë	129 545	1	38 432	0
9	Mungesa materiale ose monetare	10 227	0	132 209	1.2
10	Të tjera nga e cila: Dëmi në Albpetrol sh.a.	1 973 965 **1 740 255**	13	6 720 242 **5 186 275**	60
	SHUMA	**15 089 825**	**100**	**11 198 404**	**100**

Sjellim në vëmendje se vlera prej 11 992 177 mijë lekë të dëmit ekonomik të zbuluar në vitin 2013, përfaqëson dëmin e shkaktuar buxhetit të shtetit nga mosarkëtimi i garancisë bankare "Vetro Energy PTE lid" së privatizimit të shoqërisë Albpetrol sh. a. Fier.

Grafiku nr. 4



Grafiku nr. 5



Dinamika e indikatorit të dëmeve të zbuluara për periudhën shtatëvjeçare 2008-2014 rezulton:

Grafiku nr. 6



Nga një analizë krahasimore të periudhave katërvjeçare 2008-2011 me periudhën trevjeçare 2012-2014 konstatohet se dëmi ekonomik i zbuluar për periudhën tre vjeçare 2012-2014 është rreth dy herë më i madh se vlera e dëmit të zbuluar për periudhën e katër viteve së bashku 2008, 2009, 2010, 2011.

Grafiku nr. 7



Situata e dëmeve ekonomikë të rekomanduara për zhdëmtim dhe zbatimi i tyre në nivel vjetor për periudhën 2008-2014 rezulton:

Grafiku nr. 8



Nga analiza e këtyre treguesve të grupuar në vite rezulton që për periudhën katërvjeçare 2008-2011 krahasuar me periudhën 2012-2013-2014 rezulton se dëmi ekonomik i rekomanduar për zhdëmtim dhe treguesi i zbatimit të tij për periudhën tre vjeçare 2012-2014 është sa dyfishi i periudhës katërvjeçare 2008-2011.

Grafikisht paraqitet si më poshtë vijon:

Grafiku nr. 9



Në totalin e **dëmit ekonomik të zbuluar nga auditimi i kryer në Ministritë dhe institucionet në nivel qendror** i cili rezulton në vlerën rreth **3 043 milionë lekë** rreth 70 % ose 2 088 milionë lekë përfaqëson dëmin e evidentuar nga shkeljet e ligjshmërisë nga shitja e pasurisë dhe dhënia e objekteve me qira dhe me koncesion të pronës shtetërore.

30 % e dëmit është zbuluar në shkeljet e ligjshmërisë për pagat dhe shpërblimet, në shpenzimet operative, në prokurime etj.

Përsa i përket dëmit ekonomik të rezultuar në **fushën e doganave/tatim taksave** konstatohet një vlerë dëmi ekonomik në rreth 1 miliardë lekë nga të cilat rreth 91 % përfaqëson dëmin e konstatuar në organet doganore, pasi në organet tatimore KLSH është penguar për kryerjen e auditimeve. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore në vartësi të saj, në vijimësi dhe në interpretim të gabuar të dispozitave ligjore në fuqi kanë ndërhyrë në të drejtat dhe kompetencat që i takojnë ekskluzivisht KLSH-së si Institucion Suprem i Auditimit në vend nëpërmjet mos vënies në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar prej tij.

Mungesa e të ardhurave të konstatuara në fushën e doganave është në shumën 941 530 mijë lekë (të natyrës keqklasifikim të mallrave doganore dhe pranim të vlerës së transaksionit të pa bazuar në kuadrin rregullator), përkatësisht në Degët e Doganave: Durrës, Vlorë, Fier, Tiranë, Kapshticë, Kakavijë, Berat, Bllatë, Qaf-Botë, Morinë-Kukës, Sarandë, Rinas, Tre-Urat Përmet dhe Elbasan. Mungesa e të ardhurave të konstatuara në fushën e tatim taksave është ne shumën prej 81 767 mijë lekë (mosllogaritje ose llogaritur më pak detyrime tatimore për subjektet tatimpaguese si dhe mosarkëtim i tyre), konstatuar në Drejtoritë e Tatim-Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkive: Fier, Korçë, Tiranë, Shkodër, Elbasan, Lezhë dhe Vlorë.

Në totalin e dëmit të zbuluar në fushën e **Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit prej 5 702 194 mijë lekë 93% përfaqëson dëmin e zbuluar nga auditimi i kryer në AlbPetrol sh.a.**

Ky dëm për nga natyra përfaqëson prodhimin e padorëzuar Albpetrolit sh.a. nga kompanitë koncensionare, që përfshin pjesën e prodhimit paraekzistues dhe pjesën e Albpetrolit (PPE&PPA) konform marrëveshjes hidrokarbure, dëm financiar nga dy marrëveshje të lidhura me një nga këto kompani, si edhe penalitete e kamatvonesa të pavjela ndaj tyre.

Dëmi i shkaktuar si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të deritanishme të Administratorit të shoqërisë Albpetrol sh.a. (manipulimi me çmimet, me cilësinë e naftës, etj.) është shumë herë më i madh sesa ai i konstatuar nga KLSH.

KLSH ka rekomanduar kryerjen e një hetimi të plotë nga Prokuroria, dhe ngritjen e një grupi të përbashkët auditimi ndërmjet Ministrisë dhe AKBN, për të audituar jo vetëm gjithë aktivitetin e shoqërisë por edhe kompanitë koncensionare (pa cënuar në asnjë rast në rrugë joligjore të drejtat e këtyre kompanive). Konkluzionet e këtij auditimi do të çojnë në paraqitjen e realitetit dhe përmasat e vërteta të këtij dëmi të madh, jo vetëm ekonomik.

Nga auditimet e kryera në fushën e **Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme** vlera e dëmit ekonomik rezulton në shumën rreth **1 399 4 milionë lekë** nga e cila rreth 50% e vlerës totale përfaqëson vlerën e evidentuar në 3 Drejtori Rajonale ALUIZN-it e kategorizuar si mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit. Pjesa tjetër e dëmit të evidentuar përfaqëson dëmin ekonomik të zbuluar në institucionet në nivel vendor për shkelje të ligjshmërisë në fushën e pagave e shpërblimeve, shpenzimeve operative, në prokurime etj.

2.1.2 *Zbatimi i Rekomandimeve*

Një nga treguesit kryesorë të performancës së auditimit është niveli i zbatimit të rekomandimeve. Në referencë të standardeve ndërkombëtare të auditimit ndjekja e zbatimit të rekomandimeve është një nga objektivat kryesore të veprimtarisë së institucioneve supreme të auditimit. Në punën tonë audituese kemi synuar që rekomandimet të kenë një ndikim të ndjeshëm në përmirësimin e gjendjes së subjekteve të audituara në funksion të miradministrimit të fondeve në dispozicion por dhe të një qeverisje sa më të mirë.

Në tabelë janë dhënë të gjitha rekomandimet e bëra në auditimet e realizuara gjatë vitit 2014 krahasuar me 2013 sipas llojit të tyre dhe më pas jepen të dhënat duke bërë edhe një krahasim me rekomandimet e viteve të mëparshme për të parë edhe trendin e tyre në nivelin e zbatueshmërisë sipas viteve dhe sipas llojit të këtyre rekomandimeve.

Tabela nr. 4

Nr.	Lloji i masës	2013	2014
1	Propozime për ndryshim legjislacioni	82	88
2	Masa Organizative	2 003	2 603
3	Masa Administrative	236	302
4	Masa Disiplinore	925	1 135
	TOTALI (1 deri 4)	3246	4 128
6	Masa zhdëmtimi 000/lekë	15 077 225	11 085 084
7	Kallëzime Penale		
7.a	-Kallëzime Penale - numër	38	41
7.b	-Kallëzime Penale - persona	94	149
7.c	-Kallëzime Penale 000/lekë	1 166 061	506 9 49

Analiza e të dhënave tregon se në vitin 2014 indikatori i propozimit të rekomandimeve është me i madh në të gjitha llojet e tyre duke reflektuar në total 882 rekomandime me shumë se viti 2013. Gjatë vitit 2014 kemi rezultuar me një numër me të madh rekomandimesh për propozimet e ndryshimit të legjislacionit, 88 propozime.

Rritje e ndjeshme rezulton në dhënien e masave organizative rreth 600 me shumë në nivel vjetor duke reflektuar në këtë mënyrë kontributin e KLSH-së në përmirësimin e sistemeve të menaxhimit në njësite publike.

Këtë vit kemi propozuar rreth 1135 masa disiplinore ose rreth 23 % më shumë se viti i kaluar. Impakti i dhënies së masave disiplinore pa dyshim do të rrisë nivelin e përgjegjshmërisë menaxheriale të nëpunësve në sektorin publik.

Kallëzimet penale nuk është se janë qëllim në vetvete për aktivitetin tonë megjithëse është një tregues i rëndësishëm i luftës ndaj korrupsionit dhe shfaqjeve që rrezikojnë standardet e qeverisjes së vendit.

Përsa i përket indikatorit të performancës në lidhje me zbatimin e rekomandimeve për vitin 2014 rezulton një trend në rritje për të gjitha kategoritë e rekomandimeve.

Tabela nr. 5

Nr.	Lloji i masës	2013	2014	Ndryshim (+)/(-)
1	Propozime për ndryshim legjislacioni	16	37	+21
2	Masa Organizative	977	1 748	+771
3	Masa Administrative	153	211	+58
4	Masa Disiplinore	652	918	+266
	TOTALI (1 deri 4)	1798	2 914	+1116
5	Masa zhdëmtimi 000/lekë	2 534 983	3 892 791	+1 357 808

Në mënyrë grafike trendi i masave të rekomanduara rezulton në rritje për të gjitha kategoritë e tyre kundrejt dy periudhave krahasimore 2008-2011 dhe 2012-2014 dhe konkretisht:

Grafiku nr. 10



2.1.3 *Propozime për ndryshime apo përmirësim të legjislacionit*

KLSH si nxitës i ndryshimit kontribuon në mënyrë domethënëse në drejtim të përmirësimeve që mund të bëhen në kuadrin ligjor, duke identifikuar rastet kur dobësitë dhe shmangiet janë shkaktuar si rezultat i paqartësive apo kompleksitetit të ligjeve. Duke e konsideruar Institucionin e KLSH-së si një institucion reformues të kuadrit rregullator ligjor në fokus të veprimtarisë tonë audituese ka qenë dhënia e rekomandimeve për përmirësim legjislacioni. Gjatë vitit 2014 janë rekomanduar

gjithsej 88 propozime për ndryshim legjislacioni dhe analizuar në një dinamikë në vite konstatohet një trend rritës i propozimit të rekomandimeve si dhe statusit te zbatimit te tyre. Nga analiza krahasimore rezulton se numri i rekomandimeve të dhëna përgjatë periudhës tre vjeçare 2012-2014 është rreth 15 % më i madh se numri i rekomandimeve të dhëna gjatë periudhës katërvjeçare 2008-2011.

Grafiku nr. 11



Dinamika e treguesit të propozimeve të rekomandimeve të propozuara dhe të zbatuara për ndryshim legjislacioni në nivel vjetor për periudhën 2008-2014 paraqitet:

Grafiku nr. 12



Spektri i propozimeve të rekomanduara nga KLSH është mjaft i gjerë përfshirë **amendime kushtetuese,** ndryshime të ligjeve bazë si dhe ndryshime të Vendimeve të Këshillit të Ministrave apo dhe akte të tjera rregullative. Përmendim:

1. Në drejtim të mirëmenaxhimit të financave publike. Në kuadrin e përmbushjes së detyrimit kushtetues për paraqitjen në Kuvend të Raportit **"Mbi ekzekutimin e buxhetit të shtetit të vitit të kaluar financiar"** në konvergjencë të plotë me objektivat e strategjisë së zgjerimit të BE-së dhe në një linjë me prioritetet e reformave i ka **prezantuar Kuvendit një set rekomandimesh** të cilat synojnë marrjen e masave për sigurimin e qëndrueshmërisë, kredibilitetit të financave publike dhe konsolidimin e një kuadri, rregulli fiskal.

Përgjatë vitit 2014 sikurse edhe gjatë vitit 2012-2013, KLSH ka sjellë në vëmendje të Kuvendit faktin se situatat buxhetore janë karakterizuar nga projeksione mjaft optimiste, gjë e cila ka sjellë krijimin e një hendeku të thellë midis targeteve të planifikuara me ato të realizuara dhe që në mënyrë të pashmangshme ka çuar në rishikimin e treguesve buxhetore gjatë ekzekutimit të buxhetit.

Krahas sa më sipër:

- Referuar zhvillimeve ekonomike ndaj nivelit të borxhit publik dhe risqeve që ai mbart në situatën e brishtë makroekonomike të vendit;
- Referuar faktit që ndryshimi i kuadrit rregullator të limitimit të borxhit publik ndaj PBB-së, legjitimon mungesën e një tavani për borxhin publik dhe riskun e rritjes së tij;
- Duke shqyrtuar trajektoren e borxhit publik ndaj PBB-së, ku në harkun kohor të dy viteve të fundit borxhi publik u rrit në 4.9% të PBB-së dhe në terma nominale, në 112 miliardë lekë duke arritur në fund të vitit 2013 një stok prej 884.7 miliardë lekë ose 65.15 % të PBB-së, si dhe në vijim të rekomandimeve të dhëna nga KLSH **si në vitin 2012 dhe 2013**, **KLSH në Tetor 2014 i prezantoi kuvendit rekomandimin për** ndërmarrjen e të gjitha masave për hartimin e një kuadri, rregulli fiskal, i cili të synojë në **reduktimin e nivelit të borxhit publik** në një periudhë të përcaktuar kohore dhe sigurimin e një qëndrueshmërie afatgjatë të borxhit publik;

KLSH ka rekomanduar:

- Përgatitjen dhe paraqitjen e një iniciative ligjore **për vendosjen në Kushtetutë** dhe në Ligjin "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"

të indikatorit të borxhit publik ndaj PBB-së, në nivelin 60 % dhe arritjen e këtij niveli në terma afatgjatë.

- Po kështu KLSH në funksion të promovimit të një qëndrueshmërie dhe kredibiliteti të financave publike; në funksion të përmirësimit të planifikimit të performancës fiskale, të projeksioneve makroekonomike dhe parashikimeve buxhetore; **ka rekomanduar ndërmarrjen e iniciativës ligjore për ngritjen e një Këshilli Fiskal** i cili duhet të gëzojë statusin e një institucioni publik të pavarur, dhe që duhet të ketë një pavarësi operacionale shumë strikte e rigoroze nga politika.

Ky rekomandim ishte në konvergjencë të plotë me orientimet e Bashkimit Europian dhe të Fondit Monetar Ndërkombëtar për ngritjen dhe funksionimin e Këshillave Fiskale si institucione publike të pavarura por jo vetëm; rekomandimi është në një linjë me praktikat e ndjekura nga shumë vende vitet e fundit të cilët kanë ngritur agjencitë e pavarura me synim promovimin e politikave fiskale.

2. Në drejtim të domosdoshmërisë së fuqizimit të ligjit "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i cili rezulton me një rezistencë të ulët, pra është lehtësisht i thyeshëm nga pikëpamja e vendimmarrjes parlamentare, si dhe referuar faktit që ky ligj është në fazën e ndryshimit dhe rishikimit të tij nga Ministria e Financave, në vijim të rekomandimit të paraqitur nga KLSH gjatë vitit 2013, **kemi rekomanduar që:**

Shqyrtimi i ndryshimeve të parashikuara në Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020 të ligjit "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe miratimi i tij në Kuvend të bëhet me një shumicë të cilësuar parlamentare.

3. Në drejtim të përcaktimit në Ligjin Organik të Buxhetit të përdorimit të të ardhurave nga privatizimi për uljen e borxhit publik e investimeve kapitale dhe dëmshpërblimin e ish të përndjekurve politikë, KLSH ka konstatuar se pavarësisht tendencës në rritje të buxhetimit të të përndjekurve politikë, nevojat dhe detyrimet ligjore për këtë shtresë sociale janë më të larta se financimi faktik në vite. Sa më sipër, në vijim edhe të rekomandimit të dhënë gjatë vitit 2013 në kuadrin e rishikimit të Ligjit Organik të Buxhetit, **KLSH i rekomandoi Kuvendit:**

Në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të përcaktohet që të ardhurat nga privatizimet duhet të përdoren së pari dhe kryesisht për të ulur borxhin publik, ku 50% të jetë kufiri i

poshtëm, dhe pjesa tjetër prej 30 % të përdoret për financimin e investimeve kapitale si dhe 20% për dëmshperblimin ligjor të ish të përndjekurve politikë.

4. Risi në rekomandimet e adresuara Kuvendit gjatë vitit 2014 ishte dhe rekomandimi mbi domosdoshmërinë e hartimit të ligjit "Për përgjegjësinë materiale" sipas të cilit: Ministria e Financave të ndërmarrë të gjitha masat për ngritjen e një grupi pune për hartimin e Ligjit "Mbi përgjegjësinë materiale" në të cilin të trajtohet përgjegjësia financiare e punonjësve të njësive publike (zyrtarët e lartë dhe punonjësit e të gjithë niveleve) për dëmet ekonomike të shkaktuara qëllimisht apo nga neglizhenca, gjatë ose në lidhje me procesin e ekzekutimit të detyrave zyrtare.

5. Në drejtim të përcaktimit ligjor të mos lejimit të Këshillit të Ministrave për të dhënë garanci shteterore mbi stokun e përcaktuar me ligj, kemi rekomanduar:

Në ligjet e vjetore të buxhetit të mos vendosen klauzola përcaktuese të cilat i adresojnë Këshillit të Ministrave të drejtën për rritjen e stokut të borxhit përtej limiteve të përcaktuara me ligj.

6. Vlerësimi i veprimtarisë së **strukturave të auditimit të brendshëm në sektorin publik** është një prej objektivave kryesore të veprimtarisë së KLSH në atributet e institucionit që kryen auditimin e jashtëm ne sektorin publik.

Në funksion të përmbushjes së këtij detyrimi ligjor KLSH përgjatë vitit 2014 është fokusuar në dhënien e një sërë rekomandimeve të cilat synonin në përmirësimin e kuadrit rregullator ligjor **me impakt konsolidimin dhe modernizimin** e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, dhe auditimit të brendshëm në sektorin publik**.**

2.1.4 *Ndryshime organizative*

Rekomandimet për ndryshime organizative marrin rëndësi të veçantë për vetë karakterin parandalues që ato kanë. Masat e propozuara për ndryshime organizative në subjektet e audituara synojnë jo vetëm korrigjimin e rasteve të mosfunksionimit eficient të rregullave e kontrolleve por për më tepër kanë si qëllim zhvillimin dhe përmirësimin në të ardhmen. Nga 2014-ta KLSH rezulton të ketë propozuar 2 603 rekomandime të cilat synojnë përmirësimin e sistemeve organizative të subjekteve të audituara. Nga 2 603 masa të rekomanduara gjithsej janë zbatuar plotësisht 1 748 prej tyre, pjesërisht 37, dhe janë në proces zbatimi 330 masa. Përsa i përket masave të rekomanduara për periudhën 2012-2014, KLSH ka rekomanduar rreth 22 % masa më shumë se periudha katër vjeçare 2008-2011.

Grafiku nr. 13



Më poshtë paraqesim tendencën në vite të masave organizative dhe statusin e zbatimit të tyre.

Grafiku nr. 14



2.1.5 *Masat administrative dhe disiplinore*

Rekomandimet për masa me karakter parandalues nuk zbehin domosdoshmërinë e ndëshkimit. Nëpërmjet masave disiplinore dhe administrative është synuar të jepen rekomandimet e përshtatshme për të luftuar shkakun e shkeljeve dhe devijimeve nga kuadri ligjor e administrativ publik. Për të metat dhe shkeljet e konstatuara për çdo subjekt të audituar, në bazë të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, KLSH-ja ka lënë detyra për zbatim, duke njoftuar edhe institucionet apo nomenklaturat përkatëse.

Për shkeljet e konstatuara KLSH u ka kërkuar organeve respektive shqyrtimin dhe marrjen e 1,437 *masave disiplinore dhe administrative,* lloji dhe zbatimi i të cilave, sipas njoftimeve zyrtare me shkrim nga organet përkatëse dhe rikontrollit të zbatimit të rekomandimeve në subjektet e audituara, paraqitet si vijon:

Tabela nr.6

Nr.	Lloji i masës	Propozuar Gjithsej	Gjendja aktuale e zbatimit		
			Të zbatuara	Pa përgjigje	% realizimit
1	"Vërejtje me shkrim"	380	305	75	80.2
2	"Vërejtje me paralajmërim"	423	415	8	98.1
3	"Pezullim ngritje në detyrë"	23	4	19	17.4
4	"Kalim në një nivel më të ulët"	29	11	18	37.9
5	"Largim nga shërbimi civil"	12	7	5	58.3
6	"Largim nga detyra"	13	3	10	23
7	"Largim nga puna"	118	67	51	56.8
8	Në kompetencë të Institucionit	137	106	33	76.2
9	Masa administrative (gjoba)	170	127	41	75.6
10	Në kompetencë të APP-së	132	84	48	63.6
Shuma		**1 437**	**1 129**	**308**	**78.56**

Në grafikun më poshtë, ilustrohen përqindjet e realizimit të masave disiplinore sipas llojit të masave ku vihet re që realizim më të lartë kanë masat "Vërejtje me paralajmërim" dhe "Vërejtje me shkrim".

Grafiku nr. 14



Nga analiza sipas llojit te masave te rekomanduara konstatohen rritje të numrit të vërejtjeve të dhëna për gjetjet dhe konstatimet jo shumë të ndjeshme (me 177 masa) ndërsa për largimet nga detyra/puna niveli është i njëjte me rekomandimet e të vitit 2013. Konstatohet një rritje me e madhe e kategorisë së masës së pezullimit të ngritjes në detyrë mase e cila frenon stimulimin në karrierë të nëpunësve publikë të cilët rezultojnë me shkelje gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre ne administratën publike.

Struktura e masave disiplinore dhe administrative për vitin 2014 paraqitet si më poshtë:

Grafiku nr. 15



Sikurse konstatohet edhe nga grafiku masat disiplinore të rekomanduara për periudhën 2012-2014 rezultojnë 26% më shumë se ato të rekomanduara gjatë periudhës 2008-2011. Për sa i përket zbatimit të tyre ky tregues rezulton 22% më shumë referuar periudhave krahasimore.

Niveli i zbatimit te masave disiplinore dhe administrative në total rezulton rreth 78.6% nivel ky i kënaqshëm dhe i pranueshëm referuar dhe standardeve ndërkombëtare.

Por nëse do të kryenim një analizë analitike sipas kategorive të masave disiplinore rezulton një nivel tejet i ulët për zbatimin e masave disiplinore “largim nga detyra” 23 % dhe moszbatim i masave të pezullim të ngritjes në detyre 17%.

Si institucion do të kërkojmë në vijimësi dhe në rrugë ligjore, zbatimin maksimalisht të rekomandimeve tona, veçanërisht zbatimin e këtyre rekomandimeve ndaj

drejtuesve të mesëm apo të lartë të paaftë apo të korruptuar të njësive publike të audituara, duke kontribuar në formimin e forcimin e kulturës së ndëshkueshmërisë në administratën publike.

Kontributi i KLSH-së për forcimin e kulturës së ndëshkueshmërisë të atyre që janë në poste të larta dhe shkelin ligjin (Urdhri nr. 70, datë 18.04.2006).

Lufta kundër korrupsionit, në të cilën KLSH dhe institucionet e tjera shtetërore duhet të angazhohen, si dhe pritshmëritë e opinionit të gjerë publik në lidhje me punën tonë në këtë drejtim, parashtrojnë kërkesën e kryerjes së kësaj lufte në vazhdimësi, pa kompromis dhe ndaj çdo institucioni apo nëpunësi të infektuar prej virusit të korrupsionit.

Kjo kërkesë e domosdoshme për arritjen e një standardi të pranueshëm mirëqeverisjeje, imponon nevojën e pasjes së një vullneti të fortë dhe konstant institucional në mostolerimin e asnjë rasti korrupsioni pavarësisht nivelit ku ai shfaqet apo shkallës së shtrirjes së tij.

Këtë vullnet dhe kontribut institucional, në forcimin e kulturës së ndëshkueshmërisë, sidomos ndaj zyrtarëve të lartë të administratës shtetërore, shkelës flagrant të ligjit dhe mosbesues ndaj ekzistencës së forcës ndëshkuese të shtetit, Kontrolli i Lartë i Shtetit e ka treguar në mënyrë konstante gjatë këtyre tre viteve të fundit ku në numrin e konsiderueshëm të rekomandimeve tona për dhënien e masave disiplinore, largimit nda detyra si dhe bërjes së kallëzimeve penale janë përfshirë nëpunës të nivelit të lartë drejtues të administratës shtetërore.

Nisur nga shkalla e zbatueshmërisë së Urdhrit të Kryeministrit Berisha nr. 70, datë 18.04.2006 “Për masat në zbatim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, auditit të brendshëm dhe Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsionit në Këshillin e Ministrave, në institucionet në varësi të Kryeministrit a të Ministrave” dhe e rezultateve që ai ka mundur të prodhojë deri më sot në praktikë, kërkohet që për vetë kushtet aktuale të administratës shtetërore si dhe nivelit të korrupsionit të perceptuar dhe konstatuar gjerësisht, ky urdhër nga qeveria e tanishme të pranohet ose të përmirësohet e ripërtërihet në kuadër të ridimensionimit dhe rikonceptimit të luftës ndërinstitucionale kundër korrupsionit.

Si rrjedhojë, KLSH i qëndron ende propozimit të një **ripërtëritje të këtij urdhri nga ana e Këshillit të Ministrave** apo rikonceptimit të tij në formë më të plotë, i cili do

të vlerësohej jo vetëm si një hap i mëtejshëm dhe cilësor në luftën kundër korrupsionit por do të shërbente si një instrument mjaft konstruktiv për optimizmin e rezultateve të veprimtarisë audituese të KLSH-së.

2.1.6 *Kallëzimet për ndjekje penale*

Të angazhuar plotësisht dhe duke e konsideruar veten pjesë aktive në luftën kundër korrupsionit, KLSH ka treguar korrektësi në dërgimin e rasteve të korrupsionit, vjedhjes dhe mashtrimit për hetime të mëtejshme në Prokurori. Rastet e dërguara për ndjekje penale paraqiten në tabela dhe grafikë që tregojnë numrin si dhe subjektet të cilët janë dërguar për ndjekje penale.

Për sa i përket kallëzimeve penale të përgatitura gjatë këtij viti por edhe vlerësimit tonë në lidhje me dosjet e auditimit, kemi evidentuar në përgjithësi një rritje graduale të cilësisë së materialeve të auditimit.

Në total numri i kallëzimeve për vitin 2014 ka qenë 41 kallëzime për 149 persona të akuzuar dhe të detajuara sipas departamenteve të auditimit paraqiten:

Tabela nr. 7

Departamenti i Auditimit	**Nr. i kallëzimeve**	**Nr. personave të kallëzuar**
Ministritë/Institucionet qendrore e ALP	14	47
Niveli Vendor	16	62
Projektet	9	29
Dogana/Tatime	2	10
Total	**41**	**149**

Të klasifikuara sipas nivelit menaxherial kallëzimet penale përgjatë vitit 2014 janë kryer për 3 Drejtorë të Përgjithshëm, 22 Drejtorë Drejtorie, 2 Kancelarë Universiteti, 3 Kryetarë Komunash, 1 zv/Kryetar *Bashkie*, dhe 1 Kryetar i Këshillit Bashkiak, trend ky i njëjtë edhe me kallëzimet e kryera në tre vitet e kaluara.

Në total, dëmi ekonomik që i është shkaktuar buxhetit si pasojë e shkeljeve të trajtuara në këto kallëzime arrin në 5 069 494 000 lekë.

Nga një analizë në vite numri i kallëzimeve penale të denoncuara në organin e prokurorisë gjatë harkut kohor të tre viteve 2012-2014 është rreth 2.2 herë më

shumë se kallëzimet penale të kryera në katër vitet së bashku 2008-2011, ndërsa numri i personave të kallëzuar penalisht rezulton rreth 2.7 here më i lartë sikurse paraqitet ne grafikun e mëposhtëm:

Grafiku nr. 16



Grafiku nr. 17



Gjatë kësaj periudhe, nga ana e KLSH-së janë bërë ***41 kallëzime penale***, për drejtues të rangut të mesëm dhe të lartë në:

- Universitetin Bujqësor, Tiranë (dy kallëzime penale);
- KESH sh.a., Tiranë (dy kallëzime penale);
- Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë (dy kallëzime penale);

- Institutin e Shëndetit Publik, Tiranë;
- Institutin e Sigurimeve Shoqërore, Tiranë (dy kallëzime penale);
- Autoritetin Rrugor Shqiptar (dy kallëzime penale);
- Autoritetin Portual, Durrës (dy kallëzime penale);
- Agjencinë Kombëtare e Burimeve Natyrore, Tiranë (dy kallëzime penale);
- Projektin "Ndërtimi i aksit rrugor Tiranë-Elbasan";
- Portin Detar, Sarandë;
- Albpetrol sh.a., Fier;
- Drejtorinë e Arkivit Shtetëror Vendor, Vlorë;
- Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Tiranë;
- Ujësjellës-Kanalizime, Durrës;
- Degën e Doganës, Durrës;
- Degën e Doganës, Kakavijë;
- Drejtorinë Rajonale ALUIZNI-t, Tiranë;
- Drejtorinë Rajonale ALUIZNI-t, Tirana 1;
- Drejtorinë Rajonale ALUIZNI-t, Elbasan 1;
- Drejtorinë Rajonale ALUIZNI-t, Durrës;
- Drejtorinë Rajonale ALUIZNI-t, Berat;
- Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, Tiranë;
- Bashkinë Vlorë;
- Bashkinë Ura-Vajgurore;
- Komunën Qendër, Mallakastër;
- Komunën Remas, Lushnjë;
- Komunën Udenisht, Pogradec;
- Komunën Shënkoll, Lezhë;

- Komunën Kodër Thumanë, Krujë;
- Komunën Golem, Kavajë;
- ZVRPP, Tiranë;
- ZVRPP, Kavajë;
- ZVRPP Durrës;
- Komunën Voskopojë;

Të 41 kallëzimet penale janë në hetim nga degët e prokurorive në rrethe, (një rast në prokurorinë e krimeve të rënda) dhe janë pasqyruar në mënyrë më të detajuar në aneksin bashkëlidhur këtij Raporti.

2.2 Auditimet e Performancës

Gjatë vitit 2014 veprimtaria audituese reflektoi vijimësinë e filozofisë menaxheriale, sipas së cilës auditimi i performancës do të vijojë të jetë një nga shtyllat e zhvillimit dhe modernizimit të KLSH-së.

Këtë vit janë hedhur hapa të rëndësishëm në raport me vitet paraardhëse, duke reflektuar një rritje të numrit të të Auditimeve të Performancës prej 2 auditimesh.

Grafikisht veprimtaria e KLSH-së në kryerjen e autimeve të performancës në vite paraqitet:

Grafiku nr. 18



Gjatë periudhës Janar–Dhjetor 2014, KLSH ka realizuar dhe evaduar 8 auditime performance, si edhe ka iniciuar 4 auditime të reja.

Për 2014 në fokus të veprimtarisë audituese ka qenë adresimi nga institucioni i KLSH-se të çështjeve jetike dhe të rëndësishme për taksapaguesin, jo thjesht në aspektin mediatik, afatshkurtër apo për të kënaqur interesat e ngushta të grupeve të interesit, por në drejtim të rritjes së mirëqenies, përmirësimit të parametrave të shërbimeve publike dhe interesave të gjera të popullatës.

Në këtë prizëm, auditimet e evaduara për 2014 janë kryer në fushat si më poshtë:

- "Performancën e KESH sh.a." në drejtim të liberalizimit të tregut të energjisë elektrike;
- "Performancën e shërbimit bibliotekar kombëtar", në drejtim të hapësirave fizike në dobi të lexuesit, librit dhe bibliotekës;
- "Sigurinë rrugore", të orientuar nga përdoruesi i rrugës si element kyç i kësaj sigurie;
- "Performancën e RTSH-së" me fokus projektin e digjitalizimit institucional;
- "Censusi 2011", për të vlerësuar nivelin e saktësisë së këtij projekti;
- "Menaxhimi i pajisjeve mjekësore spitalore në QSUT";
- "Shërbimi parashkollor" me fokus cilësinë e shërbimit në çerdhet dhe kopshtet e Tiranës;
- "Laboratori kimik doganor".

2.2.1 *Performanca e KESH sh.a., Liberalizimi i tregut të energjisë elektrike*

Konteksti i auditimit: Sistemi elektro-energjetik shqiptar, si rezultat i akumulimit të problemeve në vijimësi pas viteve 90, gjendet përballë sfidash shumëdimensionale: me natyrë strategjike, teknologjike e operacionale, tregtare e financiare, duke vënë në rrezik jo vetëm zhvillimin e funksionimin normal të vetë këtij sistemi, por dhe integrimin e tij në sistemet rajonale të energjisë dhe investimet e reja për prodhimin e energjisë elektrike, si dhe duke u bërë pengesë serioze për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm të vendit tonë. Në këtë kuadër përfshihen edhe pasojat mbi KESH sh.a., si operatori kryesor i këtij sistemi për furnizimin me energji elektrike, si dhe treguesit cilësorë në standardet tekniko-ekonomike të energjisë

elektrike të furnizuar dhe mungesa e furnizimit të pandërprerë me energji elektrike për konsumatorët. Kjo për arsye se KESH sh.a., krahas prodhimit përgjigjet dhe për furnizimin publik me shumicë.

Gjendja financiare e KESH sh.a., në fund të viti 2013 rezulton me mungesë të likuiditeteve si rezultat i blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve të CEZ Shpërndarje në shumën 53 735 648,3 mijë lekë; klientëve të pa arkëtuar, me vlerë të transferuar nga OST, prej 40 691 823 mijë lekë; nga pamundësia financiare me burime të vetat për blerjen e energjisë elektrike nga importi për garantimin e furnizimit me energji dhe mbulimin e humbjeve të CEZ Shpërndarje, si dhe blerjet nga HEC-et private dhe ato koncesionare, nga viti 2010 e në vazhdim, overdraftet e marra nga KESH sh.a., kanë pësuar rritje 3,4 herë, duke arritur në 214 926 755 euro ose 30 132 731 000 lekë në fundin e vitit 2013, etj.

Aktualisht KESH sh.a., për shkak të mënyrës së organizimit dhe administrimit, nivelit të hapjes së tregjeve, mungesës së strategjive afatgjata për zhvillimin e sektorit energjitik të shoqëruara me planin e masave të zbatimit dhe kostot përkatëse, ndërhyrjet qeveritare në dëm të saj, vendosjes së raporteve të detyrueshme me operatorë privatë, megjithëse funksionon si shoqëri publike, është në një pozitë të disfavorshme në këtë sektor për shkaqet e mësipërme, gjë që reflekton në fund të fundit cilësinë dhe koston e furnizimit me energji elektrike për taksapaguesit.

Mesazhi i auditimit: "Ngarkimi me funksionin e prodhuesit publik të energjisë, garantimi i blerjes së energjisë së prodhuar nga HEC-et e dhëna me koncesion, si dhe ndërtimi i marrëdhënieve kontraktuale me çmime të rregulluara (të diktuara ose nga ERE, ose nga qeveria në marrëveshjet koncesionare), sigurimi i importit (blerjes) së energjisë elektrike për llogari të CEZ Shpërndarje (aktualisht OSHEE), jo vetëm që e kanë denatyruar funksionin themelor të një shoqërie publike (sigurimin e fitimit dhe rritjen e efektivitetit), por e kanë zhytur atë në detyrime financiare ndaj klientëve, duke e bërë domosdoshmëri ndryshimin e mënyrës se funksionimit, administrimit dhe menaxhimit, nëpërmjet ndarjes së përgjegjësive (prodhimi nga blerja: importi dhe/ose blerja e energjisë nga HEC-et e dhëna me koncesion), si dhe hapjen e tregut të energjisë elektrike, të cilat do të reflektohen në fund të fundit në cilësinë dhe koston e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve".

Gjetje, konkluzione dhe rekomandime kryesore:

I. Modeli aktual i tregut ka ndikuar në situatën ekonomike dhe financiare të KESH sh.a., në këto drejtime:

- Fillimisht, modeli aktual i tregut nuk ka arritur synimet e veta për të krijuar strukturën e nevojshme që të ketë konkurrencë në tregun e shitjes me shumicë, si dhe ka dështuar në krijimin strukturave të nevojshme ligjore dhe rregullatore për privatizimin e suksesshëm të industrisë elektro-energjitike, duke filluar me sektorin e Shpërndarjes;

- Modeli i tregut ka dështuar në këto drejtime kryesore: të sigurojë përfitime sa më të mëdha për klientët në drejtim të sigurisë së furnizimit me energji elektrike dhe shërbim cilësor e të qëndrueshëm; në liberalizimin e tregut të energjisë elektrike, për të krijuar një strukturë tregu që rrit interesin dhe numrin e pjesëmarrësve në të; zhvillimin e një reforme tarifore me interes për mbrojtjen e konsumatorëve dhe njëkohësisht për rritjen e eficiencës së sistemit elektro-energjetik shqiptar; integrimin e tregut të energjisë elektrike të vendit tonë në Tregun Rajonal e më vonë në Tregun Europian të Energjisë Elektrike;

- Ka një situatë të komplikuar të tregut të energjisë elektrike në vendin tonë, i cili nuk mundëson ndërhyrjen me strategji dhe politika afatgjata në këtë sektor, duke ndikuar për rrjedhojë në performancën e pjesëmarrjes në tregun rajonal dhe më gjerë;

- Si rezultat i shtimit të vazhdueshëm të futjes në rrjetin e shpërndarjes të HEC-eve të dhëna me koncesion, krahas përmirësimit potencial të qëndrueshmërisë së furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve si rezultat i shtimit të prodhimit, kemi aktualisht përkeqësim të situatës financiare të KESH sh.a. Ky përkeqësim vjen si rezultat i raportit të detyruar vendosur nga ERE për tarifën e blerjes prej tyre, disa herë më të lartë se sa çmimi i shitjes tek Operatori i Shpërndarjes, madje në disa raste me tarifa blerjeje edhe më të larta sesa çmimet e importit;

- Prodhimi publik i KESH sh.a., (p.sh në vitin 2013 prej 5 811 762 Mwh) është mëse i mjaftueshëm për të garantuar furnizimin aktual me energji elektrike të popullatës (i cili për vitin 2013 ka pasur nevoja vjetore 2 261 313 Mwh), edhe me përfshirjen nivelit aktual të humbjeve, i cili detyrimisht me ndryshimin e pronësisë së operatorit të shpërndarjes dhe përmirësimet në menaxhim dhe administrim do të vijë duke u zvogëluar. Prodhimi i kësaj sasie energjie nga KESH sh.a., me kosto shumë të ulët (1,14 lekë/kwh në vitin 2013), shitja me tarifë të caktuar nga ERE (2,3 lekë për vitin 2013) Operatorit të Shpërndarjes (CEZ-it, sot OSHEE) dhe blerja nga konsumatori me një çmim prej 7,7 dhe 13,5 lekë për kwh dëshmon për marzhe pozitive dhe të konsiderueshme fitimi të operatorëve të përfshirë, madje theksojmë

se çmimi final që paguhet nga konsumatori është nga më të lartët në rajon, në një kohë që për nga niveli i mirëqenies (të ardhurave) vendi ynë renditet në fund.

Për sa më lart, KLSH ka rekomanduar:

✓ Ndryshimin e modelit të tregut të energjisë elektrike në funksion të kalimit gradual në një treg të liberalizuar, me synim rritjen e konkurrencës; zhvillimin e një reforme tarifore me interes për mbrojtjen e konsumatoreve; mundësimin për ndërhyrje me strategji dhe politika afatgjata; integrimin e këtij tregu në Tregun Rajonal dhe atë Evropian të Energjisë Elektrike, duke siguruar qëndrueshmëri dhe shërbim cilësor në furnizimin me energji elektrike.

✓ Ndarjen e Divizionit të Furnizimit Publik me Shumicë nga KESH sh.a., si strukturë më vete, duke e vendosur KESH sh.a., si operator në treg në cilësinë e prodhuesit dhe tregtuesit të energjisë elektrike, duke bërë të mundur fuqizimin ekonomik dhe financiar të KESH sh.a., në funksion të rritjes së efektivitetit të përdorimit të burimeve hidrike në kaskadën e Drinit (e vetmja publike aktualisht); përmirësimi i teknologjisë ekzistuese dhe për pasojë uljen e kostos, si dhe mundësimin e burimeve të tjera për rritjen e prodhimit dhe diversifikimin e burimeve elektrike.

✓ Në kushtet aktuale të modelit ekzistues të tregut dhe pozicionimit të operatorëve në këtë sistem, si edhe në perspektivën e ndryshimeve të mundshme, rekomandojmë ruajtjen e çmimeve aktuale të energjisë elektrike për konsumatorët familjarë. Arsyet e mungesës së eficiencës në këtë sektor nuk kanë lidhje me çmimin, por mosarkëtimin dhe rregullat e tregut në përgjithësi. Po kështu, rritja e çmimit të energjisë penalizon konsumatorët korrektë dhe favorizon vjedhësit e energjisë, duke sjellë komplikime sociale. Rritja e çmimit rrit gjithashtu presionin inflacionist për ekonominë si të tërë, gërryen fuqinë blerëse dhe madje mund të shpjerë në rënie të ritmit të rritjes. Përfundimisht, rritja e çmimit të energjisë duhet të konsiderohet nga MEI si alternativë e fundit e përmirësimeve në këtë sektor dhe shoqërinë në përgjithësi; kjo pasi humbjet të jenë reduktuar në nivele të pranueshme, pasi tregu të jetë liberalizuar dhe konkurrenca të veprojë normalisht dhe pasi të jetë bërë një studim i plotë dhe i kujdesshëm i efekteve e risqeve në ekonomi dhe harmonizimit me politikat monetare, fiskale e sociale.

✓ Pavarësisht ndryshimeve organizative dhe administrative që mund dhe duhet të ndërmerren në KESH sh.a., ERE duhet të harmonizojë më mirë domosdoshmërinë e rritjes së burimeve elektro-energjetike nga HEC-et e dhëna me koncesion me interesin e biznesit pjesëmarrës në këtë aktivitet, nëpërmjet politikave të çmimeve,

ku mbi bazën e madhësisë së investimit dhe sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike, të llogaritet për secilin prej tyre periudha e vetëshlyerjes së investimit dhe gradualisht prodhimi i këtyre subjekteve të kalojë në çmime tregu.

Megjithëse Modeli i Tregut, teorikisht, midis të tjerave merr në konsideratë që të sigurojë përfitime sa më të mëdha për klientët në drejtim të sigurisë se furnizimit me energji elektrike dhe shërbim cilësor e të qëndrueshëm; liberalizimin e tregut të energjisë elektrike duke krijuar një strukturë tregu që rrit interesin dhe numrin e pjesëmarrësve në të; zhvillimin e një reforme tarifore me interes për mbrojtjen e konsumatorëve dhe njëkohësisht për rritjen e eficiencës së sistemit elektro-energjetik shqiptar; integrimin e tregut të energjisë elektrike të vendit tonë në Tregun Rajonal e më vonë në Tregun Europian të Energjisë Elektrike[1], praktikisht konstatohet se pikërisht në këto drejtime kryesore ka dështuar.

Ky model i tregut nuk ka arritur synimet e veta për të krijuar strukturën e nevojshme që të ketë konkurrencë në tregun e shitjes me shumicë, si dhe ka dështuar në krijimin e strukturave të nevojshme ligjore dhe rregullatore për privatizimin e suksesshëm të industrisë elektro-energjitike, duke filluar me sektorin e Shpërndarjes.

2.2.2 *Infrastruktura e Shërbimit Bibliotekar Kombëtar*

Konteksti i auditimit: Duke vlerësuar hapësirat funksionale në shërbimin bibliotekar dhe kryesisht të Bibliotekës Kombëtare si institucion i dijes dhe kujtesës mbarëkombëtare, në kultivimin e dashurisë për librin, kurimit të imazhit të librit, mbledhjes, ruajtjes, përpunimit, ngritjes së nivelit shkencor e akademik të traditës bibliotekare, është padyshim me vend shtimi i këtyre hapësirave në drejtim të përmirësimit cilësor të shërbimit bibliotekar kombëtar.

Aktualisht, shërbimi bibliotekar dhe Biblioteka Kombëtare e ushtron aktivitetin e saj në kushte të vështira, jo të denja për një institucion të tillë, simbol të kulturës kombëtare. Konkretisht mungojnë hapësirat fizike funksionale, gjë e cila ka përkeqësuar gradualisht ruajtjen dhe zhvillimin e fondit të librit, cilësinë e shërbimit ndaj lexuesit, kushtet e punës për punonjësit, krijimin e një perspektive afatgjatë

[1] VKM nr. 338, datë 19.3.2008 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, i ndryshuar.

dhe të qëndrueshme zhvillimi, bashkëpunimet me institucione homologe apo akademike brenda e jashtë vendit, etj.

Mesazhi kryesor i auditimit: "Biblioteka Kombëtare dhe shërbimi bibliotekar, në bashkëpunim me qeverinë shqiptare dhe pushtetin vendor, të krijojnë një qasje të re në vlerësim të librit dhe shërbimit qytetar, me synim ruajtjen e kulturës kombëtare dhe rritjen e vetë-edukimit të tij".

Rekomandime kryesore:

1. Nga Biblioteka Kombëtare në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe përvojave më të mira ndërkombëtare të hartohen dhe miratohen standardet e bibliotekave për çdo fushë të veprimtarisë së saj, të hartohen aktet nënligjore të harmonizuara me ligjin e bibliotekave.

2. Shërbimi bibliotekar dhe Biblioteka Kombëtare të marrë hapa konkretë për rregullimin e ambienteve dhe veprimtarisë së saj në shërbim të komunitetit dhe përdoruesve të saj.

3. Ministria e Kulturës, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, të marrë hapa konkretë për saktësimin e ambienteve të Bibliotekës Kombëtare dhe shtimin e tyre, si brenda Pallatit të Kulturës, ashtu dhe ndërtimit të një ambienti të ri të konceptuar për Bibliotekë Kombëtare.

Ministria e Kulturës, në bashkëpunim me Bashkinë e qytetit të Tiranës si qendra më e madhe administrative e vendit, të përfshijë në planet e saj strategjike ndërtimin e bibliotekës së qytetit, që Kryeqytetit aq shumë i mungon.

Ministria e Kulturës, në bashkëpunim me pushtetin vendor, të hartojnë plane për ndërtimin e godinave të reja bibliotekare dhe rikonstruksionin e atyre ekzistuese.

4. Për vazhdimin e procesit normal të punës në të ardhmen në Bibliotekën Kombëtare duhet të merren hapa konkretë për sigurimin e perspektivës së zhvillimit të ambienteve të reja, në kushtet kur ky proces nuk ka të ndalur dhe zhvillohet gjithmonë.

2.2.3 Siguria Rrugore

Konteksti i auditimit: Qarkullimi dhe siguria rrugore janë çështje kryesore sociale për këtë dekadë, pasi aksidentet në trafikun rrugor janë një nga tetë shkaqet e humbjes së jetës në nivel global dhe shkaku kryesor i vdekjes për të rinjtë e

grupmoshës 15-29 vjeç. Në Shqipëri, kostot që shkaktojnë aksidentet rrugore përllogariten në miliona euro.

Problemi i sigurisë rrugore na takon të gjithëve. Të gjithë ne jemi përdorues të rrugës si në rolin e drejtuesit të automjetit, këmbësorit, biçiklistit apo të pasagjerit. Nga të dhënat paraprake të institucioneve të përfshira në auditim, rezulton se pjesa më e madhe e aksidenteve janë pasojë e sjelljes së drejtuesve të automjeteve ose atyre që shkelin rregullat e trafikut.

Pikërisht në këtë kontekst, ku ndërthuren probleme të rrugëve, por edhe të edukatës së përgjithshme qytetare, të një tradite të munguar, nëse do t'i referohemi statistikave të viteve 2011-2013, numri i të vrarëve është mesatarisht 317 vetë për çdo vit. Rritja e numrit të aksidenteve nga viti në vit përbën një shqetësim shumë të madh qytetar dhe institucional. Nëse nuk merren masat e duhura dhe lejohet vazhdimi i prirjeve të së shkuarës, numri i vdekjeve nga aksidentet do të ketë tendencë rritjeje.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, përballë një dukurie kaq shqetësuese për shoqërinë tonë, duke mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, ISSAI 5800, në bashkëpunim me kolegët tanë të Zyrës së Audituesit të Përgjithshëm në Kosovë dhe me asistencën e bashkëpunëtorëve të Zyrës Kombëtare të Auditimit në Suedi, për herë të parë, ndërmori iniciativën e kryerjes së auditimit paralel për sigurinë rrugore në Shqipëri dhe në Kosovë.

Mesazhi kryesor i auditimit: “Edhe pse është bërë shumë në drejtim të politikave dhe legjislacionit, ato duhet të adresohen kryesisht në hartimin e standardeve në dhënien e lejeve të drejtimit, ku ka vend për përmirësime të mëtejshme, për faktin se “ Siguria rrugore“ përsëri mbetet një shqetësim serioz”.

1. Rritja e ndërgjegjësimit ndaj problemit;

2. Realizimi i përmirësimeve të përgjithshme të sigurisë rrugore që adresojnë risqet ndaj drejtuesve te rinj;

3. Rritja e nivelit të kursit të praktikës për fazën e shoqërimit nga të rritur;

4. Të zbatohen kufizime mbrojtëse gjatë drejtimit të mjetit në fazat fillestare të drejtimit. Te sigurohen masa penguese apo penalizuese të efektshme ndaj sjelljeve të papërshtatshme;

5. Përmirësimi i trajnimeve dhe testimeve për drejtuesit, me fokus vetë-ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit e rrethanave që çojnë në drejtimin e sigurt.

2.2.4 *Performanca e RTSH-së – Projekti i digjitalizimit të TVSH-së*

Konteksti i auditimit: Një nga sfidat e fundit me të cilën po përballet TVSH është kalimi nga transmetimi analog në atë numerik. Ky është një kusht i përcaktuar edhe nga Bashkimi Evropian. Afati përfundimtar i kalimit të plotë në transmetimet numerike televizive është data **17 Qershor 2015**. Mënyra e kalimit të plotë në transmetimet numerike, institucionet përkatëse, financimet, mbulimi i territorit, si dhe çështje të tjera, të cilat lidhen me këtë proces, përcaktohen në strategjinë për kalimin nga transmetimet analoge në ato numerike të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Procedimi i është ngarkuar Ministrisë për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit dhe institucioneve të tjera publike të përfshira në strategji.

Mesazhi kryesor i auditimit: "Parimisht RTSH është në gjendje të garantojë mbarëvajtjen e kalimit në transmetimet digjitale por, konkretisht suksesi i kësaj ndërmarrjeje varet nga kryerja e një reforme thelbësore në pothuajse të gjitha aspektet organizacionale".

Rekomandimet Kryesore:

1. Drejtoria e Përgjithshme e RTSH-së (DPRTSH) duhet të hartojë dhe propozojë disa amendamente shtesë në ligjin 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" në shërbim të përcaktimit të treguesve të pavarësisë redaksionale, garantimit të financimit dhe sanksionimit të vetë-administrimit.

2. DP e RTSH-së duhet të hartojë dhe të formalizojë Deklaratën e Politikave të Programit (Deklarata e Qëllimit) për vitet 2014-2018 si edhe një plan-veprim, të cilin ta miratojë në KDRTSH për arritjen e qëllimeve strategjike, në veçanti për projektin e Kalimit në transmetimet numerike.

3. Këshilli Drejtues i RTSH (KDRTSH) duhet të miratojë Statutin e ri dhe Rregulloren e re të RTSH-së, pas: 1) rihartimit të këtyre dispozitave bazuar në Ligjin 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe në Strategjinë e kalimit në transmetimet numerike, 2) reflektimit të vërejtjeve dhe sugjerimeve të dala nga diskutimi i gjerë në të gjitha njësitë e RTSH-së, 3) evidentimit të nevojave të prodhimit, 4) evidentimit të nevojave të reformimit të gjithanshëm të RTSH-së.

4. DP e RTSH-së, në bashkëpunim me të gjitha njësitë dhe strukturat vartëse, duhet të hartojë dhe të formalizojë Kodin e etikës së RTSH-së, bazuar në kode të ngjashme etike të mediave publike evropiane.

5. DP e RTSH-së duhet të hartojë mbi bazë konsultimi me Drejtorinë e TVSH-së, përafrimin me standardin evropian dhe kërkesat që rrjedhin nga Strategjia e Kalimit në Transmetimet Numerike, hartimin dhe aprovimin në KDRTSH të Kontratës së transmetuesit publik me AMA-n.

6. DP e RTSH-së duhet të ndalojë praktikën e marrjes së kompetencave të njësive vartëse në shkelje të Statutit dhe Rregullores së brendshme të RTSH-së dhe të krijojë një model biznesi të drejtimit të decentralizuar të institucionit, me delegim kompetencash dhe përgjegjësish, përputhur me Nenin 5, Pika A e Statutit.

7. DP e RTSH-së duhet t'i kërkojë Kuvendit të Shqipërisë, të konsiderojë kuotën gjinore në zgjedhjen e Këshillit Drejtues të RTSH-së, në një minimum prej 30%. Vetë RTSH duhet të rrisë numrin e grave në pozitat drejtuese të RTSH-së të paktën në nivelin e 30% sipas ligjit për barazinë gjinore.

Krahas sa më sipër janë paraqitur rekomandime për përmirësimin e sistemeve të menaxhimit të riskut, sistemeve të komunikimit, të menaxhimit të pranisë së RTSH-së në Internet dhe mediat sociale, menaxhimit te vlerave arkivore, burimeve njerëzore reduktimit të kostove, etj.

2.2.5 *Censusi 2011*

Konteksti i auditimit: Performanca e Census 2011 u auditua me synim përmirësimin e zhvillimit të proceseve të ardhshme të Censusit të popullsisë dhe të banesave. Ky auditim shërben për të informuar palët e interesuara mbi zhvillimin e këtij procesi, përgatitja dhe kryerja e të cilit kërkoi angazhimin e një vëllimi të madh burimesh financiare njerëzore dhe materiale. Identifikimi i shkaqeve të problematikave dhe sugjerimi i rrugëzgjidhjeve për përmirësime janë synimi i punës sonë në çdo auditim.

Ky subjekt u përzgjodh për auditim, duke mbajtur në konsideratë:

- Rëndësinë e këtij procesi në vendim-marrjen e politikave ekonomike e sociale qeveritare dhe hartimin e planeve strategjike;
- Vetëm Census mund të gjenerojë të dhëna të plota e të detajuara të realitetit demografik, ekonomik e social;

- Impaktin social me një bazë shumë të gjerë të grupeve të interesit;
- Trajtimin në media si një proces i rëndësishëm, duke tërhequr vëmendjen e publikut, sidomos për aspekte të veçanta;
- Koston e lartë të implementimit;
- Periodicitet i rrallë në realizim (1 herë në 10 vjet).

Mesazhi i auditimit: "Pavarësisht punës së mirë në realizimin e objektivave kryesore dhe vështirësive të hasura nisur nga kompleksiteti i procesit të Census 2011, regjistrimi i popullsisë dhe i banesave nuk ka mbuluar të gjithë zonën e regjistrimit të RSH, si dhe nuk ka qenë i orientuar në përqasjen kosto-efektivitet".

Rekomandimet Kryesore:

1. INSTAT, në kuadër të zhvillimeve të sistemeve të informacionit nga Ministritë e Linjës, apo institucione të ndryshme, duhet të fillojë të krijojë një regjistër popullsie të përditësuar me të dhënat administrative dhe nga anketat. Ky regjistër do të mundësonte realizimin e Censusit të popullsisë dhe banesave në vitin 2021 bazuar kryesisht në regjistra, duke shmangur mënyrën tradicionale.

2. Në të ardhmen të merret në konsideratë që të ngrihen struktura mbështetëse për organizimin e punës për realizimin e projekteve të planifikuara në programe, që të minimizohen lëvizjet e punonjësve pjesë përbërëse e këtyre strukturave.

3. Në formulimin e kontratave me punonjësit e rekrutuar, të specifikohen qartë të drejtat dhe detyrimet e palëve, aplikimi i masave shtrënguese disiplinore dhe administrative, duke i përdorur si një instrument ndërgjegjësues për integritetin dhe profesionalizmin e punonjësve të përfshirë në Census.

4. Plotësimi i pyetësorëve të Census të mundësohet edhe në faqet online të INSTAT (shqip dhe anglisht); kjo për të patur një mbulim sa më të madh të popullsisë, si dhe për t'i ardhur më pranë asaj kategorie që për shkaqe të ndryshme nuk mund të jetë prezent në banesë gjatë orarit zyrtar (kur edhe bëhet numërimi).

5. Për çështje me ndjeshmëri publike, sikurse është feja, regjistrimi i informacionit të bëhet rigorozisht. Kjo duke marrë shkas edhe nga pakënaqësitë apo kontestimet që mund të bëjnë me të drejtë komunitetet fetare.

Përgjigjja e subjektit: Pati observacione të shumta nga ana e subjektit, për shkak se informacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit në fazën audituese nuk

ishte i plotë. Observacionet nuk u pranuan edhe pasi u analizuan informacionet shtesë që shoqëronin observacionet.

2.2.6 *Menaxhimi i pajisjeve mjekësore në QSUT*

Konteksti i auditimit: Spitalet publike mbajnë një rrjet të gjerë të pajisjeve mjekësore, duke filluar nga artikuj të vegjël që kushtojnë relativisht lirë, e deri tek më të mëdhenjtë që janë kompleksë dhe kushtojnë shtrenjtë, disa miliona apo miliarda lekë.

Në fund të vitit 2012, vlera kontabël e pajisjeve mjekësore të mbajtura vetëm në QSUT, ishte rreth 5,7 miliardë lekë. Kjo vlerë përfaqësonte 57% të aktiveve afatgjata të të gjithë QSUT.

Burimi kryesor i financimit për pjesën dërrmuese të kësaj vlere ka qenë buxheti i shtetit dhe institucionet financiare ndërkombëtare. Po kështu, një burim tjetër mjaft i konsiderueshëm janë edhe ndihmat apo donacionet nga spitalet simotra të vendeve të tjera, shoqatat humanitare, institucionet fetare, etj.

Mesazhi kryesor i auditimit është: "QSUT nuk mban dokumentacion të plotë dhe të saktë për pajisjet nën zotërim, si edhe nuk bën një planifikim të kujdesshëm për blerjen dhe vënien në funksionim të pajisjeve të reja, që kapin vlera monetare shumë të mëdha".

Gjetje dhe rekomandime kryesore:

1. QSUT mban një rrjet të gjerë të pajisjeve mjekësore, afërsisht 3 000 të tilla, duke filluar nga artikujt e vegjël e deri tek më të mëdhenjtë dhe kompleksë. Inventarizimi fizik i fundit i pajisjeve mjekësore është bërë në fund të vitit 2008 dhe vlera kontabël e tyre ka qenë 3 077 000 951 lekë. Në vitet e mëpasme nuk është kryer inventar fizik, në një kohë që vlera kontabël e tyre, në fund të vitit 2012, është rritur në 5 700 000 000 lekë dhe përfaqëson rreth 57 % të vlerës së aktiveve afatgjata të të gjithë QSUT-së.

2. Gjendja kontabël për këtë periudhë, për shkak të moskryerjes së inventarëve fizikë, nuk mund të pasqyrojë saktësisht lëvizjen e pajisjeve mjekësore si: vlerat e blerjeve, të dhurimeve, të nxjerrjeve jashtë përdorimit, të kalimeve kapitale, të shitjeve të mundshme, si dhe mungesat apo tepricat që mund të rezultonin nga kryerja e inventarëve fizikë.

3. Nga Qeveria Austriake, në vitin 2010 është financuar me kredi në vlerën 7,1 milionë euro, blerja e "Akseleratorit Linear" dhe disa pajisjeve mjekësore përbërëse të tij, për shërbimin e Neurokirurgjisë në QSUT. Kjo procedurë është kryer në Austri, në zbatim të marrëveshjes financiare dhe sipas ligjeve të shtetit austriak.

4. Në asnjë rast të blerjeve të pajisjeve nuk u identifikua që në specifikimet teknike të pajisjeve të ishin vendosur apo parashikuar aspektet e trajnimit të stafit mjekësor që do të përdorë pajisjet dhe të stafit teknik që do t'i mirëmbajë ato. Në asnjë rast nuk janë marrë në konsideratë aspektet e trajnimit të tyre edhe mbas instalimit të pajisjeve. Po kështu, në asnjë rast të blerjeve të pajisjeve nuk u identifikua se në specifikimet teknike të pajisjeve të jenë vendosur apo përcaktuar aspektet e mirëmbajtjes dhe kostot e mirëmbajtjes. Pikërisht, për këto arsye, në disa raste të blerjeve të pajisjeje komplekse dhe moderne, nuk është siguruar efektiviteti dhe eficiensa e përdorimit dhe e mirëmbajtjes së tyre.

Sa më sipër KLSH ka paraqitur një **sërë rekomandimesh** si për QSUT-në dhe Ministrinë e Shëndetësisë të cilat synonin menaxhimin me eficiencë të sistemit financiar buxhetor si dhe marrjen e masave për vënien në funksionim të aparaturave mjekësore.

Përgjigjja e subjektit: Subjekti i pranoi të gjitha gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e këtij auditimi.

2.2.7 *Shërbimi parashkollor*

Konteksti i auditimit: Ky auditim performance ka në qendër të vëmendjes shërbimin parashkollor, duke analizuar problematikën aktuale dhe instrumentet, që strukturat shtetërore kanë në dispozicion për të përmirësuar situatën.

Sot fëmija konsiderohet një subjekt aktiv që përfshihet në bashkëveprimin e vazhdueshëm me bashkëmoshatarët, të rriturit dhe mjedisin social dhe kulturor ku bën pjesë. Ky përfytyrim për fëmijën kushtëzon tiparet karakteristike që duhet të kenë institucionet parashkollore. Institucionet, shërbimet dhe qendrat përgjegjëse për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve, duhet të veprojnë në përputhje me standardet përkatëse në fushën e sigurisë, shëndetit, numrit dhe aftësive të personelit në dispozicion.

Shërbimi parashkollor përballet me sfida të shumta dhe problematika të larmishme, duke filluar që nga aksesi i kufizuar në kopshte dhe çerdhe, e deri tek cilësia e

diskutueshme e shërbimeve që ato ofrojnë. Kjo situatë mund të ketë disa pasoja negative. Në aspekt afatgjatë, nëse prindërit do të detyrohen të zgjedhin midis rritjes së fëmijëve dhe punësimit të tyre, kjo mund të ketë ndikim në zhvillimin social dhe edukimin e brezave të ardhshëm. Në aspekt më afatshkurtër, kjo është një situatë e cila ka ndikim në tregun e punës dhe zhvillimin ekonomik të një vendi. Këto aspekte janë shumë të rëndësishme dhe prandaj u ndërmor ky auditim, duke u fokusuar në aspektet strukturore të shërbimit parashkollor, të cilët janë të matshëm dhe përcaktohen nga një kuadër rregullator i caktuar.

Mesazhi kryesor i auditimit është: "Edhe pse është bërë shumë në drejtim të hartimit të standardeve sasiore dhe cilësore, përkujdesja ndaj fëmijëve të kopshteve dhe çerdheve nuk është e mjaftueshme".

Gjetje dhe rekomandime kryesore:

1. Në mbështetje të objektivave të saj strategjike dhe duke mbajtur në konsideratë Objektivat Zhvillimorë të Mijëvjeçarit të OKB, MAS të konsiderojnë përfshirjen e nxënësve 5-6 vjeçar në arsimin e detyruar me synim rritjen e aksesit në arsimin parashkollor. Ky shërbim mund të ofrohet në kopshte ose në klasat përgatitore pranë shkollave 9-vjeçare, nëse këto të fundit janë të konceptuara sipas standardeve të kopshtit.

2. MAS dhe Bashkia e Tiranës, në kushtet e kapaciteteve të kufizuara, të implementojnë një sistem regjistrimi në institucionet publike parashkollore i cili i jep prioritet pranimit të fëmijëve nga familjet në gjendje ekonomike nën mesataren, si një masë afatshkurtër për të reduktuar momentalisht kërkesën e tepërt.

3. Plani i ri i Përgjithshëm Rregullues i Tiranës, duhet të marrë parasysh kërkesën e lartë për shërbimin parashkollor, duke përcaktuar sheshe të përshtatshme për ndërtimin e kopshteve dhe çerdheve të reja, si në periferinë e qytetit ashtu edhe pranë qendrës së Tiranës, ku dendësia e popullsisë është rritur ndjeshëm.

4. Bashkia e Tiranës në bashkëpunim me ASHR të shqyrtojë mundësinë për të kryer një shpërndarje të studiuar të burimeve njerëzore që mbulojnë shërbimin shëndetësor në kopshte dhe çerdhe, në mënyrë të tillë që ky shërbim të jetë i pranishëm edhe në 16 kopshtet dhe 5 çerdhet ku aktualisht mungon.

5. QEZHEF, të shqyrtojë mundësinë për të modifikuar planin e punës së psikologëve dhe punonjësve socialë, duke i ndarë ata sipas njësive bashkiake, me

qëllim që një psikolog dhe një punonjës social të jenë të fokusuar gjithmonë në të njëjtat çerdhe.

6. DAR Tiranë të optimizojë shpërndarjen e psikologëve në kopshte, duke mbajtur në konsideratë numrin e fëmijëve të regjistruar në çdo kopsht si dhe duke i kushtuar rëndësi kopshteve me numrin më të lartë të fëmijëve me nevoja të veçanta.

Përgjigjja e subjekteve: Të gjitha subjektet e audituara shprehën dakordësinë për gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e këtij auditimi.

2.2.8 Në Drejtorinë e Laboratorit Doganor:

Objekti i auditimit: "Vlerësimi objektiv, profesional dhe i pavarur i DLD, në kryerjen me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të rolit të saj, për sigurimin e ekspertizës shkencore, analizimin me profesionalizëm dhe saktësi të të gjithë mostrave, për të cilat është kërkuar kryerja e analizave laboratorike nga të tretët".

Mesazhi kryesor auditimit është: "Rritja e rolit të Laboratorit Doganor, si një hallkë e rëndësishme në përcaktimin e vërtetësisë së origjinës së mallrave ka si nevojë imediate rritjen e gamës dhe cilësisë së shërbimeve, nëpërmjet akreditimit të tij nga institucione të autorizuara, proces i cili kërkon mbështetje financiare, burime njerëzore dhe logjistike".

Laboratori Doganor është i vetmi që ofron këtë shërbim ndaj Degëve Doganore, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe organeve shtetërore të tjera, për rrjedhojë të gjithë këto institucione, kanë peshën e tyre specifike në përmirësimin e performancës së tij. Bashkëpunimi që DPD dhe DLD ofruan në këtë auditim, tregon dëshirën e tyre për të modernizuar Laboratorin Doganor dhe sistemin doganor në përgjithësi.

Por, me gjithë punën e mirë të deri tanishme, arritja e standardeve në përmbushjen e kërkesave për akreditim të Laboratorit Doganor Shqiptar, mbetet objektivi dhe sfida kryesore e tij dhe gjithë institucioneve të cilat kanë rolin e tyre në arritjen e këtij objektivi.

Në përfundim të auditimit Kontrolli i Lartë i Shtetit konkludoi se laboratorët doganorë janë krahu shkencor i doganave, si dhe një instrument thelbësor në sigurimin e integritetit të kufijve. Në vitet e fundit, roli i tyre ka evoluar duke u përshtatur me ndryshimet në modelet e tregtisë dhe evolucionin teknik. DLD ka zhvilluar veprimtarinë e tij si një Organizëm i Vlerësimit të Konformitetit, pa u

vlerësuar nga një organizëm i autorizuar, konkretisht Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA). Akreditimi është një mekanizëm që ndikon në rritjen e besueshmërisë dhe ndihmon autoritetet, ekonominë dhe shoqërinë që të gjykojnë nëse laboratorët e provave, organizmat e inspektimit, certifikimit (Organizma të Vlerësimit të Konformitetit) plotësojnë detyrat specifike.

Laboratori Doganor në kuadër të përfitimit të asistencës teknike nga projekti IPA-2011, nuk është mbështetur me fonde financiare, burime njerëzore të mjaftueshme, me qëllim sigurimin e kushteve sipas standardeve të kërkuara, të përcaktuara këto nga DPA, si dhe të monitoruara dhe vlerësuara gjatë implementimit të projektit IPA-2011.

Drejtoria e Laboratorit Doganor është ende larg realizimit të kushteve dhe standardeve të kërkuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) për akreditim. Mos akreditimi i Laboratorit Doganor, si një objektiv i tij i përcaktuar që prej vitit 2011 e në vazhdim, cënon qëllimin e tij për kryerjen e një game sa më të gjerë analizash dhe me rezultate të pakontestueshme.

DLD është në fazën e dytë "Aplikimi për akreditim", të procesit të akreditimit (gjithsej 8 faza) fazë e cila kërkon realizimin e një sërë kriteresh dhe plotësim dokumentacioni ku krahas përpilimit të procedurave të reja dhe rritjen e kapaciteteve teknike, duhet gjithashtu të realizohen dhe objektivat e kushtet që lidhen me procesin e akreditimit.

Faktori kryesor që ka ndikuar negativisht në ecurinë e këtij procesi është mos realizimi i kushteve nga ana e Laboratorit Doganor, të cilat lidhen ngushtësisht me mungesën e fondeve për realizimin e kritereve dhe standardeve që duhet të plotësojë DLD në kuadër të projektit IPA-2011, pavarësisht përpjekjeve dhe kërkesave për fonde gjatë vitit të fundit nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Ministria e Financave dhe DPD në vite nuk i ka dhënë vëmendjen e duhur DLD, në mbështetjen financiare që kërkon plotësimi i kushteve, arritja e standardeve, e besueshmërisë dhe operimi i këtij laboratori edhe për të tretë jashtë sistemit.

Përveç sa më sipër u konstatua mosplotësim i kushteve për ambientet e punës, gjendja e godinës jo në parametra normale në zonat që janë objekt i parametrave të veçantë meteorologjikë si (temperatura, lagështia, pluhuri, energjia, vibracioni, steriliteti) **të cilat nuk garantojnë kushtet optimale të punës,** nivel shumë të ulët të kushteve të sigurisë në punë, nuk kryhen matje për nivelin e ndotjes në ambientet e punës si dhe nuk është parashikuar dalje në rastet e emergjencës, kushte të

papërshtatshme për mbajtjen dhe administrimin e mostrave të ardhura, të analizuara, në kuadër të projektit IPA-2011 rezultoi se përpara fillimit të implementimit të këtij projekti, nga ana e DPD-së dhe DLD-së nuk janë kryer trajnime në nivelin e kërkuar, trajnimet e zhvilluara nuk i përgjigjen plotësisht nevojave të institucionit në lidhje me kërkesat sipas vendit të punës dhe kapaciteteve profesionale të disponueshme etj.

Nga DLD nuk janë marrë masa për sigurimin e një pc-net i brendshëm midis kompjuterëve të stafit, instalimin e një softwari antivirus për të mbrojtur të dhënat e LD nga dëmtimi ose humbja, instalimin e procedurave back-up për ripërftimin e të dhënave në rast dëmtimi apo humbje, me qëllim përshpejtimin dhe unifikimin e marrjes dhe shpërndarjes së informacionit dhe dokumenteve të Laboratorit Doganor. Në degët doganore nuk disponohen të gjitha mjetet për marrjen e mostrave (kryesisht për mallra të caktuara me specifika të veçanta).

Mbështetur në gjetjet dhe konkluzionet sa më sipër, KLSH i ka rekomanduar Ministrisë se Financave **mbështetje me fonde për investime në infrastrukturën** e Laboratorit Doganor sipas kërkesave të bëra nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave pasi mosrealizimi në kohë i objektivave rrezikon të bllokojë procesin e akreditimit.

KLSH ka rekomanduar gjithashtu **DPD forcimin e bashkëpunimit me Drejtorinë e Laboratorit** me qëllim realizimin e kushteve, kritereve dhe dokumentacionit që i kërkohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, nëpërmjet një plani të detajuar masash, ku të përcaktohen strukturat, personat përgjegjës**,** fondet dhe afatet për realizimin e tyre, sigurimin e ambienteve të nevojshme, krijimin e kushteve optimale për shëndetin e punonjësve, marrjes e masave për ruajtjen e administrimin e mostrave në kushte optimale, ristrukturimin e objektit të punës të DLD-së, fokusimin e tij vetëm në dhënien e rezultateve të analizave laboratorike si dhe, DLD duhet të vazhdojë me intensitet procedurat për plotësimin e një prej kushteve që duhen për t'u akredituar, si pjesëmarrja në testet nder laboratorikë të zotësisë, për të vlerësuar performancën teknike të tij, organizimin e trajnimeve të vazhdueshme etj.

Rritja e rolit këshillues & rekomandues të auditimeve të performancës ndaj subjekteve të audituara

Numri i gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve për çdo auditim, sikurse edhe numri i subjekteve të përfshira në një auditim të vetëm, kanë ardhur duke u rritur. Nga pikëpamja e implementimit prej subjekteve të këshillave dhe rekomandimeve

tona, këtu ka ende shumë për të bërë. Konstatohet se shumica e zyrtarëve të çdo niveli në administratën publike, kanë një qëndrim refraktar ndaj KLSH-së dhe ende nuk e kuptojnë rolin e auditimit të performancës.

E perceptojnë atë si një instrument më shumë kontrolli dhe penalizimi dhe jo si një aleat me të cilin mund të bashkëpunojnë frytshëm. Nuk mund ta ruash rolin këshillues dhe rekomandues kur sasia dhe cilësia e informacionit që subjektet vënë në dispozicion është evazive, e mangët dhe e deformuar. Kanë qenë të pakta subjektet që i kanë pranuar dhe kanë reflektuar pozitivisht ndaj raporteve tona e konkretisht: KESH sh.a., QEZHEF, INSTAT (pjesërisht), etj. Padyshim qe kjo situate impakton negativisht aspektin e implementimit te rekomandimeve.

2.3 Letrat e qytetarëve

Komunikimi direkt me publikun është një tregues i rëndësishëm për shpalosjen e një prej parimeve kryesore të një Institucioni Suprem të Auditimit, transparencës. Në këtë pikëpamje ai mund të konsiderohet dhe si një lloj i veçantë auditimi dhe për këtë qëllim KLSH i ka dhënë rëndësi të veçantë trajtimit të letrave të publikut. KLSH është shume e hapur edhe ndaj ankesave të qytetarëve, të cilat na adresohen me postë të zakonshme ose elektronike.

Këto letër-ankesa të qytetarëve, administrohen me profesionalizëm nga punonjësit e KLSH-së në funksion të tematikës që trajtojnë dhe qytetarët marrin në çdo rast përgjigje për shqetësimin e ngritur, me përjashtim të rasteve kur çështjet e ngritura nuk janë kompetencë e KLSH-së.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka trajtuar gjatë 2014, 394 ***letra dhe ankesa,*** për probleme të ndryshme, nga të cilat 170 ***rezultuan jashtë kompetencave dhe juridiksionit të institucionit.*** Nga 224 kërkesa dhe ankesa në kompetencë të KLSH, 121 prej tyre janë verifikuar dhe u është dhënë përgjigja përkatëse, ndërsa 103 janë në procesin e verifikimit. Fushat kryesore të shqetësimit publik të qytetarëve për çështje të qeverisjes në vend, janë:

- *36.9% e ankesave të adresuara KLSH-së i takojnë administrimit financiar dhe fushës së prokurimit publik;*
- *32.7% privatizimit dhe kthimit të pronës;*
- *1.3% taksa, tatime e dogana;*
- *29.1% fushave të tjera.*

Grafiku nr. 19



Në zbatim të Planit të Zhvillimit Strategjik te institucionit dhe me mbështetjen e projektit IPA të BE-së, KLSH do të ripunojë **strategjinë e tij të komunikimit** për të qenë sa më pranë Kuvendit, publikut dhe medias, duke sjellë vazhdimisht ide të reja, të cilat janë domosdoshmëri për të qenë inovativë, atraktivë dhe në koherencë me ndryshimet e shpejta të TI.

2.4 Kontrolli i cilësisë

Në një frekuencë vjetore, Kryetari i KLSH kërkon vlerësimin e kontrollit të cilësisë së punës audituese, nëpërmjet të cilit një numër i caktuar i dosjeve shqyrtohen nga një grup ekspertësh të jashtëm dhe brenda institucionit,me qëllim identifikimin e dobësive dhe marrjen e masave për përmirësime të mëtejshme në cilësinë e auditimit. Kontrolli i sigurimit të cilësisë, bazuar në ISSAI 40, synon të garantojë një përmirësim të vazhdueshëm të punës audituese, që konfirmon faktin se institucioni në procesin auditues zbaton standardet kombëtare dhe ato ndërkombëtare të auditimit. Pikërisht për këto arsye, sigurimi i cilësisë ka qenë dhe mbetet në vazhdimësi objektiv kryesor i veprimtarisë së KLSH.

Për vitin 2014, në zbatim të Urdhrit të Kryetarit nr. 129, datë 25.11.2014 “Për Kontrollin e Sigurimit të Cilësisë”, u krijua një grup i posaçëm shqyrtimi, i përbërë nga ekspertë të jashtëm nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (një risi kjo për këtë vit) dhe auditues të spikatur në fushat e tyre profesionale, faktor i cili ka ndikuar ndjeshëm në cilësinë e raportin e fazës së parë të sigurimit të cilësisë.

Për fazën e parë të procesit (faza e dytë nuk ka mbaruar), nga shqyrtimi i 16 dosjeve të auditimit, të përzgjedhura në mënyrë rastësore, rezultoi që krahas punës së bërë dhe rezultateve të arritura në drejtim të sigurimit të cilësisë, në procesin e programimit, zbatimit, raportimit të përfundimeve të auditimeve dhe ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve, u konstatuan edhe disa të meta e mangësi në zbatim të kërkesave të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme dhe Manualet e Auditimit, ndaj të cilave kërkohet të reflektohet për arritjen e një niveli më të lartë të sigurimit të cilësisë në të gjithë veprimtarinë e KLSH-së. Rekomandimet e dhëna nga Grupi i Shqyrtimit "Për Kontrollin e Sigurimit të Cilësisë", mbulojnë të gjithë procesin e auditimit në të gjitha fazat e kryerjes së tij dhe konsistojnë në dhënien e mendimeve për përmirësime mbi bazën e dobësive të konstatuara. Më konkretisht rekomandimet e dhëna nga Grupi i Shqyrtimit "Për Kontrollin e Sigurimit të Cilësisë", paraqiten si më poshtë:

Faza e planifikimit të auditimit:

✓ Hartimi i programit të auditimi sa më i plotë dhe në zbatim të Rregullores së Brendshme.

✓ Lidhur me përcaktimin e grupeve të auditimit duhet të kihet parasysh, përdorimi më racional i planifikimit të burimeve njerëzore, për sa i përket numrit të përshtatshëm të audituesve si dhe përcaktimi i stafit me aftësitë dhe eksperiencën e duhur.

✓ Përcaktimi i afatit të auditimit në përputhje me afatet e përcaktuara në Rregullore.

Faza e kryerjes së Auditimit

✓ Hartimi i aktverifikimeve dhe procesverbaleve në përputhje me kërkesat për hartimin e dokumenteve sipas Rregullores së Brendshme.

Faza e Raportimit dhe Evadimit të materialeve të auditimit.

✓ Grupet e auditimit duhet të marrin masa për trajtime sa më të plota e të qarta të observacioneve të sjella nga subjektet dhe personat e ngarkuar me përgjegjësi.

✓ Grupet e auditimit duhet të marrin masa për të përmirësuar trajtimin dhe paraqitjen e Projektraporteve dhe në veçanti Raporteve Përfundimtare pasi janë shumë të gjata dhe janë kopje e thjeshtë e procesverbaleve dhe aktverifikimeve të mbajtura.

✓ Grupet e auditimit duhet të marrin masa për të faktuar realizimin dhe takimet përmbyllëse me subjektin para hartimit të Projektraportit.

✓ Nga grupet e auditimit të merren masa, që në projektvendim, për shkeljet e rënda ligjore të konstatuara, të propozojnë masë disiplinore për të gjithë personat e ngarkuar me përgjegjësi.

✓ Përgjegjësi i grupit të auditimit dhe anëtarët e grupit, të marrin masa për të plotësuar dosjen e auditimit me letrat e punës dhe shënimet e mbajtura nga audituesi.

✓ Me qëllim përmirësimin e paraqitjes sa më cilësore të materialeve të auditimit dhe evitimit të problematikave të hasura gjatë zbatimit të saj, duhet të përmirësohet Rregullorja e Brendshme si dhe te plotësohen Formularët Standarde që përmban Rregullorja.

Këto rekomandime janë strukturuar sipas nevojës për të ndërhyrë dhe përmirësuar Rregulloren e Brendshme, Manualet dhe udhëzuesit e veprimtarisë audituese, ashtu dhe në nevojën e audituesve për të përsosur njohuritë dhe dijet profesionale.

Për këtë qëllim KLSH ka ngritur Grupe Pune dhe synon të ketë një sistem të fortë mbikëqyrje dhe monitorimi gjatë gjithë veprimtarisë audituese duke synuar parandalimin dhe shmangien e risqeve që sjellin mos arritjen e objektivave dhe rezultojë si auditime të cilësisë së ulët.

2.5 Analiza e Vetëvlerësimit të Integritetit IntoSAINT

Në kuadrin e përpjekjeve të bëra gjatë dekadave të fundit, në nivel global për zhvillimin e institucioneve, sistemeve dhe mekanizmave për promovimin e integritetit dhe parandalimin e korrupsionit në sektorin publik, KLSH ka adoptuar metodologjinë e vetëvlerësimit të integritetit në Institucionet Supreme të Auditimit (IntoSAINT), e konsideruar si një nga metodat inovative dhe të efektshme, me impakt rritjen e pritshmërive në zhvillimin e politikave të integritetit.

KLSH zhvilloi analizën vjetore nën frymën e vetëvlerësimit, e cila ofroi një pamje mjaft reale të performancës së arritur nga KLSH gjatë vitit 2014, duke pasqyruar krahas arritjeve dhe identifikimin e fushave vunerabël, vlerësimin e maturisë së kontrolleve dhe fokusin drejt së ardhmes.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) ndan bindjen e thellë institucionale se përmirësimi i qeverisjes publike arrihet nëpërmjet rritjes së transparencës dhe përgjegjshmërisë,

duke luftuar me efektshmëri korrupsionin, si brenda institucionit, ashtu dhe tek institucionet publike që KLSH auditon. Lufta parandaluese, krijimi i mjedisit me integritet të lartë, është arma më e mirë për të goditur korrupsionin.

Për këto arsye, thelbi i luftës parandaluese ndaj dukurive të abuzimit dhe korrupsionit në administratën publike, është ndërtimi dhe ruajtja e vlerave të integritetit të plotë institucional.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, përgjatë vitit 2014, në vijim të përmbushjes së objektivave strategjike dhe vjetore, me synim vlerësimin e arritjes së këtyre objektivave, nën frymën e Parimeve Themelore dhe Standardeve të INTOSAI-t, për zhvillimin e një qasje të strukturuar të hartimit dhe zbatimit të politikave institucionale të integritetit, për herë të parë aplikoi instrumentin e vetëvlerësimit të integritetit **IntoSAINT.**

Zhvillimet në qasjen e menaxhimit institucional u reflektuan në procesin e analizës së veprimtarisë së KLSH përgjatë vitit 2014, e cila, në dallim nga analizat e mëparshme të fokusuara në ofrimin e informacionit dhe analizimit të problemeve, erdhi **si risi jo vetëm më formë, por mbi të gjitha në përmbajtjen e saj,** pasi për herë të parë analiza vjetore u krye duke përdorur një instrumentin konstruktiv dhe dobiprurës të vetëvlerësimit të integritetit IntoSAINT.

I gjithë procesi u karakterizua nga dy elementë thelbësorë për një Institucion Suprem Auditimi: **transparenca dhe pjesëmarrja.** Nëpërmjet mekanizmit të vetëvlerësimit u sigurua gjithëpërfshirja e stafit, ku si audituesit dhe personeli mbështetës raportuan dhe dhanë idetë e tyre, nëpërmjet qasjes së **këshillimit, dialogimit mbështetjes dhe pozitivizmit.**

Në themel të procesit të aplikimit të IntoSAINT është procesi i informimit dhe komunikimit në dy drejtime hierarkike (nga poshtë – lart dhe nga lart- poshtë), duke u mbështetur në metodologjinë ku çdo punonjës vlerëson punën në kuadrin e përgjithshëm institucional të KLSH.

Parimi kryesor i zbatimit të kësaj metodologjie është "vetëvlerësimi" dhe çelësi i suksesit të aplikimit të këtij instrumenti është roli aktiv dhe kontribues i çdo individi, pjesë e stafit të institucionit.

Aplikimi i një qasje të tillë **kërkon maturi** dhe **pjekuri të proceseve, individëve** që i kryejnë këto procese **dhe të drejtuesve që** mbështeten mbi to.

Nëpërmjet këtij instrumenti si rezultat i angazhimit të çdo individi, **auditues dhe drejtues** u bë i mundur vlerësimi i performancës 2014, duke evidentuar dobësitë

dhe vunerabilitetet e veprimtarisë individuale të gjithsecilit, të sektorit, drejtorisë dhe departamentit, ndërkohë që analizat dhe rekomandimet u shtrinë edhe në aspektin menaxherial institucional.

Procesi i vetëvlerësimit konsistoi në marrjen e informacionit nga poshtë-lart lidhur me mënyrën se si perceptohet nga çdo audites kryerja e veprimtarisë audituese, në pajtueshmëri me standardet e INTOSAI-t dhe procedurat e përcaktuara në Rregulloren e Brendshme, Manualet dhe Udhëzuesit e tjerë të KLSH.

Duke synuar jo vetëm profesionalizmin por dhe një shkallë të lartë përgjegjshmërie në kryerjen dhe cilësinë e auditimit, KLSH nëpërmjet aplikimit të IntoSAINT nxiti dhe promovoi integritetin dhe sjelljen etike si pjesë e rëndësishme e përgjegjshmërisë individuale dhe institucionale.

Zbatimi i IntoSAINT gjatë analizës vjetore 2014 të KLSH, u realizua në bashkëpunim me pedagogët dhe studentët e Universitetit Shtetëror "Ismail Qemali" të Vlorës (risia e dytë e procesit), si dhe të shumë ekspertëve, analistëve dhe profesorëve të njohur nga shoqëria civile e vendit (risia e tretë), që garantuan paanshmërinë dhe transparencën e plotë të analizës.

Krahas sa më sipër, në ndryshim nga metoda klasike e aplikimit të IntoSAINT në SAI-t homologë, vetëvlerësimi nuk u përqendrua vetëm në vlerësimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të integritetit, por kjo metodë ishte gjithëpërfshirëse, duke u shtrirë edhe në sistemet e tjera, sikurse është sistemi i menaxhimit të procesit të auditimit, sistemi i sigurimit të cilësisë së auditimit, sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore, etj.

Instrumenti i vetëvlerësimit të integritetit në KLSH u përshtat dhe u zhvillua në një mënyrë mjaft origjinale, duke zbatuar udhëzimet dhe parimet e **IntoSAINT si metodologji, si dhe kërkesat e standardit ISSAI 41 "Instrumenti për analizën e boshllëqeve".**

Konkluzionet dhe rekomandimet e rezultuara nga procesi i aplikimit të instrumentit IntoSAINT paraqiten si vijon:

Konkluzion i përgjithshëm

1. Në analizën e faktorëve që u realizua nëpërmjet IntoSAINT- si metodologji vetëvlerësimi dhe vetëdiagnostifikimi konkludohet se aplikimi i këtij instrumenti **rezulton tepër i dobishëm** në drejtim të matjes së nivelit të maturisë së kontrolleve të përgjithshme dhe të integritetit në veçanti qasje e cila thekson trajtimin e

çështjeve jo thjesht **si pengesa** por më tepër si **mundësi** për të fokusuar zhvillimet drejt së ardhmes.

2. Rezultatet e arritura treguan **për një përmbushje të kënaqshme të objektivave**, por të analizuara nën frymën IntoSAINT, ato nxorën në pah vështirësi dhe fusha vunerabël, të cilat në raportin e vetëvlerësimit janë trajtuar me kujdes duke u analizuar nën dritën e perspektivës, duke u mbështetur fort në çfarë kemi bërë mirë, por nga ana tjetër reflektojnë rritjen e përpjekjeve se si mund ta çojmë dhe më përpara zhvillimin e këtij institucioni.

Politikat Menaxheriale Institucionale

3. KLSH si institucioni më i lartë auditues në vend, ka përgjegjësinë për të qenë transparent dhe profesional ndaj publikut të gjerë për të vlerësuar e më pas raportuar mbi shkallën e përgjegjshmërisë që qeveria dhe organet e saj kanë treguar në përdorimin e parave publike, proces ky që ka në thelb të çështjes integritetin. Ne funksion sa më sipër nga aplikimi i qasjes IntoSAINT rezultoi se KLSH **ka hartuar, vendosur dhe zbaton politika** që i shërbejnë përmbushjes së detyrimeve të saj kushtetuese dhe të cilat i monitoron dhe i përditëson në vijimësi duke reflektuar në to praktikat më të mira të fushës.

4. Nga procesi i vetëvlerësimit rezultoi se **"cilësia e auditimit"** mbetet një element nga më të rëndësishmit në përmbushjen e këtyre përgjegjësive, ndaj zbatimi në pajtueshmëri të plotë të ISSAI 40 sipas të cilit "*SAI duhet të vendosë politika dhe procedura të projektuara për të nxitur një kulturë të brendshme e cila pranon se cilësia është esenciale për të gjithë punën e vet*", tregon angazhimin real të këtij institucioni në drejtim ***të politikave institucionale me fokus në cilësi***.

5. Rezultatet e aplikimit te IntoSAINT nxorën në pah stilin dhe filozofinë e menaxhimit "Tone at the Top" sipas të cilit ky Institucion në tre vitet e fundit është menaxhuar në mënyrë strategjike, ku vendimet janë marrë nën optikën e realizimit dhe impakteve afatgjatë, duke vlerësuar dhe trajtuar me efektivitet risqet dhe trajtimin e tyre nën fokusin e mundësisë së zhvillimit për të ardhmen. Sa më sipër konkludohet se objektivat e vendosur në Strategjinë e Zhvillimit për periudhën 2013-2017, janë në interpretim në përputhje të plotë të Objektivave Strategjikë të INTOSAI-t të përshtatura këto me kushtet dhe fazën e zhvillimit të KLSH.

Frekuenca e aplikimit te Instrumentit IntoSAINT

6. Vetëvlerësimi i integritetit nëpërmjet aplikimit të instrumentit IntoSAINT **do të jetë i përhershëm** dhe do të aplikohet në mënyrë periodike (çdo fund viti), në nivel

institucional dhe individual pasi vetëm duke u trajtuar në këtë mënyrë do të arrihen rezultate e pritshme dhe të kërkuara për mbajtjen e **një niveli të lartë integriteti** në institucionin e KLSH-së dhe krijimin e profilit të audituesit profesional dhe me integritet jo vetëm brenda institucionit por edhe ne optiken e palëve të treta – parlamentit, medias dhe publikut.

Mbi efektivitetin e sistemit të kontrollit të etikës dhe integritetit

7. Rezultatet e IntoSAINT nxorën në pah se Integriteti dhe Etika janë tashmë pjesë e kulturës në KLSH, dhe pjesë e veprimtarisë së çdo individi si në nivel drejtues ashtu dhe auditues. Me synim sigurimin e vazhdimësisë rekomandohet që këto arritje **duhet të ruhen, mbahen dhe zhvillohen** më tej nëpërmjet aplikimit të praktikave më të mira dhe udhëheqjes nga shembulli më i mirë.

Raporti i vetëvlerësimit: një mjet konstruktiv

8. Identifikimi i pikave të forta dhe njëkohësisht dobësive që ekzistojnë në praktikat e punës në KLSH si dhe rekomandimet iu bënë me dije gjithë stafit të KLSH-së si dhe u adresuan për zbatim në periudhat në vijim. Kjo kërkon një shkallë të lartë ndërgjegjësimi të çdo audituesi për detyrat dhe përgjegjësitë e tij në nivel individual dhe në kuadrin e të gjithë institucionit. Në çdo veprim, audituesit duhet të konsiderojnë si arritjet ashtu dhe dështimet si pjesë e institucionit në të cilin ata duhet të punojnë me përkushtim dhe integritet.

Mbi stilin dhe filozofinë e menaxhimit "Ton at the Top"

9. "Tone at the Top", shembulli vjen nga lart, është një frymë që vendos përgjegjësi shtesë mbi nivelin drejtues të KLSH. Rezultate e IntoSAINT dëshmuan që këto përgjegjësi janë vendosur jo vetëm **në nivel politikash**, por njëkohësisht dhe në **mbikëqyrjen monitorimin** dhe mbi të gjitha **mbështetjen** e stafit auditues me burimet e nevojshme për kryerjen e auditimeve. Vlerësimet pozitive të cilat rezultuan në prodominacë dëshmuan faktin se të gjithë palët, vendimmarrëse dhe ekzekutive kanë bashkëpunuar dhe mbështetur njëri tjetrin me synim arritjen e objektivave të vendosura. Por krahas sa më sipër në vlerësim të aspekteve vunerabël dhe dobësive rezulton se ka ende vend për përmirësim të bashkëpunimit sipas të cilit drejtuesit e departamenteve do të duhet të qëndrojnë më afër audituesve dhe grupeve të auditimit, për të siguruar cilësinë si gjatë kryerjes ashtu dhe pas përfundimit të auditimit, **duke monitoruar dhe mbikëqyrur** hap pas hapi kryerjen e detyrave, dhe duke qenë të përgatitur për përballimin e çdo pengese apo sfide që mund të cenojë arritjen e objektivave.

Tranzitimi nga "ndërtimi" i kapaciteteve tek "forcimi dhe zhvillimi" i mëtejshëm

10. Parimet dhe Vlerat e SAI-t modern janë adoptuar dhe kërkohen në vazhdimësi të aplikohen në çdo hap të veprimtarisë së KLSH. Kërkesa për cilësi qëndron gjithnjë në përgjegjësinë e audituesit publik. Për këtë KLSH do të vazhdojë të përsosë dhe më tej qasjen audituese, metodologjitë e punës dhe aftësojë kapacitetet audituese. Tashmë KLSH kalon në një fazë të re nga ndërtimi në zhvillim të kapaciteteve dhe kjo kërkon ecje përpara, nën shembullin e më të përparuarit. Zhvillimi nëpërmjet të mësuarit dhe aplikimi i metodologjive dhe teknikave bashkëkohore të auditimit kthehet tashmë jo vetëm në një kërkesë por në një domosdoshmëri e progresit.

Në drejtim të funksionimit te një sistemi efektiv të trajnimit.

11. Në përfundim të procesit të vetëvlerësimit , krahas elementëve të aktiviteteve audituese dhe të tjera mbështetëse, një pjesë e mirë e konkluzioneve dhe rekomandimeve të dala si rezultat i analizës së fakteve, gjendjes aktuale dhe studim i nevojave për të ardhmen lidhen ngushtë me zhvillimin e kapaciteteve audituese.

Konstatohet se audituesit kanë filluar të kuptojnë dhe vlerësojnë drejt konceptin e zhvillimit dhe formimit të tyre profesional. Pas tre vjet eksperiencash të reja në fushën e trajnimeve, stafi i KLSH vlerëson trajnimin si një nga komponentët kryesorë për cilësinë e punës dhe arritjen e pritshmërive në auditim. Tashmë fokusi shkon përtej identifikimit të nevojave dhe kërkesave të përgjithshme për trajnime, por duket qartë se ata janë më të qartë në idetë e tyre cilat janë mangësitë, si mund të korrigjohen dhe për çfarë lloj dijesh a njohurish kanë nevojë në mënyrë që të mund të ecin me hapin që kërkon dhe vetë zhvillimin institucional të KLSH, dhe tú përgjigjen me përgjegjshmëri dhe përgjegjësi të lartë kërkesave të profesionit të audituesit publik.

Nga analiza e vetëvlerësimit u konstatua qartë se për të arritur cilësinë në auditim, nuk është e mjaftueshme çfarë është bërë por gjithashtu duhet të fokusohemi **tek çfarë duhet të bëjmë**. Për këtë qëllim përgjigjet e pyetësorëve të vetëvlerësimit u analizuan në pikëpamjen e "mësimeve të nxjerra"për të arritur më pas në gjetjen e rrugëve të përshtatshme për rekomandime për përmirësim në të ardhmen, si në aspektin e përgjithshëm të institucionit ashtu dhe në nivel individual Departamenti/Drejtorie.

Motoja "Experientia Mutua Omnibus Prodest" vlerësohet si një "driver" i fuqishëm në pasurimin e audituesve të KLSH me njohuri, dije dhe eksperienca të vendeve të tjera dhe institucioneve homologe.

2.6 Botimet e KLSH dhe prezenca në media

Botimet e KLSH për vitet 2012-2014 vijnë në realizim të misionit kushtetues të institucionit për të informuar publikun dhe Kuvendin, si dhe në zbatim të standardeve profesionale INTOSAI mbi komunikimin në kohë dhe gjerësisht të SAI-ve nëpërmjet mediave, faqeve të internetit dhe mjeteve të tjera. Mbi të gjitha, ato ndihmojnë forcimin e kapaciteteve audituese të stafit të KLSH-së. Kolana e botimeve të KLSH-së ka arritur në 35 tituj në tre vitet e fundit dhe titujt e këtyre botimeve janë vërtet impresionues, si për larmishmërinë e temave, ashtu dhe për sasinë e informacionit që përmbajnë si për lexuesit e fushës së auditimit dhe të ekonomisë, ashtu edhe për lexuesin e thjeshtë të interesuar për fushën e auditimit.

Gjatë vitit 2014, KLSH ka vijuar me sukses punën në këtë drejtim, duke i shtuar 21 botimeve te viteve 2012-2013, 14 botimet e 2014, të cilat variojnë nga publikime informuese për raportet vjetore të institucionit dhe marrëdhëniet me Kuvendin, tek botimet shkencore për standardet INTOSAI, për udhëzuesit e auditimeve të ndryshme, e tjerë. Me konkretisht janë titujt si më poshtë:

1. Analiza vjetore e punës 2013;
2. Performanca e KLSH-së 2013 (shqip/anglisht);
3. Revista "Auditimi Publik" nr. 6,7, 8 (shqip/anglisht);
4. Audituesit e KLSH në shtypin e përditshëm, janar-qershor 2014, volumi i II-të;
5. Konferenca e Tretë Shkencore e KLSH-së, *"Auditimi Kombëtar në Shërbim të Qeverisjes Kombëtare";*
6. 60 Vjet INTOSAI, 50 Vjet Sekretariat i Përgjithshëm;
7. Numri special i INTOSAI Journal për Kongresin e Pekinit;
8. Standardet INTOSAI mbi mjedisin (ISSAI 5110-5140);
9. Etika në SAI dhe në Institucionet e tjera Publike;
10. IntoSAINT;
11. ISSAI 5220 dhe Kodi i Transparencës Fiskale;
12. Auditimi mjet për një qeverisje më të mirë: rasti i Shqipërisë.

Ndër këta tituj vlen të veçojmë tre numra të 2014 të ***Revistës Shkencore "Auditimi Publik",*** e cila vazhdon me sukses sfidën e nisur, duke arritur në numrin 8 të saj, si një *revistë shkencore* periodike 4-mujore në fushën e Auditimit Publik, që botohet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Në këtë Revistë kanë kontribuar me shkrimet e tyre personalitete të fushës së Ekonomisë nga vendi si dhe personalitete të njohura dhe me eksperiencë nga Institucionet Supreme të Auditimit (SAI) nga vende të rajonit e më gjerë, duke i dhënë "Auditimit Publik" një vlerë të shtuar dhe një përmasë rajonale, duke kontribuar në mbledhjen e mendimit të përparuar të profesionistëve të fushës së auditimit.

Këto botime janë realizuar gjithashtu në bashkëpunim me të gjitha strukturat e tjera të KLSH-së, kryesisht me audituesit me përvojë, të cilët kanë sjellë me dinjitet mendimet e tyre profesionale. Vlen të evidentohet botimi ***"Forcimi i infrastrukturës etike në Institucionet Supreme të Auditimit dhe Auditimi i Etikës në sektorin publik"***, i cili jep një përmbledhje të zgjeruar të eksperiencave të shumë SAI-ve evropiane në auditimin e zbatimit të rregullave të etikës në institucionet që auditojnë, si dhe shembuj të suksesshëm të kryerjes së vetëvlerësimit të integritetit brenda SAI-t, nëpërmjet instrumentit "IntoSAINT". Aktualisht, KLSH po punon në këtë drejtim dhe si anëtar i grupi *Task Force* për auditimin dhe etikën, ka ngritur tashmë strukturën e tij etike, Sektorin e Etikës dhe Integritetit, ka Kodin e tij të Etikës dhe së fundmi ka ngritur edhe Komisionin e Etikës. Botimi tjetër në këtë fushë, ***"IntoSAINT",*** është padyshim i një rëndësie parësore sepse shërbeu edhe si udhërrëfyes për realizimin e analizës se këtij viti në këtë fryme, dhe vjen si botim komplementar me atë të "Forcimit të infrastrukturës etike në SAI dhe Auditimin e Etikës në sektorin publik". Këto dy botime do të ndihmojnë për ta bërë sjelljen etike, pjesë integrale të veprimtarisë tonë. Është e sigurt që KLSH mbështetur në profesionalizmin e audituesve dhe në bashkëpunimin efikas me aktorë dhe faktorë të tjerë, do ti realizojë objektivat ambiciozë që i ka vendosur vetes në fushën e botimeve, si pjesë integrale e zbatimit të strategjisë 2013-2017 për rritjen e transparencës dhe komunikimit me publikun, me qëllim modernizimin e institucionit.

Partneriteti me mediat (Media ne raport me KLSH dhe KLSH në raport me mediat)

Aktualisht, KLSH është në vitin e tretë të implementimit të Planit të Zhvillimit strategjik të Institucionit 2013-2017 dhe ka realizuar një pjesë të mirë të nën-objektivave të njërit prej 6 Objektivave kryesorë të zhvillimit, atë të "Rritjes së ndikimit të KLSH-së përmes Komunikimit dhe Bashkëpunimit".

Referuar ISSAI 12, "Vlerat dhe dobitë e SAI-ve-sjellja e ndryshimeve ne jetën e qytetarëve":...*Një SAI i pavarur, efektiv dhe i besueshëm është një komponent thelbësor në një sistem demokratik, ku përgjegjshmëria, transparenca dhe integriteti janë pjesë e domosdoshme e një demokracie të qëndrueshme...*

KLSH ka rritur gradualisht, duke arritur në fund të vitit 2014 që të gjashtëfishojë praninë e tij me informacion dhe mesazhe në median e shkruar dhe të katërfishojë prezencën e tij në median audiovizive, krahasuar me vitin 2010. Gjatë 2014, shtypi i shkruar ka pasqyruar raportet dhe deklaratat tona për shtyp me një numër prej 867 artikuj, njoftime, editoriale dhe komente analitike, përkundrejt 690 gjithsej përgjatë 2013, ose 26% më shumë. Gazetarët u janë përgjigjur prononcimeve tona, problematikave të dala nga auditimet e ushtruara nga ana jonë dhe aktiviteteve të ndryshme gjatë këtij viti. Transparenca e veprimtarisë së KLSH-së po rritet nga viti në vit dhe ne jemi gjithnjë e më të hapur e bashkëpunues me median. Kjo evidentohet lehtazi edhe nëpërmjet shifrave e grafikut të mëposhtëm:

Grafiku nr. 20



Gjatë 2014, në mediat audiovizive janë **transmetuar 432 sekuenca filmike**, edicione informative, apo kronika të ndryshme televizive nga TV kombëtare dhe ato lokalet, **nga 332 për vitin 2013 dhe vetëm 98 në 2010**, duke informuar dhe sensibilizuar opinionin publik për rezultatet e auditimeve të ushtruara nga KLSH dhe aktivitetet e ndryshme lidhur me veprimtarinë e KLSH-së, si marrëveshjet me institucione homologe, brenda dhe jashtë vendit, me shoqatat e profesionistëve të fushës së financave dhe të auditimit, organizatat e shoqërisë civile aktive në luftën kundër korrupsionit, etj.

Një risi e padiskutueshme është edhe prezenca e audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit në shtypin e shkruar, të cilët nëpërmjet shkrimeve të tyre kanë bërë prezente për lexuesit problematikat e auditimeve në institucionet shtetërore, por edhe zhvillimet e institucionit, rritjen e kapaciteteve audituese të stafit nëpërmjet trajnimeve, etj. Gjatë 2014, ne kemi qenë prezentë **pothuajse në të gjitha gazetat me 134 shkrime, të shkruar nga 51 auditues të KLSH-së, përkundrejt 124 shkrimeve në vitin 2013 të 42 audituesve**. Shkrimet e botuara gjatë vitit 2013 janë përmbledhur në librin "Audituesit e KLSH-së në median e shkruar", volumi i I-rë dhe në volumin e II-të janë botuar shkrimet që i përkasin gjashtë-mujorit të parë të vitit 2014. Brenda tre mujorit të parë të këtij viti, do të botohet volumi i III-të që i përket shkrimeve të botuara gjatë 2014. Të gjitha këto botime i përkasin kolanës së botimeve të KLSH-së.

KLSH përgatit çdo tre muaj buletinin e auditimeve, në bazë të të dhënave të auditimeve të përfunduara, i cili është një mjet informimi më shumë për publikun dhe një tregues me shumë në lidhje me transparencën e institucionit.

KLSH **ka rritur bashkëpunimin dhe partneritetin me organizatat** e shoqërisë civile në kryerjen e vrojtimeve dhe analizave të përbashkëta për nivelin e korrupsionit dhe shkallës së transparencës në administratën publike.

Në këtë kuadër KLSH ka ndërmarrë katër procese Mini Peer Review, të cilat janë projekte bashkëpunimi me katër OJF dhe organizata profesioniste të fushës dhe konkretisht:

- "Kontrolli i Cilësisë në të ftohtë" nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit;
- "Kontrolli i Procesit të Rekrutimit të stafit të KLSH-së", nga Instituti "G&G Group";
- "Realizimi i transparencës dhe komunikimit të KLSH-së me publikun dhe qytetarët" nga Lëvizja Evropiane, Shqipëri;
- "Analiza e impaktit të shkrimeve të Audituesve të KLSH-së në shtypin e shkruar ", nga botuesi i Gazetës "Ekonomia";

KLSH po bashkëpunon me shoqërinë civile, median, universitetet, nëpërmjet organizimit të takime dypalëshe dhe shumëpalëshe, konferencave dhe simpoziumeve me qëllim rritjen e transparencës dhe shkallës së përgjegjshmërisë së administratës publike në menaxhimin e fondeve publike me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet.

Faqja WEB e KLSH-së ka informacione të përditësuara për planet dhe raportet e auditimeve, standardet e auditimit, bazën ligjore, raportet qe KLSH-së i paraqet çdo vit Kuvendit në përmbushje të detyrimeve Kushtetuese, strukturën, botimet, aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, etj. Intensifikimi dhe rritja cilësore e komunikimit të KLSH-së ka sjellë rezultate, veçanërisht në rritjen e vëmendjes së medias për raportet e auditimit dhe për institucionin në tërësi, si edhe në rritjen e besueshmërisë së qytetarëve ndaj institucionit.

2.7 *Miratimi i Ligjit të Ri "Për Organizmin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*

Në prill të vitit 2014, Komisioni Parlamentar për Ekonominë dhe Financat nisi diskutimin e projekt-ligjit të KLSH-së, me amendimet mbi ligjin ekzistues, sipas sugjerimeve të DG-Budget dhe SIGMA-s dhe në zbatim të rekomandimeve të Progres Raporteve të Komisionit Europian për Shqipërinë në vitet 2011, 2012 dhe 2013.

Në bazë të nenit nr 81, të Kushtetutës u paraqit në Kuvend nga Kryetari i Komisionit të Ekonomisë, Deputeti Erion Braçe, varianti i projekt-ligjit i përgatitur nga KLSH.

Ky proces ishte vijim i konsultimeve të vitit 2012, të tryezave të organizuara nga KLSH-ja me palët e interesit si ekspertë kontabël, bota akademike e jurisprudencës dhe kontabilitetit, shoqëria civile dhe mediat si dhe nga organizma ndërkombëtare si SIGMA dhe (DG-Budget) të Komisionit Evropian.

Nisur nga ndryshimet e shumta në strukturë dhe përmbajtje që varianti i fundit i projektligjit për KLSH-në parashikonte në raport me ligjin ekzistues, u ra dakord që ky projektligj të kalonte në variantin e një ligji të ri për KLSH-në, kjo edhe në bazë të kritereve imponuese të teknikës legjislative.

Ligji i Ri për KLSH përmban ndryshime që rregullojnë në mënyrë përfundimtare pavarësinë e plotë institucionale të KLSH-së duke parashikuar njëkohësisht një konceptim modern të të drejtave dhe detyrave të tij sipas standardeve INTOSAI, rritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të tij dhe rritjen e kapaciteteve administrative, certifikimin e audituesve, saktësimin e të drejtës së KLSH-së për të audituar programet e zhvilluara me fondet e akorduara nga BE për Shqipërinë, dhe të së drejtës për të certifikuar llogaritë financiare, si dhe vendosjen në ligj në mënyrë eksplicite të dy formave më koherente të auditimit, të performancës dhe auditimit të IT, të përdorura gjerësisht nga institucionet tona homologe moderne dhe me eksperiencë.

I konsideruar nën këndvështrimin e mendimeve sugjerimeve të dhëna nga personalitete akademike e profesionale, nën frymën e zbatueshmërisë dhe pajtueshmërisë me Standardet e INTOSAI-t, Projekt Ligji për KLSH pas miratimit në parim në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit të Komisionit Evropian, iu paraqit për miratim Kuvendit.

Në procesin e miratimit të ligjit të ri, KLSH u mbështet fuqishëm nga organizma ndërkombëtarë si Delegacioni i BE-së në Shqipëri, SIGMA dhe DG-Budget të cilët ofruan përkrahjen e tyre me këshilla dhe konsulencë në takime që u organizuan me anëtarë të Komisioneve të Kuvendit pjesë e këtij procesi.

Përfundimisht në Kuvend u miratua Ligji 154/2014, datë 27.12.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Ky moment përfaqëson një pikënisje për angazhime të mëtejshme dhe zhvillim të Kontrollit të Lartë të Shtetit në të njëjtën linjë me Institucionet Supreme të Auditimit të vendeve të zhvilluara, anëtare të BE-së dhe praktikave më të mira të fushës.

3 BURIMET DHE PËRDORIMI I TYRE

3.1 Struktura Organizative e Kontrollit të Lartë të Shtetit



Ndryshimet dhe zhvillimet që kanë ndodhur në ambientin veprues të KLSH gjatë viteve të fundit, pritshmëritë që vijnë si rezultat i miratimit të ligjit të ri, nxorën në pah nevojën për rishikim dhe përshtatje të strukturës organizative dhe formave të bashkëveprimit midis njësive të Institucionit.

Duke vlerësuar lart nevojën për ndryshim dhe nxitjen për risi dhe novacion, në Tetor të vitit 2014, me Vendim të Kryetarit të KLSH u miratua Struktura e re Organizative e cila përshtat më së miri qëllimet institucionale me detyrat dhe angazhimet e çdo njësie organizative: Departamenti, Drejtorie apo Sektori në kuadrin e objektivave strategjikë të Institucionit të konkretizuara tashmë në një Strategji të Zhvillimit për periudhën 2013-2017.

Në funksion të arritjes së pritshmërive për modernizimin institucional si dhe implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) u krijua Departamenti i Politikave të Auditimit, boshti kryesor i veprimtarisë të të cilit është

hartimi i politikave të auditimit dhe mbështetja e Departamenteve të auditimit gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre audituese.

Riorganizimi synoi një rivendosje dhe përcaktim të qartë të përgjegjësive të çdo individi dhe strukture në skemën e organizimit dhe performancës së KLSH, dhe njëkohësisht duke marrë në konsideratë aftësitë, dijet dhe kompetencat e çdo audituesi me qëllim arritjen e efektivitetit dhe cilësisë së lartë në auditim e performancë. KLSH udhëhequr nga praktikat më të mira të institucioneve homologe dhe këshillat dhe ekspertizën e fituar në vite, ka tashmë një strukturë që reflekton më së miri qëllimet dhe objektivat që institucioni ka vendosur për të arritur në të ardhmen.

3.2 Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Qëllimi i Institucioneve Supreme të Auditimit është që të përmirësojë vazhdimisht performancën e tij, dhe kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet një stafi i cili është i motivuar, është i mirë menaxhuar, si dhe që shpërblehet në mënyrë të drejtë. Menaxhimi efektiv dhe profesional i Burimeve Njerëzore është jetik për të ndihmuar një institucion që ta arrijë këtë.

Duke u mbështetur në udhëzimet dhe praktikat më të mira për ndërtimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të Institucioneve Supreme të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka vijuar të investojë në zhvillimin e burimeve njerëzore.

Që në fillimin e vitit 2014, me anë të Vendimit nr. 17 datë 28.02.2014 të Kryetarit të KLSH, i ndryshuar me Vendimit nr. 149, datë 31.10.2014, "Për Strukturën e Renditjes së Punëve, Klasifikimin e Vendeve të Punës dhe Nivelin e Pagave në KLSH për vitin 2014", është miratuar struktura organike, me një total prej 166 punonjësish. Nga viti 2011 dhe 2012, vite në të cilat struktura ka pasur një numër total prej 156 punonjësish ka ardhur duke u rritur me një shtesë prej 5 vendesh në vitin 2013 përkatësisht 161 punonjës dhe 5 vende për vitin 2014, përkatësisht 166 punonjës.

Në total numri i stafit kryeauditues dhe atij auditues në vitin 2014 arriti në 119 punonjës (nga 113 në vitin 2013, 110 punonjës në 2012 dhe 2011), e që zë rreth 72% të numrit total të punonjësve, ose nëse do të shtonim dhe audituesit e specialistët në Departamentin e Politikave të Auditimit përkatësisht 13 punonjës ky numër arrin në 132 punonjës dhe përfaqëson rreth 80 % të numrit total të punonjësve. Stafi i shërbimeve mbështetëse (logjistike & IT, shërbime, buxhet-

financë, burime njerëzore, etj.) përbëhet nga 19 punonjës ose 11.4% të totalit. 8% e punonjësve përfaqësojnë stafin drejtues të institucionit.

Grafiku nr. 21



Siç shikohet nga grafiku struktura e punonjësve ka vijuar të ndryshojë në favor të stafit auditues.

Klasifikuar sipas arsimimit, në strukturën organike për vitin 2014, punonjësit me arsim të lartë zënë 157 punonjës, ose në masën rreth 95% kundrejt numrit total të punonjësve/nga 149 apo 94% që rezultonin në vitin 2013, 145 punonjës, ose në masën 93% në vitin 2012, dhe 141 punonjës ose 90% që rezultonin në vitin 2011.

Të ndarë sipas profilit të diplomimit, klasifikimi i punonjësve me arsim të lartë është:

- 36 Financierë (21.6%) nga 37 në vitin 2013, 35 në vitin 2012, 26 në vitin 2011;
- 13 Kontabilistë (8%) nga 15 në vitin 2013, 18 në vitin 2012, 19 në vitin 2011;
- 43 Ekonomistë të ndryshëm (26%) e njëjtë me vitin 2013, 44 në vitin 2012, 53 në vitin 2011;
- 24 Juristë (14.04%) e njëjtë me vitin 2013, 21 në vitin 2012, 17 në vitin 2011;
- 26 Inxhinierë (16%) nga 20 në vitin 2013, 17 në vitin 2012, 23 në vitin 2011;
- 13 punonjës me diploma të tjera (8%) nga 9 në vitin 2013, 2012 dhe në 2011.

Me synim menaxhimin efektiv te burimeve njerëzore në raste të caktuara specialistë nga Departamenti i Politikave të Auditimit marrin pjesë në auditime, drejtojnë procesin e kontrollit të cilësisë në të ftohtë, etj.

Grafikisht zhvillimet dhe ndryshueshmëria e strukturës organizative të KLSH për vitet 2011-2014 paraqitet si vijon:

Grafiku nr. 22



Me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të performancës individuale dhe për të fituar njohuri, aftësi dhe teknika të reja, në zbatim të Udhëzimit të Kryetarit të KLSH-së nr. 3 datë 15.09.2012 "Për përsosjen arsimore profesionale të audituesve të KLSH-së", një pjesë e punonjësve kanë përfunduar studimet në degë të dyta apo zotërojnë diploma e certifikata të ndryshme profesionale të cilat mundësojnë përdorimin e aftësive, në mënyrë më efektive dhe në përshtatje me situata të reja. Këto rezultate në pjesën më të madhe (me përjashtime shumë të pakta) janë arritur gjatë tre viteve të fundit.

Treguesit e përsosjes arsimore individuale rezultojnë si më poshtë:

- 15 punonjës kanë një diplomë të dytë nga të cilët 13 në Drejtësi dhe 2 në Financë;
- 2 punonjës kanë Diplomë Ndërkombëtare në Kontabilitet dhe Auditim (CIPFA);
- 4 punonjës kanë certifikatën Kontabël i Miratuar dhe 1 punonjës ka certifikatën Ekspert Kontabël;
- 21 punonjës kanë certifikatën e Audituesit të Brendshëm;

- 2 punonjës kanë certifikatën e Vlerësimit të Pasurive të Paluajtshme;
- 6 punonjës kanë certifikata të trajnimeve të zhvilluara on-line nga IDI (Iniciativa për zhvillim e INTOSAI-t).

Duke konsideruar që rekrutimi dhe përzgjedhja është pika e nisjes për menaxhimin e burimeve njerëzore KLSH e ka lidhur rekrutimin e stafit ngushtë me strategjinë, strukturën dhe funksionet e tij. Rekrutimi dhe përzgjedhja janë të rëndësishme pasi ato ndihmojnë SAI-n që të sigurohet që ai ka stafin e duhur me kualifikimet e duhura, aftësitë dhe përvojën për të plotësuar nevojat e tanishme dhe ato që ka në të ardhmen.

Rekrutimi dhe përzgjedhja janë proceset të cilët të çojnë që të kesh personin e duhur, në vendin e duhur, në kohën e duhur. Kjo është shumë e rëndësishme për performancën e institucionit.

Gjatë vitit 2014 janë ndjekur të gjitha procedurat sipas rregullave dhe dispozitave ligjore në fuqi mbi nëpunësit civilë, për rekrutimin e 25 punonjësve nga 21 punonjës që janë rekrutuar në vitin 2013 apo nga 36 të rekrutuar në vitin 2012.

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të INTOSAI-t, KLSH synon të ruajë dhe të zhvillojë një fuqi audituese dinamike, duke përfshirë nxitjen dhe lehtësimin e stafit duke u krijuar mundësi për promovimin dhe për integrimin e stafit ekzistues ashtu dhe atij të ri. Për këtë qëllim gjatë vitit 2014 janë zhvilluar 6 testime dhe janë miratuar 20 vendime për ngritje në kategori, krahasuar me vitin 2013 gjatë së cilit u zhvilluan 3 testime dhe janë realizuar 23 ndryshime në kategori, duke ju dhënë në këtë mënyrë mundësinë zhvillimit të karrierave profesionale brenda institucionit, nëpërmjet konkurrimit. Ndërkohë që numërohen 6 raste të uljes në kategori.

Për vitin 2014 përbërja e punonjësve sipas funksioneve dhe detyrave që kryejnë ka qenë:

- 13 Personel drejtues (ku përfshihen Kryetari, Drejtorët e Përgjithshëm, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorët e Departamenteve e të Drejtorive) që përbën 8% të numrit total të punonjësve nga 14 në vitin 2013, 2012 dhe 10 në vitin 2011.
- 9 Kryeauditues që përbën 5.4 % të numrit total të punonjësve në vitin 2014 nga 7 (4%) Kryeauditues në vitin 2013, 5 në vitin 2012 dhe 7 në vitin 2011.
- 111 Auditues (67 %) nga 106 (66%) Auditues në vitin 2013, 105 në vitin 2012 dhe 106 në vitin 2011.

- 33 Punonjës mbështetës (përgjegjës sektori, specialistë, juristë, zëdhënës, punonjës mbështetës) që përbën 20% të numrit total të punonjësve/nga 28 në 2013, 23 në vitin 2012 dhe 22 në vitin 2011.
- 8 Punonjës shërbimi që përbën 5% të numrit total të punonjësve nga 9 në vitin 2013, 2012 dhe 10 në vitin 2011.

Grafiku nr. 23



Tregues të tjerë po aq të rëndësishëm për burimet njerëzore janë mosha e punonjësve të institucionit dhe raporti femra/meshkuj gjatë viteve 2011-2014 përkatësisht si më poshtë:

- Mosha mesatare në KLSH në fund të vitit 2014 është 46.1 vjeç nga 46.21 vjeç që rezultonte në vitin 2013, 48 vjeç në vitin 2012 dhe 50 vjeç në vitin 2011.
- Vjetërsia në institucion është rreth 8 vjet nga 8.2 vjet për person që ka qenë në vitin 2013, 8.7 në vitin 2012, 9.1 në vitin 2011.
- Rezultojnë 22 punonjës nën moshën 30 vjeç, nga mosha 31-50 vjeç janë 65 punonjës ndërsa mbi 51 vjeç janë 78 punonjës. Krahasuar me vitin 2013 kemi një rritje të numrit të punonjësve në moshën nën 30 vjeç me 37 %.
- Raporti femra/meshkuj është 39% me 61% në vitin 2014 nga 37% me 63% që ishte për vitin 2013, 32% me 68 % në vitin 2012, 33.5% me 66.5% në vitin 2011.

Grafiku nr. 24



Rezultojnë të punësuara në Institucion 65 punonjëse femra, 11 prej të cilave në pozicione drejtuese (Sekretare e Përgjithshme, Drejtore e Përgjithshme, Drejtore Departamenti, Drejtore Drejtorie, Kryeauditueseë, Përgjegjëse Sektori), 15 punonjëse femra në Departamente, Drejtori dhe Sektorë mbështetës e ndihmës dhe 39 punonjëse femra në pozicione audituese.

KLSH mban kurdoherë në konsideratë se puna e institucionit është e bazuar në njohuri të shumta dhe aspekti i të mësuarit të zhvillimit të kapitalit njerëzor është bërë një faktor vendimtar për sukses. Të mësuarit në nivelin individual të punonjësve është i rëndësishëm, dhe vlerësohet në institucionin tonë si një faktor kyç për arritjen e qëllimeve strategjike. Një kulturë e fortë e të mësuarit të mirë-integruar individual dhe organizativ forcon kapacitetet e një SAI dhe i mundëson atij dhënien e efektit të dëshiruar. Në përpjekje për të arritur këtë Kryetari i KLSH-së në vitin 2012 nxori Udhëzimin nr. 3, nr. 1054, prot. datë 15.09.2012 "Për përsosjen arsimore profesionale të audituesve të KLSH-së". Në zbatim të këtij udhëzimi, krahas arritjeve të vitit 2013 në këtë vit vazhdojnë studimet në një fakultet të dytë, studime master, studime për doktoraturë, apo studime për pajisjen me certifikata të ndryshme 31 punonjës, 18.6 % e stafit përkatësisht si më poshtë:

- 6 punonjës vazhdojnë studimet për Drejtësi;
- 1 punonjës vazhdon studimet për Financë;

- 14 punonjës vazhdojnë studimet Master në Financë, Kontabilitet-Auditim, etj;
- 6 punonjës vazhdojnë studimet për Doktoraturë;
- 4 punonjës vazhdojnë studimet për pajisjen me certifikata si Ekspert Kontabël ose Vlerësimi i Pasurive të Paluajtshme.

3.3 *Trajnimi dhe Zhvillimi Profesional i Stafit*.

Standardi i Përgjithshëm i ISSAI 200, përcakton se "KLSH duhet të *adoptojë politika dhe procedura për të zhvilluar dhe trajnuar punonjësit e tij për t'i aftësuar që të kryejnë detyrën e tyre në mënyrë efektive dhe për të përcaktuar bazat për avancimit profesional të audituesve dhe stafit tjetër*"[1]. I angazhuar në kryerjen e misionit për të cilin është krijuar dhe funksionon, KLSH mbështetet fuqimisht në Standardet e INTOSAI-t duke i konsideruar si pjesë e përpjekjeve për rritjen e dijeve profesionale të institucionit[2].

Kontrolli i Lartë i Shtetit nëpërmjet Sistemit të Trajnimeve ka synuar dhe ka si qëllim *të sigurojë ndërtimin dhe forcimin e kapaciteteve audituese, rritjen dhe zhvillimin e tyre profesional përfshirë përgatitjen dhe të mësuarit në nivel institucional dhe kombëtar si dhe inkurajimin e pjesëmarrjes në aktivitete trajnuese ndërkombëtare, të udhëhequr nga motoja e INTOSAI-t "Experentia mutua omnibus prodest".*

Reformimi institucional gjatë ***tre viteve të fundit*** vuri në fokus të politikave të zhvillimit kapacitetet audituese, krijimin e kompetencave të larta profesionale, procese këto që vijuan të zhvilloheshin me sukses dhe gjatë vitit 2014. Procesi i Trajnimit, tashmë i riorganizuar dhe rikonceptuar në aspekte te rëndësishme jo vetëm për sa i përket formatit por dhe përmbajtjes e metodologjisë, ndikoi në mënyrë të vazhdueshme në rritjen dhe aftësimin e audituesve duke qenë tërësisht i orientuar drejt përmirësimit të cilësisë së auditimit.

Metodologjitë e reja të aplikuara në trajnime, organizimi dhe trajtimi i çështjeve të identifikuara nga procesi i vlerësimit, inventarizimit dhe analizës së nevojave të stafit për njohuri dhe aftësi në fusha të ndryshme të auditimit dhe lidhur me të, orientimi drejt rezultateve/outputit, ndikuan ndjeshëm në rritjen e nivelit të

2. Standardet e Auditimit INTOSAI, botim i KLSH, 2012, ISSAI 200, Standardet e Përgjithshme të SAI, faqe 106.

3. Bujar Leskaj, Hyrje, Standardet e Auditimit INTOSAI, botim i KLSH, Tiranë, 2012.

pjesëmarrjes së stafit në trajnime duke bërë të mundur arritjen e objektivit të vendosur në Programin Vjetor të vitit 2014, që çdo auditues të kishte mesatare të pjesëmarrjes deri në 25 ditë trajnimi/person dhe për çdo auditues të rekrutuar gjatë dy viteve të fundit niveli i trajnimit të mos ishte më pak se 30 ditë trajnimi/auditues të ri.

Treguesi i Performancës së pjesëmarrjes në trajnime e vendos KLSH në nivelet e larta të Institucioneve Ndërkombëtare Homologe të Auditimit të Lartë dhe njëkohësisht thekson dhe më shumë progresin e arritur nëse i referohemi eksperiencave trajnuese të para tre viteve kur numri tepër i kufizuar i trajnimeve dhe i personave që u angazhuan në të tilla aktivitete nuk lejuan që ky tregues të kalonte nivelin e 2,1-3,1 ditëve të trajnimit/person. Rezultatet e arritura që konsistojnë në ***12-fishin e mesatares së trajnimit*** për person dhe ecuria në vite, tregojnë për një qasje të qëndrueshme dhe të suksesshme që vihet re gjatë tre viteve të fundit.

Duke iu referuar të dhënave informuese lidhur me pjesëmarrjen për periudhën 5 vjeçare, 2010- 2014, është shume e dukshme se si reformimi i sistemit të trajnimeve si pjesë integrale e reformës institucionale në KLSH është zhvilluar i plotë, duke përfshirë çdo aspekt të ndërtimit dhe forcimit të kapaciteteve, shtrirja e tij ka qenë gjithëpërfshirëse duke i siguruar çdo individi të drejtën dhe mundësinë e të mësuarit dhe të trajnuarit. Grafiku i mëposhtëm tregon progresin tepër të rëndësishëm dhe të madh që është bërë lidhur me pjesëmarrjen në trajnime:

Grafiku nr. 25



Metodologjia dhe format e trajnimit

Gjatë vitit 2014, trajnimet vijuan të sillnin risitë e tyre nëpërmjet formave dhe metodologjive bashkëkohore sipas të cilave u ofruan aktivitete të shumëllojshme të zhvillimit të stafit.

Në përshtatje me burimet, trajnimet u organizuan:

Grafiku nr. 26



✓ **Trajnime brenda vendit:** Trajnime që janë organizuar duke u mbështetur nga ekspertë të brendshëm e të jashtëm, nga organizata apo institucione kombëtare apo ndërkombëtare si më poshtë:

- Trajnime në nivel institucional në KLSH: të cilat u organizuan mbi bazë ditore nga trajnues/auditues të lartë, Kryeauditues dhe Drejtues të Lartë të KLSH dhe u fokusuan në përditësimin e njohurive të fushave të veçanta dhe auditimit;

- Trajnime brenda çdo Departamenti Auditimi individualisht në formën e tryezave të diskutimit profesional në terma të rasteve nga praktikat audituese;

- Trajnime/workshop-e të ofruar nga Ekspertë të huaj, që përfshinë trajtimin e tematikave specifike të profesionit të auditimit në formatin e prezantimeve të kombinuar me raste studimorë nga eksperiencat e vendeve të tjera;

- Konferenca III-të Shkencore e KLSH "Auditimi Kombëtar në funksion të Qeverisjes Kombëtare" e ideuar dhe realizuar në një shtrirje punimesh dy ditore në formatin e sesioneve plenare të moderuar nga Kryetari i KLSH dhe përfaqësues të Institucioneve Supreme të Auditimit të Polonisë, Sllovenisë, Gjykatës Turke të Auditimit dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit të KE-së krijuan një gërshetim mjaft efektiv të qasjeve profesionale me ato akademike, kombëtare dhe ndërkombëtare në funksion të zhvillimit të kapaciteteve në nivelet më të larta

profesionale. Grafiku i mëposhtëm pasqyron skemën e organizimit të trajnimeve brenda vendit, gjatë vitit 2014.

Grafiku nr. 27

E-learning. Trajnimet on-line u ofruan kryesisht nga IDI, Programi i 3 i-ve për implementimin e Standardeve të INTOSAI-t që u ofrua në një set 35 orësh trajnimi on-linedhe mbuloi fushat e Auditimit të Pajtueshmërisë dhe të Auditimt të IT.

Këto trajnime kishin si qëllim përgatitjen e facilitatorëve/moderatorëve dhe më pas të certifikimit të tyre për kryerjen dhe mbështetjen e procesit të vlerësimit dhe zbatimit të Strategjisë për Implementimin e ISSAI-ve në KLSH.

- Trajnime të ofruara nga Shkolla e Administratës Publike ASPA dhe organizata të tjera profesionale e publike mbuluan nevojat për trajnime në fusha specifike që kanë lidhje tepër të rëndësishme me ushtrimin e funksionit të auditimit sikurse janë Prokurimet Publike, Legjislacioni Evropian, Procesi i Planifikimit të Integruar, Menaxhimi financiar dhe kontrolli, Gjurma e Auditimit, etj. Vazhdon seti i trajnimeve të organizuara nga KLSH në bashkëpunim me ASPA-n për "Prezantimin e Nëpunësve në Administratën Publike" duke siguruar jo vetëm përmbushjen në aspektin ligjor detyrues por mbi të gjitha frytshmërinë dhe dobinë e trajnimit për stafin pjesëmarrës të nivelit të lartë drejtues dhe të audituesve. Rezultatet e larta të vlerësimit dëshmuan për impaktin pozitiv që ky trajnim solli në drejtim të përfitimit të njohurive.

- Trajnimi on-line përfshiu dhe përmirësimin e nivelit të njohjes së gjuhës angleze. Stafi i përfshirë në trajnimin on-line të gjuhës anglezë me metodën "Tell me more" on-line u mbështet fuqishëm nga Kryetari i KSLH, duke monitoruar dhe nxitur vazhdimisht përmirësimin e njohurive për këtë gjuhë duke e konsideruar si një mundësi që zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve të kalojë kufijtë e studimit dhe trajnimit me materiale në gjuhën shqipe, por ti krijohet akses të gjithë audituesve të njihen dhe me praktikat ndërkombëtare dhe të marrin pjesë në aktivitete të

organizuara jashtë vendit, në pritje dhe të implementimit të projektit IPA gjatë vitit 2015.

- Trajnime "Prezantim me Institucionin e KLSH" u ofrohen audituesve të rinj si një set trajnimi 15 ditor dhe kanë si qëllim njohjen me ambjentin dhe kuadrin ligjor e procedurial të KLSH, Standardet e Auditimit për SAI-t (ISSAI), Udhëzuesit për Auditimin Financiar, Auditimin e Përputhshmërisë dhe Auditimin e Performancës si dhe prezantimin e përgjithshëm të punës nga çdo Departament Auditimi.

Përmbajtja e Trajnimeve

Programi i Veprimtarisë së Trajnimit të stafit të KLSH për vitin 2014 përcaktoi drejtimet kryesore të trajnimit përfshirë: tematikat kryesore, pjesëmarrësit dhe kohën e zhvillimit të trajnimit si dhe trajnuesit. Duhet theksuar se, gjatë implementimit si rezultat i rishikimit dhe vlerësimit të herëpashershëm të nevojave të stafit u organizuan dhe trajnime jashtë Programit të cilat kishin si qëllim, mbajtjen e trajnimit në terma realiste dhe sa më afër nevojave aktuale për njohuri në fushat specifike profesionale.

✓ ***Trajnimet përshinë njohuri mbi 4 llojet e auditimit:***

1. Auditimin e Sistemeve të IT;
2. Auditimin e Përputhshmërisë;
3. Auditimin Financiar;
4. Auditimi i Performancës.

Tematikat e trajnimeve u zhvilluan në përshtatje me nivelin e zhvillimit aktual të secilit lloj trajnimi por njëkohësisht duke u fokusuar në perspektivat e së ardhmes dhe Strategjinë e Zhvillimit. Kjo bëri që Auditimi i IT të vendosej në qendër të trajnimeve brenda dhe jashtë vendit por pa lënë mënjanë trajnimet e tjera që janë në fillimet e aplikimit sikurse Auditimi i Performancës dhe Auditimi Financiar.

✓ Rritja e cilësisë së auditimit ka përcaktuar nevojat gjithnjë në rritje për njohuri dhe dije të audituesve dhe në fusha të tjera që kanë lidhje të ngushtë me auditimin sikurse janë:

- Njohuri dhe përditësim mbi Legjislacionin kombëtar dhe Ndërkombëtar;
- Menaxhimi i Projekteve me Financim të Huaj;
- Përdorimi i mjeteve të IT në auditim, njohja dhe përfitimet e përdorimit;
- Integrimi në BE dhe Legjislacioni BE-së (acquis communaitaire);

- Menaxhimi i Financave Publike

Trajnimet në tematikat e mësipërme i ofruan audituesve një bazë të dobishme mbi të cilën ata mund të mbështeten për kryerjen e auditimeve me cilësi të lartë dhe në pajtueshmëri të plotë me Standardet dhe Rregullat e Auditimit.

Grafiku nr. 28



✓ Roli tepër i rëndësishëm dhe profesioni delikat i audituesit të jashtëm publik në dhënien e sigurisë mbi përdorimin e fondeve publike kërkon që audituesit të zotërojnë jo vetëm tiparet profesionale por dhe sjelljen etike dhe integritetin si pjesë të profilit të nëpunësit të lartë publik. Trajtimi i ISSAI-ve të niveli 1-3. Përfshirë Deklaratën e Limës, ISSAI 1, Deklaratën e Meksikos, ISSAI 10 dhe në mënyrë të veçantë ISSAI 30 dhe më pas ISSAI 100, 200, 300 dhe 400 shërbejnë si niveli bazë mbi të cilin gjatë vitit të ardhshëm do të organizohen dhe implemetohet IntoSAINT, metoda e vetëvlerësimit të integritetit.

Performanca e trajnimeve dhe treguesit

Grafiku nr. 29



Veprimtaria trajnuese e KLSH vjen në këtë analizë të vitit 2014 me tregues që pasqyrojnë performancë shumë të mirë dhe zhvillimi të qëndrueshëm të Sistemit të Trajnimit të ngritur prej tre vitesh në KLSH. Arritjet dhe për më tepër tejkalimi i treguesve të vendosur në objektivat e Planit vjetor, dëshmuan angazhimin dhe mbështetjen e madhe që KLSH i ka dhënë dhe vijon t'i japë procesit të rritjes dhe forcimit të kapaciteteve audituese, dhe njëkohësisht

angazhimin serioz në përgjithësi të stafit auditues për të mësuar dhe për t'u zhvilluar profesionalisht.

Treguesit e performancës së arritur gjatë vitit 2014 krahasuar dhe me periudhat e mëparshme përfshijnë sa më poshtë:

1. Arritja prej 26 ditë trajnimi/person gjatë vitit 2014 përfaqëson një rritje prej ***12 herë më shumë trajnime krahasuar me vitin 2011, kur ky tregues ishte vetëm 2,1 dt/p*** dhe për vitin ***2010 ishte 3.1 dt/p.***

2. Në total u kryen 3700 ditë persona të trajnuar ku mori pjesë i gjithë stafi i KLSH, duke vendosur një nivel të paarritur më parë në KLSH, përfshirë këtu trajnime të të gjitha llojeve, të cilat krahasuar me vitin 2011 ishin **227 d**he në vitin 2010 ishin **434** ditë persona trajnimi gjithsej, ndërkohë që ndryshimi i madh i ndodhur në 2012, ku u zhvilluan rreth 2800 ditë njerëz trajnime vazhdon të qëndrojë në nivele të larta gjatë tre viteve të fundit, sikurse pasqyrohet në grafikun e mëposhtëm:

Grafiku nr. 30



Ecuria e Trajnimit në 5 vitet e fundit në ditë persona të trajnuar

1. Rëndësi e veçantë i është dhënë organizimit të trajnimeve të posaçme për stafin e ri. Këto trajnime zënë 22% të gjithë totalit të trajnimeve të KLSH, të cilat bënë të mundur që treguesi për 30 ditë trajnimi/person për stafin e saporekrutuar të arrihet për një periudhë kohore më pak se një vit.

2. Trajnerët e angazhuar përfshijnë kryesisht staf me cilësi të larta profesionale dhe drejtuese brenda KLSH. Në trajnime u përfshinë 20 kryeauditues, auditues të

parë dhe Drejtues të Drejtorive apo Departamenteve dhe pjesa tjetër u ofrua nga ekspertë të jashtëm.

3.4 *Teknologjia e Informacionit IT*

Mbi modernizimin e infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit.

Duke e konsideruar tepër të rëndësishme rolin e përdorimit të teknologjisë së informacionit për të gjithë veprimtarinë e saj, KLSH ka përqendruar përpjekjet dhe ka mundësuar që infrastruktura e IT gjatë vitit 2014 të rinovohej plotësisht.

Në referencë sa më sipër si nëpërmjet investimeve në IT ashtu dhe nëpërmjet mbështetjes së partnerëve ndërkombëtarë TIKA-s u bë e mundur që i gjithë stafi i KLSH të pajiset me mjete kompjuterike PC Desktop të viteve të fundit ashtu dhe pjesa më e madhe me laptop.

Një ndërmarrje e tillë krijoi një bazë të fortë mbështetëse për stafin e KLSH për rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të punës.

Grafiku nr. 31



Rritja e shkallës së informatizimit të veprimtarisë është shoqëruar dhe me mbështetjen teknike dhe asistencën nga stafi i IT-së i cili ka punuar në mirëmbajtje të pajisjeve kompjuterike, duke përballuar punën në rritje në këtë drejtim.

Një risi në fushën e TI-së është dhe vendosja e Intranet WEB Portal për punonjësit e KLSH”.

Nën shembullin më të mirë të homologeve tanë me financim me fonde nga buxheti i shtetit **gjatë vitit 2014 u investua për riformatimin e intranetit të ri të KLSH** ne formën e një portali WEB që i mundëson punonjësve të KLSH të ndajnë mes tyre informacione dhe të dhëna të tjera elektronike, si brenda ashtu dhe nga jashtë institucionit.

Implementimi i këtij portal WEB në serverat e KLSH, në formën e një web-serveri virtual mbështetet mbi Cluster Microsoft Hyper-V ekzistues.

Për realizimin e tij u implementua një mekanizëm njohje dhe autorizimi që u mundëson punonjësve të KLSH një hyrje të sigurtë dhe të kontrolluar në ketë portal, si në LAN (rrjetin e brendshëm) ashtu edhe ne WAN (internet).

3.5 Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit

Urdhri i Kryetarit të KLSH më 15.10.2014, inicioi krijimin e Drejtorisë së Auditimit të TI-së si pjesë e Departamentit të Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm. Synimet e KLSH për të bërë pjesë të praktikave të saj audituese dhe Auditimet e Teknologjisë së Informacionit janë bërë prezentë që në Dhjetor të vitit 2011 në Projekt Ide-në e paraqitur pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë nga Kryetari i KLSH-së ku thuhej se *"Intensifikimi i përdorimit të metodave bashkëkohore të teknologjisë së informacionit do të jetë një nga instrumentet bazë të rritjes së performancës së punës së KLSH-së dhe do të lehtësojë kontrollet e kryqëzuara të transaksioneve financiare"*[3]. Strategjia e Zhvillimit te KLSH 2013 -2017 përcaktoi objektivat e KLSH për zhvillimin e auditimeve të këtij lloji, ku zhvillimi i auditimeve të TI-së është përfshirë si një nga objektivat strategjikë të periudhës duke përcaktuar gjithashtu dhe partneret dhe mbështetësit kryesorë të procesit.

Të mbështetur fillimisht që në vitin 2012 e në vijim nga SIGMA me trajnime në fushën e auditimit te TI-së dhe më pas të përfshirë në Programin e Trajnimit të IDI për audituesit e TI-së filluan përpjekjet e para për të përgatitur stafin që në të ardhmen do të bëhej pjesë e këtyre auditimeve. Krahas këtyre institucioneve, një

[3] Citim nga botimi i parë i projekt idesë së paraqitur pranë Komisionit të Ekonomisë dhe Financave nga Kryetari i KLSH-së në Kuvend.

numër i konsiderueshëm trajnimesh janë ofruar dhe nga Institucionet Homologe të Turqisë, Polonisë, Sllovenisë e Kroacisë.

Këto zhvillime kanë krijuar kushtet e përgjithshme me fokus në ndërtimin dhe më pas rritjen e kapaciteteve audituese për teknologjinë e informacionit dhe kanë pajisur ata me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të qenë të aftë të kryejnë të tilla auditime.

I konsideruar dhe nga audituesit profesionistë si një nga auditimet më komplekse, aplikimi i auditimeve të TI-së përbën një nga sfidat me të cilat KLSH ka filluar që të përballet gjatë 2014 që me krijimin e Drejtorisë së Auditimit të TI-së. Nevoja për staf të kualifikuar, të pajisur me njohuri profesionale të TI-së dhe njëkohësisht me dëshirën për zhvillim dhe mësim u përball me vështirësitë për të rekrutuar stafin e duhur dhe të përshtatshëm që do të mundësojnë suksesin në të ardhmen të këtij auditimi.

Për këtë qëllim, stafi i angazhuar në këtë Drejtori gjatë tremujorit të fundit të vitit 2014 u trajnua në drejtime të ndryshme sikurse është Programi IDEA, përdorimi i teknikave CAAT në auditim, menaxhimi i Riskut të TI-së dhe Auditimi i Sistemeve të TI-së. I rëndësisë së veçantë është trajnimi për certifikimin e audituesve të TI-së nga IDI on-line. Hap kryesor ishte ndërrmarja e misionit të vetëvlerësimit të Sistemeve të TI-së në KLSH me **moderimin e SAI-t Zviceran,** i cili shërbeu si pikë referimi për të vlerësuar nivelin e maturitetit të TI-së dhe përcaktimin e objektivave të zhvillimit për të ardhmen në këtë fushë.

Krahas trajnimeve, shumë rëndësi iu kushtua dhe përgatitjes së dokumenteve metodologjikë në fushën e auditimit të TI-së të cilat janë ende në zhvillim. Gjithashtu publikime të ndryshme me tematikë mbi teknologjinë e informacionit kanë shërbyer dhe do të shërbejnë për rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit dhe njohjes së auditimeve të TI.

Auditimi i sistemeve të TI-së është një nga sfidat e veprimtarisë audituese dhe do të përbëjë një nga prioritetet menaxheriale në vijimësi.

4 BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

4.1 Bashkëpunimi me Kuvendin

Marrëdhëniet e bashkëpunimit të KLSH me Kuvendin gjejnë shprehjen e tyre në një tërësi aktivitetesh të cilat përfshijnë:

- Bashkëpunimi për miratimin e Ligjit të Ri të KLSH;
- Raportimi dhe Informacione lidhur me Raportet Zyrtare për Komisionet e Kuvendit;
- Rezoluta e Kuvendit dhe puna e KLSH për implementimin e Rezolutës.

Bashkëpunimi për miratimin e ligjit ka filluar më 28.11.2012, me kërkesën e parë të KLSH-së drejtuar Kuvendit për marrjen në shqyrtim dhe propozimin nga e tij të projektligjit të ri të KLSH-së. Në datë 28.11.2013 KLSH i është drejtuar Kuvendit me kërkesën e dytë për marrjen në shqyrtim dhe propozimin nga e tij të projektligjit të ri të KLSH-së, data 27.11.2014 është data e miratimit të ligjit nga Kuvendi, dhe në datë 06.02.2015 është data e hyrjes ne fuqi (15 ditë pas botimit në fletoren zyrtare) e ligjit.

Në qershor të vitit 2014, Kuvendi i Shqipërisë miratoi rezolutën "Për Vlerësimin e Veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2013" dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit duke vlerësuar maksimalisht rëndësinë e rekomandimeve të kësaj rezolute hartoi Planin e veprimit për implementimin e këtyre rekomandimeve, një pjesë e të cilave përputhen plotësisht me objektivat strategjikë të zhvillimit te Institucionit për periudhën 2013-2017.

Nga analiza e veprimtarisë së Institucionit për periudhën korrik 2014-1 mars 2015, referuar edhe planit te veprimit për zbatimin e rezolutës, rezulton qe Kontrolli i Lartë i Shtetit ka realizuar ne pjesën më të madhe objektivat e vendosura, me përjashtim te atyre që lidheshin me miratimin e Ligjit të ri dhe me projektin IPA 2013, i cili nuk filloi te aplikohet ne periudhën e parashikuar. Një informacion më i plotë dhe i detajuar *mbi realizimin e Planit të Veprimit në kuadrin e Rezolutës do i paraqitet Kuvendit në qershor të vitit 2015 pasi një pjesë e masave dhe objektivave të vendosura përfundojnë në këtë periudhë që përkon me rekomandimet për harkun kohor të një viti.*

KLSH ka përvijuar punën dhe është angazhuar maksimalisht në zbatimin e politikave antikorrupsion, në funksion të detyrimeve kushtetuese, ligjore dhe të kërkesave të organizatave ndërkombëtare, rekomandimeve të progres-raporteve të Komisionit Evropian, me qëllim mbrojtjen e fondeve shtetërore të taksapaguesve shqiptarë. Aktualisht, KLSH po përshtat Rregulloren e Institucionit me ndryshimet që vijnë nga Ligji i ri i KLSH-së dhe po punon për Strategjinë e Menaxhimit të riskut (janë ngritur Grupe pune për të dyja këto çështje). KLSH ka filluar nga puna për rishikimin dhe përditësimin e Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së, për periudhën 2013-2017, në përputhje me zhvillimet e fundit në institucion.

4.2 Bashkëpunimi brenda vendit

KLSH vlerëson se një bashkëpunim produktiv mes strukturave publike dhe shoqërisë civile jep pa dyshim rezultate konkrete në rritjen e transparencës dhe përmirësimin e analizave ekonomike, nëpërmjet shfrytëzimit të të dhënave mbi indikatorët ekonomiko-shoqëror në Shqipëri, me qëllim përmirësimin e qeverisjes.

Institucioni ka përvijuar edhe gjatë 2014 me nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me OJF-të aktive në luftën kundër korrupsionit dhe me partnerë profesionalë (praktikë e filluar në vitin 2012 dhe 2013) që do të na ndihmojnë për të realizuar sfidat e ardhshme, siç janë modernizimi i institucionit, thellimi i luftës kundër korrupsionit dhe parandalimi i tij dhe konkretisht:

Në datën 19 maj 2014 u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit mes KLSH-së dhe Institutit Shqiptar të Shkencave (ISHSH), i cili realizon në Shqipëri projektin *Open Data Albania.*

Në zbatim të kësaj Marrëveshje, KLSH do të angazhohet për shkëmbimin e të dhënave me interes reciprok, duke hapur edhe një dritare tjetër komunikimi me publikun, me qëllim rritjen e transparencës. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi do të krijohet mundësia e shfrytëzimit të të dhënave të ndryshme të publikuara nga Open Data Albania që është një projekt serioz dhe i vlerësuar si brenda ashtu edhe jashtë vendit, për cilësinë e të dhënave dhe analizave që publikon e përgatit. Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje përforcon edhe një herë qasjen e re që ka KLSH ndaj Shoqërisë Civile, duke pasur parasysh dhe vlerësuar faktin që këto bashkëpunime gjenerojnë ide të reja dhe ndihmojnë në përmirësimin e luftës ndaj korrupsionit.

KLSH ka nënshkruar në datën 24 nëntor 2014, Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Shoqatën e Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë (SHKFSH), e cila drejtohet nga Prof. Dr. Sherif Bundo.

KLSH vlerëson bashkëpunimin me Shoqatat e Profesionistëve dhe kjo marrëveshje me SHKFSH vjen pas nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione homologe në Shqipëri, si me Institutin e Eksperteve Kontabël të Autorizuar (IEKA), Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit (KKK) dhe Shoqatën e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (SHKÇAK), duke e kthyer bashkëpunimin me këto shoqata të qëndrueshëm dhe në linja konkrete. Vlen për t'u përmendur që në Këshillin e Përgjithshëm të SHKFSH ka 18 profesorë me titull, të cilët do të jenë pjesë e këtij bashkëpunimi për çështje të caktuara, me qëllim përmirësimin e qeverisjes. Aktualisht, KLSH ka realizuar projekte konkrete bashkëpunimi me disa prej OJF-ve dhe organizatave të profesionistëve të fushës në këto drejtime:

- "Realizimi i transparencës dhe komunikimit të KLSH-së me publikun dhe qytetarët" nga Lëvizja Evropiane, Shqipëri;
- "Analiza e impaktit të shkrimeve të Audituesve të KLSH-së në shtypin e shkruar ", nga botuesi i Gazetës "Ekonomia";
- "Kontrolli i Cilësisë në të ftohtë" nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit; dhe
- "Kontrolli i Procesit të Rekrutimit të stafit të KLSH-së", nga Instituti "G&G Group".

Të gjitha këto projekte janë parë si *Mini Peer Review* dhe kanë nxjerrë produkte konkrete, ku janë evidentuar përveç arritjeve dhe mangësitë e dobësitë. Të gjitha rekomandimet e dhëna nga këto organizata do të shikohen me prioritet nga KLSH me qëllim përmirësimin e punës në të ardhmen.

Bashkëpunime me profesoratin e Universiteteve, me Organizatat e Profesionistëve të fushës dhe me OJF-të (deri tani KLSH ka nënshkruar 14 marrëveshje të tilla bashkëpunimi) ka përvijuar ngushtë edhe përgjatë vitit 2014, duke vlerësuar maksimalisht kontributin e tyre për Revistën Shkencore të KLSH-së, Konferencën e tretë Shkencore, trajnimet, rekrutimet e stafit, etj.

4.3 Bashkëpunimi ndërkombëtar

4.3.1 Projekti i Binjakëzimin nën Programin IPA 2013

Në kuadër të asistencës për Shqipërinë dhe të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit, IPA 2013, komponenti i I-rë, KLSH ka fituar një financim nga Bashkimi Evropian për ***"Forcimin e kapaciteteve të Auditimit të Jashtëm"*** me vlerë 2.11 milionë euro.

Ky projekt binjakëzimi është ndër 7 projektet e përzgjedhur nga BE për t'u implementuar në mënyrë të decentralizuar nga institucionet e shtetit shqiptar dhe DKBMJ do të veprojë si homolog për partnerin e binjakëzimit.

Zbatimi i Projektit IPA 2013 të KLSH-së, i cili nis në maj të vitit 2015, vjen pas miratimit të ligjit të ri organik për institucionin nga Kuvendi i Shqipërisë më 27 nëntor 2014, i cili shënon shkëputjen përfundimtare të KLSH-së nga kontrollet e tipit inspektim financiar dhe profilizimin e tij si një institucion modern evropian i auditimit suprem publik, i cili e bazon tërësisht aktivitetin e tij në standardet e INTOSAI-t dhe moton e kësaj organizate *"Experentia mutua Omnibus prodest (Nga eksperienca e përbashkët përfitojnë të gjithë"*.

Projekti do të jetë një mbështetje e rëndësishme teknike për zbatimin e ligjit të ri, diversifikimin e mëtejshëm të llojeve të auditimeve të KLSH-së dhe rritjes së cilësisë së tyre. Fisha teknike e projektit u qarkullua nga Komisioni Europian në 28 vendet anëtare të BE-së dhe në datën 5 dhjetor 2014, u zhvillua procesi i selektimit të SAI-ve që aplikuan dhe që ishin të interesuara për këtë projekt.

Në datën 22 janar 2015, Delegacioni i BE në Tiranë ka shpallur fituesit e këtij Projekti dhe konkretisht janë dy SAI partnere europiane, NIK-u polak dhe SAI Kroat, me të cilët ne kemi pasur një bashkëpunim shumë të mirë këto tre vitet e fundit.

Ky projekt i financuar nga BE, me kohëzgjatje 2 vjeçare (deri në maj të vitit 2017), është pa diskutim një mbështetje e fortë por është njëkohësisht edhe një nga sfidat e radhës së KLSH-së, i cili ka treguar në vitet e fundit që po punon fort dhe po realizon cilësisht objektivat e tij, duke ecur në mënyrë të sigurt në rrugën e tij të modernizimit, atë të realizimit të auditimeve të tij në përputhje të plotë me standardet INTOSAI dhe praktikat më të mira të vendeve anëtare të Bashkimit Europian.

4.3.2 Shkëmbimi eksperiencave dhe trajnimeve nga Institucione Ndërkombëtare

Përgjatë vitit 2014, ka vijuar bashkëpunimi i suksesshëm me SNAO-n dhe JWGAA. Kështu, audituesit e KLSH-së kanë marrë pjesë në sesionet e trajnimit të organizuar nga SNAO në bashkëpunim me ZAP-in e Kosovës mbi auditimet e performancës ashtu si edhe në workshopet mbi Auditimet paralele të performancës mbi "Eficiencën e energjisë", të zhvilluara në Tiranë dhe Bosnje dhe Hercegovinë.

Kryetari i KLSH-së, z. Bujar Leskaj me Drejtues të SAI-ve homologe, në Rumani.

Përfitimi i statusit të vendit kandidat për në BE, solli për KLSH-në edhe intensifikimin e marrëdhënieve dhe të bashkëpunimit konkret me ECA-n, Gjykatën Europiane të Audituesve. Një tjetër vlerë e shtuar kjo për institucionin ku KLSH përfiton nga përvoja më e mirë e një prej institucioneve më prestigjioze europiane. Për herë të parë, auditues të KLSH-së do të jenë pjesë përbërëse e strukturave të ECA-s, të cilët përfituan nga programet e internshipit të këtij institucioni, të drejtën për të kontribuar pranë departamenteve dhe drejtorive të ndryshme të ECA's.

Vizitat Zyrtare të zhvilluara nga delegacionet e KLSH-së të kryesuara nga z. Leskaj në SAI-n e Polonisë, Turqisë, në Gjykatën e Audituesve të Rumanisë, në Zyrën Shtetërore të Auditimit të Kroacisë u ndoqën më pas me disa vizita studimore (një formë e zgjeruar e trajnimit) të grupeve të audituesve të KLSH në Institucione homologe të këtyre vendeve.

Foto e një grupi audituesish të KLSH-së me Prof. Ass. Dr. Recai Akyel, President i Gjykatës Turke të Llogarive

Kryetari i KLSH-së me Presidentin e Gjykatës Europiane të Audituesve, Viktor Manuel da Silva Caldeira

Kryetari i KLSH-së z. Bujar Leskaj së bashku me z. Krzysztof Kwiatkowski, Presidenti i SAI-t Polak dhe z. Wojciech Kutyła, Zëvëndës-President i SAI-t Polak, gjatë vizitës zyrtare në Poloni.

Trajnimet e ofruara nga Institucionet ndërkombëtare përfshijnë aktivite brenda dhe jashtë vendit.

SIGMA ka vijuar të jetë partneri strategjik i KLSH në mbështetjen që i ka dhënë prej tre vitesh në vijim Kontrollit të Lartë të Shtetit në drejtim të ngritjes dhe zhvillimit të kapaciteteve audituese. Nëpërmjet Këshilltarit të Lartë z. Joop Vrolijk, SIGMA ka qenë prezente në Shqipëri me trajnime të nivelit të lartë profesional, duke krijuar njëkohësisht një bazë të qëndrueshme për zhvillimin e pavarur të një sistemi efektiv trajnimesh. Të konceptuara në sesione tre ditore, grupe prej 25-30 audituesish u trajnuan në çështje të ndryshme të fushës së auditimit duke filluar nga "Elementët Bazë të Profesionit" (trajtim ky i disenjuar për stafin e ri deri tek çështje tepër specifike dhe qasje moderne sikurse Auditimi mbi Bazë Sistemi, Auditimi i Prokurimeve, Auditimi i Projekteve me Financim të Huaj. Dobishmëria e të tilla aktiviteteve u shtri përtej trajnimit deri në identifikimin e mundësive për përmirësime dhe zbatueshmëri në të ardhmen. Me rekomandime dhe këshilla tepër të dobishme SIGMA ka mbështetur KLSH për vitalizmin dhe nxitjen e inovacionit në këtë institucion.

Trajnime janë organizuar në bashkëpunim me SAI homologe të vendeve të tjera apo institucione të tjera ndërkombëtare që ofrojnë trajnime të fushës së auditimit si dhe pjesëmarrje ne konferenca ndërkombëtare te fushës. Pjesëmarrja e stafit të KLSH në veprimtari trajnimi dhe zhvillimi jashtë vendit të klasifikuara për nga mënyra e organizimit tregohet në grafikun e mëposhtëm:

Grafiku nr. 32



Gjatë vitit u trajnuan 125 persona jashtë vendit që përfaqësojnë 86 % të stafit të KLSH duke arritur një mesatare trajnimi afërsisht 6 ditë trajnimi/person jashtë vendit përkatësisht në:

- Trajnime të organizuara në formën e vizitave studimore dhe worshope-ve në Institucionet Homologe SAI të vendeve të ndryshme në kuadrin e zbatimit të Marrëveshjeve të Bashkëpunimit që KLSH ka nënshkruar dhe vijon të nënshkruajë me këto institucione për shkëmbim eksperiencash dhe të dijeve midis audituesve të vendeve të ndryshme. Gjykata Turke e Llogarive dhe NIK i Polonisë kanë vijuar të jenë ofruesit kryesorë për trajnime të stafit të KLSH pranë institucioneve të tyre duke u kthyer kështu dhe në mbështetësit më të fuqishëm në procesin e ndërtimit të kapaciteteve audituese të pajisura me njohuri dhe eksperienca ndërkombëtare.

- KLSH përgjatë vitit 2014 ka qenë pjesëmarrës dhe kontribues aktiv në takimet e Grupeve të Punës dhe Komisioneve të organizuara nga INTOSAI dhe EUROSAI. Politika e hapur ndaj eksperiencave ndërkombëtare në fushën e auditimit publik ka sjellë një ndryshim rrënjësor lidhur me konceptimin e përfaqësimit të Auditimit Publik Shqiptar në rrjetet profesionale ndërkombëtare. Angazhimi i stafi të KLSH në Grupe Pune, Task Force dhe aktivitete të tjera ndërkombëtare ka shkuar përtej pjesëmarrjes së thjeshtë, KLSH është vendosur në nivelet e kontribuesve më aktivë duke treguar profesionalizëm të lartë. Sot KLSH është pjesë e disa Grupeve të punës të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t si dhe pjesë e TASK Forcës për Etikën etj.

- Pjesëmarrja në Kongreset e Organizatave Profesionale Ndërkombëtare, INTOSAI, EUROSAI, etj., ka mundësuar prezantimin e KLSH me një profil të ri, të orientuar drejt një të ardhme për një auditim publik modern dhe të mbështetur fuqishëm në Standardet e INTOSAI.

- Seminare trajnimi të organizuara nga institucione publike ndërkombëtare në fushën e menaxhimit të financave publike dhe auditimit. Megjithë mundësitë e limituara, KLSH është përpjekur të shfrytëzojë më së miri pjesëmarrjen në seminare dhe trajnime të organizmave profesionale ndërkombëtarë për punonjës publikë sikurse është CEF/Qendra e Ekselencës në Financë, Slloveni, trajnime të tjera të organizuara nga IDI etj. Me një përzgjedhje të kujdesshme, audituesit që kanë marrë pjesë në të tilla trajnime kanë shërbyer si trajnerë që eksperiencat dhe njohuritë e fituara tí shpërndajnë midis kolegëve auditues, në mënyrë që askush të mos ndjehet i përjashtuar nga marrja e dijeve dhe njohurive.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, përveç të qenit anëtar i Grupit të Punës së EUROSAI-t për Auditimet e Mjedisit dhe i Task Forcës mbi Auditimin dhe Etikën, gjatë vitit 2014, u pranua dhe tashmë është anëtar edhe i Grupit të Punës së EUROSAI-t si ai mbi Auditimin e Fondeve të alokuara për fatkeqësitë dhe katastrofat, duke dhënë një kontribut të konsiderueshëm në aktivitet e këtyre grupeve dhe duke e përcjellë eksperiencën më të mirë të vendeve anëtare për ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve të veta audituese.

Krahas sa më sipër KLSH është anëtare e Grupit të Punës për rishikimin e Standardit Ndërkombëtar të Auditimit "Kodi Etik" ISSAI 30.

Përgjatë vitit 2014, theksojmë pjesëmarrjen në 34 takime të rëndësishme si kongrese, konferenca, takime, seminare, trajnime, (këto të fundit edhe në kuadrin e zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me SAI-et homologe), përfshirë dhe pjesëmarrjen në Simpoziumin Ndërkombëtar lidhur me sfidat e IT për auditimin e jashtëm dhe Takimin e 9 të Grupit të Punës për Teknologjinë e Informacionit të EUROSAI organizuar nga Gjykata e Auditimit e Gjermanisë, me rastin e 300 vjetorit të themelimit të saj, Potsdam, Gjermani.

4.3.3 *KLSH në Kongresin e IX-të EUROSAI*

Në datat 16 deri më 19 Qershor 2014, në Hagë zhvilloi punimet Kongresi i IX-të i Organizatës Europiane të Institucioneve Supreme të Auditimit, EUROSAI, me pjesëmarrjen e delegacioneve nga 50 Institucionet Supreme të Auditimit të Europës si dhe të ftuar të tjerë, ndër të cilët Gjykata Europiane e Llogarive, Organizata IDI dhe SIGMA me tematikë "Inovacionin".

Inovacioni ishte tema qendrore e këtij Kongresi, nën moton "Kur ka qenë hera e fundit që ke bërë diçka për herë të parë?", me synimin final për të kontribuar në përmirësimin e vazhdueshëm të auditimit publik.

Në përmbushje të objektivave të tij, në këtë kongres diskutimet zyrtare u alternuan me paraqitje artistike dhe jo formale të njerëzve të suksesshëm nga bota e artit dhe biznesit. KLSH dha kontributin e tij në workshop-in "Open mic" ku u prezantua bashkëpunimi i KLSH me Organizatat e Shoqërisë Civile, duke u fokusuar në rëndësinë dhe domosdoshmërinë e këtij bashkëpunimi si dhe në përfitimet që ai mbart. Ky prezantim ngjalli interes tek të pranishmit dhe u konsiderua një mënyrë inovative për të rritur llogaridhënien, transparencën dhe impaktin e SAI-t në publik.

Gjithashtu, duke qenë se KLSH është pjesë e Task Forcës së ngritur mbi integritetin dhe etikën, në bashkëpunim me SAI-n e Kroacisë, u krye moderimi i workshop-it mbi "Vlerën më të mirë të parasë nëpërmjet respektimit të etikës në procesin e prokurimit publik".

Konkluzionet dhe rekomandimet e miratuara në Deklaratën përfundimtare të këtij Kongresi kishin si qëllim të jepnin orientime se si Institucionet Supreme të Auditimit në Europë do të punojnë në tre vitet e ardhshme, kryesisht në lidhje me inovacionin. Veprimet duhen ndërmarrë në tre fusha të ndryshme: kulturë dhe lidership, transmetimi i mesazhit dhe "Open Data".

KLSH konsideron këto ngjarje si tepër të rëndësishme dhe të dobishme për përcaktimin e objektivave të së ardhmes, dhe jo vetëm. KLSH ka treguar angazhimin për tí zbatuar në punën dhe vendimet për zhvillimin. Kryerja e analizës së

veprimtarisë për vitin 2014 nën dritën e metodologjisë IntoSAINT është një tregues real i qëndrimit pozitiv aktiv të KLSH ka ndaj Institucioneve Ndërkombëtare dhe praktikave të tyre të përparuara.

4.3.4 *Bashkëpunimi dhe pjesëmarrja në Konferencën e III-të Shkencore të organizuar nga KLSH.*

Konferenca e III-të shkencore e KLSH-së, nga risi në traditë

Në vijim të traditës pozitive të krijuar nga KLSH gjatë tre viteve të fundit, në datat 29-30 tetor 2014 u organizua në Tiranë, Konferenca e Tretë Shkencore e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Ajo erdhi pas Konferencës së Parë Shkencore, të zhvilluar në dhjetor 2012, një forum kushtuar tërësisht historikut të KLSH në 87 vjetorin e themelimit të tij dhe në 100 Vjetorin e Pavarësisë së Shtetit Shqiptar. Konferenca e Dytë Shkencore, e dhjetorit 2013, u përqendrua në rolin e institucioneve supreme të auditimit për një menaxhim financiar të përgjegjshëm në sfidat e sotme, duke e shpalosur të plotë karakterin e saj shkencor dhe duke sjellë punime me vlerë, gjetje e rekomandime cilësore nga studiues e profesionistë të auditimit privat e publik, si dhe të financave publike, nga jashtë dhe brenda vendit.

Konferenca e fundit strukturoi, thelloi dhe konsolidoi më tej natyrën e saj kërkuese shkencore, hulumtuese e të dhënies së rekomandimeve, duke shtjelluar temën e saj qendrore: ***Auditimi kombëtar në shërbim të qeverisjes kombëtare***.

Konferenca realizoi avokatinë e plotë të profesionit të financierit publik, kontabilistit dhe audituesit publik suprem, duke përcjellë mesazhin se pa financierë,

kontabilistë dhe auditues të përgatitur mirë dhe me integritet të lartë, qeverisja e vendit humbet shumë në llogaridhënie, transparencë, efektivitet dhe eficiencë. Audituesi suprem profesionist luan jo vetëm rolin e w*atchdog* për financat publike dhe menaxhimin e fondeve të Shtetit, por edhe atë të "bilbilfryrësit" (*whistle-blower*), duke denoncuar rastet e abuzimit me fondet publike dhe duke bashkëpunuar me institucionet e tjera të Shtetit, me shoqërinë civile dhe me mediat, për kufizimin e rasteve të mashtrimit financiar dhe korrupsionit, si dhe vendosjen e kulturës së ndëshkueshmërisë së funksionarëve publikë që abuzojnë.

Ndër mesazhet kryesore të aktivitetit, nga shumica e kumtesave të paraqitura, përmirësimi i cilësisë së menaxhimit të financave publike, si një mjet për të optimizuar arritjen e objektivave kombëtarë të zhvillimit strategjik, u prezantua si sfida kryesore në shumë vende. Konferenca dha tezën se, duke përmirësuar proceset dhe institucionet buxhetore, cilësia e financave publike rritet, ndërkohë që eficienca, efektiviteti dhe transparenca përbëjnë sot tre objektivat themelorë të buxhetimit modern.

Prej tre dekadash është hera e parë që realizohen forume të tilla shkencore dhe kjo i dedikohet filozofisë së menaxhimit "Ton at the Top" të KLSH-së, që e ka orientuar institucionin drejt një pune profesionale në auditim, e cila prodhon risi, inovacion dhe kërkim shkencor.

Konferencën e nderoi me praninë e tij Presidenti i Republikës, SH.T.Z. Bujar Nishani, Ambasadori i SHBA-ve, SH.T.Z. Aleksander Arvizu, Deputeti i Parlamentit Evropian, z. Igor Sholtes, njëkohësisht edhe Zv/Kryetar i Komisionit të Buxhetit në PE, Këshilltari Kryesor i Drejtorit të Përgjithshëm të DG-Budget dhe Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Komisionin Evropian, z. Robert Gielisse, Presidentit e institucioneve supreme të auditimit (SAI-ve) të Kroacisë dhe Malit të Zi, z. Ivan Klesiç dhe z. Milan Daboviç, etj., të cilët përcollën mesazhet, vlerësimet e tyre për këtë aktivitet shkencor. Në Konferencë u lexua përshëndetja nga Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAI-t, Dr. Josef Moser, prej Drejtorit të Përgjithshëm të Gjykatës Austriake të Audituesve, z. Wolfgang Wiklicky dhe z. Joop Vrolijk, Këshilltar i Lartë i SIGMA/OECD.

Konferencën e përshëndetën edhe dy deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, Sekretari i Komisionit të Ekonomisë dhe Financës e akademiku Prof. Dr. Anastas Angjeli dhe Zëvëndës Kryetari i Kuvendit z. Edmond Spaho, të cilët theksuan hapat e bërë vitet e fundit nga KLSH në drejtim të kryerjes së auditimeve me cilësore dhe shtimit të

kapaciteteve profesionale të audituesve. Ata garantuan një bashkëpunim të frytshëm të Kuvendit me KLSH në të ardhmen

Konferenca e III-të Shkencore e KLSH realizoi ndërveprimin me komunitetin shkencor të auditimit dhe të financave publike në Shqipëri, të përfaqësuar denjësisht në forum nga organizatat profesionale të fushës, si Këshilli Kombëtar i Kontabilistëve, IEKA, etj, por edhe nga akademikë të njohur, profesorati shqiptar dhe studiues të financave publike. Ky ndërveprim u zgjerua dhe shkoi më thellë, duke u ballafaquar me idetë, studimet, gjetjet dhe rekomandimet e ekspertëve të institucioneve supreme të auditimit (SAI-ve), partnere të KLSH-së dhe përfaqësuesve të lartë të institucioneve si Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit (DG-Budget) e Komisionit Evropian, SIGMA, etj. Konferenca solli eksperiencat më të reja të SAI-ve partnere në fushën e auditimit të jashtëm publik dhe përmirësimit të qeverisjes, duke thelluar luftën ndaj korrupsionit. Diskutuesit, sidomos përfaqësuesit nga SAI polak (NIK), nga Gjykata e Llogarive e Turqisë, SAI Kroat, Austriak, Malit të Zi, etj., dhanë përvojat e tyre gjatë auditimit, për të luftuar korrupsionin dhe mashtrimin financiar, duke treguar format më frytdhënëse të bashkëpunimit me institucione të tjera publike, me shoqërinë civile, mediat, etj., për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së administratës shtetërore. Aktiviteti u shndërrua në një forum shkëmbimi e ballafaqimi mendimesh, idesh dhe eksperiencash, sepse studiuesit shqiptarë sollën realitetet e tyre në organizimin e kontabilitetit, financave publike dhe auditimit në Shqipëri. Konferenca shkencore e KLSH-së është shndërruar tashmë në një forum të konsoliduar dhe takim të mirëpritur, ku debatohet gjerësisht dhe në thellësi për mënyrat e shëndoshjes së financave publike dhe rritjen e rolit të auditimit publik të jashtëm e të brendshëm, për forcimin e ndërveprimit mes tyre, etj. Aktiviteti mori vlerësimin maksimal të shumë personaliteteve të vendit dhe të huaja që morën pjesë dhe përshëndetën punimet e Konferencës. Profesorati shqiptar, i përfaqësuar denjësisht në Konferencë nga emra të njohur në fushën e analizës së riskut, financave publike, kontabilitetit dhe auditimit, etj, si Prof. Dr. Skënder Osmani, Prof. Dr. Omer Stringa, Prof. Dr. Jorgji Bollano, Prof. Dr. Aurela Anastasi, Prof. Ass. Dr. Sazan Guri, Prof. Ass. Dr. Hysen Çela, Dedë Kola, etj, dha ide, mendime dhe propozime konkrete për përmirësimin e auditimit të jashtëm dhe të brendshëm publik në Shqipëri. Kjo Konferencë u mundësua në sajë të mbështetjes të institucioneve supreme të auditimit (SAI-ve), partnere të KLSH, si SAI polak, kroat, malazes, austriak, etj, si dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit (DG-Budget) pranë Komisionit Evropian.

5. VLERËSIME

Shprehje e vlerësimeve nga institucione dhe personalitete të vendit dhe ndërkombëtarë, për punën dhe zhvillimin e auditimit të jashtëm publik në Shqipëri, nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

5.1 Vlerësimet dhe rekomandimet e BE në Progres Raportin 2015 për KLSH-në

(*nga **ALBANIA REPORT 2015**, në kapitullin 32 "Kontrolli financiar", në faqen 73, publikuar në muajin nëntor 2015)*

EUROPEAN COMMISSION

Brussels, 10.11.2015
SWD(2015) 213 final

COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT

ALBANIA
2015 REPORT

Accompanying the document

COMMUNICATION FROM THE COMMISSION TO THE EUROPEAN PARLIAMENT, THE COUNCIL, THE EUROPEAN ECONOMIC AND SOCIAL COMMITTEE AND THE COMMITTEE OF THE REGIONS

EU Enlargement Strategy

{COM(2015) 611 final}
{SWD(2015) 210 final}
{SWD(2015) 211 final}
{SWD(2015) 212 final}
{SWD(2015) 214 final}
{SWD(2015) 215 final}
{SWD(2015) 216 final}

EN EN

"*Përderisa një ligj i rishikuar i KLSH, në linjë me orientimet e INTOSAI-t, u miratua në shkurt 2015, ka një kuadër të përshtatshëm kushtetues dhe ligjor për të garantuar pavarësinë funksionale dhe vepruese të institucionit suprem të auditimit (SAI-t). KLSH ka 149 vende pune, të cilat nuk janë të mjaftueshme të mbulojnë mandatin e tij me auditime, duke i përfshirë të gjitha institucionet publike.*

Për të ndihmuar fuqizimin e kapaciteteve të tij institucionale, KLSH ka përditësuar planin e tij të zhvillimit strategjik për periudhën 2015-2017, i cili parashikon përmirësimin e cilësisë së punës audituese, në përputhje me standardet INTOSAI. Ndërsa KLSH si SAI mund të kryejë çdo lloj auditimi, ai në pjesën dërmuese kryen auditime të përputhshmërisë ligjore, duke përcaktuar dëmin ekonomik dhe shkeljen e ligjeve, më tepër se sa të fokusohet në mënyrën se si të parandalohen të tilla dëme.

Auditimet financiare ende nuk përfundojnë në opinione profesionale auditimi. Auditimet e performancës duhet të rriten në numër dhe të përputhen plotësisht me standardet ndërkombëtare. Manualet e auditimit janë, por kanë nevojë të rishikohen, për t'u përputhur me standardet e INTOSAI-t.

Impakti i punës audituese është i kufizuar për shkak të numrit të ulët të institucioneve të audituara. Në vitin 2014, KLSH përfundoi 160 auditime, duke zbuluar parregullsi që totalizojnë 11.19 miliardë Lekë. SAI denoncoi në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm 41 raste për 149 zyrtarë, si pjesë e luftës kundër krimit ekonomik, mashtrimit dhe korrupsionit.

Raportet e auditimit përmblidhen çdo tre muaj dhe botohen në faqen e internetit të KLSH-së. Ministria e Financave zhvilloi një plan veprimi për ndjekjen e gjetjeve të SAI-t, por një ndjekje sistematike ka nevojë të fuqizohet akoma. Raporti vjetor për auditimet që KLSH çon në Parlament, diskutohet në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, por sërisht nuk ka ndjekje sistematike parlamentare".

5.2 SH.T.Z. Bujar Nishani, President i Republikës së Shqipërisë

(*nga përshëndetja në Konferencën e Tretë Shkencore të KLSH, Tiranë, 29-30 tetor 2014*)

"*Dëshiroj njëkohësisht të vlerësoj në mënyrë shumë të hapur dhe shumë të sinqertë arritjet e dallueshme qoftë në dinamikë qoftë dhe në cilësi të Kontrollit të Lartë të Shtetit gjatë viteve të fundit, ashtu siç dëshiroj të vlerësoj eksperiencën e vyer që mblodhi gjatë gjithë viteve te funksionimit të këtij institucioni që nga krijimi i tij. Fakti që ky institucion ka në objektin e punës së tij paranë publike por njëkohësisht dhe mënyrën e*

*trajtimit ligjor të saj **na bën të gjithë të përgjegjshëm dhe të angazhuar**, jo vetëm për të qenë pjesë e këtyre tryezave të kësaj konference, si pjesë e ndarjes së përgjegjësive të përbashkëta, por njëkohësisht për të qenë të qartë në objektivat e gjithsecilit prej nesh për të pasur angazhime konkrete të bashkëveprimit dhe ndërveprimit midis institucioneve, njëkohësisht për të qenë të qartë në raport me publikun, me qytetarin në raport me jetën e përditshme të Shqiptarëve.*

5.3 Ambasadori i SHBA në Shqipëri, SH.T.Z. Alexandër A. Arvizu

(*nga përshëndetja në Konferencën e Tretë Shkencore të KLSH, Tiranë, 29-30 tetor 2014*)

"Në një qeveri, një auditues i mirë është i pavarur dhe kujdesshëm. Një shoqëri demokratike duhet të veprojë me auditues të mirë. Ata janë "rojtarët" që hedhin dritë mbi prokurimet, punësimin dhe shpenzimet e qeverisë. Në luftën kundër korrupsionit, është vendimtare të pasurit e një zëri të ndershëm, të saktë, të kujdesshëm dhe – më e rëndësishmja – të pavarur për të ruajtur burimet e njerëzve.

Kontrolli i Lartë i Shtetit është një administrues i rëndësishëm për Shqipërinë, mbikëqyr proceset teknike dhe financat e agjencive të qeverisë për të zbuluar shpërdorimin, mashtrimin dhe abuzimin.

Në luftën kundër korrupsionit, Shqipëria ka vënë një shembull të mirë për rajonin duke krijuar Njësitë e Përbashkëta Hetimore (NjPH). NjPH-të ndërthurin prokurorët me Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Financave, Shërbimin Informativ Shtetëror, Inspektoriatin e Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, dhe sigurisht me Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka qenë një partner i përkushtuar dhe jetik për Njësitë e Përbashkëta Hetimore. Në vitin 2012 ai iu referoi NJPH-ve 15 çështje. Më 2013 referimet u rritën në 25. Ndonëse viti 2014 nuk ka përfunduar ende, Kontrolli i Lartë i Shtetit iu ka referuar tanimë 29 çështje NJPH-ve.

Ndërsa Shqipëria i afrohet BE-së, është inkurajuese të shohësh që Kontrolli i Lartë i Shtetit të bëhet më aktiv dhe profesional dhe që bashkëpunon më shumë me të tjerët. Dhe sigurisht, të gjithë inkurajojmë një bashkëpunim më të madh dhe partneritete mes institucioneve audituese të shteteve të tjera, përfshirë ata të përfaqësuar në këtë konferencë këtë javë".

5.4 Dr. Igor Soltes, Anëtar i Parlamentit Europian

(*nga përshëndetja në Konferencën e Tretë Shkencore të KLSH, Tiranë, 29-30 tetor 2014*)

"Si Nënkryetar i Komisionit të Kontrollit Buxhetor të Parlamentit Europian, shpreh mirënjohjen ndaj Dr. Leskaj, Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, për ftesën e tij dhe për mundësinë që më dha që t'ju përshëndes juve në Konferencën e Tretë Shkencore. Urimet e mia për këtë ngjarje të veçantë!

Si ish-president i Gjykatës Sllovene të Auditimit, kuptohet që doja të shfrytëzoja njohuritë dhe eksperiencat e mia në mënyrën më të mirë dhe ju bashkova Komisionit të Kontrollit të Buxhetit të Parlamentit Europian.

Është interesante që tani jam pjesë e linjës së marrjes së produkteve të Gjykatës Europiane të Audituesve si raporte, rekomandime, raporte speciale, prej të cilave merret një informacion shumë i rëndësishëm, nga i cili varet puna e Komisionit. Një

pozicion i veçantë dhe i përshtatshëm për mua sepse më jep mundësinë të shikoj dhe të ndjek politikisht punën e audituesve të Luksemburgut. Brenda komisionit më është dhënë përgjegjësia e veçantë e marrëdhënieve dhe mbikëqyrjes së Gjykatës Europiane të Audituesve.

Në vijim mund të them se kam besim që bashkëpunimi ynë do të jetë edhe më i fuqishëm në nivele të ndryshme dhe e ardhmja jonë do të na rezervojë shumë gjëra interesante! Do të jem i lumtur dhe i nderuar të bashkëpunoj me ju në zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit tonë të ndërsjellë!"

5.5 Z. Robert Gielisse, Këshilltar Kryesor i Drejtorit të DG-Budget

(*nga përshëndetja në Konferencën e Tretë Shkencore të KLSH, Tiranë, 29-30 tetor 2014*)

"I nderuar Presidentit i Republikës së Shqipërisë, SH.T.Z. Bujar Nishani,

Si një nga bashkëkryetarët e kësaj Konference Shkencore të KLSH-së, në emër të të gjithë pjesëmarrësve, më lejoni t'Ju falënderoj për fjalën Tuaj frymëzuese.

Prania juaj sot në këtë Konferencë është një nder i madh dhe është perceptuar nga të gjithë si një sinjal i rëndësishëm i besimit Tuaj ndaj Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe ndaj vlerave thelbësore që ky institucion ka. Ndër këto vlera mund të përmendim në veçanti: Pavarësinë; Objektivitetin dhe Paanshmërinë; Integritetin; Konfidencialitetin; Kompetencën.

Këto vlera universale kryesore janë ato në të cilat mbështeten draft-ndryshimet në ligjin për KLSH-në, që do t'i sigurojnë institucionit të bëjë detyrën e tij, auditimin e jashtëm të të ardhurave dhe shpenzimeve publike, në përputhje me Standardet

Ndërkombëtare dhe ato të INTOSAI-t. Ky draft është mirëpritur pozitivisht nga të gjitha palët e përfshira, si në Shqipëri ashtu dhe jashtë saj, në veçanti nga Bashkimi Evropian dhe ka marrë miratimin e Komisionit kompetent në Parlament. Ai do të votohet në Parlament së shpejti.

***Zoti President**, ky vit ka qenë i shënuar për vendin tuaj, sepse Shqipëria u bë një vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Rruga për këtë qëllim të përbashkët nuk do të jetë e lehtë. Shumë gjëra duhet të përshtaten, për të siguruar objektivat kryesore të tilla si qeverisja ekonomike.*

Bashkimi Evropian e vë theksin në përmbushjen e këtyre objektivave dhe njeh rolin e rëndësishëm që ka auditimi i jashtëm publik për arritjen e tyre.

Ne jemi të bindur se KLSH, po avancon në procesin e të qenurit një institucion që vepron në përputhje me standardet e INTOSAI, si mbrojtës i burimeve publike dhe unë kam besim që KLSH çdo herë është e gatshme ta përmbush këtë rol.

5.6 Përshëndetja e Sekretarit të Përgjithshëm të INTOSAI-t, dhe Presidentit të Gjykatës Austriake të Auditimit, Z. Josef Moser

*(kjo përshëndetje u përcoll në Konferencë **nga Drejtori i Përgjithshëm i Gjykatës Austriake të Auditimit, z. Wolfgang Wiklicky)***

Institucioni Shqiptar i Auditimit dhe Gjykata Austriake e Auditimit (ACA) kanë bashkëpunuar ngushtë gjatë dekadave të fundit

Mbështetja teknike ka vazhduar gjatë viteve.

Në vitin 2013 ky bashkëpunim mori një kuptim të ri pas nënshkrimit të Memorandumit të Bashkëpunimit, i cili fokusohet në bashkëpunimin dypalësh dhe shumëpalësh për çështjet e mëposhtme.

- *Shkëmbimi i eksperiencave për përmirësimin e metodologjive të auditimit të jashtëm publik.*
- *Trajnimet dhe përmirësimi i njohurive profesionale të anëtarëve të stafit të të dy institucioneve.*
- *Shkëmbimi i informacionit dhe dokumentacionit për aktivitetet profesionale të të dy palëve.*
- *Organizimi i projekteve kërkimore dhe audituese të përbashkëta sipas programeve për të cilat palët kanë rënë dakord më parë.*

Bashkëpunimi midis dy institucioneve tona ka qenë një bashkëpunim i hapur dhe i besueshëm i bazuar në vlerat e auditimit të jashtëm dhe besimin në vlerat dhe përfitimet e shkëmbimit të eksperiencës së ndërsjellë.

Në këtë kontekst, unë do të doja të përcjell mirënjohjen e Dr. Moser, Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Z. Bujar Leskaj, për përpjekjet e tij të vazhdueshme për zhvillimin e mëtejshëm të KLSH."

5.7 Prof. Ass. Dr. Recai Akyel, Zëvëndës-President i Bordit Drejtues të EUROSAI-t dhe President i Gjykatës Turke të Llogarive

(nga përshëndetja me rastin e 90 vjetorit të KLSH-së, Tiranë, 26 maj 2015)

Si Gjykatë Turke e Llogarive, ne jemi gjithmonë të gatshëm për të punuar së bashku me ju. Me 90 vjet përvojë, ju përfaqësoni harmoninë midis traditës dhe progresit. Gjykata Turke e Llogarive, me historinë e saj përfshin më shumë se 150 vjet, ka një perspektivë të pasur, përvoja dhe njohuri të shumta. Siç theksohet

dhe në moton INTOSAI-t, "Nga eksperienca e përbashkët përfitojnë të gjithë".

Ju të gjithë jeni të vetëdijshëm se, në vitet e fundit, ne kemi mësuar nga njëri-tjetri dhe jemi tërhequr nga forca e njëri-tjetrit. Në vitin 2012, ne kemi nënshkruar një memorandum mirëkuptimi për të rritur bashkëpunimin ndërmjet institucioneve tona. Që atëherë, ne kemi organizuar shumë aktivitete bashkëpunuese për të shkëmbyer njohuritë dhe përvojat dhe për të përmirësuar kapacitetet tona profesionale dhe institucionale. Është besimi im i sinqertë se KLSH do të vazhdojë përparimin e saj dhe partneriteti ndërmjet institucioneve tona do të forcohet edhe më tej në vitet që vijnë.

5.8 Z. Wojciech Kutyła, Zëvëndës-President i SAI-t Polak (NIK)

(nga kumtesa e mbajtur në Konferencën e III-të Shkencore të KLSH-së, Tiranë, 29-30 tetor 2014)

"…Roli i Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë në luftën kundër korrupsionit është parësor dhe për realizimin me sukses të këtij roli, NIK bashkëpunon me shumë institucione të tjera brenda vendit... si me Prokurorinë, me Zyrën e Konkurrencës dhe Mbrojtjen e Konsumatorit si dhe me Shkollën Kombëtare Juridike dhe Prokurorisë Publike, por merr pjesë aktive, gjithashtu, në shumë grupe pune të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t, në seminare, trajnime, konferenca, etj.. Kjo Konferencë Shkencore është shembulli më i mirë i motos së INTOSAI-t, "Nga eksperienca e përbashkët përfitojnë të gjithë...".

5.9 Z. Ivan Klesiç, Audituesi i Përgjithshëm i SAI-t të Kroacisë

(*nga përshëndetja në Konferencën e Tretë Shkencore të KLSH, Tiranë, 29-30 tetor 2014*)

Konferenca e III-të shkencore e KLSH-së do të shërbejë për të krijuar një klimë të favorshme për nxitjen efektive të bashkëpunimit midis Institucioneve Supreme të Auditimit të rajonit dhe më gjerë.

Unë jam gjithashtu i sigurt se ajo do të na frymëzojë të gjithë ne, se si ti perceptojmë zhvillimet e reja, si, ku dhe se si ne mund të ndihmojmë njëri-tjetrin.

5.10 Z. Milan Daboviç, President i Senatit të SAI-t të Malit të Zi

(*nga përshëndetja në Konferencën e Tretë Shkencore të KLSH, Tiranë, 29-30 tetor 2014*)

Vlerat dhe dobitë e punës së institucioneve supreme të auditimit, janë të dukshme dhe sigurojnë llogaridhënie, efektivitetet dhe transparencë të përdorimit të burimeve publike në përfitim të qytetarëve.

Për të rritur vlerën e punës dhe rezultatet e institucioneve supreme të auditimit, ne duhet të theksojmë rëndësinë e bashkëpunimit tonë rajonal dhe ndërkombëtar. Bota është duke ndryshuar shumë shpejt, kështu që Institucionet Supreme të Auditimit përballen me sfida të reja në përmirësimin e mirë-qeverisjes dhe llogaridhënies publike.

Unë besoj se bashkëpunimi i mëtejshëm profesional midis institucioneve tona duhet të forcohet, në mënyrë që të realizohen sfidat me të cilat institucionet tona përballen në negociatat për në BE.

5.11 Z. Erion Braçe, Kryetar i Komisionit Komisionit për Ekonominë dhe Financat

(nga diskutimet në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, 15 korrik 2015)

"Zoti Leskaj faleminderit për raportimin tuaj pranë këtij komisioni dhe për komunikimin e vazhdueshëm pothuajse gjatë gjithë vitit qoftë për detyrat të vendosura nga Kuvendi për realizimin e tyre, qoftë dhe për informacionin që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me punën, veprimtarinë e KLSH-së në proces."

5.12 Z. Florion Mima, Deputet i Kuvendit të Shqipërisë

(nga diskutimet në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, 15 korrik 2015)

"...Pasi u njohëm me të gjitha produktet që ju keni vënë sot në dispozicion të komisionit, kam bindjen dhe besoj se ndaj të njëjtën bindje edhe me kolegët se sot secili nga ne me gojën plotë mund të thotë se kemi një institucion auditi modern dhe perëndimor. Ju dhe ekipi juaj duhet të ndiheni krenarë për transformimin rrënjësor që i keni bërë një trupi që dikur merrej vetëm me kontroll-revizione të tipit sovjetik, tashmë është një ent i jashtëm i kontrollit të parave publike, dinjitoz dhe perëndimor."

6. VEPRIMTARITË SOCIAL-KULTURORE

6.1 Mbi promovimin e botimeve të KLSH-së në Panairin e Librit

Në datën 13.11.2014, në një nga mjediset e promovimeve të librave dhe botimeve të ndryshme të Pallatit të Kongreseve, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në vazhdën e veprimtarive që zhvillon për çdo vit, promovoi botimet e tij të periudhës 2012-2014. Qëllimi i këtyre botimeve është implementimi i strategjisë EUROSAI 2011-2017 dhe i strategjisë së KLSH

për vitet 2013-2017, sidomos rritja e transparencës së veprimtarisë se institucionit, me qëllim përmirësimin e qeverisjes.

Po ashtu me anë të këtyre botimeve, KLSH synon stimulimin e memories institucionale, të kompetencës profesionale të audituesve si dhe ofrimin e bazës për kryerjen me sukses të auditimeve të tilla, si ai i performancës. Botimet përfaqësojnë punën e përbashkët sipas motos së INTOSAI–t (Komunitetit të Institucioneve Supreme të Auditimit Publik”):

“Experientia mutua omnibus prodest”
(Nga eksperienca e përbashkët përfitojmë të gjithë).

Botimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit pasqyrojnë dhe përfshijnë katër objektivat themelore të strategjisë së EUROSAI, 2011- 2017: ndërtimin e kapaciteteve, standardeve profesionale, shkëmbimin e njohurive e të eksperiencave dhe menaxhimin në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë e të komunikimit të

dobishëm. Kjo kolanë, e cila do të pasurohet nga viti në vit do të paraqes, njëkohësisht, reformat e thella që ka nisur institucioni, për të forcuar auditimin financiar e për të sjellë në vëmendje auditimin e performancës. Një pjesë e këtyre botimeve përmban materiale dhe nga të dy konferencat e para shkencore të KLSH. Në këtë veprimtari përshëndetën të ftuarit e nderit Prof. Dr. Jorgji Bollano, z. Ndriçim Kulla, studiuesi i letrave shqipe, si dhe Prof. Ass. Dr. Sazan Guri. Ky promovim ishte i dyti i këtij lloji nga Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

6.2 Aktivitet për ditën botërore të librit.

Në ditën Botërore të Librit, më datë 23 prill 2014, për të gjithë punonjësit dhe audituesit e institucionit, pranë Sekretarisë së KLSH u vunë në dispozicion shumë botime librash të autoreve botërore dhe të vendit, në zhanret letrare, historike dhe studimore. Secili punonjës dhe auditues, si dhe ekspert i jashtëm, krahas shfletimit dhe këqyrjes së botimeve, përzgjodhi dhe mori falas një libër, si dhuratë e Kryetarit të KLSH në këtë ditë të shënuar për kulturën botërore.

6.3 Aktivitet kulturor- Vizitë ekspozite

Në datën 29 tetor 2014, me rastin e Konferencës së Tretë Shkencore të KLSH, shumë auditues të institucionit, si dhe përfaqësues të DG-Budget, Deputeti i Parlamentit Evropian Dr. Igor Sholtes, Presidentë dhe përfaqësues të lartë të SAI-ve partnere, vizituan Ekspozitën e Piktorit të mirënjohur Arben Golemi në Atelienë

pranë Akademisë së Arteve, ku vetë piktori dhuroi për të ftuarit dy albume me pjesët me të zgjedhura të krijimtarisë së tij.

6.4 Ekspozita e piktorit Roland Runaj

Në datat 23-24 qershor 2014, audituesit e KLSH zhvilluan një workshop në qytetin e Vlorës, në bashkëpunim me SIGMA dhe në këtë kuadër u krijua mundësia për të vizituar ekspozitën e piktorit vlonjat Roland Runaj, e cila ishte hapur në sallën e Galerisë së Arteve të qytetit të Vlorës, e vendosur në Pallatin e Kulturës "Labëria".

6.5 Takim me piktorët Llambi Blido dhe Lek Tasi në mjediset e KLSH-së

Në vazhdim të takimeve të punonjësve të Kontrollit të Lartë të Shtetit me njerëz të shquar të artit dhe të kulturës shqiptare, me nismën e Kryetarit të KLSH-së, në datë 25.07.2014 në mjediset e këtij Institucioni, u organizua një takim me piktorët Llambi Blido dhe Lekë Tasi.

Megjithëse në një moshë relativisht të thyer, të dy piktorët vazhdojnë të punojnë duke na befasur e duke na dhënë ende vepra me vlerë në fushën e pikturës dhe artit. Në këtë takim u evidentua fakti i pasionit të z. Llambi Blido që megjithëse i verbër vazhdon të pikturojë. Nga ana e piktorit Lekë Tasi, auditori u njoh me eksperiencën e tij dhe punët e veta aq të vlerësuara brenda dhe jashtë Shqipërisë.

6.6 Takim me filozofin dhe antropologun, kritikun e artit dhe studiuesin e historisë Dr. Përparim Kabo

Në datën 22 shtator 2014, KLSH nisi një mënyrë të re komunikimi duke ftuar në biseda të lira dhe të hapura personalitete të ndryshme të vendit, nga hapësira mbarë shqiptare dhe të huaj. Qëllimi i këtyre aktiviteteve në trajtën e bashkëbisedimeve interaktive është zgjerimi dhe thellimi i njohurive por dhe interesave dhe kërshërisë së stafit të KLSH-së. Takimi i datës 22 shtator startoi këtë eksperiencë të re. I ftuar ishte filozofi dhe antropologu, kritiku i artit dhe studiuesi i historisë Dr. Përparim Kabo. Ftesa ishte bërë nga KLSH duke marrë shkas nga botimi i tij më i fundit i korrikut 2014, titulluar: ”EPISTOLATE-Antropologjia e Frymës”.

Në fjalën e hapjes Kryetari i KLSH-së z. Bujar Leskaj theksoi: “Përparim Kabo shpërfaq një profil të studiuesit shumëplanësh… Filozof, antropolog, kritik arti dhe me librin e tij më të ri titulluar EPISTOLATE-Antropologjia e frymës edhe historian por krejt i veçantë në rrëfenjën e tij.

Libri përfaqëson një studim atipik të historisë së popullit tonë që i largohet formës klasike të historiografisë pasi është i ndërtuar si Antropologji Historike, duke e vlerësuar historinë si një antropologji e protagonistëve dhe institucioneve.

Më pas aktiviteti vijoi me leximin e letrës që autori i kishte dërguar Imzot Fan Nolit me rastin e përvjetorit të Kongresit të Beratit të shtatorit 1922 për autoqefalinë e

Kishës Ortodokse të Shqipërisë, e cila u interpretua me emocion nga aktori shquar i skenës dhe ekranit Mjeshtri Madh, Bujar Asqeriu.

6.7 Për nder të gjithë audituesve të ZAP–it të Kosovës u shfaq në skenë monodrama "Zoti Ibrahim dhe lulet e Kuranit"

Në datën 10 korrik 2014, në sallën e Teatrit Kombëtar eksperimental "Kujtim Spahivogli" për nder të gjithë audituesve të ZAP-it të Kosovës, që ndodheshin në Tiranë në kuadër të zhvillimit të analizës së tyre vjetore të punës, dhe audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit u shfaq në skenë monodrama "Zoti Ibrahim dhe lulet e Kuranit", e realizuar prej Mjeshtrit të Madh, Mirush Kabashi.

6.8 Projeksioni filmik "Here be dragons", i regjisorit Marc Cousins dhe me producentë Don Boyd dhe Genc Përmeti.

Gjatë zhvillimit të punimeve të Konferencës së tretë shkencore organizuar nga KLSH në datat 29-30 tetor, 2014 me temë "Auditimi Kombëtar në shërbim të Qeverisjes Kombëtare", për të gjithë të ftuarit, veçanërisht për përfaqësuesit e SAI-ve homologe dhe të Parlamentit Europian e DG Budget, si dhe për pjesëmarrësit e tjerë, u organizuan edhe disa aktivitete social-kulturore.

Në pasditen e datës 28 tetor, me mjaft interes u ndoq nga të ftuarit dhe pjesëmarrës të tjerë, projeksioni filmik "Here be dragons", i regjisorit Marc Cousins, producentëve Don Boyd e Genc Përmeti, të shkruar nga Marc Cousins e Thomas

Logoreci. Filmi dokumentar hidhte dritë mbi perceptimin e vetë regjisorit Cousins mbi të shkuarën dhe të tashmen në Shqipëri.

6.9. Botimi i librit "60 vjet INTOSAI, 50 vjet Sekretariat i Përgjithshëm"

Në kuadrin e 60 vjetorit të themelimit të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI-t botoi librin "**60 vjet INTOSAI, 50 vjet Sekretariat i Përgjithshëm".**

Me miratimin e z. Josef Moser, Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI, KLSH botoi në gjuhën shqipe këtë libër të rëndësishëm historik.

Përkthimi në gjuhën shqipe erdhi pas një pune serioze, cilësorë dhe profesionalë të një grupi audituesish të KLSH-së.

Në mënyrë të veçantë, përkthimi në shqip i këtij libri ka rëndësi për audituesit e KLSH, por edhe për të gjithë audituesit publik të vendit, për të kuptuar domethënien dhe peshën e organizatës ndërkombëtare të INTOSAI-t.

6.10. Leksione të Prof. Dr. Skënder Osmani

Në bashkëpunim me Fakultetin Gjeologji Miniera të Universitetit Politeknik të Tiranës, është realizuar një cikël leksionesh, në të cilin kanë marre pjesë drejtues dhe auditues të KLSH-së. Leksionet janë zhvilluar nga Prof. Dr. Skënder Osmani dhe kanë trajtuar çështje të përmbledhura lidhur me kuptimet themelore të riskut siç janë ato të probabilitetit, moduleve e disa zbatimeve të tyre në degë të ndryshme. Janë trajtuar gjithashtu disa kuptime fillestare të elementëve të stokastikës dhe ndonjë element i fazistikës dhe proceseve të zhvillimit të tyre.

Një vend i veçantë sidomos në aspektin aplikativ i është kushtuar objekteve, vlerësimit të riskut, rikuperimit dhe menaxhimit të tij në fushën e auditimit.

7. FOKUSI DREJT SË ARDHMES: Perspektiva dhe sfida 2015

KLSH përgjatë vitit 2015 veprimtarinë institucionale do ta fokusojë:

A. Në drejtim të përmirësimit të kuadrit rregullator

- Viti 2015 do të jetë viti në të cilin KLSH do ta ushtrojë veprimtarinë bazuar ne një ligj të ri, i cili reflekton praktikat me te mira te fushës.

- Me miratimin e ligjit do të angazhohemi me nxjerrjen e **një sërë aktesh rregullatore,** të cilat janë të lidhura me menaxhimin e procesit të auditimit përcaktimin e përgjegjësive te reja në fushën e auditimit, cilësimin e të drejtave dhe detyrimeve te institucionit bazuar në standardet INTOSAI, si dhe organizimin dhe strukturën, statusin e personelit, procesin e certifikimit të pasqyrave financiare të subjekteve të audituara, certifikimin e audituesve, etj. I gjithë ky proces përbën **një sfidë për stafin e KLSH**-së të cilin pa dyshim do ta përballojmë me sukses.

B. Në drejtim të veprimtarisë audituese

- ✓ ***Konsolidimi i auditimit të përputhshmërisë, shtimi i numrit dhe rritja e vazhdueshme e cilësisë në auditimet e performancës*** do të jetë në fokus të veprimtarisë audituese të KLSH-së përgjatë vitit 2015. Ngritja e kapaciteteve me synim kryerjen e auditimeve financiare do jetë një nga prioritetet e periudhave në vijim.
- ✓ Gjatë vitit 2015 KLSH do të vijojë me kryerjen dhe rritjen e kapaciteteve për auditimet TI në entet e sektorit publik.
- ✓ ***Zhvillimi i infrastrukturës dhe mjeteve të TI*** gjatë procesit auditues është një nga objektivat në të cilat do të përqendrohet menaxhimi institucional përgjatë vitit 2015.
- ✓ ***Thellimi i luftës kundër korrupsionit*** do të jetë në fokus të veprimtarisë tonë institucionale *dhe krahas veprimtarisë audituese dhe modernizimit të tij, do të vazhdojë të thellojë luftën kundër korrupsionit, duke denoncuar aktet korruptive në publik, media, prokurori e më gjerë.*

C. ***<u>Në fushën e metodologjisë dhe zhvillimit profesional</u>***, duke e konsideruar zhvillimin profesional si pjesë integrale e zhvillimit strategjik për periudhën e ardhshme dhe për të siguruar arritjen e objektivave që KLSH ka vendosur në Programin e Trajnimit për vitin 2015, fokusi në të ardhmen do të drejtohet në disa pika kryesore si:

- ✓ ***" Zhvillimi profesional" do të bëhet pjesë e vlerave kryesore*** të KLSH dhe një kulturë që përkrahet nga të gjithë punonjësit në institucion.
- ✓ Zbatimi i një modeli trajnimi bashkëkohor dhe sistematik, që trajnimet kryhen për të gjitha nivelet në vijimësi dhe ***të orientuar drejt rezultateve.***
- ✓ Të ndërtohet një lidhje e fuqishme për përshtatshmërinë ndërmjet nevojave të institucionit dhe nevojave të çdo individi për trajnim, ç'ka do të sjellë që ***Kontributi i trajnimeve*** të ketë impakt duke u shërbyer të gjithë punonjësve në të gjitha nivelet për të përftuar aftësitë e kërkuara individualisht dhe me tej në nivel institucional.
- ✓ Të mësuarit gjatë zhvillimit, që kërkon krijimin i një sistemi për të vlerësuar efektivitetin e trajnimit, progresin dhe përmirësimin e vazhdueshëm.
- ✓ Krijimin e një profili të lartë profesional dhe etik të Audituesit të Lartë Publik, pjesë e stafit të KLSH.
- ✓ Ruajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të rritmeve të veprimtarisë trajnuese, qasjen e tyre bashkëkohore dhe plotësimin në vijimësi të nevojave të stafit në formën dhe mënyrat më të përshtatshme.
- ✓ Metodologjia e zhvillimit të udhëhiqet nga veprimtaritë kërkimore shkencore dhe botimet e KLSH të kthehen në burim parësor të trajnimit dhe zhvillimit të stafit.

D. ***<u>Në fushën e komunikimit, botimeve dhe marëdhënieve më jashtë</u>***, qëllimi kryesor mbetet rritja e rolit parësor në sjelljen e ideve të reja, veçanërisht në fushën e komunikimit, në mënyrë që edhe në këtë fushë të jemi inovativë, duke gjetur mënyrën më efikase të komunikimit me Kuvendin, median, publikun, subjektet e audituara, etj.

Sfidat e së ardhmes e vënë fokusin në:

- ✓ Rritja e numrit dhe e cilësisë së botimeve të KLSH-së, gjatë 2015 do të vazhdojë të mbetet një prioritet për institucionin sepse ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e kapaciteteve audituese dhe për rrjedhojë të cilësisë së punës në auditimin, krahas rritjes së transparencës me publikun. Për vitin e ardhshëm janë parashikuar 15 botime, me të cilat kolona e botimeve të KLSH-së do të arrijë shifrën 50 dhe botimet do të kalojnë në një fazë më të avancuar duke ju përgjigjur tendencave të kohës dhe eksperiencave më të mira evropiane, duke u përqendruar në fushën e teknologjisë së informacionit (COBIT 4.1, Objektivat e kontrollit të Teknologjisë së Informacionit), inovacionit në fushën e auditimit e më gjerë dhe komunikimit modern, veçanërisht me publikun. Krahas këtyre risive, KLSH do të përvijojë të botojë revistën shkencore 4 mujore "Auditimi Publik", raportin e aktivitetit te Institucionit, analizën vjetore, botimin për Konferencën e IV-t shkencore, etj.
- ✓ Realizimi i strategjisë së komunikimit të KLSH-së.
- ✓ Implementimi i IPA që sigurisht do të ketë edhe vështirësi, duke pasur parasysh që do të jetë viti i parë i aplikimit,
- ✓ Bashkëpunimi me IEKA dhe SHKÇAK, me synim forcimin e kapaciteteve për Auditimin dhe dhënien e opinioneve mbi Pasqyrat Financiare.
- ✓ Konkludimin e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me SAI-et e rajonit (Bullgari, Serbi, Greqi).
- ✓ Implementimi me projekte konkrete i marrëveshjeve të bashkëpunimit me OJF-të dhe shoqatat e Profesionisteve të fushës.
- ✓ Bashkëpunim konkret me përfaqësitë e Bankës Botërore dhe OSBE në Shqipëri, për mundësinë e projekteve të përbashkëta për zhvillimin e kapaciteteve audituese.
- ✓ Ngritja në një nivel me të vërtetë shkencor e kumtesave të audituesve të KLSH në Konferencën e katërt shkencore të KLSH-së, në vjeshtën e vitit 2015.
- ✓ Ruajtja e nivelit të shkrimeve të Revistës Shkencore të KLSH-së dhe përmirësimi i tyre, në mënyrë që Revista të ruajë karakterin e saj shkencor dhe emrin që ka krijuar.

Parë në tërësi, viti 2014 ka qenë për institucionin e KLSH një vit konsolidimi dhe qëndrueshmërie të reformave te nisura që në vitin 2012.

Bazuar në punën e bërë dhe konsolidimin e reformave që po realizohen, duke patur parasysh shtimin e ndikimit dhe të rolit të SAI-ve në botë, të konfirmuar nga Rezoluta e dytë A/69/228 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara të datës 19 dhjetor 2014, duke synuar realizimin e plotë të programit IntoSAINT për KLSH, jemi të bindur se viti 2015 do të jetë viti i zbatimit të ligjit të ri dhe i përsosjes së mënyrës së organizimit dhe drejtimit të institucionit, për të përçuar praktikat më të mira të institucioneve simotra evropiane në këto fusha.

Qëndrueshmëria në ecurinë e reformave do të na sjellë rezultate më të larta në përmirësimin e qeverisjes kombëtare, në sinergji dhe bashkëpunim të plotë me qytetarin, Kuvendin, shoqatat profesionale dhe shoqërinë civile.

8. ANALIZA E REALIZIMIT TË BUXHETIT TË KLSH-së PËR VITIN 2014

Bazuar në Ligjin vjetor të buxhetit të shtetit të vitit 2014, me ndryshime KLSH-së i është akorduar një fond në total prej 371 453.5 mijë lekë nga i cili 341 153.5 mijë lekë përfaqësonin financime nga burime të brendshme buxhetore dhe 30 milionë lekë nga burime te huaja.

Treguesit e buxhetit total në nivel institucional referuar planit fillestar, ndryshimet gjatë vitit dhe shpenzimeve faktike, paraqiten në tabelën si me poshtë vijon:

Njësia në mijë/lekë

Nr.	ARTIKULLI (Kodi-Emri)	Plani fillestar	Ndryshimet gjatë vitit	Plani me ndryshime	Realizimi 2014	Në %	Diferenca F-P
A	B	1	2	3	4	5	6
Shpenzime Korrente:							
1	600 - Paga	212 000	-2 000	210000	201 472.2	96	-8527.8
2	601 - Sigurime	27 000	+2 000	29 000	28 802	99.3	-198
3	602 - Mallra dhe Shërbime	65 000		65 000	54 526.5	84	-10 473.5
4	605 - Transferta Korrente të huaja	16 150		16 150	124 .1	8	-16 025.9
5	606 - Transferta për Buxhetet Familjare & Individë	1 303.5		1 303.5	1 303.5	100	0
Shpenzime Kapitale:							
6	231 - Financim i brendshëm	20 000		20 000	9 012	45	-10 988
7	230 - Financim i huaj	30 000		30 000	0	0	-30 000
TOTALI		371 453.5	0	371 453.5	295 240.3	84	-76 213.2

Nga analiza faktoriale sipas kategorisë së shpenzimeve në nivel artikulli rezulton:

- Fondi i pagave është realizuar në rreth 96% të kuotave të planifikuara.
- Fondi i Sigurimeve Shoqërore është realizuar 99%.
- Fondi i shpenzimeve operative “mallra dhe shërbime“ rezulton në nivelin 84% të kuotave të planifikuara.

- Buxheti i investimeve të planifikuara për "furnitura dhe pajisje" në vlerën 11.1 milionë lekë është realizuar në nivelin 100% të objekteve të planifikuara duke reflektuar një kursim të fondeve prej rreth 2 milionë lekë.

- Shpenzimet me burim të huaj financimi me vlerë 30 000 mijë lekë, këto fonde të planifikuara për implementimin e projektit IPA nuk u bënë efektive për faktin që projekti IPA nuk filloi përgjatë 2014.

- Përmendim se për vitin 2014 u arrit një protokoll bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA) dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit me objekt furnizimin me pajisje dhe programe në mbështetje të dy SAI-t për zbatimin e sistemit të menaxhimit të auditimit, bazuar në teknologjinë e informacionit. Granti u lëvrua në vlerën 15 729 mijë lekë.

- Përsa i përket fondit të transfertave korrente në vlerën 16 milionë lekë i cili përfaqëson fondin e akorduar bazuar në marrëveshjen me FMN-në, me destinacion shpenzime për pagat e ekspertëve të cilët do të angazhoheshin për auditimin e pagesave të borxheve të prapambetura, ky fond nuk u shpenzua nga ana e KLSH-së.

Situata buxhetore për vitin 2014 e analizuara në nivel artikulli rezulton:

1. Pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore (llogaria 600-601)

a) Pagat nga 210 000 mijë lekë të planit vjetor janë shpenzuar 201 472 mijë lekë ose në masën 96%.

b) Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore nga 29 000 mijë lekë të plani vjetor janë shpenzuar 28 802 mijë lekë ose në masën 99.3%

Shuma e shpenzuar për zërin "paga" përfshin pagat e punonjësve të KLSH-së dhe të ekspertëve të jashtëm të përkohshëm të kontraktuar dhe paguar konform shkresave dhe kontratave të nënshkruara me ta.

2. Transferta korrente dhe të huaja (llogaria 605)

Gjatë periudhës raportuese 2014 janë shlyer detyrimet për kuota anëtarësimi për organizatat INTOSAI dhe EUROSAI*, në shumën 124 075 lekë nga 150 mijë lekë të planifikuara.*

3. Transferta për buxhetet familjare dhe individët (llogaria 606)

Për vitin 2014 fondi i veçantë rezulton i realizuar në masën 53% të fondit disponibël. Gjatë kësaj periudhe, është dhënë nga fondi i veçantë me kërkesat e bëra nga ana e jonë dhe të konfirmuar nga Ministria e Financave një fond prej 1 303.5 mijë lekë për daljen e punonjësve në pension, rast fatkeqësie dhe sëmundje.

4. Shpenzimet operative (llogaria 602)

Nga 65.000 mijë lekë plani vjetor janë shpenzuar 54 526.5 mijë lekë ose në masën 84%. Nga analiza më e detajuar e realizimit të shpenzimeve rezulton që në këtë nivel realizimi kanë ndikuar diferenca (kursimet) nga proceset e prokurimit të fondeve në rreth 6 milionë lekë, si dhe një pjesë e fondeve të shpenzimeve për udhëtim e dieta të ditëve të fundvitit janë kryer në fillim vitin pasardhës. Me ketë zë shpenzimesh janë përballuar gjithashtu edhe mbulimi i nevojave administrative të shpenzimeve si: shpenzime për drita, ujë, telefon etj. Në këtë artikull një pjesë të konsiderueshme e zënë shpenzimet për trajnime jashtë dhe brenda vendit dhe për dieta në funksion të veprimtarisë audituese. Ngritja e kapaciteteve është një nga objektivat strategjikë të KLSH që parashikohet në Strategjinë e Zhvillimit 2013-2017. Për arritjen e këtij objektivi, KLSH ka marrë pjesë në mënyrë aktive në shumë aktivitete trajnimi, takime dhe grupe pune, konferenca dhe simpoziume, të cilat kanë synuar ndërtimin e kapaciteteve, rritjen e aftësive dhe njohurive profesionale të audituesve në funksion të rritjes së cilësisë së auditimit. Organizimi dhe pjesëmarrja në këto aktivitete janë shoqëruar me kostot përkatëse duke u fokusuar në menaxhim sa më të kujdesshëm dhe përdorim sa më me efektivitet.

5. Shpenzimet për investime kapitale (llogaria 231)

Bazuar në Ligjin e buxhetit të shtetit të vitit 2014 plani i buxhetit me destinacion investimet kapitale rezultoi në shumën 50 milionë lekë.

I detajuar sipas burimit të financimit rreth 20 milionë lekë përfaqësonin fonde buxhetore me burim të brendshëm financimi dhe 30 milionë lekë me burim të huaj.

- Më poshtë paraqitet realizimi i buxhetit të investimeve për vitin 2014 i detajuar sipas zërave:

Mijë lekë

Nr.	Emertimi	Plani sipas ligjit vjetor të buxhetit	Plan i ndryshuar (ngurtësim 10%)	Fakt	Realizimi %	Diferenca
a	b	1	2	3	4	5
1	Pajisje kompjuterike	11 140	9 550	7 730	81	1 820
2	Rikonstruksioni rrjeti elektrik	430	0	0		0
3	Rikonstruksion I godinës	480	480	370	77	110
4	**Pajisje zyrash,** nga të cilat:	**1 050**	**1 050**	**912**	**85**	**158**
	Karrige	200	200	182	91	18
	Rafte	200	200	168	84	32
	Stenda për historikun	200	200	174	87	26
	Kondicioner	200	200	163	82	37
	Të tjera (kamera, aparat, regjistrim, fshesa korrenti,etj.)	250	250	225	83	45
	Totali investimeve	**13 100**	**11 100**	**9012**	**81**	**2 088**
6	TVSH/kosto lokale	6 900	6 900	0	-	6 900
7	Financim i huaj, IPA	30 000	30 000			30 000
8	Fond i ngrirë	0	2 000	0	-	2 000
	SHUMA	**50 000**	**50 000**	**9 012**	**45**	**40 988**

- Nga analiza faktoriale e buxhetit të investimeve sipas zërave konstatohet se buxheti i investimeve të planifikuara për "furnitura dhe pajisje" në vlerën 11.1 milionë lekë është realizuar **në nivelin 100 % të objekteve të planifikuara** dhe duke reflektuar një kursim të fondeve prej rreth 2 milionë lekë, si rezultat i zbatimit të procedurave të prokurimit dhe nivelit të lartë të konkurrencës së ofertimit në këto procedura.

  Argumentojmë se për procedurën e prokurimit me objekt "Blerje pajisje kompjuterike" si rezultat i procedurave të prokurimit "konkurrimit" kontraktimi rezultoi në rreth 85 % te fondit limit.

- Nga fondi total i investimeve nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik u ngurtësua fondi prej 2 milionë lekë (10 % e investimeve të brendshme) për rrjedhojë nuk lejohej përdorimi i këtij fondi.

- Fondi prej 30 milionë lekë dhe 6.9 milionë lekë i planifikuar për financimin e projektit IPA I nuk u përdor gjatë vitit 2014 për shkak të mosbërjes efektive të marrëveshjes së financimit nga donatorët.

Konform kritereve të përcaktuara për hartimin dhe zbatimin e buxhetit referuar udhëzimeve të Ministrit të Financave nxjerrë për këtë qëllim KLSH-ja ka plotësuar dhe paraqitur në afat projektbuxhetin për vitin 2014, si dhe ka kryer procedurat konform kërkesave ligjore të ekzekutimit të buxhetit gjatë vitit.

Në zbatim të ligjit për MFK-në, Kryetari i KLSH-së ka nxjerrë aktet përkatëse, në zbatim të të cilave është miratuar ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik të Institucionit dhe Koordinatori i Riskut.

Struktura organizative e KLSH-së reflekton kërkesat e nenit 12 të Ligjit nr nr. 10296, datë 08/07/2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" për sa i përket kritereve të linjave të raportimit dhe arsimimit për nëpunësin zbatues. Nëpunësi zbatues (Përgjegjësja e financës ka vartësi dhe raporton tek Sekretari i Përgjithshëm njëherazi nëpunësi autorizues i institucionit).

KLSH ka hartuar Strategjinë e Menaxhimit të Riskut të KLSH-së, e cila u është dhënë për zbatim dhe ndjekje çdo Drejtori Departamenti dhe Drejtorie.

Në zbatim të ligjit për MFK-në brenda muajit shkurt 2015 është dërguar në Ministrinë e Financave te Nëpunësi i Parë Autorizues, Deklarata dhe Raporti Vjetor për vitin 2014, "Për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në KLSH", si dhe

përgjigja e Pyetësorit "Për vetëvlerësimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në KLSH".

Nga Sektori i Financës, çdo muaj është bërë rakordimi i situacioneve të shpenzimeve të buxhetit me Degën e Thesarit dhe Ministrinë e Financave.

- Janë hartuar evidencat statistikore sipas formularëve përkatës, si dhe, raporti i shpenzimeve faktike të KLSH sipas artikujve buxhetorë referuar kuadrit rregullator te zbatimit të buxhetit.

- Gjithashtu, Sektori i Financës ka kryer me rigorozitet e në mënyrë periodike kontrollin e shpenzimeve për prokurimet dhe shpenzimet e kryera me bankë dhe arkë.

- Janë kryer rakordimet me Degën e Thesarit për realizimin e shpenzimeve të buxhetit, si dhe janë bërë akt-rakordimet për çeljen dhe lëvizjen e fondeve buxhetore me Drejtorinë e Buxhetit në Ministrinë e Financës.

- Në përfundim të çdo muaji janë realizuar rakordimet dhe kontrollet e duhura për veprimet gjatë kësaj periudhe, duke kontabilizuar dhe duke u vendosur në mënyre kronologjike dokumentet.

- Dokumentet vërtetuese si faturat, fletëhyrjet, fletëdaljet, mandat-arkëtimet, mandat-pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet dhe të tjera akte, janë kryer në mënyrë vijuese dhe duke respektuar afatet kohore.

- Për vitin 2014 KLSH ka përpiluar bilancin kontabël për vitin 2014 në afatin e duhur.

- Janë dorëzuar brenda afatit pranë Drejtorisë së Menaxhimit dhe Monitorimit të Buxhetit, të Ministrisë së Financave raportet e monitorimit të shpenzimeve faktike, sipas programeve dhe artikujve.

Bashkëlidhur kësaj analize buxhetore ndodhen edhe pasqyra e llogarive vjetore të KLSH-së 2014.

PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TE VITIT USHTRIMOR 2014

Bilanci i KLSH-së, i vitit 2014

a. AKTIVI

Nr. Rreshti	Nr.LLOG.	EMËRTIMI I LLOGARIVE TË AKTIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi Paraardhës
1.	12	Rezultate të mbartura (saldo debitore)		
2.	**A**	**AKTIVE TË QËNDRUESHME**	73,166,758.20	60,458,539.20
3.	**20,230**	**I. Të pa trupëzuara**	268,873	143,582
4.	201	Prime të emisionit dhe rimbursimi të huave		
5.	202	Studime dhe kërkime		
6.	203	Koncesione, patenta, licenca të tjera ngjashme	3,077,738	1,646,000
7.	209	Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të pa trupëzuara (-)	(2,808,865)	(1,502,418)
8.	230	Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme patrupëzuara		
9.	**21,23,24,28**	**II. Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara**	72,897,885.20	60,314,957.20
10.	210	Toka, troje, terrene		
11.	211	Pyje, kullota, plantacione		
12.	212	Ndërtime e konstruksione	17,006,621	16,637,021
13.	213	Rrugë, rrjete, vepra ujore		3,585,335
14.	214	Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune	9,758,121	37,403,588
15.	215	Mjete transporti	33,600,000	37,447,000
16.	216	Rezerva shtetërore		
17.	217	Kafshë pune e prodhimi		
18.	218	Inventar ekonomik	99,092,587.20	50,924,627.20
19.	219	Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të trupëzuara (-)	(86,559,444)	(85,682,614)
20.	231	Shpenzime proces për rritjen e AQT		
21.	232	Shpenzime proces për transferime kapitale		
22.	24	Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara		
23.	28	Caktime		
24.	**25,26**	**III. Aktive Financiare**		
25.	25	Huadhënie e nënhuadhënie		
26.	26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet		
27.	**B**	**AKTIVE QARKULLUESE**	32,095,381.60	34,904,343
28.	**Klasa 3**	**I. Gjendja e Inventarit**	9,665,356.60	12,863,170
29.	31	Materiale	8,417,661.60	7,536,427

Nr. Rreshti	Nr.LLOG.	EMËRTIMI I LLOGARIVE TË AKTIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi Paraardhës
30.	32	Objekte inventari	1,247,695	5,326,743
31.	33	Prodhime, punime e shërbime në proces		
32.	34	Produkte		
33.	35	Mallra		
34.	36	Gjë e gjallë në rritje e majmëri		
35.	37	Gjendje të pambritura ose pranë të tretëve		
36.	38	Diferenca nga çmimet e magazinimit		
37.	39	Shuma të parashikuara për zhvlerësim të inventarit (-)		
38.	**Klasa 4**	**II. Kërkesa arkëtimi mbi Debitorët**	22,430,025	22,041,173
39.	409	Furnitorë (Debitorë), parapagime pagesa pjesore		
40.	411-418	Klientë e llogari të ngjashme		
41.	423.429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba		400
42.	431	Të drejta e taksa për t'u derdhur në shtet		
43.	432	Tatime mbledhur nga shteti për llogari të Pushtetit Lokal		
44.	433	Shpenzime fatkeqësi natyrore që mbulon shteti		
45.	4342	Të tjera operacione me shtetin (debitor)	19,893,373	19,504,121
46.	435	Sigurime Shoqërore		
47.	436	Sigurime Shëndetësore		
48.	437.438	Organizma të tjera shoqërore		
49.	44	Institucione të tjera publike		
50.	45	Marrëdhënie me institucionet brenda dhe jashtë sistemit		
51.	465	Efekte për t'u arkëtuar nga shitja letrave me vlerë vendosjes		
52.	468	Debitorë të ndryshëm	2,536,652	2,536,652
53.	49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)		
54.	**50.59**	**III. Llogaritë financiare**		
55.	50	Letra me vlerë të vendosjes		
56.	511	Vlera për t'u arkëtuar		
57.	512	Llogari në bankë		
58.	520	Disponibilitete në thesar		
59.	531	Llogari në arkë		
60.	532	Vlera të tjera		
61.	54	Akreditiva dhe paradhënie		
62.	56	Llogari në organizma krediti		
63.	59	Provigjone zhvlerësimi letra me vlerë vendosjes (-)		
64.	**C**	**LLOGARI TË TJERA AKTIVE**		
65.	477	Diferenca konvertimi aktive		
66.	481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime		
67.	486	Shpenzime të periudhave të ardhshme		
68.	**85**	**REZULTATI I USHTRIMIT (saldo debitore)**		
69.	**X**	**TOTALI I AKTIVIT**	**105,262,139.80**	**95,362,882.20**

b. PASIVI

Nr. Rreshti	Nr. LLOG.	EMËRTIMI I LLOGARIVE TË AKTIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi Paraardhës
1.	**A.**	**FONDE TË VETA**	82,832,114.80	73,321,709.20
2.	**10**	**I. Fonde të veta**	82,832,114.80	73,321,709.20
3.	101	Fonde bazë		
4.	105	Grante të brendshme kapitale		
5.	106	Grante të huaja kapitale		
6.	107	Vlera Aktive të Qëndrueshme të caktuara në përdorim		
7.	109	Rezerva nga rivlerësimi aktiveve të qëndrueshme		
8.	**11**	**II. Fonde të tjera të veta**		
9.	111	Fonde rezervë		
10.	115	Caktim nga rezultati i vitit për investime		
11.	116	Të ardhura nga shitja e Aktiveve të Qëndrueshme		
12.	**12**	**III. Rezultati i mbartur**		
13.	**13**	**IV. Subvencione te jashtëzakonshme (-)**		
14.	**14**	**V. Pjesëmarrje të institucionit në investime për të tretë**		
15.	**15**	**Shuma parashikuara për rreziqe e shpenzime**		
16.	**B**	**D E T Y R I M E**		
17.	**16,17,18**	**I. Borxhe afatgjatë**		
18.	16	Huamarrje e brendshme dhe të ngjashme		
19.	17	Huamarrje e huaj		
20.	**Klasa 4**	**II. Detyrime afatshkurtër**	22,430,025	22,041,173
21.	419	Klientë (Kreditore), parapagesë pjesore		
22.	401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	41,400	184,560
23.	42	Personeli e llogari të lidhura me to	13,164,353	12,948,453
24.	431	Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa	2,018,295	2,113,420
25.	432	Tatime mbledhur nga shteti për llogari të Pushtetit Lokal		
26.	433	Shteti fatkeqesi natyrore		
27.	4341	Të tjera operacione me shtetin (kreditor)	2,537,052	2,537,052
28.	435	Sigurime Shoqërore	2,486,039	2,376,366
29.	436	Sigurime Shëndetësore	1,800,146	1,532,940
30.	437-438	Organizma të tjere shoqërore	382,740	348,382
31.	44	Institucione të tjera publike		
32.	45	Marrëdhënie me institucione brenda e jashtë sistemit		
33.	460	Huadhënës		
34.	464	Detyrime për t'u paguar për blerjen e letrave me vlerë		
35.	466	Kreditorë për mjete në ruajtje		
36.	467	Kreditorë të ndryshëm		
37.	**C**	**LLOGARI TË TJERA**		
38.	475	Të ardhura për t'u regjistruar për vitet pasardhëse		
39.	478	Diferenca konvertime pasive		
40.	480	Të ardhura për t'u klasifikuar ose rregulluar		
41.	487	Të ardhura të arkëtuara para nxjerrjes së titullit		
42.	85	**REZULTATI I USHTRIMIT (Saldo kreditore)**		
43.	**X**	**T O T A L I I PA S I V I T**	**105,262,139.8**	**95,362,882.2**

c. SHPENZIME

Nr. Rreshti	Nr. LLOG. të shpenzimeve	EMËRTIMI I LLOGARIVE TË AKTIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi Paraardhës
a	b	C	1	2
1.	Klasa 6	**A. SHPENZIME SHFRYTËZIMI (I-IV)**	283,150,053.20	270,255,221
2.	60	**I. Shpenzime Korente**		
3.	**600**	**Paga, shpërblime e të tjera personeli**	201,931,629	195,661,494
4.	6001	Paga, personeli i përhershëm	201,931,629	195,661,494
5.	6002	Paga, personeli i përkohshëm		
6.	6003	Shpërblime		
7.	6009	Shpenzime të tjera personeli		
8.	**601**	**Kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore**	28,911,672	27,056,439
9.	6010	Kontribute për sigurimet shoqërore	25,557,094	24,302,191
10.	6011	Kontribute për sigurimet shëndetësore	3,354,578	2,754,248
11.	**602**	**Mallra dhe shërbime të tjera**	54,176,950.60	48,213,170
12.	6020	Materiale zyre e të përgjithshme	301,040	214,320
13.	6021	Materiale dhe shërbime speciale		
14.	6022	Shërbime nga të tretë	3,879,108	4,022,975
15.	6023	Shpenzime transporti	5,643,141	6,031,607
16.	6024	Shpenzime udhëtimi	37,546,068.40	32,562,540
17.	6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	5,000,026.20	3,622,202
18.	6026	Shpenzime për qiramarrje	252,852	196,112
19.	6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale		528,527
20.	6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua		
21.	6029	Shpenzime të tjera operative	1,554,715	1,034,887
22.	**603**	**Subvencionet**		
23.	6030	Subvencione për diferencë çimimi		
24.	6031	Subvencione për të nxitur punësimin		
25.	6032	Subvencione për të mbuluar humbjet		
26.	6033	Subvencione për sipërmarrjet individuale		
27.	6039	Subvencione të tjera		
28.	**604**	**Transferime korente të brendshme**		
29.	6040	Transferime korente tek nivele të tjera Qeverisë		
30.	6041	Transferime koente tek institucione qeveritare të ndryshme		
31.	6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore		
32.	6044	Transferime korente tek Organizatat jofitimprurëse		
33.	**605**	**Transferime korente me jashtë**	124,075	117,881
34.	6051	Transferime për Organizatat ndërkombëtare	124,075	117,881
35.	6052	Transferime për qeveritë e huaja		
36.	6053	Transferime për institucionet jofitimprurëse të huaja		
37.	6059	Transferime të tjera korente me jashtë shtetit		
38.	**606**	**Transferta për buxhetin familjar e individë** (Ndihmë ekonomike)	1,203,540	605,200

Nr. Rreshti	Nr. LLOG. të shpenzimeve	EMËRTIMI I LLOGARIVE TË AKTIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi Paraardhës
39.	6060	Transferta të paguara nga ISSH e ISKSH		
40.	6061	Transferta të paguara nga Institucione të tjera e Organe të Pushtetit Vendor (Ndihmë ekonomike)	1,203,540	605,200
41.	**63**	**II. Ndryshimi i gjendjeve të inventarit (+,-)**	(3,197,813.40)	(1,398,963)
42.	**68**	**III. Kuota amortizimi dhe shuma të parashikuara**		
43.	681	Kuotat e amortizimit të shfrtytëzimit		
44.	682	Vlera e mbetur e AQ të nxjerra jashtë përdorimit e të shitura		
45.	683	Shuma të parashikuara të shfrytëzimit		
46.	686	Shuma të parashikuara për aktivet financiare		
47.	**65-66**	**B. SHPENZIME FINANCIARE (I+II)**		
48.	**65**	**I. Shpenzime financiare të brendshme**		
49.	650	Interesa per bono thesari dhe kredi direkte		
50.	651	Interesa për huamarrje të tjera të brendshme		
51.	652	Interesa Letra tjera vlerë Qeverisë		
52.	656	Shpenzime nga këmbimet valutore		
53.	**66**	**II. Shpenzime financiare të jashtme**		
54.	660	Interesa për huamarrje nga Qeveri të huaja		
55.	661	Interesa për financime nga institucione ndërkombëtare		
56.	662	Interesa për huamarrje të tjera të jashtme		
57.	**67**	**C. SHPENZIME TË JASHTËZAKOSHME**		
58.	677	Humbje nga gabime të lejuara në vitet ushtrimore paraardhëse		
59.	678	Shpenzime të tjera të jashtëzakonshme		
60.	**Klasa 6**	**TOTALI I SHPENZIMEVE**	**283,150,053.20**	**270,255,221**
61.	**82,83,84,**	**D. OPERACIONE KORIGJIMI TË REZULTATIT**	**3,197,813.40**	**1,398,963**
62.	828	Tituj të ardhurash të anuluara		
63.	831	Caktim të ardhurash funksionale për investime		
64.	8420	Derdhje të ardhura në buxhet		
65.	8421	Derdhje në buxhet të ardhurave të papërdorura		
66.	8422	Transferim të ardhurave brenda sistemit		
67.	8423	Transferime për ndryshim gjendje	3,197,813.40	1,398,963
68.	8424	Transferim për debitore të konstatuar e të ngjashme		
69.	**Klasa 6 e 8**	**TOTALI I OPERACIONEVE**	**286,347,866.60**	**271,654,184**
70.	**85**	**REZULTATI NGA FUNKSIONIMI**		
71.	76	**B. TË ARDHURA FINANCIARE**		
72.	760	Nga interesat e huadhënies brendshme		
73.	761	Nga interesat e huadhënies së huaj		
74.	765	Të ardhura nga interesat e depozitave		
75.	766	Të ardhura nga këmbimet valutore		
76.	**77**	**C. TË ARDHURA TË JASHTZAKONSHME**		
77.	773	Nga veprimtari të mbyllura e ndryshuara të tjera të strategjisë		

Nr. Rreshti	Nr. LLOG. të shpenzimeve	EMËRTIMI I LLOGARIVE TË AKTIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi Paraardhës
78.	777	Nga gabime të lejuara në vitet ushtrimore paraardhëse		
79.	778	Korrigjime nga vitet e kaluara		
80.	779	Të ardhura të tjera		
81.	**Klasa 7**	**TOTALI I TË ARDHURAVE**		
82.	**82, 84**	**D. OPERACIONET KORIGJIM I REZULTATIT**		
83.	829	Urdhër i shpallur anuluar ose parashkruar		
84.	841	Transferimi i ndryshimit të gjendjes		
85.	**Klasa 7 e 8**	**TOTALI OPERACIONEVE**		
86.	85	**REZULTATI I VEPRIMTARISE**		
87.	X	**T O T A L I**		

d. TË ARDHURAT

Nr. Rreshti	Nr. LLOG. të ardhurave	PERSHKRIMI TE ARDHURAVE TE USHTRIMIT	VITI USHTRIMOR	VITI MEPARSHEM
a	**b**	**C**	**1**	**2**
1.	**Klasa 7**	**A. TË ARDHURA TË SHFRYTËZIMIT (I-VII)**	**286,347,866.60**	**271,654,184**
2.	**70**	**I. TË ARDHURA TATIMORE (a+b+c+d+e+f+g)**		
3.	**700**	***a) Mbi të ardhurat, fitimin e ardhurat kapitale***		
4.	7000	Tatim mbi të ardhurat personale		
5.	7001	Tatim mbi fitimin		
6.	7002	Takse e tatim mbi biznesin e vogël		
7.	7009	Tjera tatime		
8.	***702***	***b)Tatime mbi pasurinë***		
9.	7020	Mbi pasurinë e paluajtshme		
10.	7021	Mbi shitjen e pasurisë se paluajtshme		
11.	7029	Të tjera mbi pasurinë		
12.	**703**	***c)Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit***		
13.	7030	Tatim mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)		
14.	7031	Akciza		
15.	7032	Taksë mbi shërbimet specifike		
16.	7033	Taksë mbi përdorimin mallrave e lejim veprimtarie		
17.	7035	Taksë vendore mbi përdorimin mallrave e lejim veprimtarie		
18.	**704**	***d)Taksë mbi tregtinë e transaksione ndërkombëtare***		
19.	7040	Taksë doganore për mallrat e importit		
20.	7041	Taksë doganore për mallrat e eksportit		
21.	7042	Tarifë shërbimi doganor dhe koliposte		
22.	7049	Të tjera taksa mbi tregtinë e transport ndërkombëtar		
23.	**705**	***e)Taska e rrugës***		
24.	**708**	***f) Të tjera tatime e taksa kombëtare***		

Nr. Rreshti	Nr. LLOG. të ardhurave	PERSHKRIMI TE ARDHURAVE TE USHTRIMIT	VITI USHTRIMOR	VITI MEPARSHEM
25.	**709**	***g)Kamat vonesa***		
26.	**75**	**II. KONTRIBUTE SHOQËORE E SHËNDETSORE**		
27.	750	Nga të punësuarit		
28.	751	Nga punëdhënësit		
29.	752	Nga të vetëpunësuarit		
30.	753	Nga fermerët		
31.	754	Nga sigurimet vullnetare		
32.	755	Kontribut i buxhetit për sigurime shoqërore		
33.	756	Kontribut i buxhetit për sigurime shëndetësore		
34.	**71**	**III. TË ARDHURA JO TATIMORE (a+b+c)**		
35.	**710**	***a) Nga ndërmarrjet dhe pronësia***		
36.	7100	Nga ndërmarrje publike jo financiare		
37.	7101	Nga ndërmarrje publike financiare		
38.	7109	Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia		
39.	**711**	***b) Shërbime administrate e të ardhura sekondare***		
40.	7110	Tarifa administrative dhe rregullatore		
41.	7111	Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh		
42.	7112	Taksë për veprime gjyqësore e noteriale		
43.	7113	Nga shitja e mallrave e shërbimeve		
44.	7114	Të ardhura nga biletat		
45.	7115	Gjoba e kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime		
46.	7116	Të ardhura nga transferimi pronës, legalizimi i ndërtimeve pa leje		
47.	**719**	***c) Të tjera të ardhura jo tatimore***		
48.	**72**	**IV. GRANTE KORENTE (a+b)**	286,347,866.60	271,654,184
49.	**720**	***a)Grant korent i brendshëm***	266,454,493.60	252,150,063
50.	7200	Nga i njëjti nivel Qeverisje		
51.	7201	Nga nivele të tjera Qeverisje		
52.	7202	Nga buxheti për pagesa posaçme të ISSH		
53.	7203	Nga buxheti për mbulim të deficiti të ISSH e ISKSH		
54.	7204	Pjesëmarrje e institucionit në tatime e taksa nacionale		
55.	7205	Financime shtesë nga të ardhura krijuar brenda sistemit		
56.	7206	Financim i pritshëm nga buxheti	19,893,373	19,504,121
57.	7207	Sponsorizime nga të tretë		
58.	7209	Të tjera grante të brendshme		
59.	**721**	***b) Grant korent i jashtëm***		
60.	7210	Nga Qeveri të Huaja		
61.	7211	Nga Organizata Ndërkombëtare		
62.	**73**	**V. NDRYSHIM GJENDJEVE PRODUKTEVE**		
63.	**78**	**VI. PUNIME PËR INVESTIME E RIMARRJE**		
64.	781	Punime, investime në ekonomi		
65.	782	Rimarrje parash për aktive qarkulluese		

Nr. Rreshti	Nr. LLOG. të ardhurave	PERSHKRIMI TE ARDHURAVE TE USHTRIMIT	VITI USHTRIMOR	VITI MEPARSHEM
66.	783	Rimarrje parash për aktivet e qëndrueshme		
67.	784	Suprimim i shumave parash për shpenzime të viteve të ardhshme		
68.	785	Përdorim i shumave parash për shpenzime të viteve të ardhshme		
69.	787	Tërheqje nga sektori i investimeve		
70.	**76**	**B. TË ARDHURA FINANCIARE**		
71.	760	Nga interesat e huadhënies brendshme		
72.	761	Nga interesat huadhënies se huaj		
73.	765	Të ardhura nga interesat e depozitave		
74.	766	Të ardhura nga këmbimet valutore		
75.	77	**C. TË ARDHURA TË JASHTZAKONSHME**		
76.	773	Nga veprimtari të mbyllura e ndryshime të tjera strategjisë		
77.	777	Nga gabime të lejuara në ushtrimet paraardhëse		
78.	778	Korrigjime nga vitet e kaluara		
79.	779	Të ardhura të tjera		
80.	**Klasa 7**	**TOTALI I TË ARDHURAVE**	286,347,866.60	271,654,184
81.	**82.84**	**D. OPERACIONI KORIGJIM I REZULTATIT**		
82.	829	Urdhër i shpallur anuluar ose parashkruar		
83.	841	Transferimi i ndryshimit të gjendjes		
84.	**Klasa 7 e 8**	**TOTALI OPERACIONEVE**	286,347,866.60	271,654,184
85.	**85**	**REZULTATI I VEPRIMTARISË**		
86.	**X**	**T O T A L I**	**286,347,866.60**	**271,654,184**

NJËSITË PUBLIKE TË AUDITUARA NGA KLSH GJATË VITIT 2014

1. Ish-Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBZHR&AU), Tiranë;
2. Ministria e Energjetikës & Industrisë, Tiranë; (Koncensionet)
3. Ministria e Shëndetësisë, Tiranë;
4. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivit të Shtetit, Tiranë;
5. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, Tiranë;
6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Tiranë;
7. Universiteti Politeknik, Tiranë;
8. Universiteti Bujqësor, Tiranë;
9. Shkolla e Magjistraturës, Tiranë;
10. Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi", Tiranë;
11. Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Tiranë;
12. Instituti i Shëndetit Publik, Tiranë;
13. Drejtoria e Arkivit Shtetëror Vendor, Durrës;
14. Drejtoria e Arkivit Shtetëror Vendor, Vlorë;
15. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Tiranë;
16. Muzeu "Gjergj Kastrioti Skënderbeu", Krujë;
17. Komuna Qendër, Mallakastër;
18. Banka e Shqipërisë;
19. Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë;
20. Ministria e Financave, Tiranë;
21. Autoriteti Rrugor Shqiptar;

22. Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, Tiranë;
23. Drejtoria Rajonale e ISSH, Tiranë;
24. Fondi Shqiptar i Zhvillimit;
25. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Tiranë;
26. ARRSH për borxhin;
27. Ministria e Shëndetësisë, QSUT për borxhin;
28. Zyra Shqiptare e të Drejtave të Autorit, Tiranë;
29. Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë;
30. Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës;
31. Qendra Kombëtare e Regjistrimit, Tiranë;
32. Administrata e Presidentit, Tiranë;
33. Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike-Dividenti;
34. Komisioni i Prokurimit Publik;
35. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivit të Shtetit, Tiranë (verifikim ankesash);
36. Bashkia Vlorë;
37. Bashkia Berat;
38. Bashkia Ura-Vajgurore;
39. Bashkia Elbasan;
40. Bashkia Lushnjë;
41. Bashkia Bajram Curri;
42. Bashkia Përrenjas;
43. Bashkia Krujë;
44. Bashkia Peshkopi;
45. Bashkia Rrogozhinë;
46. Bashkia Peqin;
47. Bashkia Laç;

48. Bashkia Shijak;
49. Bashkia Korçë;
50. Bashkia Sarandë;
51. Bashkia Shkodër;
52. Bashkia Burrel;
53. Bashkia Rrëshen;
54. Bashkia Vorë;
55. Komuna Paskuqan, Tiranë;
56. Komuna Fshat, Tropojë;
57. Komuna Bërxull, Tiranë;
58. Komuna Rrashbull, Durrës;
59. Komuna Qendër, Librazhd;
60. Komuna Shënkoll, Lezhë;
61. Komuna Farkë, Tiranë;
62. Komuna Remas, Lushnjë;
63. Komuna Qendër Çlirim, Fier;
64. Komuna Miras, Devoll;
65. Komuna Tomin, Dibër;
66. Komuna Golem, Kavajë;
67. Komuna Labinot Mal, Elbasan;
68. Komuna Margegaj, Tropojë;
69. Komuna Lekbibaj, Tropojë;
70. Komuna Bicaj, Kukës;
71. Komuna Kodër, Thuman;
72. Komuna Lurë, Dibër;
73. Komuna Voskopojë, Korçë;

74. Komuna Ksamil, Sarandë;
75. Komuna Kashar, Tiranë;
76. Komuna Pezë, Tiranë;
77. Komuna Udenisht, Pogradec;
78. Komuna Gjepalaj, Durrës;
79. Këshilli i Qarkut, Elbasan;
80. Këshilli i Qarkut, Dibër;
81. Prefektura e Qarkut, Vlorë;
82. Prefektura e Qarkut Fier;
83. Drejtoria Rajonale Rrugore Qendrore, Tiranë;
84. Drejtoria e Rajonit Rrugor Jugor, Gjirokastër;
85. Drejtoria e Rajonit Rrugor Verior, Shkodër;
86. Agjencia e Zhvillimit Bujqësor e Rural, Tiranë;
87. ALUIZNI Drejtoria Qendrore;
88. Drejtoria Rajonale ALUIZNI,Tirana 1;
89. Drejtoria Rajonale ALUIZNI, Durrës;
90. Drejtoria Rajonale ALUIZNI, Elbasan 1;
91. Drejtoria Rajonale ALUIZNI, Berat;
92. ZVRPP, Tiranë;
93. ZVRPP, Kavajë;
94. ZVRPP, Durrës
95. ZVRPP, Elbasan;
96. Ujësjellës sh.a., Ura-Vajgurore;
97. Zbatimi i rekomandimeve të vitit 2013;
98. Projekti “Zhvillimi i rrugëve Bashkiake Tiranë”, Bashkia Tiranë;
99. Projekti “Mbi menaxhimin e mbetjeve të ngurta të Tiranës”, DPUK Tiranë;

100. Projekti “Modernizimi i Asistencës Sociale”, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë;
101. Projekti “Programi rural i furnizimit me ujë”, FSHZH;
102. Projekti “Modernizimi i asistencës sociale”, pjesa e dytë;
103. Projekti “Administrimi dhe menaxhimit i tokës, Komponenti D. Ndërhyrje emergjente në zonën Shkodër-Lezhë”;
104. Projekti “Furnizimi me ujë dhe shërbimet sanitare Orikum”, Vlorë;
105. Projekti “Ndërtimi i aksit rrugor Tiranë-Elbasan”;
106. Projekti “Ndërtimi i rrugës Levan-Tepelenë”;
107. Autoriteti i Aviacionit Civil, Tiranë;
108. Autoriteti Portual, Durrës;
109. Porti Detar sh.a., Sarandë;
110. Albpetrol sh.a., Fier;
111. KESH sh.a., Tiranë;
112. Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., Tiranë;
113. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Tiranë;
114. Agjencia Rajonale e Mjedisit, Tiranë;
115. Agjencia Rajonale e Mjedisit, Qarku Durrës;
116. Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Tiranë;
117. Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Gjirokastër;
118. Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Shkodër;
119. Drejtoria e Përgjithshme Detare, Durrës;
120. Ujësjellës-Kanalizime sh.a., Tiranë;
121. Ujësjellës-Kanalizime sh.a., Durrës;
122. Ujësjellës-Kanalizime sh.a., Shkodër;
123. Ujësjellës-Kanalizime sh.a., Mirditë

124. Ujësjellës-Kanalizime sh.a., Gjirokastër;
125. INSIG sh.a., Tiranë;
126. Qendra e Trajtimit të Studentëve Nr.1 sh.a., Tiranë;
127. Qendra e Trajtimit të Studentëve Nr.2 sh.a., Tiranë;
128. Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, Tiranë;
129. Zbatimi i rekomandimeve të vitit 2013;
130. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Tiranë;
131. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Tiranë;
132. Dega e Doganës Rinas;
133. Dega e Doganës Tiranë;
134. Dega e Doganës Durrës;
135. Dega e Doganës Fier;
136. Dega e Doganës Vlorë;
137. Dega e Doganës Kapshticë;
138. Dega e Doganës Qafë-Botë, Sarandë;
139. Dega e Doganës Bllatë;
140. Dega e Doganës Kakavijë;
141. Dega e Doganës Berat;
142. Dega e Doganës Morinë, Kukës;
143. Dega e Doganës Tre Urat, Përmet;
144. Dega e Doganës Elbasan;
145. Drejtoria e Tatim-Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë;
146. Drejtoria e Tatim-Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Fier;
147. Drejtoria e Tatim-Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Shkodër;
148. Drejtoria e Tatim-Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Korçë;
149. Drejtoria e Tatim-Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Vlorë;

150. Drejtoria e Tatim-Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Elbasan;
151. Drejtoria e Tatim-Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Lezhë;
152. Laboratori Kimik Doganor, pranë DP. Doganave, Tiranë;
153. Ministria e Shëndetësisë, QSUT "Pajisjet mjekësore spitalore";
154. Radio Televizioni Shqiptar;
155. Ministria e Arsimit dhe Sportit, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, Drejtoria Arsimore Rajonale, Çerdhet dhe Kopshtet e Tiranës;
156. Instituti i Statistikës, "Censusi 2011", Tiranë;
157. Ministria e Kulturës, Biblioteka Kombëtare, Tiranë; "Infrastruktura e Shërbimit";
158. Ministria e Energjisë dhe Industrisë, KESH sh.a., ERE;
159. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, DPSHTRR, Policia e Shtetit;
160. Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH).

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tel. 042 251267

Nr. 711 Prot. Tiranë, më 15/07/2014

Lënda: *Kërkesë për auditimin e llogarive vjetore të KLSH-së*

Drejtuar: **Z. Ilir META**
Kryetar i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

TIRANË

Paraprakisht, më lejoni t'Ju falenderoj për ndihmën dhe mbështetjen që Ju si Kryetar i Kuvendit i keni dhënë institucionit të KLSH-së, për përmbushjen e objektivave dhe detyrimeve tona kushtetuese dhe ligjore.

Në vlerësim të miratimit nga Kuvendi të Vendimit nr. 64/2013 datë 26.11.2013, "Për fillimin e procedurave parlamentare për auditimin e veprimtarisë së KLSH-së", vendim i cili reflekton më së miri përmbushjen e kërkesavë të Ligjit Organik të KLSH-së, por edhe kërkesave të Standarteve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 20, parimi 6, *"...pasqyrat financiare të SAI-t bëhen publike dhe janë subjekt i auditimit të jashtëm të pavarur apo rishqyrtimit parlamentar..."*., ne kërkojmë mbështetjen Tuaj për zbatimin sa më shpejt të këtij vendimi.

Duke marrë shkas se gjatë vitit 2012 dhe 2013 nuk u ushtrua auditim mbi llogaritë e KLSH-së dhe bërjen publike të tyre, dhe njëherësh duke ju referuar faktit se kanë kaluar mbi 12 vjet që nuk auditohen këto llogari, më duhet t'Ju drejtohem përsëri, duke parashtruar përsa vijon:
- Në nenin 3, paragrafi i tretë, të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", i ndryshuar, përcaktohet:
"KLSH duhet çdo vit të përgatisë llogaritë e tij në përputhje me ligjin për buxhetin. Llogaritë e tij kontrollohen nga një organizëm i pavarur, i caktuar nga Kuvendi dhe raporton te ky".
Kryerja e auditimit të jashtëm të pavarur në institucionet supreme të auditimit (SAI) cilësohet dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit të INTOSAI (cituar më sipër), po kështu dhe në rekomandimet e paraqitura nga SIGMA në raportet e vlerësimit të veprimtarisë të KLSH-së për vitet 2008, 2009, 2010 dhe 2011.

Përsa më sipër, rikërkoj zyrtarisht auditimin e llogarive të KLSH-së për periudhën 2002-2013 dhe bërjen publike të tyre, duke plotësuar Ju si organi më i lartë, Kuvendi i Shqipërisë dhe ne si KLSH, organi suprem i auditimit, një detyrim të përmbajtur në ligjin tonë integral dhe në standardet ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI.

Ju bëjmë me dije se ky auditim duhet të kryhet sa më parë sepse ne kemi kërkuar tashmë një mision vlerësimi "Peer Riview" nga nje Institucion Suprem Auditimi partner, bazuar në Standartin Ndërkombëtar të Auditimit, ISSAI 5600.

Me bindjen se ky auditim do të përbëjë vlerë të shtuar për performancën e Kontrollit të Lartë të Shtetit, më lejoni të shpreh edhe një herë falenderimet për bashkëpunimin dhe konsideratat e mia më të larta.

Bujar LESKAJ

KRYETAR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 106/8 Prot. Tiranë, më 14.07.2015

Lënda: **Lidhur me statusin e zbatimit të planit të veprimit për rekomandimet e rezolutës së datës 26 qershor 2014 të Kuvendit të Shqipërisë**

Drejtuar: **Z. Erion BRAÇE**
KRYETAR I KOMISIONIT PËR EKONOMINË DHE FINANCAT

Në zbatim të rezolutës së datës 26 qershor 2014 të Kuvendit të Shqipërisë lidhur me "Vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2013", ne kemi përgatitur Planin e Veprimit për zbatimin e kësaj rezolute, të miratuar në datën 7 korrik 2014 dhe të dërguar pranë Kuvendit në datën 07/07/2014.

Bashkëngjitur do të gjeni informacionin e plotë lidhur me statusin e zbatimit të planit të veprimit për rekomandimet e rezolutës së datës 26 qershor 2014 të Kuvendit të Shqipërisë, të cilin po e dërgojmë një ditë përpara raportimit tonë mbi "Performancën e KLSH-së për vitin 2014", pranë Komisionit të Ekonomisë dhe Financave.

Dëshiroj t'Ju informoj që Projekti IPA 2013 për KLSH-në, ishte parashikuar të fillonte në fillim të vitit 2015 dhe është shtyrë për në muajin tetor të vitit 2015. Megjithatë edhe me burimet e brendshme, ne i kemi zhvilluar pjesërisht objektivat tona, siç do ta konstatoni edhe nga materiali bashkëngjitur.

Duke vlerësuar bashkëpunimin me Kuvendin e Shqipërisë, dhe veçanërisht e maksimalisht me Komisionin e Ekonomisë dhe Financave që Ju drejtoni, ne shprehim njëkohësisht angazhimin tonë për përmbushjen e objektivave dhe të misionit tonë si agjent i publikut dhe i Kuvendit të Shqipërisë për mirëadministrimin e parasë publike.

KRYETAR
Bujar LESKAJ

MBI STATUSIN E ZBATIMIT

TË PLANIT TË VEPRIMIT

PËR

REKOMANDIMET E REZOLUTËS

SË DATËS 26 QERSHOR 2014

TË KUVENDIT TË SHQIPËRISE

(Nr 106/6 Prot, Datë 07.07.2014)

HYRJE

Si institucioni më i lartë i auditimit publik në vend, me qasjen dhe këndvështrimin themelor që vepron si institucion agjent kushtetues i Kuvendit, për të siguruar miradministrimin me efektivitet, efiçiencë dhe ekonomicitet të fondeve shtetërore, duke e ushtruar veprimtarinë e tij audituese në bazë të Standardeve të INTOSAI-t, dhe veçanërisht ISSAI 1, Deklarata e Limës, Neni 8 "*Marrëdhënia me Parlamentin*", të ISSAI 12 "*Vlerat dhe Përfitimet e Institucioneve të Auditimit të Jashtëm Publik-të bësh diferencën në jetën e qytetarëve*", dhe standardit ISSAI 21 "*Parimet dhe Praktikat e mira të Transparencës dhe Përgjegjshmërisë*", si dhe në bazë të Kushtetutës së Shqipërisë, Neni 164 i saj, si dhe të Ligjit të tij organik, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) paraqet veprimet përfundimtare të "Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit dt. 26 qershor 2014", me Nr. Prot. 106/6, datë 07/07/2015, në respekt të gjithë mbështetjes së deritanishme të marrë nga Kuvendi i Shqipërisë e, në mënyrë të veçantë, nga Komisioni Parlamentar për Ekonominë.

Ky Plan mbulon periudhën Korrik 2014 - Korrik 2015.

Rekomandimet e Rezolutës së Kuvendit përfshihen gjithashtu natyrshëm në objektivat e Strategjisë së Zhvillimit 2013-2017 (të ripunuar) të KLSH, të përgatitur me ndihmën e ekspertëve të SIGMA-s dhe bazuar në drejtimet dhe planet strategjike të zhvillimit të organizatave INTOSAI (2011-2016) dhe EUROSAI (2011-2017).

Këto Rekomandime e kanë ndihmuar dhe orientuar konkretisht institucionin në reformimin e thellë dhe në vijueshmëri të tij, në përputhje me standardet profesionale ndërkombëtare të fushës ISSAI, me rekomandimet e Progres Raporteve të BE, me detyrimet kushtetuese dhe me pritshmëritë e larta të qytetarëve dhe opinionit publik të vendit.

Viti që kaloi ishte viti i një hapi të konsiderueshëm integrues në fushën e auditimit të jashtëm publik, i miratimit nga Kuvendi të ligjit të ri integral të institucionit, që i jep qasje shumë më të theksuar evropiane dhe profesionale KLSH, duke e afruar ndjeshëm me standardet e auditimit të jashtëm publik të BE-së dhe të ECA-s, Gjykatës së Audituesve të Bashkimit Evropian.

Institucioni gjykon se auditimet e përzgjedhura dhe të kryera gjatë kësaj periudhe, si dhe të gjitha gjetjet, rekomandimet dhe këshillimet e dhëna nga KLSH në frymën e zbatimit të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë të datës 26 qershor 2014, përbëjnë një bazë të sigurt për ta parë të garantuar të ardhmen e bashkëpunimit të efektshëm me Kuvendin dhe sidomos me Komisionin e Ekonomisë, si dhe me të gjithë veprimtarët e tjerë publikë: Qytetarët shqiptarë, Qeverinë, shoqërinë civile dhe median, për një auditim sa më cilësor të administrimit të fondeve publike, i cili rrit përgjegjshmërinë dhe transparencën e këtij administrimi, duke kontribuar ne rritjen e mirëqeverisjes, përmes thellimit të luftës kundër korrupsionit dhe antikulturës së pandëshkueshmërisë së zyrtarëve shtetërorë që shkelin ligjin dhe abuzojnë me fondet publike, të gjitha këto tërësisht në dobi të taksapaguesve dhe qytetarëve shqiptarë.

Shënim: *Shtyrja tej kohës së parashikuar e nisjes së Projektit të Binjakëzimit IPA 2013 ka sjellë që statusi i zbatimit të një sërë aktivitetesh të planifikuara të zhvendoset në periudhat në vijim, ndonëse KLSH ka vijuar punën për përmbushjen e Rekomandimeve të Kuvendit me burimet dhe kapacitetet e brendshme institucionale.*

Tiranë, 14 korrik 2015

KRYETARI

Bujar LESKAJ

Nr.	Rekomandimi i Kuvendit	Struktura zbatuese në KLSH	Koha e zbatimit	Fondet e duhura për zbatim	Statusi i Implementimit
1	***Angazhim maksimal në zbatimin e politikave antikorrupsion, në funksion të detyrimeve kushtetuese, ligjore dhe të kërkesave të organizatave ndërkombëtare, rekomandimeve të progres-raporteve të Komisionit Evropian, me qëllim mbrojtjen e fondeve shtetërore të taksapaguesve shqiptarë*** Ky rekomandim është i përfshirë tërësisht në Objektivin 5 "R*itja e kontributit të KLSH për qeverisjen e mirë, nëpërmjet luftës kundër korrupsionit*", të Strategjisë së Zhvillimit 2013-2017 të KLSH (Objektivi 5 dhe nën objektivat 5.1.1 -5.1.10 dhe nën objektivi nr 2.3 i objektivit nr 2 i Strategjisë së ripunuar 2015-2017)				
1.1	Zhvillimi i metodologjisë për orientimin e auditimit bazuar në riskun për mashtrim dhe korrupsion	Departamenti i Politikave të Auditimit	Korrik 2014 e në vijimësi	Buxheti i Shtetit/IPA 2013	Zhvillimi i metodologjisë për orientimin e Auditimit bazuar ne riskun e mashtrimit dhe korrupsionit ka qenë dhe do të vijojë të jetë në fokus të veprimtarisë menaxheriale nën objektivin të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të stafit auditues dhe hartimit te kuadrit rregullativ të fushës. Në funksion sa më sipër është nxjerrë Urdhri i Kryetarit nr. 1, date 13/01/2014 "Për Metodologjinë e Riskut" dhe me pas Urdhri nr. 18, datë 12/02/2015 "Për ngritjen e Grupit të Punës që do të punojë për përpunimin e informacionit të marrë nga institucionet shtetërore për identifikimin e objekteve me risk ekonomik, financiar dhe shoqëror". Në përfundim të këtij "projekti" do të rezultohet me përcaktimin dhe orientimin e veprimtarisë audituese të KLSH-së në ata sektorë të ekonomisë në të cilët risku ekonomik financiar shoqëror apo edhe politik është i konsiderueshëm. Po kështu referuar aktiviteteve që do të kryhen si rezultat e implementimit të projektit IPA 2013 për këtë komponent është parashikuar: 1- Zhvillimi i manualit të auditimit referuar çështjeve të mashtrimit dhe korrupsionit (Aktiviteti 2.1.3). 2-Zhvillimi i qasjes bazuar në risk të planifikimit strategjik të auditimeve financiare dhe të përputhshmërisë (Aktiviteti 2.2.1). Krahas sa më sipër në vazhdën e praktikës se organizimit të Konferencave Ndërkombëtare Shkencore në tremujorin e IV të

Nr.	Rekomandimi i Kuvendit	Struktura zbatuese në KLSH	Koha e zbatimit	Fondet e duhura për zbatim	Statusi i Implementimit
					këtij viti KLSH do të organizojë Konferencën e IV shkencore Ndërkombëtare objekti i së cilës do të jetë "Risku dhe menaxhimi i tij" . Qëllimi i kësaj konferencë do të jetë shpalosja e ideve, qasjeve metodologjive te menaxhimit të riskut gjatë procesit të auditimit por jo vetëm, trajtuar ky komponent në një rrafsh edhe me të gjerë adresuar sektorëve të ekonomisë, politikave ekonomike nën një optikë inovative siç mund të jetë Risku dhe Korrupsioni, etj. Po kështu, në Tetor të 2015 KLSH do të jetë institucioni organizator, dhe pritës i Workshopit me teme "Auditimi bazuar në Risk dhe Materialitet" organizuar në kuadrin e kalendarit të aktiviteve të Rrjetit të Koordinatorëve të SAI-ve të vendeve anëtare të BE-së,vendeve kandidate dhe kandidate të mundshme për në BE me pjesëmarrjen e ECA-s dhe SIGMA dhe Grupin e punës për aktivitetet e përbashkëta në auditim. (JWGAA). Në këtë aktivitet do të marrin pjesë përfaqësues nga SAI Turqisë, i Malit të Zi, Serbisë, Maqedonisë, Bosnje Hercegovinës Kosovës, si dhe pjesëmarrës nga përfaqësues të Gjykatës Europiane të Auditimit (ECA), SIGMA, SAI i Suedisë (SNAO).
1.2	Zhvillimi i trajnimeve specifike të stafit në lidhje me auditimin e mashtrimit dhe të korrupsionit	Departamenti i Politikave të Auditimit, Drejtoria e B.Njerëzore	Korrik 2014-Qershor 2015	Buxheti i Shtetit / IPA 2013	Me synim rritjen e kapaciteteve KLSH ka përkthyer dhe botuar "Auditimin e integritetit" si një metodë inovative e luftës kundër mashtrimit dhe korrupsionit bazuar në një metodologji balancuese të masave parandaluese dhe atë ndëshkimore. Ky material është punuar me të gjithë stafin audites. Në bazë të planit të implementimit të Projektit IPA (aktiviteti 2.1.2) është parashikuar kryerja e trajnimeve me objekt auditimin e mashtrimit dhe korrupsionit dhe përfshirë sistemin e sinjalizuesve (Whistle blower), si një metodologji specifike në këtë fushë. Është përkthyer dhe punuar libri "Auditimi i mashtrimit dhe Kontabiliteti Ligjor".

Nr.	Rekomandimi i Kuvendit	Struktura zbatuese në KLSH	Koha e zbatimit	Fondet e duhura për zbatim	Statusi i Implementimit
					Janë zhvilluar trajnime specifike në këtë fushë.
1.3	Rritja e marrëdhënieve të bashkëpunimit me agjencitë e angazhuara në luftën kundër korrupsionit (si Prokuroria e Shtetit, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, Autoriteti i Konkurrencës, etj.)	Kryetari i KLSH, Drejtoria Juridike dhe e Zbatimit të Standardeve	Korrik 2014-Korrik 2015	Buxheti i Shtetit	Për vitin 2014, KLSH ka denoncuar në prokurori 41 kallëzime penale për 149 persona dhe periudhën Janar Qershor 2015 KLSH i ka adresuar Prokurorisë 27 kallëzime penale për 74 persona dhe të gjitha këto kallëzime janë regjistruar nga Prokuroria. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka marrë pjesë në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga OPDAT-i Tiranë, me pjesëmarrjen e Kryetarëve të Njësive të Përbashkëta Hetimore (NJPH), si përfaqësues nga Prokuroria e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe Koordinatorët e NJPH nga dikasteret nënshkruese të Memorandumit të Bashkëpunimit të datës 6 Maj 2009. Ne këtë kuadër janë zhvilluar tre takime në nivel drejtues apo teknik, trajtuar më hollësisht ne seksionin 2.4.
1.4	Hartimi i metodologjisë për kuptimin dhe referimin në Prokurori të veprave penale që lidhen me mashtrimin dhe korrupsionin.	Departamenti i Politikave të Auditimit, Drejtoria Juridike dhe e Zbatimit të Standardeve	Ne vjiméesi	Buxheti i Shtetit	Zbatimi i këtij aktiviteti është i lidhur ngushtësisht edhe me veprimet dhe produktet e trajtuara me sipër referuar seksioneve 1.1; 1.2; 1.3 dhe do te jete objekt i gjatë implementimit të projektit IPA 2013 aktivitetet qe do te zhvillohen ne kuadrin e komponentit nr 2 "Zhvillimi i metodologjive të auditimit dhe kapaciteteve".
1.5	Thellimi i punës për evidentimin e rasteve të denoncimit të korrupsionit nga mediat, publiku si dhe të mesazheve që vijnë nga Kuvendi i Shqipërisë.	Drejtoria e Komunikimit, botimeve, mardh. me jashtë, Departamentet e Auditimit	Korrik 2014-Qershor 2015	Buxheti i Shtetit	Është ne procedurat standarde të planifikimit dhe ushtrimit të veprimtarisë audituese marrja e indicieve bazuar në evidentimin e rasteve të denoncimit të korrupsionit në media, publiku dhe mesazheve nga parlamenti. Në urdhrin nr. 19, datë 12.02.2015, të Kryetarit të KLSH-së "Për raportimin e procesit të auditimeve në subjekte" është përcaktuar detyrimi i shqyrtimit dhe përpunimit nga Grupet e auditimit të informacionit i rezultuar nga denoncimet ne median e shkruar, apo elektronike të rastet e korrupsionit, mashtrimit dhe shkeljeve te ligjshmërisë. Krahas sa më sipër KLSH ka vendosur procedura standarde për evidentimin dhe regjistrimin si indicie të auditimit të sinjalizimeve dhe ankesave nga qytetaret mediat etj. Janë ndërmarrë disa auditime nisur nga indiciet ne Media dhe ndjeshmëria e qytetareve, përmendim: - "Ndërtim Ujësjellësi depo Qafa e Kashit-Lapulec" (kallëzim

Nr.	Rekomandimi i Kuvendit	Struktura zbatuese në KLSH	Koha e zbatimit	Fondet e duhura për zbatim	Statusi i Implementimit
					penal, nr. 868/8 datë 11.04.2014, për shpërdorim detyre) - Muzeu Kombëtar "Gjergj Kastrioti" Krujë për abuzime me arkëtimet e të ardhurave nga shitja e biletave. - Arkivi Shtetëror Vendor, Vlorë, për lënien në qarkullim të dokumentacioneve që nga prokuroria është klasifikuar si i falsifikuar (çështja ka kaluar për kallëzim penal, nr. 175/11 datë 16.06.2014, për shpërdorim detyre) - Drejtoria e Përgjithshme e Arkivit, Tiranë, për verifikimin e ankesave të dy punonjësve, si rezultat i kryerjes së veprimeve fiktive për marrjen në dorëzim të mallrave nga furnitorët - ARRSH për Borxhet e prapambetura, - Min. Shëndetësisë QSUT, - AKBN, - Albpetrol sh.a. (ankesa dhe denoncime nga Sindikatat dhe Media), - "Albafilm" sh.a., - e raste të tjera.
1.6	Shkëmbimi i përvojës me SAI-t homologe me përvojë në fushën e auditimit të mashtrimeve financiare.	Kryetari i KLSH, Drejtoria e Komunikimit, botimeve, mardh. me jashtë,	Korrik 2014 në vijimësi	Buxheti i Shtetit /SAI partner	KLSH ka marrë pjesë aktive dhe ka qenë kontributor aktiv në të gjitha aktivitetet e organizuara nga SAI-t homologe apo dhe Institucionet Ndërkombëtare. Përmendim: -Pjesëmarrja në seminarin e zhvilluar në datat 3-7 Mars 2014, në Hungari me temë "Praktikat më të mira ndërkombëtare në forcimin e integritetit në sektorin publik", organizuar nga Zyra Shtetërore e Auditimit të Hungarisë për të mbështetur punën kundër korrupsionit të Institucioneve Supreme të Auditimit në vendet në zhvillim. Qëllimi i këtij seminari ishte që të rritej integriteti i institucioneve publike në vendet në zhvillim, të shpjegohej metodologjia e anketimit mbi integritetin e aplikuar gjatë këtyre viteve të fundit nga SAI Hungarez, si dhe të shkëmbeheshin eksperiencat e ndryshme. -Pjesëmarrja në Konferencën e organizuar nga Këshilli i Europës, Konferenca rajonale ballkanike " Mbi zbulimin dhe investigimin e korrupsionit e mashtrimit përmes procedurave të auditimit". Pjesëmarrja në Kongresin Ndërkombëtar mbi prokurimin publik organizuar në Slloveni 23-24 Prill 2015.

Nr.	Rekomandimi i Kuvendit	Struktura zbatuese në KLSH	Koha e zbatimit	Fondet e duhura për zbatim	Statusi i Implementimit
					Pjesëmarrja në Konferencën dhe seminarin mbi transparencën dhe integritetin 23-27 Mars 2015, Hungari.
1.7	Formulimi i një rekomandimi për Qeverinë në lidhje me promovimin e transparencës për vendimmarrjet menaxheriale	Drejtoria Juridike dhe e Zbatimit të Standardeve; Drejtoria e Komunikimit, botimeve, mardh. me jashtë,	Korrik 2015 dhe në vijimësi	Buxheti i Shtetit / IPA 2013	Zbatimi i rekomandimit deri më tani është formuluar, dhe adresuar për zbatim subjekteve të audituara në vijimësi. Për gjetjet dhe problematikat më të rëndësishme me impakte në menaxhimin e financave publike apo dhe shkeljet e konstatuara në sektorët me rëndësi strategjike, KLSH i ka adresuar qeverisë, Kryeministrit, anëtarëve të Këshillit të Ministrave informacionet mbi gjendjen e konstatuar dhe rekomandimet për përmirësimin e situatës dhe marrjen e masave me karakter legjislativ dhe organizativ. Në funksion sa më sipër për formulimin e rekomandimit në trajtë më të plotë ligjore do te asistohemi edhe nga ekspertët e projektit IPA 2013.
1.8	Identifikimi i dobësive të instrumenteve të përgjegjshmërisë menaxheriale në institucionet e audituara dhe pasqyrimi i tyre në raportet e auditimit	Departamentet e Auditimit Drejtoria Juridike dhe e Zbatimit të Standardeve, Departamenti i Politikave të Auditimit	Ne vijimësi	Buxheti i Shtetit	Identifikimi i dobësive dhe instrumenteve të përgjegjshmërisë menaxheriale si dhe vlerësimit i efektivitetit të funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm është objekt i procesit të auditimit në të gjitha auditimet e kryera dhe në çdo raport auditimi pasqyrohen mangësitë shkeljet dhe masat rekomanduese për përmirësimin e gjendjes.
2	***Ndjekjen rast pas rasti të ecurisë së kallëzimeve penale, duke ridimensionuar komunikimin institucional me organet e drejtësisë dhe me institucionet e hetimit, si dhe kërkimet për shpërblimin e dëmit të shkaktuar ndaj fondeve buxhetore për shlyerjen e dëmeve dhe ndëshkimin e personave përgjegjës*** Ky rekomandim është i përmbajtur tërësisht në Objektivin 5 «*Rritja e kontributit të KLSH për qeverisjen e mirë, nëpërmjet luftës kundër korrupsionit*", të Strategjisë së Zhvillimit 2013-2017 të KLSH (Objektivi nr. 5 e nën objektivat 5.1.1-5.1.10 të Strategjisë së ripunuar 2015-2017)				
2.1	Rritja e numrit të kontrolleve dhe auditimeve të KLSH për zbatimin e masave të propozuara nga institucioni për shpërblimin e demit ndaj Buxhetit të Shtetit	Departamentet e Auditimit	Korrik 2014 dhe ne vijim	Buxheti i Shtetit	Gjatë vitit 2014 janë realizuar 160 auditime përkundrejt 153 auditimeve në vitin 2013. Në çdo auditim të kryer nga KLSH një nga pikat është verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së gjatë auditimit të fundit në subjekt. Në fund të çdo viti, çdo Departament Auditimi harton nje program të veçante për auditimin e zbatimit te rekomandimeve të tij. Në këtë mënyrë KLSH (në nivel Departamenti auditimi) për të gjitha auditimet e kryera gjatë veprimtarisë audituese vjetore

Nr.	Rekomandimi i Kuvendit	Struktura zbatuese në KLSH	Koha e zbatimit	Fondet e duhura për zbatim	Statusi i Implementimit
					harton raportet departamentale të konsoliduara për statusin e zbatimit të rekomandimeve. Krahas sa më sipër nën aktivitetin 1.2.3 të Projektit IPA është parashikuar përgatitja e një manuali dhe zhvillimi i IT sistem mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.
2.2	Kërkesa për hartimin e një ligji për përgjegjësinë materiale të zyrtarëve publikë në lidhje me vendimmarrjet e tyre, me qëllim parandalimin dhe kufizimin e gabimeve të rënda dhe abuzimeve në menaxhimin e fondeve buxhetore, nga ana e drejtuesve të lartë publikë	Kryetari i KLSH, Drejtoria Juridike e Zbatimit të Standardeve	Janar-Korrik 2015	Buxheti i Shtetit	KLSH në Raportin "Mbi zbatimin e buxhetit të Shtetit të vitit 2013" ka paraqitur argumentet dhe propozimet mbi domosdoshmërinë e hartimit të ligjit "Për përgjegjësinë materiale". Për më shumë bashkëlidhur rezolutes ndodhet dokumenti i propozimit. KLSH me shkresën nr. 659, datë në datë 6 .07.2015 ia ka adresuar propozimin për hartimin e ligjit "Për përgjegjësinë materiale" dhe Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Zëvendës Kryetarit të Kuvendit Ministrit te Financave, Kryetarit të Komisionit të Ekonomisë, Kryetarëve të Grupeve Parlamentare të Partisë Demokratike e të Partisë Socialiste dhe Kryetarit të Komisionit të Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejta Njeriut .
2.3	Realizimi i një memorandumi me Qeverinë, në baze të të cilit personat e administratës qendrore që kallëzohen penalisht nga KLSH për dëm të shkaktuar ndaj fondeve buxhetore, të pezullohen përkohësisht nga puna si edhe inkurajimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së për Institucionet Qendrore.	Kryetari i KLSH, Drejtoria Juridike e Zbatimit të Standardeve	Dhjetor 2014 dhe ne vijimësi	Buxheti i Shtetit	KLSH ka insistuar për hartimin e një dokumenti (memorandumi) bashkëpunimi me qeverinë veçanërisht ne momentin e hartimit te Strategjisë Kombëtare të Qeverisë kundër korrupsionit si dhe ia ka adresuar dhe Kuvendit me Raportet qe KLSH paraqet ne Kuvend ne kuadrin e përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore. Realizimi i këtij dokumenti është në vartësi të vendimmarrjes së Qeverisë.
2.4	Thellimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me Prokurorinë dhe nxitje për dërgimin ne Gjykate, në një kohë sa më të shpejte, të rasteve flagrante të denoncuara dhe të kallëzuara	Kryetari i KLSH, Drejtoria Juridike dhe e Zbatimit të Standardeve	Korrik 2014 e ne vijimësi	Buxheti i Shtetit	Në shkurt të vitit 2015, nga ana e institucioneve respektive pjesë e marrëveshjes së bashkëpunimit për krijimin e Njësisë së Përbashkët Hetimore (NJPH) janë zhvilluar dy takime në nivel drejtues në Shkurt 2015 dhe në nivel teknik në Mars 2015 për evidentimin e problematikave që kanë shoqëruar veprimtarinë ndërinstitucionale në luftën kundër korrupsionit gjetjen e mekanizmave të forcimit të bashkëpunimit dhe rifreskimin e

Nr.	Rekomandimi i Kuvendit	Struktura zbatuese në KLSH	Koha e zbatimit	Fondet e duhura për zbatim	Statusi i Implementimit
	penalisht nga KLSH				përmirësimit të marrëveshjes ekzistuese të bashkëpunimit . Çdo kallëzim penal i kryer nga KLSH-ja që është mbyllur nga Prokuroritë e Rretheve është rihapur nga Prokurori i Përgjithshëm pas kërkesës të kryer nga ana jonë. Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Hetimit në Prokurorinë e Përgjithshme kanë mbështetur KLSH-në në këtë proces.
3	***Hartimin e programeve të punës për rritjen e efiçiences së veprimtarisë auditueese në drejtim të auditimit të performances, auditimit financiar dhe atij tematik, si dhe rifillimin e punës për auditimin vlerësues*** Ky rekomandim është i përmbajtur tërësisht ne Objektivin 2 «*Rritja e kapaciteteve auditueese dhe e cilësisë së auditimit*" dhe Objektivin 3 "*Përmirësimi i cilësisë dhe shtimi i numrit të auditimeve të performances*" të Strategjisë së Zhvillimit 2013-2017 të KLSH (Objektivi nr 2 nënobjektivat 2.2 ; 2.5, dhe objektivi nr. 3, nënobjektivat 3.1-3.4 të Strategjisë së ripunuar 2015-2017)				
3.1	Hartimi i plotë i programit vjetor të auditimit 2015 sipas modelit të bazuar në risk	Kryetari i KLSH, Drejtoria Juridike dhe e Zbatimit të Standardeve, Departamenti i Politikave të Auditimit,	Nëntor-Dhjetor 2014 e në vijim	Buxheti i Shtetit / IPA 2013	Programi i auditimit për 2015 është hartuar sipas modelit të bazuar në risk. Bazuar në aktivitetin 2.2.1 dhe 2.2.2 të Projektit IPA 2013 do të zhvillohet qasja e planifikimit strategjik të auditimit bazuar në risk.
3.2	Përgatitja e një udhëzuesi të veçantë lidhur me programimin e auditimit të bazuar në rrezik	Kryetari i KLSH, Drejtoria Juridike dhe e Kontrollit të Cilësisë Departamenti i Politikave të Auditimit	Dhjetor 2014 dhe në vijimësi	Buxheti i Shtetit / IPA 2013	Është punuar në këtë drejtim dhe ka drafte të përfunduara. Për menaxhimin e riskut janë vënë në dispozicion të të gjithë stafit auditues disa udhëzues, të nevojshëm për menaxhimin e riskut institucional dhe për punën auditueese: në fazën e planifikimit të auditimit, punës në terren dhe vlerësimit pas përfundimit të auditimit. Përmbushja e këtij rekomandimi është i lidhur ngushtësisht edhe me aktivitetet dhe masat e ndërmarra sikurse është përshkruar në seksionin 1.1.
3.3	Trajnimi i stafit të përzgjedhur lidhur me përdorimin e modelit të riskut në programimin vjetor të	Departamenti i Politikave të Auditimit, Drejt. B. Njerëzore	Korrik 2015 dhe në vijimësi	Buxheti i Shtetit / IPA 2013	Gjatë vitit 2014, trajnimet që mbulojnë këtë tematikë janë realizuar si pjesë e trajnimit për Planifikimin Strategjik dhe Vjetor të Auditimit. Urdhëri i Kryetarit të KLSH nr.18, datë 12.02.2015 parashikon kryerjen e Trajnimeve për këtë qëllim. Projekti IPA ka

Nr.	Rekomandimi i Kuvendit	Struktura zbatuese në KLSH	Koha e zbatimit	Fondet e duhura për zbatim	Statusi i Implementimit
	auditimit				parashikuar trajnime për këtë çështje.
3.4	Kryerja e *"Peer Review (rishikim nga kolegët)"* nga një SAI i zhvilluar partner, me qëllim zbulimin e mundësive për përmirësim të mëtejshëm të performancës dhe menaxhimit të KLSH	Kryetari i KLSH, Departamenti i Politikave të Auditimit SIGMA SAI-t partnere	Viti 2015 e ne vijim	Buxheti i Shtetit	KLSH është përzgjedhur nga Gjykata Austriake e Auditimit (ACA) dhe INTOSAI, si SAI Evropian në të cilin do të zhvillohet procesi i *Peer Review,* lidhur me pavarësinë e SAI-ve. Me shkresën nr 901/3 datë 19.06.2015 z. Josef Moser, President i ACA dhe Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t, konfirmoi përzgjedhjen e KLSH-së për kryerjen e procesit të Peer-Review në rajonin e EUROSAIT-t.
3.4.1	Kërkesë e KLSH-se për *"Peer Review"*, drejtuar 28 SAI-ve të vendeve anëtare të BE-së.	Kryetari i KLSH-së	Korrik 2014 e ne vijim	Buxheti i Shtetit	KLSH i ka adresuar kërkesën për kryerjen e Peer Review 28 SAI-ve të vendeve anëtare të BE-së. Kërkesës i janë përgjigjur shtatë SAI të vendeve të BE-së dhe konkretisht: SAI i Sllovakisë, Sllovenisë, Holandës, Estonisë, Lituanisë, Kroacisë dhe i Polonisë.
3.5	Rishikimi i manualit te auditimit financiar	Kryetari i KLSH, Departamenti i Politikave të Auditimit, SIGMA SAI-t partnere	Procesi nisi ne Shkurt-2015 dhe përfundon në Nëntor 2015	Buxheti i Shtetit / IPA 2013	Në kuadër të implementimit të aktiviteteve IPA 2013 është parashikuar rishikimi i manualit të auditimit financiar dhe kryerja e auditimeve pilot. Krahas sa më sipër KLSH në kuadrin e zbatimit të marrëveshjes me IDI- INTOSAI nënshkruar në vitin 2013 për implementimin e ISSAI-ve ka hartuar Strategjinë e Implementimit të ISSAI për vitin 2015-2016. Në **strategjinë e Implementimit të ISSAI 2015-2016** nën objektivin *"Ndërtimi i manualit të Auditimit Financiar për të udhëzuar kryerjen e auditimit në përputhje të plotë me kërkesat e standardeve ndërkombëtare të auditimit"* është parashikuar rishikimi i Manualit të Auditimit Financiar nga burime të brendshme dhe ndërrmarja e trajnimeve të stafit nga moderatorët e certifikuar nga IDI për implementimin e Manualit.
3.6	Zhvillimi i metodologjive	Dep. Auditimit të	Korrik 2014-	Buxheti i	Në këtë drejtim Departamenti i Auditimit të Performancës ka

Nr.	Rekomandimi i Kuvendit	Struktura zbatuese në KLSH	Koha e zbatimit	Fondet e duhura për zbatim	Statusi i Implementimit
	specifike për auditimet e performances dhe përdorimin e teknikave të reja në auditim	Performances, Departamenti i Politikave të Auditimit	Korrik 2015	Shtetit	arritur: 1. Formulimin e programit-tip, projekt/raportit dhe raportit-tip për auditimin e performancës, sipas modelit holandez dhe suedez, ku janë specifikuar në rubrika drejtimet në të cilat duhet të shtrihet një auditim i suksesshëm performance; 2. Janë zhvilluar trajnime me kolegët e SNAO-s për metodologjitë audituese, sipas qasjes lart-poshtë, poshtë-lart, problemore dhe integrale; 3. Janë përkthyer dhe botuar ne gjuhën shqipe dy botime të rëndësishme: • "Manuali i Departamentit të Auditimit të Performancës" dhe • "Indikatorët e performancës" sipas modelit të NAO-s britanike.
3.7	Workshop për Auditimin e Performances, në lidhje me veprimtarinë audituese të Departamentit për vitin 2014	Dep. Auditimit të Performances	Zhvilluar ne Prill 2015.	Buxheti i Shtetit	Në prill 2015 është zhvilluar Workshop-i për veprimtarinë audituese të vitit 2014, ne bashkëpunim me profesoratin e Universitetit "Aleksandër Xhuvani", Elbasan.
4	***Garantimin e veprimtarisë audituese me cilësi të lartë dhe efektivitet, sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të auditimit*** Ky rekomandim është i përfshirë tërësisht në Objektivin 2 «*Rritja e kapaciteteve audituese dhe e cilësisë së auditimit*" të Strategjisë së Zhvillimit 2013-2017 të KLSH (Objektivi nr 2 dhe nën objektivat nr 2.1-2.10 të Strategjisë së ripunuar 2015-2017)				
4.1	Hartimi i Strategjisë së Implementimit të standardeve të INTOSAI-t, ISSAI-ve, duke përfshirë gjetjet e "iCAT-s" (Mjetet e Vlerësimit të Pajtueshmërisë me ISSAI-t)	Sekretari i Përgjithshëm, Departamenti i Politikave të Auditimit Drejtoria e Metodologjisë	Qershor 2015	Buxheti i Shtetit	Është hartuar Strategjia e Implementimit te ISSAI-ve dhe Plani i Veprimit për vitin 2015-2016 dhe hartimin e standardeve Kombëtare të Auditimit ne vitin 2017. Me Vendimin nr 58 datë 30.06.2015 të Kryetarit është miratuar

Nr.	Rekomandimi i Kuvendit	Struktura zbatuese në KLSH	Koha e zbatimit	Fondet e duhura për zbatim	Statusi i Implementimit
	dhe hartimin e një Plani Veprimi për implementimin e Strategjisë.				Strategjia e implementimit të Standarteve Ndërkombëtare të Auditimit 2015-2016.
4.2	Hartimi i manualit të auditimit të përputhshmërisë	Kryetari i KLSH, Dep. i Politikave të Auditimit, Dep. e Auditimit	Miratimi Përfundimtar Dhjetor 2015. (Efekti i imlementimit te IPA Projekt)	Buxheti i Shtetit / IPA 2013	Bazuar në Strategjinë e implementimit të ISSAI-ve nga burime të brendshme u parashikua dhe u përgatit drafti i Manualit të Përputhshmërisë dhe tashmë jemi në fazën e ndërmarrjes së hapave për trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve të stafit auditues për implementimin e Manualit. Rishikimi i Manualit të përputhshmërisë do të jetë objekt i implementimit të aktiviteteve të IPA 2015 si dhe kryerjes së auditimeve pilot nën asistencën e ekspertëve të IPA. KLSH krahas sa më sipër ka përkthyer dhe botuar në Shqip, Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë 4000-4200.
4.3.	a) Zhvillimi i metodologjisë për auditimin e projekteve me fonde të BE. b) Trajnimi i stafit të përzgjedhur për këtë lloj auditimi	Dep. i Politikave të Auditimit, SIGMA	Korrik 2014 e në vijimësi	Buxheti i Shtetit / SIGMA	Janë kryer trajnime nga SIGMA me objekt: Auditimi i projekteve të huaja financuar nga fondet e BE-së. (1 trajnim -25 Auditues) Janë kryer trajnime nga Qendra e Exellences e Financës Sloveni CEF (2 trajnime- pjesëmarrës 6 auditues) me objekt "Auditimi i projekteve te BE-se IPA" Një auditim pilot në projektet e financuara nga BE është parashikuar te kryhet nën implementimin e projektit IPA 2013.
4.4	Përmirësimi i skemës së menaxhimit të cilësisë së auditimit, përfshirë shqyrtimet "e nxehta" dhe "të ftohta"	Drejtoria Juridike dhe Zbatimit te Standardeve	Dhjetor 2014 e ne vijimësi	Buxheti i Shtetit	Është punuar në këtë aspekt dhe janë sanksionuar rregulla të reja në Rregulloren e Brendshme me impakt përmirësimin e skemës si për shqyrtimet e nxehta dhe të ftohta. Treguesi i sasisë së praktikave audituese që i nënshtrohet procesit të "shqyrtimit në të ftohtë"ka arritur **në 20 % të totalit** të dosjeve në nivel vjetor proces ky i kryer në bashkëpunim me OJF-të profesionale të fushës se kontabilitetit, duke rritur frytshmërinë e kontrollit në të ftohtë dhe rritur nivelin e sigurimit të cilësisë.

Nr.	Rekomandimi i Kuvendit	Struktura zbatuese në KLSH	Koha e zbatimit	Fondet e duhura për zbatim	Statusi i Implementimit
4.5	Kontraktimi i ekspertëve të jashtëm të pavarur lidhur me vlerësimet e cilësisë së auditimit.	Kryetari i KLSH, Drejtoria Juridike dhe Zbatimit te Standardeve	Shtator 2014-Qershor 2015	Buxheti i Shtetit	Janë realizuar *Mini Peer Review* ne këtë drejtim, nga eksperte të Jashtëm (KKK) dhe janë dorëzuar raportet e tyre në lidhje me kontrollin e cilësisë në të ftohtë. Janë realizuar dy procese Mini Peer Riview "Kontrolli i cilësisë në të ftohtë" në bashkëpunim me: i) Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit dhe ii) Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë.
4.6	Realizimi i 13 botimeve të KLSH-së që përfshijnë tre numra të revistës shkencore "Auditimi Publik", Standarte të Auditimit (ISSAI) , botimin për Konferencën e III Shkencore, Analizën e punës dhe performancën e institucionit për vitin 2013, etj	Kryetari i KLSH, Dep. i Politikave të Auditimit	Dhjetor 2014 –Korrik 2015	Buxheti i Shtetit	Gjatë vitit 2014, KLSH ka vijuar me publikimin e botimeve duke i shtuar 21 botimeve te viteve 2012-2013, **14 botimet e 2014,** të cilat variojnë nga publikime informuese për raportet vjetore të institucionit dhe marrëdhëniet me Kuvendin, tek botimet shkencore për standardet INTOSAI, për udhëzuesit e auditimeve të ndryshme, e tjerë. Me konkretisht janë botuar titujt si më poshtë: 1. Analiza vjetore e punës 2013 2. Performanca e KLSH-së 2013 (shqip/anglisht) 3. Revista "Auditimi Publik" nr. 6,7, 8 (shqip/anglisht) 4. Audituesit e KLSH në shtypin e përditshëm, janar-qershor 2014, volumi i II-të; 5. Konferenca e Tretë Shkencore e KLSH-së, *"Auditimi Kombëtar në Shërbim të Qeverisjes Kombëtare";* 6. 60 Vjet INTOSAI, 50 Vjet Sekretariat i Përgjithshëm; 7. Numri special i *INTOSAI Journal* për Kongresin e Pekinit; 8. Standardet INTOSAI mbi mjedisin (ISSAI 5110-5140); 9. Etika në SAI dhe në Institucionet e tjera Publike; 10. INTOSaint; 11. ISSAI 5220 dhe Kodi i Transparencës Fiskale; 12. Auditimi mjet për një qeverisje më të mirë: rasti i Shqipërisë. ***Për vitin 2015 KLSH*** ka parashikuar t'i shtojë kolanës së botimeve të KLSH-së 15 tituj te rinj, nga të cilët deri tani janë përfunduar 8

Nr.	Rekomandimi i Kuvendit	Struktura zbatuese në KLSH	Koha e zbatimit	Fondet e duhura për zbatim	Statusi i Implementimit
					tituj: 1. Analiza vjetore e punës 2014; 2. Revista "Auditimi Publik" nr. 9 (shqip/anglisht); 3. Audituesit e KLSH në shtypin e përditshëm, qershor-dhjetor 2014, volumi i III-të; 4. Konferenca e Tretë Shkencore e KLSH-së, *"Auditimi Kombëtar në Shërbim të Qeverisjes Kombëtare"*, në gjuhën angleze; 5. Standartet e GAO's; 6. Indikatorët e Performancës; 7. Manuali i Departamentit të Auditimit të Performancës; 8. Manuali i auditimit të IT. Fondi i shpenzuar për 14-15 publikime në nivel vjetor rezulton në rreth **2.1 milionë lekë** duke realizuar nëpërmjet procedurave të prokurimit një çmim modest **prej 140 mije lekë për çdo botim,** me rreth 250 kopje secili dhe mesatarisht 300 faqe për kopje (përfshirë në këtë çmim fletë palosje dhe katalogë te botimeve).
4.7	Rritja e prezencës se Audituesve në shtypin e shkruar me qëllim rritjen e transparencës së punës së tyre për publikun e gjerë.	Departamentet e Auditimit	Korrik 2014-Qershor 2015	Buxheti i Shtetit	Gjatë 2014, KLSH ka qenë prezente pothuajse në të gjitha gazetat me 134 shkrime, të shkruara nga 51 audites të KLSH-së, përkundrejt 124 shkrimeve në vitin 2013 të 42 audituesve. Gjatë periudhës Janar-Qershor 2015, KLSH ka qenë prezentë pothuajse në të gjitha gazetat me 62 shkrime, të shkruara nga 38 audites të KLSH-së.
4.8	Vazhdimi i promovimit të vlerave të Institucionit dhe ngritja e komisionit për kremtimin e 90 vjetorit të tij.	Kryetari i KLSH, Drejtoria e Komunikimit, Mardh. me jashte	26 Maj 2015	Buxheti i Shtetit	**Realizuar.** Është ngritur Komisioni për Organizimin e ceremonisë, e cila u zhvillua më 26 maj 2015. Në ceremoninë e organizuar në sallën e seancave Plenare të Kuvendit të Shqipërisë morën pjesë personalitete të larta të Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI) nga Europa, drejtues të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) dhe Organizatës Europiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI) si dhe personalitete të larta të

Nr.	Rekomandimi i Kuvendit	Struktura zbatuese në KLSH	Koha e zbatimit	Fondet e duhura për zbatim	Statusi i Implementimit
					shtetit shqiptare, drejtues të Institucioneve të pavarura Shqiptare, deputetë, përfaqësues të OJF-ve, të profesionistëve të fushës së Ekonomisë dhe Auditimit dhe të Medias. Ceremoninë e nderuan me pjesëmarrjen e tyre, gjithashtu dhe z.Josef Moser, President i Gjykatë Austriake të Auditimit dhe njëkohësisht Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t, z. Vitor Caldeira, President i Gjykatës Europiane të Audituesve, z. Recai Akyel, Zv/President i EUROSAI-t dhe President i Gjykatës Turke të Llogarive, z. Ivan Klesic, Auditues i Përgjithshëm i SAI-t kroat, z. Milan Dabovic, President i SAI-t të Malit të Zi, z. Milenko Sego, Auditues i Përgjithshëm i SAI-t të Bosnje dhe Hercegovinës; z.Radoslav Sretenovic, President i SAI-t të Serbisë; z. Wojciech Kutyła, Zv.President i NIK-ut Polak; z.Naser Ademi, zv.Auditues i Përgjithshëm i SAI-t të Maqedonisë, z. Cosmin Nicula, zv.President i SAI-t të Rumanisë, z.Artan Venhari, zv.Auditues i Përgjithshëm i ZAP-it të Kosovës, si dhe përfaqësues të institucioneve të rëndësishme të BE-së si z.Robert Gielisse, nga DG Budget dhe z. Joop Vrolijk, SIGMA. Një përshëndetje krejt e veçantë për 90 vjetorin e KLSH-së ishte ajo e z. Gene Dodaro, Kontrollorit të Përgjithshëm të Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA, i cili nëpërmjet një video mesazhi i përcolli stafit të KLSH-së urimet për 90 vjetorin e institucionit. Ceremonia u përshëndet nga Presidenti i Republikës, z. Bujar Nishani dhe Kryetari i Kuvendit z. Ilir Meta.
5	***Konsolidimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me partneret vendas dhe të huaj, me synim përmirësimin e menaxhimit publik dhe financiar të vendit*** Ky rekomandim është i përmbajtur tërësisht në Objektivin 6 «*Rritja e ndikimit përmes Komunikimit dhe Bashkëpunimit*" të Strategjisë së Zhvillimit 2013-2017 të KLSH (Objektivi 6 dhe nën objektivat 6.1.1-6.1.9 e Strategjisë së ripunuar 2015-2017).				

Nr.	Rekomandimi i Kuvendit	Struktura zbatuese në KLSH	Koha e zbatimit	Fondet e duhura për zbatim	Statusi i Implementimit
5.1	Rinisja e një bashkëpunimi konkret me strukturat e auditimit të brendshëm në Ministrinë e Financave, në bazë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të 8 majit 2012, mes Ministrisë së Financave dhe KLSH	Kryetari i KLSH, Drejtoria Juridike dhe Zbatimit te Standardeve	Korrik 2014 dhe në vijim.	Buxheti i Shtetit	Aktualisht ekziston një bashkëpunim me strukturat e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe po synohet për riaktivizimin e marrëveshjes.
5.2	Vazhdimi dhe thellimi i bashkëpunimit me Auditimin e Brendshëm të Ministrisë së Financave, me Autoritetin e Konkurrencës, me Institutin e Administratës Publike, si dhe me shoqatat e shoqërisë civile, me të cilët KLSH ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi ne vitet 2012-2013	Kryetari i KLSH, Drejtoria Juridike dhe Zbatimit te Standardeve, Dep. i Politikave të Auditimit	Korrik 2014 dhe ne vijimësi	Buxheti i Shtetit	Kemi pasur me të gjitha këto institucione bashkëpunime konkrete, po punojmë për përditësimin e protokolleve. Përgjatë vitit 2014 dhe gjashtëmujorit të parë 2015 KLSH ka vijuar me nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me: 1-Institutin Shqiptar të Shkencës; 2-Shoqatën e Kontabilisteve dhe Financiereve të Shqipërisë; 3-Komitetin Shqiptar të Helsinkit dhe 4- Qendrës për Transparencë dhe Informim të Lirë (në mbështetje të një Projekti të QTIL dhe USAID-it).
5.3	Vazhdimi dhe thellimi i bashkëpunimit me INTOSAI, EUROSAI , ECA dhe me SAI-t partnere si SAI i Polonisë, Turqisë, Kroacisë, ZAP-i i Kosovës, SAI i Austrisë, SAI-t e vendeve të tjera ballkanike. Lidhja e marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit.	Kryetari i KLSH, Drejtoria e Komunikimit, Mardh. me jashte	Korrik 2014 dhe ne vijimësi	Buxheti i Shtetit	Kontrolli i Lartë i Shtetit, përveç të qenit anëtar i Grupit të Punës së EUROSAI-t për Auditimet e Mjedisit dhe i Task Forcës mbi Auditimin dhe Etikën, gjatë vitit 2014, u pranua dhe tashmë është anëtar edhe i Grupit të Punës së EUROSAI-t si ai mbi Auditimin e Fondeve të alokuara për Fatkeqësitë dhe Katastrofat. Gjithashtu është anëtar i Grupit të Punës "Për Rishikimin e ISSAI 30". Ka përvijuar bashkëpunimi me partneret e huaj dhe ka qenë i frytshëm në drejtim të trajnimeve. Vlen për t'u theksuar bashkëpunimi konkret me ECA-n, Gjykatën Europiane të Audituesve. Një tjetër vlerë e shtuar kjo për institucionin ku KLSH përfiton nga përvoja më e mirë e një prej institucioneve më prestigjioze evropiane. Për herë të parë, auditues të KLSH-së janë pjesë përbërëse e strukturave të ECA-s, të cilët përfituan nga programet e internshipit të këtij institucioni me afat 6 mujor si dhe

Nr.	Rekomandimi i Kuvendit	Struktura zbatuese në KLSH	Koha e zbatimit	Fondet e duhura për zbatim	Statusi i Implementimit
					vijon bashkëpunimi edhe për periudhën Shtator 2015-Mars 2016 për auditues të tjerë. Në programet e intershipit, audituesit marrin pjese dhe kontribuojnë pranë departamenteve dhe drejtorive të ndryshme të ECA-s. Në kuadrin e bashkëpunimit me SAI-t homologe në rrafshin ndërkombëtar Kryetari i KLSH-së ka zhvilluar takim pune në zyrat e Auditimit të Qeverisë të SHBA-së (GAO) me Kontrollorin e Përgjithshëm të GAO-s z. Gene Dodaro në të cilin u trajtuan një sërë çështjesh me interes të përbashkët si dhe u cilësua mbështetja e GAO-s për KLSH-në në periudhat e ardhshme. Gjatë kësaj periudhe vazhdojnë takimet me Drejtuesit e Lartë të EUROSAI-t, ECA dhe SAI-ve të Polonisë, Turqisë, Austrisë, Kroacisë, Kosovës, Malit të Zi, etj.
6	***Vijimin e bashkëpunimit me Kuvendin dhe institucionet ligj-zbatuese për përmirësimin e akteve ligjore dhe nënligjore, veçanërisht të ligjit për Kontrollin e Lartë të Shtetit*** Ky rekomandim është i përmbajtur tërësisht në Objektivin 1 «Zhvillimi i kapacitetit institucional të KLSH. Amendimi i bazës ligjore dhe rregullatore të KLSH në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat e mira evropiane" të Strategjisë së Zhvillimit 2013-2017 të KLSH (objektivi nr 1 dhe nën objektivat nr 1.1 dhe 1.3 dhe objektivit nr 6 "Rritja e ndikimit nëpërmjet komunikimit dhe bashkëpunimit" nën objektivi 6.1.6 të Strategjisë së rishikuar 2015-2017)				
6.1	Diskutime me Kryetarin e Kuvendit dhe me Komisionin e Ekonomisë dhe Financave për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit Kuvend-KLSH(propozime konkrete)	Kryetari i KLSH	Janar 2015	Buxheti i Shtetit	Ka pasur bashkëpunime, veçanërisht për miratimin e Ligjit të ri.
6.2	Bashkëpunim ne vijimësi me DG-Budget dhe SIGMA ne procesin e konsultimit për miratimin e projektligjit te KLSH në Kuvend, në përputhje të plotë me standardet e INTOSAI-t, si dhe konsultime në vijimësi me Komisionin e Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit	Kryetari i KLSH, Drejtoria Juridike dhe Zbatimit te Standardeve, Departamenti i Politikave të Auditimit	Janar 2015	Buxheti i Shtetit	Realizuar.
6.3	Raportime dhe prezencë e	Kryetari i KLSH	Shtator 2014-	Buxheti i	KLSH ka qenë prezente sa herë që është kërkuar nga Komisioni.

Nr.	Rekomandimi i Kuvendit	Struktura zbatuese në KLSH	Koha e zbatimit	Fondet e duhura për zbatim	Statusi i Implementimit
	vazhdueshme në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave mbi bazën e kërkesave të Komisionit		Qershor 2015	Shtetit	KLSH i ka bërë prezent Komisionit të Ekonomisë dhe Financave raporte dhe problematika të ndryshme të rezultuara nga veprimtaria audituese ne subjekte. Krahas sa më sipër KLSH i ka adresuar ftesa për pjesëmarrje, paraqitje të kumtesave dhe punimeve të ndryshme ne aktivitete me karakter shkencor organizuar nga KLSH, analiza, takime, si dhe aktivitete të tjera. Më hollësisht trajtuar ne seksionin 10.2. "Përcjellja e vazhdueshme e informacioneve të ndryshme në trajtë inovative për Komisionin e Ekonomisë".
6.4	Seminar pune për Standardet e INTOSAI-t dhe domosdoshmërinë e qasjes së pakufizuar në informacionin për auditimin	Kryetari i KLSH Dep. i Politikave të Auditimit, SIGMA, DG-Budget	Ne vijimësi	Buxheti i Shtetit	Në funksion të këtij komponenti janë realizuar takime pune me eksperte të SIGMA-s dhe DG Budget dhe deputete të Parlamentit Shqiptar në kuadrin e veprimtarive për miratimin e Ligjit për KLSH.
6.5	Organizimi i Konferencës së III-të Shkencore të KLSH-së "Auditimi Kombëtar në shërbim të qeverisjes Kombëtare"	Kryetari i KLSH; Komiteti i organizimit të Konferencës	Tetor 2014	Buxheti i Shtetit	Konferenca e tretë Shkencore e KLSH-se "Auditimi Kombëtar në shërbim të Qeverisjes Kombëtare është realizuar në datat 29-30 tetor 2014, në Tiranë. Në këtë Konferencë morën pjesë rreth 120 pjesëmarrës ku përveç të ftuarve vendas nga bota akademike dhe e fushës së auditimit, e më gjerë, ishin edhe delegacione përfaqësuese të SAI-ve homologe të vendeve të rajonit dhe atyre anëtare të BE-së, me të cilat KLSH bashkëpunon ngushtë në fushat me interes të përbashkët. Ishin gjithashtu të pranishëm me kontributet e tyre edhe përfaqësues të Sekretariatit të Përgjithshëm të INTOSAI-t (Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit), si edhe të institucioneve të BE-së. Konferencën e nderoi me praninë e tij Presidenti i Republikës, SH.T.Z. Bujar Nishani, Ambasadori i SHBA-ve, SH.T.Z. Aleksander Arvizu, Deputeti i Parlamentit Evropian, Igor Sholtes, njëkohësisht edhe Zv/Kryetar i Komisionit te Buxhetit në PE, Këshilltari Kryesor i Drejtorit të Përgjithshëm të DG-Budget dhe Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Komisionin Evropian, z. Robert Gielisse, Presidentët e institucioneve supreme të auditimit (SAI-ve) të Kroacisë dhe Malit te Zi, Ivan Klesiç dhe Milan Daboviç etj.

Nr.	Rekomandimi i Kuvendit	Struktura zbatuese në KLSH	Koha e zbatimit	Fondet e duhura për zbatim	Statusi i Implementimit
					Konferencën e përshëndeten edhe dy deputete te Kuvendit te Shqipërisë, Sekretari i Komisionit të Ekonomisë dhe Financës e akademiku Prof. Dr. Anastas Angjeli dhe Zëvëndës Kryetari i Kuvendit z. Edmond Spaho Profesorati shqiptar, mori pjesë ne Konferencë i përfaqësuar nga emra të njohur në fushën e analizës së riskut, financave publike, kontabilitetit dhe auditimit, etj, si Prof. Dr. Skënder Osmani, Prof. Dr. Omer Stringa, Prof. Dr. Jorgji Bollano, Prof. Dr. Aurela Anastasi, Prof.Ass. Dr.Sazan Guri, Prof.Ass. Dr. Hysen Çela, etj.
7	***Rritjen e numrit të auditimeve të subjekteve me projekte me financim të huaj, me qëllim parandalimin dhe reduktimin e shpërdorimeve të fondeve publike dhe mungesës së efektivitetit të investimeve*** Ky rekomandim është i përfshirë tërësisht në Objektivin 2 «*Rritja e kapaciteteve auditueseë dhe e cilësisë së auditimit*", Nën-Objektivi 2.3 "*Zhvillimi i auditimit të menaxhimit të fondeve të BE*", të Strategjisë së Zhvillimit 2013-2017 të KLSH e ripunuar 2015-2017 .				
7.1	Zhvillimi i metodologjive për auditimin e projekteve me fonde të BE dhe me financime të tjera të huaja. Trajnimi i stafit të përzgjedhur për auditimin e projekteve me financim të huaj.	Kryetari i KLSH, Dep. i Politikave të Auditimit,	Ne vijimesi	Buxheti i Shtetit	Përveç trajnimeve të kryera për auditimin e projekteve me financim të fondeve të BE-së, trajtuar tek seksioni 4.3 në kuadër të implementimit të projektit IPA 2013 është parashikuar kryerja e një auditimi pilot në një projekt me financim nga fondet e BE-së.
7.2	Thellimi i bashkëpunimit me Gjykatën Evropiane të Audituesve (ECA) në Luksemburg dhe përfshirja për herë të parë në statusin e vëzhguesit në takimin e radhës të komitetit të kontaktit në të cilin marrin pjesë 28 vendet e BE-së. Vizita studimore pranë ECA, në vende përfituese të fondeve të BE, për të ndarë eksperiencat në fushën e auditimit	Kryetari i KLSH, Dep. i Politikave të Auditimit, Specialistë të IPA	Korrik 2014-Maj 2015	Buxheti i Shtetit / IPA 2013	Në datat 16 – 17 tetor 2014 u zhvillua në Luksemburg takimi i Komitetit të Kontaktit të Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve të BE-së, nën drejtimin e Gjykatës Europiane të Audituesve, në kuadrin e 10 vjetorit të zgjerimit të Bashkimit Europian me 10 anëtarë të rinj në vitin 2004. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të 28 vendeve anëtare të BE-së dhe të SAI-ve të vendeve kandidate dhe para kandidate, si edhe përfaqësues të SIGMA-s. Shqipëria u përfaqësua ne këtë takim nga një delegacion i kryesuar nga Kryetari, z. Bujar Leskaj, i cili zhvilloi një takim të veçantë pune me z. me z. Vitor Caldeira, President i Gjykatës Evropiane të Audituesve gjatë të cilit u dakortësua për vizitën që z. Caldeira do të kryente me rastin e ceremonisë së 90 vjetorit të

Nr.	Rekomandimi i Kuvendit	Struktura zbatuese në KLSH	Koha e zbatimit	Fondet e duhura për zbatim	Statusi i Implementimit
					KLSH-së. Në datat 18 – 19 qershor u zhvillua në Riga të Letonisë, vend i cili ka presidencën e radhës të BE-së, takimi i Komitetit të Kontaktit të Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI) të vendeve të BE-së. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të Gjykatës Evropiane të Audituesve, përfaqësues të 28 SAI-ve të vendeve anëtare të BE-së dhe të SAI-ve të vendeve kandidate dhe para kandidate, si edhe përfaqësues të SIGMA-s. Kontrolli i Lartë i Shtetit merr pjesë për herë të dytë në këtë takim si SAI i një vendi kandidat të Bashkimit Evropian dhe u përfaqësua nga një delegacion prej tre anëtarësh. Tashme po vijon trajnimi i audituesve me programet e internshipit 6-mujot të ECA-s, dhe të tjerë janë miratuar për të përfituar nga programet e internshipit të këtij institucioni. Krahas trajnimeve afatgjata një numër i konsiderueshëm audituesish kanë marrë pjesë në trajnime afatshkurtra të organizuara nga ky institucion. Konkretisht për periudhën Janar-Qershor 2015 kanë marrë pjesë në trajnime dhe workshope pranë ECA-s 13 auditues të KLSH-së. Po kështu në kuadrin e marrëdhënieve me Gjykatën Europiane të Audituesve një grup drejtuesish nga KLSH do të shkojë për një trajnim 10 ditor në ketë institucion.
8	***Reformimin e burimeve njerëzore për t'iu përgjigjur nivelit të parametrave të kërkuara nga INTOSAI, për arritjen e objektivave integruese të vendit*** Ky rekomandim është i përfshirë në Objektivin 2 «*Rritja e kapaciteteve audituese dhe e cilësisë së auditimit*", Nën-Objektivi 2.7 "Zhvillimi i Trajnimeve				

Nr.	Rekomandimi i Kuvendit	Struktura zbatuese në KLSH	Koha e zbatimit	Fondet e duhura për zbatim	Statusi i Implementimit
	Profesionale" të Strategjisë së Zhvillimit 2013-2017 të KLSH (nen objektivi 1.2 "Rregullat e brendshme që zhvillohen në disa fusha" nënobjektivi 2.8 "Zhvillimi i trajnimeve profesionale" te Strategjisë se ripunuar 2015-2017.				
8.1	Hartimi i rregullave dhe procedurave për çertifikimin e stafit të auditimit, në zbatim të ligjit të ri të KLSH-së. Hartimi i programit të trajnimit sipas disiplinave në lidhje me çertifikimin e audituesve	Kryetari i KLSH, Departamenti i Politikave të Auditimit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Etikës.	Ne vijimesi	Buxheti i Shtetit / IPA 2013	Në rregulloren e Brendshme janë parashikuar rregullat e përgjithshme por ky ky komponent do të trajtohet në kuadrin e implementimit të projektit IPA aktiviteti 3.1.12 gjatë të cilit do të përcaktohen komponentët e certifikimit të audituesve brenda atij kuadri që e mundëson ligji organik i KLSH-së.
8.2	Krijimi i Departamentit të *Metodologjisë dhe Informacionit*, me qëllim unifikimin e metodologjisë në auditim dhe certifikimin e audituesve të jashtëm publikë.	Kryetari i KLSH	31 Tetor 2014	Buxheti i Shtetit	Me Vendimin e Kryetarit nr. 149 datë 31.10.2014 është krijuar, Departamenti i Politikave të Auditimit, brenda të cilit bën pjesë Drejtoria e Metodologjisë dhe Zhvillimit.
8.3	Përzgjedhja e trajnerëve në bashkëpunim me IEKA, Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, me Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit dhe me Shoqatën e Kontabilistëve të Certikuar dhe Audituesve të Kosovës	Kryetari i KLSH, Departamenti i Politikave të Auditimit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Etikës.	Korrik 2014 dhe ne vijim	Buxheti i Shtetit / IPA 2013	Janë lidhur Marrëveshjet me Institucionet përkatëse (IEKA,KK dhe SHKCA e Kosovës), mbi bazën e të cilave do të përzgjidhen dhe trajnerët.
8.4	Hartimi dhe zbatimi i programit të trajnimit të vazhdueshëm në përputhje me normën e caktuar (20 ditë trajnim në vit)	Kryetari i KLSH, Departamenti i Politikave të Auditimit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Etikës.	Korrik 2014 e ne vijim	Buxheti i Shtetit / IPA 2013	Çdo vit hartohet Plani i trajnimit të vazhdueshëm profesional. Për vitin 2014 dhe 2015 janë miratuar Planet vjetore përkatësisht me Vendimet e Kryetarit nr.2, datë 06.01.2014 dhe nr. 2, datë 05.01.2015. Treguesit e performancës së arritur gjatë vitit 2014 krahasuar dhe me periudhat e mëparshme përfshijnë sa më poshtë: 1. Arritja prej 26 dite trajnimi/person gjatë vitit 2014 përfaqëson një rritje prej ***12 herë më shumë trajnime krahasuar me vitin 2011, kur ky tregues ishte vetëm 2.1 dt/p*** dhe për vitin ***2010 ishte 3.1 dt/p.*** 3. Në total u kryen 3700 dite persona të trajnuar ku mori pjesë i gjithë stafi i KLSH, duke vendosur një nivel të paarritur më parë në

Nr.	Rekomandimi i Kuvendit	Struktura zbatuese në KLSH	Koha e zbatimit	Fondet e duhura për zbatim	Statusi i Implementimit
					KLSH, përfshirë këtu trajnime të të gjitha llojeve të cilat krahasuar me vitin 2011 ishin **227** dhe në vitin 2010 ishin **434** ditë persona trajnimi gjithsej, ndërkohë që ndryshimi i madh i ndodhur në 2012, ku u zhvilluan rreth 2800 dite njerëz trajnime vazhdon të qëndrojë në nivele të larta gjatë tre viteve të fundit.
8.5	Hartimi i strategjisë sektoriale të KLSH për rritjen e kapaciteteve audituese nëpërmjet trajnimit dhe zhvillimit profesional të audituesve	Kryetari i KLSH, Departamenti i Politikave të Auditimit , Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Etikës.	Tetor 2014 dhe ne vijim.	Buxheti i Shtetit / IPA 2013	Gjatë implementimit të Projektit IPA 2013 nën aktivitetin 3.1.13 nën asistencën e ekspertëve të projektit do të zhvillohen procedurat për sigurimin e trajnimit të vazhdueshëm profesional.
8.6	Vijimësia e realizimit të trajnimeve me SAI-et homologe (kryesisht SAI turk, polak dhe kroat)	Kryetari i KLSH, Departamenti i Politikave të Auditimit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Etikës.	Korrik 2014 e ne vijimësi	Buxheti i Shtetit / SAI-et partnere	Janë realizuar tre trajnime me grupe 15-20 auditues pranë Gjykatës Turke te Llogarive, lidhur me auditimin e IT dhe Auditimin Publik ne përgjithësi me kohëzgjatje 1 javore. Janë realizuar gjithashtu 2 trajnime pranë NIK-ut polak me kohëzgjatje 1 javore, trajnimet ne ECA me afat 6 mujor, dhe ne atë Kroat me afat 3 ditor për 7 auditues.
8.7	Vijimësia e realizimit të trajnimeve me SIGMA	Kryetari i KLSH, Dep. i Politikave të Auditimit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Etikës.	Korrik 2014 e ne vijimësi	Buxheti i Shtetit / SIGMA	**SIGMA**, vijon të jetë aktivisht prezente në veprimtaritë trajnuese të Stafit të KLSH. Konkretisht jan realizuar trajnimet: "Bazat e Auditimit në Sektorin Publik"për auditues të rinj, ku morën pjese 25 auditues , 3 ditë; "Planifikimi Strategjik dhe Vjetor i Auditimit" trajtoi çeshtje të një niveli më të lartë profesional ku në grup fokus ishin Drejtuesit e lartë të KLSH, 20 Drejtorë dhe Kryeauditues; "Qasja e Auditimit mbi Bazë Sistemi", 26 auditues; "Konsulencë për implementimin e ISSAI-ve", 8 auditues.
9	***Ngritjen e kapaciteteve të nevojshme për zhvillimin e teknologjisë së informacionit, duke e sjellë atë në nivele bashkëkohore, me qellim parandalimin dhe zbulimin e krimit ekonomik në këtë fushë*** Ky rekomandim është përfshirë tërësisht në Objektivin 4 «Zhvillimi dhe konsolidimi i auditimeve të Teknologjisë së Informacionit dhe përdorimi i TI në auditim" të Strategjisë së Zhvillimit 2013-2017 të KLSH dhe nen objektivi nr 2.6.4,2.6.5 dhe objektivi nr 4 i Strategjise se ripunuar 2015-2017.				
9.1	Modernizimi i rrjetit te brendshëm të komunikimit elektronik. Krijimi i bazës së të	Kryetari i KLSH, Dep. i Politikave të Auditimit, Drejtoria e	Korrik 2014 e ne vijimësi	Buxheti i Shtetit /TIKA	Realizuar dhe vijon të jetë prioritet. Më 12 Shkurt të vitit 2014 u nënshkrua një protokoll

Nr.	Rekomandimi i Kuvendit	Struktura zbatuese në KLSH	Koha e zbatimit	Fondet e duhura për zbatim	Statusi i Implementimit
	dhënave dhe i programit të komunikimit interaktiv të asistuar	logj. dhe Teknologjisë së Informacionit			bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA) dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit me objekt rinovimin e teknologjisë se informacionit të KLSH-së dhe furnizimin me pajisje dhe programe në mbështetje të dy SAI-t për zbatimin e sistemit të menaxhimit të auditimit. Granti u lëvrua në natyrë pajisje kompjuterike në vlerën 15.729 mijë lekë me impakt forcimin dhe modernizimin e infrastrukturës IT të KLSH-së. Gjithashtu gjatë viteve 2013 dhe 2014 janë investuar në IT respektivisht 15,237 mijë lekë dhe 8,039 mije lekë nga Buxheti i Shtetit.
9.2	Insistimi për të përfshirë në Ligjin e ri të KLSH-së auditimin e TI	Kryetari i KLSH	27.11.2014	Buxheti i Shtetit	Realizuar. Ligji i ri i KLSH-se është miratuar.
9.3	Publikimi i standarteve Coobit 4.01. Përkthimi i Standardit ISSAI 5310 për Sigurinë e T.I. Përkthimi i Manualit për Auditimin e T.I. (të publikuar nga EUROSAI dhe INTOSAI); Konsolidimi i strukturës se IT Audit	Kryetari i KLSH, Departamenti i Politikave të Auditimit, Drejtoria e Auditimit IT Teknologji e Informacionit	Nëntor 2014 e ne vijim	Buxheti i Shtetit /TIKA/ Gjykata Turke e Llogarive	Përfunduar përkthimi, dhe botimi i Manualit për auditimin e T.I të publikuar nga EUROSAI dhe INTOSAI. Janë botuar Standartet Coobit 4.01. (Control Objectives for Information and related Technology (COBIT)). Është krijuar dhe funksionon Drejtoria e Auditimit të IT stafi i se cilës është nen trajnim dhe edukim të vazhdueshëm, dhe kryen auditime të sistemeve të IT-së në subjekte.
9.4	Vazhdimi i trajnimit të stafit auditues për auditimin e teknologjisë së informacionit dhe përvetësimin e Programit IDEA. Kalimi në versionin e ri të programit IDEA.	Kryetari i KLSH, Dep. i Politikave të Auditimit, Teknologjia e Informacionit	Korrik 2014 e ne vijimësi	Buxheti i Shtetit / IPA 2013	I gjithë stafi auditues i KLSH-së është trajnuar me versionin e ri të Programit IDEA , janë testuar njohuritë si dhe po vijohet me përdorimin e këtij instrumenti në procesin auditues.
9.5	Ngritja e Njësisë për Auditimin e T.I. në nivel Drejtorie pranë	Kryetari i KLSH, Dep. i Politikave të	31 tetor 2014	Buxheti i Shtetit	Realizuar. Me vendimin e kryetarit nr. 149, datë 31.10.2014 është krijuar Drejtoria e Auditimit të TI, pranë Departamentit të

Nr.	Rekomandimi i Kuvendit	Struktura zbatuese në KLSH	Koha e zbatimit	Fondet e duhura për zbatim	Statusi i Implementimit
	një Departamenti Auditimi ose veçmas. Konsolidimi i strukturës së auditimit të T.I.	Auditimit, Sekt i Teknologjisë së Informacionit			Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm.
9.6	Kryerja e auditimeve pilot ne auditimin e Teknologjisë së Informacionit	Kryetari i KLSH, Departamenti i Politikave të Auditimit, Drejtoria e auditimit te Teknologjisë së Informacionit	Korrik 2014 e ne vijimësi	Buxheti i Shtetit / IPA 2013	Ka përfunduar auditimi i parë pilot nën asistencën e IDI-INTOSAI. Do të vijohet me kryerjen e auditimeve pilot nën asistencën e eksperteve të IPA projekt.
10	***Strukturimin e raportit vjetor, në aspektin formal dhe të përmbajtjes, sipas përcaktimeve kushtetuese, ligjore dhe standardeve të aplikueshme nga institucionet homologe të auditimit të jashtëm*** Ky rekomandim është i përfshirë tërësisht në Objektivin 2 "*Rritja e kapaciteteve audituese dhe e cilësisë së auditimit*" të Strategjisë së Zhvillimit 2013-2017 të KLSH nën objektivi nr 2.2.3 "Zhvillimi i auditimit financiar dhe kapaciteteve", 1.1.3 "Intensifikimi i komunikimit me Kuvendin e Shqiperise" të strategjisë së ripunuar 2015-2017.				
10.1	Përgatitja e modelit të ri të raportimit vjetor në Kuvend mbi deklaratën përfundimtare buxhetore të RSH, mbi bazën e kërkesave të Ligjit të ri dhe përmirësimi i vazhdueshëm i modelit të ri të raportimit për në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave si dhe në Kuvendin e Shqipërisë, bazuar në përvojën e mirë të SAI-ve të zhvilluara evropiane	Kryetari i KLSH, Dep. i Politikave të Auditimit,	Shtator 2014 dhe ne vijimësi	Buxheti i Shtetit /SIGMA IPA 2013	Objekt i përmirësimit te vazhdueshëm. Raporti i Performancës për vitin 2014 reflekton zbatimin e kësaj kërkesë. KLSH me miratimin e ligjit të ri dhe në kuadër të projektit IPA, KLSH do të përgatisë modelin e ri të raportimit në Kuvend.
10.2	Përcjellja e vazhdueshme e informacioneve të ndryshme në trajtë inovative për Komisionin e Ekonomisë	Kryetari i KLSH, Dep. i Politikave të Auditimit,	Shtator 2014-Maj 2015	Buxheti i Shtetit	KLSH në vijimësi i ka adresuar Komisionit të Ekonomisë informacione mbi problematikat e ndryshme te rezultuara nga veprimtaria audituese e KLSH-së dhe që kërkojnë vëmendjen e këtij komisioni me synim marrjen e masave për përmirësimin e situatës apo edhe të reformimit të kuadrit rregullator ligjor.

Nr.	Rekomandimi i Kuvendit	Struktura zbatuese në KLSH	Koha e zbatimit	Fondet e duhura për zbatim	Statusi i Implementimit
					Argumentojmë se së fundmi me shkresën nr. prot. 850/19, dhe 819/20, datë 29.05.2015 adresuar Kryetarit të Kuvendit, Komisionit të Ekonomisë dhe Financave iu bënë prezent problematikat shkeljet e konstatuara ne sektorin hidrokarbur me pasoja jo vetëm ekonomike për financat por edhe për pasuritë natyrore shtetërore. KLSH i ka përcjellë parlamentit përgjatë vitit 2014 dhe 2015: • Raportin e Aktivitetit të KLSH-së për vitin 2013; • Raportin e Aktivitetit të KLSH-se për vitin 2014; • Raportin për Zbatimin e Buxhetit të Shtetit për 2013; • Ftesë për pjesëmarrje aktive nëpërmjet mbajtjes së kumtesave në Konferencën e II-të Shkencore të KLSH-së *"Auditimi Kombëtar në Shërbim të Qeverisjes Kombëtare"*. • Ftesë për pjesëmarrje në Kremtimin e 90 vjetorit të krijimit të KLSH-së, workshopin e Auditimeve të Performancës. • Raporte të kërkuara nga Komisioni, etj. Gjatë implementimit të projektit IPA është parashikuar zhvillimi e Metodologjisë për institucionalizimin e marrëdhënieve me parlamentin aktiviteti 1.2.1

Shënim:

- **Disa nga rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë nuk janë zbatuar për shkak se Projekti IPA 2013, nuk ka filluar nga zbatimi sipas parashikimeve fillestare (zbatimi i tij do të fillojë në tetor të vitit 2015);**
- **Përditësimi i planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit është bërë deri në datën 14 korrik 2015.**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 15.07.2015, ora 10:00 – 12:34

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – Kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Raport i veprimtarisë vjetore për vitin 2014 i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Ridvan Bode, Andrea Marto, Blerina Gjylameti, Ervin Bushati, Evis Kushi, Ervin Koçi, Florion Mima, Sherefedin Shehu, Jorida Tabaku, Igli Cara, Gjovalin Kadeli dhe Luan Duzha.

Mungojnë:

Anastas Angjeli, Antoneta Dhima, Gledion Rehovica, Koço Kokëdhima, Edmond Spaho, Dashamir Shehi dhe Liljana Elmazi.

Të ftuar:

Bujar Leskaj – Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit

Luljeta Nano – Sekretare e Përgjithshme e Kontrollit të Lartë të Shtetit

Manjola Naço – Drejtore e Përgjithshme në Kontrollin e Lartë të Shtetit

Rinald Muça – Drejtor i Departamentit të Performancës në Kontrollin e Lartë të Shtetit

Kozma Kondakçiu – Drejtori i Drejtorisë së Auditimit të IT-së në Kontrollin e Lartë të Shtetit

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Përshëndetje!

Sot ka vetëm një çështje në rendin e ditës në punën këtij komisioni. Është prezantimi i raportit mbi veprimtarinë vjetore për vitin 2014 të KLSH-së. Natyrisht, do të jetë shqyrtimi dhe diskutimi rreth tij dhe në fund propozimi i rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë vjetore të KLSH- së për vitin 2014, propozim i Kuvendit.

Për të prezantuar raportin e KLSH-së për vitin 2014 në Komisionin e Ekonomisë ndodhet zoti Bujar Leskaj, kryetar i KLSH-së. Relator i komisionit lidhur me këtë çështje është zoti Ervin Koçi. Do të procedojmë me prezantimin e raportit të KLSH-së nga ana e zotit Leksaj. Më pas do të vijojmë me relatorin e komisionit. Dhe nëse kolegët deputetë kanë pyetje, do t'i adresojnë ato përkundrejt kryetarit të KLSH-së dhe do të marrin përgjigjet. Në fund do të kalojmë në diskutime.

Zoti Leksaj, urdhëroni!

Bujar Leskaj - I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ekonomisë,

Qysh në krye të herës më lejoni t'ju falënderoj për ndihmën dhe mbështetjen që ju si Komision i Ekonomisë dhe Financave i keni dhënë KLSH-së dhe për këtë mundësi që na krijoni, pavarësisht se ligjore, për të prezantuar performancën e institucionit tonë, arritjet dhe mangësitë tona, si dhe për të dhënë një nga rekomandimet si anëtar të legjislativit shqiptar.

Matja e performancës së një institucioni publik ka rëndësi parësore jo thjesht për të vlerësuar kontributin e institucionit, punën dhe arritjet e tij, por mbi të gjitha në kushtet e sotme, për t'i garantuar atij një zhvillim të qëndrueshëm në të ardhmen. Ky proces bëhet dyfish i rëndësishëm kur prezantohet përpara Komisionit të Ekonomisë dhe merren direktiva nga Komisioni i Ekonomisë.

Në kongresin e fundit të INTOSAI 21 në Pekin 2013, për të gjitha institucionet supreme të auditimit të botës, 192 institucione të tilla u shpërnda edhe një dokument pilot. Ky dokument titullohej: "Matja e performancës së institucioneve supreme të auditimit". Ky dokument do të marrë formën përfundimtare në kongresin e radhës në Intosai 22.

Ky dokument në këtë fazë është një dokument që mund të implementohet në mënyrë fakultative nga institucionet supreme të auditimit nisur nga ai rekomandim i kongresit, por mbi të gjitha në respekt të atyre orientimeve që ju keni dhënë edhe vitin e kaluar, ne jemi përpjekur që performancën e institucionit të lartë të KLSH-së për vitin 2014 dhe për 6- mujorin e parë të vitit 2015, me qëllim që të jemi të përditësuar edhe në ato mesazhe që i japim publikut, ta zhvillojmë nën kornizat dhe nën suazën e këtij standardi. Kjo në funksion edhe të asaj direktive që kemi marrë në Kongresin e Hagës EUROSAI të vitit të kaluar 2014 për sa i përket inovacionit "Kur ka qenë hera e fundit që keni bërë një gjë për herë të parë".

Kjo është një herë e parë që ne e prezantojmë performancën tonë mbi bazën e këtij dokumenti standard. Të gjithë dokumentin, në rast se ju jeni të interesuar, unë mund t'jua bëj me dije, dhe mendojmë që edhe për vitet e tjera ta ndërtojmë performancën tonë mbi bazën e këtij dokumenti për të qenë më të saktë, më korrekt dhe më kontrollues nga ju.

Matja e standardizuar e performancës së INTOSAI-it siguron një bazë objektive për të treguar lidhjet e tij të vazhdueshme me parlamentin, qytetarët dhe veprimtarët e saj. Kjo matje synon të vlerësojë kontributin e saj në menaxhimin financiar publik në qeverisjen e mirë dhe në llogaridhënie, si dhe në përpjekje për të luftuar korrupsionin.

Ky dokument standard ka një grup prej 22 treguesish, të cilët janë të ndarë në 7 fusha dhe konkretisht ato janë:

1. Performanca e SAI-ve;

2. Pavarësia dhe korniza ligjore dhe strategjia zhvillimi organizativ;

3. Auditimi dhe metodologjia;

4. Menaxhimi dhe struktura mbështetëse;

5. Burimet njerëzore dhe komunikimi;

6. Menaxhimi i palëve të interesuara.

Nga këta 22 indikatorë meqenëse është hera e parë ne kemi zgjedhur 13 prej tyre kuptohet duke i përshtatur me kushtet tona. Gjithë këtë raport ne e kemi ndërtuar në tri kolona kryesore:

1. Dhënia e treguesve të ecurisë së gjetjeve të institucionit mbështetur mbi këtë kornizë.

2. Zbatimi i rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë të qershorit të vitit 2014. Për këtë rezolutë ne miratuam edhe një planveprimi, të cilën ua kam përcjell vitin e kaluar dhe sot ne e raportojmë edhe këtu.

3. Një analizë ...për sfidat që paraqiten përpara KLSH-së.

Të 13-të treguesit që ne kemi përzgjedhur janë: auditimet dhe ecuria e tyre, dëmi ekonomik i zbuluar dhe dobishmëria, rekomandimet me impakt të lartë, numri i rekomandimeve, niveli i zbatimit të rekomandimeve, kallëzimet penale, auditimet e performancës, zhvillimi i burimeve njerëzore, kontrolli i cilësisë, transparenca dhe komunikimi, aftësia për partneritet me të huajt dhe vendas, botimi dhe kërkimi shkencor dhe përmirësimi i metodologjisë dhe veçanërisht vlerësimi INTOSAI.

Gjatë raportit këta tregues të vitit 2014 dhe të 6-mujorit të parë të vitit 2015 pra, për një 1 vit e gjysmë, ne i kemi krahasuar me gjetjet e dy vjetëve të marra së bashku 2012 dhe 2013, si dhe me treguesit të dala nga gjetjet e 4 vjetëve të marra së bashku 2008, 2009, 2010, 2011. Këto krahasime mendoj që na shërbejnë në punën tonë dhe janë një evidencë një dëshmi e qartë e punës sonë.

Së pari, numri i audititeve. Natyrisht, në gjithë këto vite në këtë periudhë 15-20-vjeçare, KLSH-ja ka një ecuri konstante për sa i përket numrit të auditimeve. Ne këtë vit kemi realizuar 160 auditime nga 159 që ishte plani, ose rreth 11% më shumë se viti 2013. Ndërsa për 6-mujorin e parë të vitit 2015 kemi realizuar 71 auditime. Vërejmë që te këto auditime kemi një rritje të lehtë, por konstante dhe të qëndrueshme në auditimet e performancës.

Në vitin 2014 ne realizuam 8 auditime performance nga 6 që kishim realizuar në vitin 2013 dhe këtë vit, në 2015-n, mendojmë të realizojmë 10 të tilla. Kemi përfunduar dhe evaduar, kemi përfunduar edhe 3 të tjera dhe besoj se gjatë gjithë vitit do t'i mbyllim ato.

Dëmi ekonomik i zbuluar. Gjatë periudhës së vitit 2014 dhe 6-mujorit të parë të vitit 2015 dëmi ekonomik i zbuluar nga KLSH-ja është rreth 27 miliardë lekë, nga të cilat 11 miliardë lekë janë sigurime të vitit 2014 dhe 16 miliardë të 6- mujorit të parë të vitit 2015, ose këto të 6-mujorit janë 119,2 milionë euro. Dhe shkeljet e disiplinës financiare për gjatë vitit 2014 dhe 6-mujorit të parë të vitit 2015 ne kemi të zbuluar 20 miliardë lekë. Grafikët përkatës tregojnë gjetjet në vitin 2014 dhe gjetjet në 6-mujorin e parë të vitit 2015, si dhe një krahasim. Unë kam paraqitur, për lehtësi në respekt të kohës suaj, edhe një pasqyrë që e mat performancën e KLSH-së, ashtu si vitin e kaluar përmes shifrave.

Po të shihet ecuria e gjetjes e zbulimit të dëmit ekonomik apo të të ardhurave të munguara në KLSH është e kënaqshme me treguesit e mëparshëm, por, natyrisht, gjithmonë e theksoj këtë dhe kërkoj ndjesë ndoshta edhe për ndonjë deklarim të mëtejshëm për publikun është larg atyre pritshmërie, që kanë qytetarët shqiptarë, jo vetëm për KLSH-në, por për krejt qeverinë, legjislativin për sa i përket zbulimit dhe luftës kundër korrupsionit.

Në rast se do të krahasojmë, dëmi i zbuluar për gjatë viteve 2014 dhe 6- mujorit të vitit 2015, pra, për një vit e gjysmë, është rreth afërisht i barabartë me atë të zbuluar në vitet 2012 dhe 2013, dhe është rreth 1,4 më i lartë se 4 vjetët e marra së bashku 2008, 2009, 2011 dhe 2012.

Dobishmëria, treguesi i dytë. Ky është treguesi kryesor për të qenë i sinqertë në SAI-et moderne të jep atë për 1 lek të shpenzuar nga buxheti i shtetit për një institucion suprem auditimi, sa lekë është kërkuar të zhdëmtohet. Pra, sa kanë qenë gjetjet e institucionit dhe këtu treguesi flet qartë për vitin 2014 dhe për 6- mujorin e parë të vitit 2015, ku tregues është 77,5 lekë dhe kemi një trend të tillë, mund të shikoni edhe grafikun përkatës, në slide-t tona është dhënë. Në rastet për 4 vjetët e marra së bashku ky tregues ka qenë 27 lekë të zbuluara për 1 lek të shpenzuar; për dy vjetët 2012-2013 ka qenë 52 lekë, ndërsa tani është 79 lekë. Pra, kemi një rritje me 25 lekë dhe në qoftë se do të sjellim në vëmendje faktin që ne krahasojmë një periudhë një vit e gjysmë me dy vjet të mëparshme dhe me 4 vjet të mëparshëm, mendoj se kjo shifër flet vet.

Rekomandimet me impakt të lartë për periudhën janar 2014-qershor 2015. Jo vetëm treguesit sasiorë, por edhe treguesit cilësorë dhe në veçanti rekomandimet me impakt të lartë janë ato që karakterizojnë sot në botë, në Europë në veçanti, SAI-et moderne, të cilave ne përpiqemi t'u përafrohemi. Natyrisht, jemi larg, por gjithsesi duke mësuar nga përvoja e tyre përpiqemi dhe, në mënyrë të përmbledhur unë nuk po zgjatem te rekomandimet që ne kemi dhënë, janë ato rekomandime, që kanë vijuar. Dhe nga vitet 2013 e 2012, të paktën në vitet kur unë drejtoj KLSH- në, insistimi ynë ka qenë për të vendosur në Kushtetutë një tavan për borxhin publik. Kur e kemi kërkuar ne përpara 3 vjetësh gjetëm një farë mirëkuptimi, por pastaj nuk u implementua. Deri në fund ka qenë kërkesa që borxhi publik të jetë në kufijtë e 60% të GDP-së. Natyrisht, sot ky borxh që ka ecur me ritme, për fatin tonë të keq, me ritme të shpejta, ndoshta mund të jetë 70%.

Megjithatë, unë insistoj që kjo duhet të vendoset në Kushtetutë dhe në një periudhë të caktuar kohore të stabilizohet në një periudhë afatshkurtër. Për këtë përvojë europiane ka përvoja polake, konkretisht të cilës ne jemi cituar edhe atëherë.

E dyta, është rekomandimi ynë për krijimin e një këshilli fiskal, i cili duhet të gëzojë statusin e një institucioni publik të pavarur dhe të ketë një pavarësi operacionale dhe shumë strikte nga politika veçanërisht nga qeveri. Të jetë një këshill fiskal i zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë.

Për fuqizimin e ligjit "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", duke pasur parasysh që është ligj lehtësisht i thyeshëm, për sa i përket pikëpamjes së numrit të votave në Kuvend, ne kemi theksuar që miratimi i tij apo në veçanti ndryshimet të bëhen në një shumicë të cilësuar parlamentare.

Problem në Shqipëri, dhe ky problem është shumë i ndjeshëm, në veçanti dhe ka reagime apo reaksione, me të drejtë, te qytetarët shqiptarë, te shoqëria civile, te pjesa e shëndoshë e shoqërisë dhe e politikës, është edhe mungesa apo forcimi i antikulturës së pandëshkueshmërisë. Dhe këtu nuk kam asnjë konotacion politik në këtë që them. Ne prej vitit të kaluar, edhe këtë vit e kemi përsëritur dhe insistojmë se në Shqipëri duhet të hartohet ligji mbi hartimin e përgjegjësisë materiale. Dhe ky ligj do të bëjë përgjegjës jo vetëm penalisht, por edhe materialisht të gjithë zyrtarët e rangut të mesëm, por veçanërisht të lartë të këtij vendi.

Për fat të keq, përgjegjshmëria nuk është kudo. Për fatin tonë të mirë dhe atë aspiratë që kemi ne për integrimin në BE më mirë sesa të kornizuar me ligje, më mirë sesa të kufizuar nga ligji, më mirë sesa të detyrohen nga ligji, ne nuk mund ta bëjmë me deklarata politike apo deklarata të tjera.

Pra, ky është edhe një rekomandim tjetër i rëndësishëm që i kemi dhënë në vijimësi Kuvendit dhe qeverisë shqiptare. Ne kemi dhënë një rekomandim tjetër dhe insistojmë te kjo. Të ardhurat nga privatizimet, veçanërisht ato të ardhura nga privatizime strategjike duhet të kalojnë 50% për shlyerjen e borxhit, 30% për investime dhe 20% për shlyerjen e detyrimeve ligjore dhe morale që shteti shqiptar ka ndaj ish-të përndjekurve politikë.

Rekomandimet tona gjatë auditimeve të vitit 2014 dhe 6-mujorit të dytë të vitit 2015, dhe që do të vijojnë edhe kur ne të vijmë në shtator për zbatimin e buxhetit faktik të 2014-s, konsistojnë edhe në forcimin që duhet t'i bëhet institucionit të auditimit të brendshëm në Shqipëri.

Prej shumë vitesh në Shqipëri kolona e auditimit publik mbështetet mbi dy shtylla kryesore: mbi auditimin e brendshëm publik dhe auditimin e jashtëm publik. Sa më shumë të forcohet, unë mendoj se puna e atyre dy institucioneve në thelb është se duhet të jenë sa më komunikuese, dhe sa më shumë të forcohet, aq më shumë është e lidhur puna me njëri-tjetrin, duhet të ketë një sinergjizim, ku sa më shumë të ngrihet profesionali, sa më shumë të forcohet auditi i brendshëm, sa më shumë të jetë i pavarur auditi i brendshëm, aq më rezultative do të jetë edhe puna jonë si auditues të jashtëm apo publik. Të mos konsiderohemi gardianë në kuptimin negativ të kësaj fjale, por të konsiderohemi gardianë në kuptimin pozitiv të kësaj fjale.

Në këtë drejtim për sa i përket përmirësimit dhe plotësimit të auditimit të brendshëm të aftësisë së tij organizmit etj., mendoj se rekomandimet tona duhet të shqyrtohen me seriozitet nga qeveria. Nga auditimet që kemi zhvilluar në Bankën e Shqipërisë ne i kemi rekomanduar këtij organi të saktësojë më mirë detyrat funksionale të këshillit mbikëqyrës dhe administrator të bankës, me synimin për të shmangur dualizmin e funksioneve, konfliktin e kompetencave dhe për të siguruar

një nivel të dëshirueshëm llogaridhënie transparencë dhe mbikëqyrje, transformimin e funksionit të inspektorit të përgjithshëm në një komitet auditimi të përbërë nga 3 anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi, auditimin e tij nga një kompani e huaj e zgjedhur nga Kuvendi, duke synuar kështu rritje të pavarësisë dhe rritje të efektshmërisë së komitetit të auditimit të brendshëm. Kemi rekomanduar, gjithashtu, rishikimin e ligjit në frymën e minimizimit të riskut potencial të abuzimit me pavarësi dhe shmangies së konfliktit të interesit, që evidentohet në praktikat e trajtimit të burimeve njerëzore, si dhe kërkesën për një transparencë të detyrueshme ligjore, lidhur me këtë aspekt dhe në të gjitha rekomandimet tona kemi nënvizuar që çdo ndryshim të ligjit organik të Bankës së Shqipërisë duhet të realizohet në bashkëpunim dhe në konsultim të ngushtë me FMN, Bankën Botërore dhe Bankën e Qendrore Europiane, kuptohet natyrisht nën drejtimin e Komisionit të Ekonomisë dhe të Financave.

Nga auditimi i marrëveshjeve hidrokarbure u konstatua auditimi që është zhvilluar në AKBN, MEI, Albpetrol. Janë auditime të shtrira në periudhën 2-3 vjeçare dhe janë auditime, për të cilat prej më se një 1 viti e ca ne gjithmonë kemi pasur presione dhe tendenca për bllokim auditimi, për mosdhënie informacioni. Megjithatë ato i kaluan falë jush dhe falë ligjit që ju miratuat me profesionalizëm dhe me integritet.

Për mendimin tonë si KLSH janë konstatuar lidhje të ndërsjella, defektoze rregullatore institucionale ndërmjet Ministrisë së Energjetikës dhe Industrisë, AKBN-së dhe Albpetrol. Këto kanë ndikuar në dështimin e misionit mbikëqyrës të procesit të administrimit të pasurive natyrore ato hidrokarbure në veçanti.

Për shkak të ndryshimit të planeve të zhvillimit, shteti shqiptar në vite nuk ka mundur të përfitojë plotësisht rentën minerare prej 194 milionë dollarësh. Nuk është arritur të realizohet kushti i faktorit “R” më i madh se 1, fakt i cili do të kishte

sjellë të ardhura shtesë për buxhetin nga pjesa takuese e produktit. Apo përdorimi i gazoilit si hollues në nivele të larta ka krijuar evazion me mirëmungesë të dokumentacionit të theksuar; ka krijuar evazion dhe dëm të lartë në buxhetin e shtetit.

Procesi monitorues i institucioneve shtetërore ka qenë pothuajse inekzistent duke u mjaftuar vetëm me vëzhgime vizuale, sporadike, pa u orientuar në kontrollin ligjor financiar dhe tekniko- shkencor të implementimit të këtyre marrëveshjeve.

Ky auditim është auditim i plotë, integral që ne kemi zhvilluar. Ndoshta unë në një kohë të dytë, ashtu siç e kërkon ligji, pasi të pres edhe 6 muaj, sesi ministria përgjegjëse e autoritetit përgjegjës dhe qeveria do të veprojë, në lidhje me konstatimet dhe rekomandimet tona, do të kërkoj të vij të paraqitem në Komisionin e Ekonomisë dhe do të vazhdoj edhe në institucionet e tjera ligjzbatuese të vendit, për t'u përpjekur dhe për të dhënë kontributin tonë detyrues, ligjor në përmirësimin e zhvillimeve në këtë sektor.

Në auditimin më të fundit ne kemi kërkuar ringritjen e Institutit Shkencor të Naftës, që të mbështesë të gjitha vendimmarrjet e lidhura me zhvillimet e sektorit të hidrokarbureve dhe të luajë rolin e oponentit teknik gjatë negocimit të marrëveshjeve, shqyrtimit të propozimeve dhe zhvillimit të operacioneve të hidrokarbureve.

Duke pasur në konsideratë rëndësinë e këtij sektori për ekonominë e vendit dhe sigurinë kombëtare, autoritetet shtetërore përgjegjëse, meqenëse jemi edhe në vitet që ka pasur dhe do të ketë tentativa për privatizim të Albpetrol-it, duhet të sigurohen që të përfshijnë në këto marrëveshje të plota apo pjesore aleatët strategjik të vendit tonë, veçanërisht ato me traditë të konsoliduar në këtë sektor si SHBA-ja, Mbretëria e Bashkuar dhe Gjermania, të përfshijë kompanitë prestigjioze

të njohura nga këto vende si edhe të mundësojnë arritjen e transparencës reale të zotëruesve të kompanive ofertuese.

Nga auditimi në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, kemi konstatuar rritje të subvencioneve buxhetore nga viti në vit, si pasojë e thellimit të deficitit të skemës së pensioneve dhe kemi analizuar faktorët që kanë influencuar në këtë thellim duke përkrahur dhe inkurajuar ndërhyrjet në ligjin "Për sigurimet shoqërore".

Një tregues i katërt është numri i rekomandimeve. Në tërësi për vitin 2014 KLSH-ja ka prodhuar 882 rekomandime më shumë se një vit më parë. Ndonëse ky tregues nuk jep shkallën e efektivitetit dhe cilësisë në punën rekomanduese, ai gjithsesi është një tregues sasior që mat sasinë e punës së kryer. Në tabelat përkatëse ne kemi dhënë edhe numrin e rekomandimeve për katër vjet, në dy vjet 2012-2013 dhe në këtë një vit e gjysmë.

Zbatimi i rekomandimeve. Zbatimi i rekomandimeve është një problem sot në botë dhe në Europë. Është problem jo vetëm për vendin tonë, por edhe për vende më të zhvilluara se ne. Për të qenë të sinqertë në rast se do të tentonim të fshihnim realitetin, ne do të ishim të kënaqur, pasi përgjithësisht kemi një tregues të zbatimit të rekomandimeve nga 63% deri në 70%. Unë e kam theksuar dhe një vit apo dy vjet më parë, që një tregues i ulët i zbatimit të rekomandimeve është ajo për sa i përket largimit nga detyra të drejtuesve të lartë të administratës shtetërore kur këta të fundit rezultojnë me shkelje. Ne kemi me dhjetëra raste të tilla, kur përgjatë vitit 2014 dhe përgjatë 6-mujorit të dytë të vitit 2015 kemi zbuluar shkelje nga këta zyrtarë të lartë, i kemi dokumentuar, kemi kryer kallëzimet penale, kemi bërë edhe propozimet në institucionet më të larta pranë ministrive për largimin e tyre nga detyra dhe kjo gjë nuk ka ndodhur. Ky është një tregues i ulët.

Ndoshta edhe në konsultimet e mëtejshme me ju mendoj se kjo është një detyrë, që nuk e kam vetëm unë si kryetari i KLSH-së, por e kemi së bashku me ju si deputetë që të kontribuojmë për ato kërkesa, që shoqëria shqiptare ka ndaj nesh. Në këtë drejtim ne mund të diskutojmë për një plan veprimi në të ardhmen, që të kemi një rakordim.

Rakordimi dhe dakordësia me Komisionin e Ekonomisë dhe me komisionet e tjera të Kuvendit të Shqipërisë, do të bëjë atë që edhe institucioni ynë të ndiejë sadisfaksionin e punës. Pra, mos të kalojë në ato pozicione vetëm të një institucioni represiv apo që të duket sikur ne përpiqemi të denigrojmë apo të ulim njerëz të caktuar, pasi edhe ne riskohemi. Unë këtë e theksoj me përgjegjësi të madhe këtu dhe ju shikoj drejt e në sy dhe jo vetëm ju, por edhe qytetarët shqiptarë dhe nuk e di nëse kamerat kanë mundësi ta fokusojnë.

Në pjesën më të madhe të të gjitha rekomandimet tona për largimin nga detyra të zyrtarëve të lartë nuk ka as përqindjen më të vogël të abuzimit nga ana jonë.

Me të drejtë që na jep ligji “Për rekomandimet”, nuk ka asnjë propozim nga ana jonë, që të mos jetë shoqëruar me argumentimet përkatëse, me dëmin që i ka shkaktuar x apo y zyrtar i lartë, madje theksoj se në raste të caktuara ndodhemi edhe në pozita të vështira, pasi ne së pari zbatojmë parimin klasik të auditimit të jashtëm publik, që audituesi denoncon atë që ka firmosur, atë që lexon, atë që shkruan dhe jo atë që çka dëgjon.

Audituesi denoncon shkeljet e shkruara dhe ka raste të caktuara, që nëpunës të nivelit të mesëm detyrohen nga eprorët e tyre të firmosin edhe kontrata prokurimesh, edhe kontrata koncensionarësh, edhe veprime të ndryshme që i çojnë ata detyrimisht në atë që ne më pas i akuzojmë për shpërdorim detyre dhe drejtuesit e tyre të lartë shpëtojnë. Megjithatë, ne kemi zbatuar ligjin në mënyrë

korrekte dhe të gjithë ata zyrtarë të lartë të rangjeve si sekretari i Përgjithshëm, drejtori i Përgjithshëm, zëvendësministra, kryetarë bashkish, zëvendëskryetarë bashkish, që ne kemi propozuar, i kanë kryer tërësisht dhe plotësisht këto shkelje dhe e kanë merituar largimin nga detyra.

Unë nuk jam thelluar në këto, nuk kam dashur të bëj show dhe puna ime mendoj si kryetar nuk matet me show në televizione dhe nuk matet me show në gazeta. Detyra ime është të konstatoj shkeljet dhe t'i bëj me dije Kuvendit të Shqipërisë përmes raporteve përkatëse, t'i bëj me dije menaxherët më të lartë duke filluar nga ministrat e deri te Kryeministri i vendit, drejtuesve të tjerë të lartë të shtetit dhe mbi të gjitha qytetarët shqiptarë.

Kallëzimet penale. Edhe për kallëzimet penale në rast se shikojmë në grafikun përkatës për vitin 2014 dhe 6-mujorin e parë të vitit 2015 kemi realizuar 67 kallëzime të tilla, nga të cilat 41 për 2014-ën dhe 26 për vitin 2015.

Kemi një tendencë, që numri i këtyre kallëzimeve është afërsisht i barabartë me numrin e kallëzimeve të dy viteve së bashku 2012-2013 dhe është rreth 1,37 herë më shumë se numri i kallëzimeve të katër viteve së bashku 2008-2009-2010-2011.

Për sa i përket problemit të kallëzimeve penale, ne kemi qenë shumë ekzigjent deri në momentin që ne përgatisim një kallëzim penal të plotë, një kallëzim penal të dokumentuar dhe prokuroria, i cili është organi i ngarkuar me kushtetutë, që përfaqëson akuzën në emër të shtetit regjistron këto kallëzime penale në emrin tonë. Edhe këtu jemi përpjekur të tregohemi të kujdesshëm pasi realizimi i detyrës nga ne dhe realizimi i detyrës institucionale nuk do të thotë që ne të kalojmë kufijtë institucional, të kalojmë tagrin tonë ligjor dhe kushtetues.

Ecuria për kallëzimet flet vetë dhe kemi dy grafikë për kallëzimet penale. Ecuria nga vitet 2008-2009 është edhe grafiku i kallëzimeve penale të krahasuara me këto

periudha me vite, që unë përmenda, gjithashtu është edhe dëmi i shkaktuar përmes veprimeve antiligjore, që na kanë çuar ne në përgatitjen e kallëzimeve penale.

Auditimet e përformancës. Në auditimet e performancës të them të drejtën nëse do të kishim një sektor auditimi të brendshëm, të fortë, solid dhe profesional, atëherë edhe pesha e rëndesës së Kontrollit të Lartë të Shtetit do të shkojë drejt këtyre auditimeve pasi janë auditime të një lloji të tillë, që duke i dhënë përgjigje pyetjeve: A po të bëhen gjërat siç duhet? A po bëhen gjërat që duhen, duke bashkëpunuar me institucione që auditojnë, janë auditime që e theksojnë dhe e konturojnë më shumë profilin qytetar siç është institucioni i KLSH-së.

Unë e theksova edhe në fillim, që ne jemi përpjekur të realizojmë ato standardet 3000-3100 që kërkojnë për auditimin e përformancës si një shqyrtim i pavarur, eficientë dhe i efektshëm të sipërmarrjeve qeveritare, programeve dhe organizmave të saj me fokus të veçantë ekonomicitetin dhe me synim përmirësimin e gjendjes.

Auditimet e performancës mendoj se do jenë gjithmonë e ardhmja e KLSH-së, në rast se ne do të mbështetemi me resurse njerëzore, do mbështetemi me ndihmë morale dhe suport. Unë dua të jem i sinqertë se nga Komisioni i Ekonomisë nuk na ka munguar mbështetja, por edhe nga strukturat e tjera dhe mbi të gjitha do të mbështetet edhe auditimi brendshëm në sektorin publik.

Unë po jua përmend vetëm si tema: Në rast se do zgjohet interesi, ne mund të flasim dhe të diskutojmë më gjerësisht për këto auditive performance. Ne kemi zhvilluar edhe një workshop për auditimin e performancës në Universitetin e Elbasanit, në të cilin ka qenë prezent edhe deputetja Evis Kushi dhe përfitoj nga ky rast ta falënderoj. Jam i hapur për të zhvilluar ndoshta edhe një raportim më të gjerë këtu te Komisioni i Ekonomisë apo edhe çfarë ju mund të më sugjeroni.

Ne kemi zhvilluar këto tema përgjatë vitit 2014: performanca e RTSH-së, projekti i digjitalizimit të TVSH-së; siguria rrugore; infrastruktura e Shërbimit Bibliotekar Kombëtar, këtu po e përmend duke qenë se ne jemi të ndjeshëm ndaj librit mesazhi kryesor i auditimit ishte: "Biblioteka Kombëtare dhe Shërbimi Bibliotekar në bashkëpunim me qeverinë shqiptare dhe me pushtetin vendor të krijojnë një qasje të re në vlerësim të librit dhe shërbimit qytetar, me synim ruajtjen e kulturës kombëtare dhe rritjen e vetedukimit të tij." Këtu kemi dhënë një rekomandim të veçantë, që të gjitha hapësirat e Pallatit të Kulturës (unë mbaj mend që tullën e parë e vuri Hrushovi, por nuk e mbaj mend se kur ka përfunduar, pasi nuk jam nga Tirana), të kthehen në shërbim të Bibliotekës Kombëtare. Ky është një rekomandim, që ne ia kemi dhënë...(mungesë incizimi); performanca e KESH-it; liberalizimi i tregut të energjisë elektrike. Këto janë dy auditime të përbashkëta, që ne i kemi bërë me një institucion modern auditimi siç është ai Suedisë dhe me zyrën e auditorit të përgjithshëm të Kosovës. Trashëgimia kulturore është një tjetër auditim tjetër performance, të cilin ne e kemi bërë edhe në bashkëpunim me ekspertë dhe me akademikë. Projekti për shërbimet bujqësore; implementimi i politikave mjedisore; efiçenca e energjisë është një auditim tjetër, që ne e kemi përfunduar; kurikulat universitare dhe avancimi në karrierën akademike; liberalizimi i shërbimit të kontrollit fizik të mjeteve e të tjera.

Treguesi i shtatë është zhvillimi kapaciteteve njerëzore. Unë përfitoj nga ky rast për t'ju falënderuar për mbështetjen, që ju na keni dhënë në burimet njerëzore në këto tre vjet. Çdo vit KLSH- ja është shtuar me 5 auditues. Mendoj se kjo gjë do të vazhdojë edhe në një plan afatmesëm, që të ruajmë një ritëm të tillë apo deri diku më të lartë për vetë faktin, që ne kemi shtuar edhe auditimin e performancës, auditimin e IT-së, auditimin e projekteve të BE-së për fondet IPA e të tjera dhe besoj se do të kem mbështetjen tuaj.

Ne jemi përpjekur që te zhvillimet e burimeve njerëzore të krijojmë filozofinë e edukimit të vazhdueshëm profesional, por siç do ta përmend edhe te analiza, sot ekzistojnë risqe në këtë drejtim. Ky është një profesion, që audituesit me moshë të vjetër, një përqindje e konsiderueshme e tyre, vazhdojnë të jenë vitalë dhe një pjesë dalim në pension më parë se dalja juridike dhe është gjithmonë risku, që audituesit e rinj duan kohë që të konsolidohen.

Kontrolli dhe sigurimi i cilësisë. Ky është një nga treguesit më të rëndësishëm në fakt, që institucionet supreme të auditimit sot i kushtojnë kujdes të veçantë. Ky ndërtohet edhe mbi bazën e një standardi përkatës të auditimit dhe është SAI i 40-të, që jep kornizën e plotë dhe ne bëjmë kontrolle të cilësisë së auditimit në të nxehtë dhe në të ftohtë. Kontrolli i cilësisë në të nxehtë janë kur ne konstatojmë abuzime të audituesve tanë apo një rëndësi të tillë të një x problemi që mund të jetë anashkaluar dhe në të ftohtë kur në të gjithë periudhën vjetore të auditimeve përzgjidhen dosjet dhe ne auditojmë.

Ne kemi arritur të auditojmë 20% të dosjeve dhe risia e vitit 2014 që unë besoj se do ta vazhdojmë, është kontrolli i cilësisë në të ftohtë, të cilin e kryejmë me ekspertë të fushës dhe jo ekspertë të përzgjedhur nga kryetari i KLSH-së, por ekspertë të pazgjedhur nga organizatat funksionale të fushës. Konkretisht për këtë vit kontrollin e cilësisë ne e kryem me ekspertët e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit dhe do të vazhdojmë edhe në vijimësi me ato organizata profesionale dhe me ato fuqi, që ne kemi nënshkruar ato marrëveshje bashkëpunimi. E provuam në vitin 2014 kur realizuam INTOSAI-n dhe mini preview procese të rishikimit që ne i quajtëm dhe mendojmë se kanë dhënë rezultat dhe është pjesë e standardeve, por është edhe pjesë e atyre detyrave që ju vetë na keni shtruar.

Transparenca dhe komunikimi. Përgjatë vitit 2014 ne kemi trajtuar 394 letra dhe ankesa, nga të cilat 170 rezultuan jashtë kompetencave të institucionit dhe pjesa

tjetër 121 janë verifikuar dhe u është dhënë përgjigje, ndërsa 100 janë në proces verifikimi. Mendoj se në këtë drejtim ne po realizojmë detyrën në mënyrë modeste dhe kemi krijuar një klimë tjetër, jo se të gjithë ata që drejtohen në zyrat e KLSH-së ne u japim zgjidhje përfundimtare dhe duhet të na mirëkuptojnë, natyra jonë është e punës rekomanduese, por kryesore është që këtë e kemi vendosur në binarë të shëndoshë dhe kjo gjë ka vazhduar edhe për 6-mujorin e parë të vitit 2015.

Institucioni ka rritur ndjeshëm praninë në mediat televizive dhe gazetat e vendit apo edhe në web-et e ndryshme. Unë përfitoj nga ky rast të falënderoj drejtuesit teknikë siç janë drejtorët e gazetave, kryeredaktorët apo pronarët e televizioneve dhe të gjithë gazetarët, që kanë punuar me përkushtim në këtë drejtim dhe pa asnjë kusht dhe në përgjithësi i kanë shërbyer edhe ata transparencës, transparencë që kërkon të realizojë KLSH-ja. Mirëkuptoj edhe ata, që për një arsye apo një tjetër ndonjëherë na kanë kritikuar apo edhe ndonjëri mund të ketë shpifur, por janë gjëra të vogla dhe jo shqetësuese.

Përveç këtyre dhe tashmë nuk mund ta quaj risi, ne kemi 3 vjet, që kemi një konsolidim. Drejtuesit e KLSH-së, audituesit, kryeauditues dhe audituesit e lartë apo edhe auditues të rinj janë prezent në median e shkruar. Ne kemi një tregues të tillë, që nga 51 auditues janë bërë 134 shkrime në gazetat e vendit përgjatë vitit 2014, përkundrejt 124 shkrimeve në vitin 2013 të 42 audituesve. I njëjti trend vazhdon edhe tani dhe përveç kësaj në botimet e ndryshme që ne kemi në ciklin tonë kolona “Botime KLSH” ne kemi edhe një kolonë të veçantë për audituesit e KLSH-së në shtypin e shkruar dhe deri tani jemi tevëllimi i tretë i saj dhe kemi përfunduar vitin 2014. Besoj se do të vazhdojmë kështu që t’i shërbejmë institucionin tonë dhe transparencës qytetare dhe të japim kontributin tonë modest për një mirëqeverisje.

Aftësia për partneritet me partnerët vendas dhe të huaj. Edhe në këtë drejtim po të flasim partneriteti i parë është ai me qytetarët që ne po përpiqemi të krijojmë me prezenca, me takime të ndryshme institucionale.

Partneriteti shumë pozitiv, që mendoj se kemi krijuar dhe kemi konsoliduar me Komisionin e Ekonomisë dhe ju vetë e ndjeni në imailet tuaja, në njoftimet dhe ftesat tona. Ne kemi një këndvështrim të ri dhe dëshirojmë shumë prezencën tuaj në punën e KLSH-së me orientime, sugjerime dhe me të gjitha gjërat e tjera. Mbështetja apo sugjerimet tuaja apo edhe përplasjet që mund të kemi pasur me ju si komision, për hir të së vërtetës mua më kanë shërbyer dhe jemi të pirur të orientohemi drejt asaj, që ne vërtet si KLSH duke ruajtur pavarësinë tonë që natyrisht e kemi të shenjtë ashtu siç e kam edhe unë personalisht të shenjtë, të veprojmë si agjentë të Kuvendit, si agjentë të ndryshimit dhe jo si spirancë, që tërhiqet zvarrë, ka qenë kjo një shprehje e viteve 2000-2003 nga misionet BE-së.

Më lejoni dua t'ju citoj këtu të nderuar deputetë, një thënie të audituesit të Përgjithshëm të GAO-s të SHBA-së, në respekt të kësaj marrëdhënie që ne kemi krijuar. Në një intervistë të tij ai thotë: "GAO mund të jetë e vetmja agjenci federale, që ka më shumë se 100 paraqitje të saj vjetore në seancat e kongresit.

Marrëdhëniet e ngushta, që menaxherët e saj dhe analistë të shquar të programeve kanë me anëtarët e kongresit dhe ndihmësit e tyre nuk janë rastësi. Zyrtarët e GAO-s shpenzojnë orë të panumërta në takime private dhe komunikim me homologët e tyre në Capitol Hill, në Kongresin Amerikan për të ndarë informacione dhe të kërkojnë udhëzime për auditimet e tyre.

Kur një komision nis një hetim të profilit të lartë të keqmenaxhimit të qeverisë, anëtarët e komisionit shpesh punojnë ngushtë me GAO-n".

Unë po ashtu besoj se edhe ju do të ngelemi shumë të kënaqur, që edhe te ne do të vijë kjo ditë, që ky partneritet i KLSH-së jo vetëm në njësitë drejtuese, por edhe të drejtuesve të lartë të KLSH- së të jetë në këto nivele.

Ne partneritetin e kemi kuptuar si partneritet me faktorët e brendshëm, ku Komisioni i Ekonomisë, qytetarët shqiptarë dhe mediat janë kryesorët. Këtu kemi shtuar dhe intensifikuar përpjekjet tona me organizatat jofitimprurëse, ato të fushës profesionale dhe ato që kanë në fokusin e tyre luftën kundër korrupsionit.

Përgjithësisht marrëveshjet e nënshkruara në vitin 2012-2013 po përpiqemi t'i implementojmë realisht, pavarësisht se kemi shumë për të bërë, por të paktën vullneti dhe dëshira ime është shumë e qartë dhe e shprehur te drejtuesit e OJF-ve, që ne kemi nënshkruar marrëveshjet përmes projekteve të caktuara. Disa nga ata i kemi angazhuar tërësisht dhe mendoj se do të vazhdojmë edhe në të ardhmen dhe me organizatat profesionale e kemi këtë bashkëpunim, por ne kemi një partneritet të ngushtë dhe me organizatat tona ndërkombëtare INTOSAI-n dhe EUROSAI-n ku Shqipëria është anëtare nga viti 1984 në mos gaboj tek INTOSAI dhe anëtare që në vitin 1990 kur u krijua EUROSAI, si edhe me institucionet supreme të auditimit të vendeve të zhvilluara të Europës si Polonia, Kroacia, Austria, Sllovenia, si edhe me vendet fqinje si Mali i Zi, Maqedonia dhe e vëllezërve tanë të Kosovës, me një SAI modern, siç është SAI turk, që ne kemi bashkëpunime dhe ndihmë në trajnimin e SAI-ve turke dhe SAI-ve polake. Gjithashtu, ne kemi ndërtuar edhe një marrëdhënie bashkëpunimi dhe mendoj se do të ecim shumë me Gjykatën Europiane të Audituesve dhe me GAO-n amerikan. Këto janë dy institucione prestigjioze, madje për këtë vit ne kemi përkthyer edhe standardet e GAO-s. Ju e keni një botim aty, ata e quajnë Libri i Verdhë në Amerikë, për standardet e auditimit të qeverisë së SHBA-së. Mendojmë se në të ardhmen ato do të jenë pjesë e implementimit, standardet e GAO-s, të Gjykatës Europiane të Audituesve dhe në përgjithësi standardet INTOSAI që ne zhvillojmë.

Përpara 2 vjetësh ne kemi nënshkruar një marrëveshje me INTOSAI dhe konkretisht me ID- in, Institucioni për Zhvillim për Implementimin e Standardeve të INTOSAI. Unë gjeta mbështetjen dhe mirëkuptimin tuaj dhe kjo është sanksionuar edhe në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit". Kjo është një sfidë, është një proces i vështirë, por besoj se ne do ta realizojmë në bazë të hapave të caktuar. Ne kemi përgatitur edhe një plan të zhvillimit të kësaj strategjie, të implementimit të tri I-ve, të cilin, në rast se nuk e kemi përcjellë dot, do ta përcjellim te komisioni juaj, me qëllim që edhe ju, krahas monitorimit për rezolutën apo asaj politike që ju mund të ndërtoni, natyrisht e dini ju shumë më mirë se ne, është e drejta juaj, të keni edhe monitorimin e këtyre standardeve.

Një tregues tjetër, tregues indikator, është botimi dhe kërkimi shkencor. Natyrisht, institucione të tjera si KLSH-ja, detyrë të parë të tyre kanë zhvillimin e auditimeve, si në aspektet sasiore, që nuk diskutohet, por më tepër në aspektet cilësore për zhvillimin dhe konsolidimin e auditimit të përputhshmërisë, të rregullshmërisë, rritjen e auditimeve të performancës, vazhdimin e auditimeve financiare. Madje me ligjin e ri na dalin detyra edhe për auditimin dhe dhënien e opinionit për pasqyrat financiare. Por, për këto institucione, në të gjithë botën, dhe ne jemi përpjekur të mësojmë nga simotrat tona europiane, përpiqen në mënyrë modeste të zhvillojnë edhe kërkimin shkencor. Ne të paktën kemi një dëshmi konkrete. Për 3 vjet rresht ne kemi organizuar një konferencë shkencore dhe duhet të më besoni, ju i keni edhe materialet, është konferencë e mirëfilltë shkencore me lektorë profesorë të huaj, me lektorë nga profesorati vendas i universiteteve shqiptare dhe Akademia e Shkencave, me lektorë të huaj të Institucioneve Supreme të Auditimit të Institutit të Kërkimeve ID-it të INTOSAI, apo edhe me personalitete të tjera të fushës.

Konferenca e tretë e zhvilluar në vitin 2014 u zhvillua në moton "Auditimi Kombëtar në Shërbim të Qeverisjes Kombëtare". Kjo ishte motoja e kongresit të fundit INTOSAI 21 të INTOSAI.

Kuptohet, gjithmonë po flasim për Shqipëri, ne nuk i kemi fare grimcat e mitomanisë, shkencën e kanë implementuar dhe e kanë zhvilluar me sukses të tjerët, detyra jonë është ta përshtatim. Natyrisht ato janë konferenca pune, kanë ngjyrimin shkencor, por ne nuk i japim mend botës, përpiqemi të reflektojmë gjërat më të fundit nga zhvillimet në komunitetin INTOSAI, të cilat janë shumë dinamike, më duhet ta pohoj këtë, përpiqemi të ruajmë trendin e ecjes pas tyre, pas një periudhe të gjatë që ne si institucion ishim shkëputur nga këto zhvillime.

Në konferencën e fundit ne vendosëm që konferenca e këtij viti do t'i përqendrohet tërësisht analizës së riskut. Unë përfitoj nga ky rast, të nderuar anëtarë të komisionit, jua kam dërguar edhe ftesën, që t'ju ftoj për të marrë pjesë në konferencën tonë, pse jo edhe me kumtesa. Analiza e riskut dhe drejtimi që ne do të përpiqemi t'i japim konferencës, natyrisht është një drejtim tërësisht profesional shumë larg politikës, nuk ka asnjë lidhje me të dhe lektorët që do të vijnë nga jashtë, të cilët do të referojnë me kumtesa të veçanta për këtë konferencë, janë personalitete të INTOSAI-it dhe të EUROSAI-it.

Botimet tona ne i sollëm në mënyrë simbolike të vitit 2014 dhe të 6-mujorit të vitit të parë të vitit 2015, që janë: analiza vjetore e punës së vitit 2013; performanca e KLSH-së 2013, shqip dhe anglisht; revista e auditimit publik, tri numra, 6, 7, 8 në shqip dhe në anglisht; autiduesit e KLSH-së në shtypin e përditshëm janar dhe qershor 2014, volumi i dytë.

Konferenca e tretë shkencore e KLSH-së, "Auditimi Kombëtar në Shërbim të Qeverisjes Kombëtare", botimi i të gjitha kumtesave në këtë konferencë, 60 vjet INTOSAI, 50 vjet Sekretariat i Përgjithshëm, është përkthim voluminoz, ku jepet historiku i organizatës sonë; numri special i INTOSAI-it, Zhurno për Kongresin e Pekinit; standardet INTOSAI mbi mjedisin SAI 51/10, 51/40; etika në SAI dhe në institucionet e tjera publike; INTOSAI, titulli i dhjetë; titulli i njëmbëdhjetë INTOSAI

52/20 dhe kodi i transparencës fiskale; titulli i dymbëdhjetë, auditimi mjet për një qeverisje, rasti i Shqipërisë. Botimet e gjysmës së parë të vitit 2015 janë: konferenca e tretë shkencore, botimi në gjuhën angleze; revista e auditimit publik, numri 9, shtator dhe dhjetor 2014; standardet e GAO- s, Institucioni Suprem për Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Këto standarde ne i botuam pasi morëm lejen përkatëse nga drejtuesi më i lartë i GAO-s, zoti Dodaro; analiza vjetore 2014; indikatorët e performacës; manuali i Departamentit të Auditimit të Performancës.

Përmirësimi i metodologjisë dhe instrumenti INTOSAI. Në kuadër të përpjekjeve të bëra gjatë dekadave të fundit në nivel global për zhvillimin e institucioneve, sistemeve dhe mekanizmave për promovimin, kjo është pjesë e kolonës së dytë, për promovimin e integritetit dhe parandalimin e korrupsionit në sektorin publik, KLSH-ja ka adoptuar metodologjinë e vetëvlerësimit të integritetit në Institucionet Supreme të Auditimit INTOSAI, e konsideruar si një nga metodat inomative dhe të efektshme, me impakt rritjen e pritshmërive në zhvillimin e politikave të integritetit. Ne zhvilluam analizën vjetore të vitit 2014 nën frymën e INTOSAI-t në bashkëpunim me pedagogët dhe studentët e Universitetit të Vlorës, duke pasqyruar, krahas arritjeve, edhe identifikimin e fushave vurnerabël të dobëta, vlerësimin e maturisë së kontrolleve dhe fokusimin drejt së ardhmes.

Kontrolli i Lartë i Shtetit aplikon qasjen, sipas së cilës përmirësimi i qeverisjes publike arrihet nëpërmjet rritjes së transparencës dhe përgjegjshmërisë, duke luftuar me efektshmëri korrupsionin, si brenda institucionit, ashtu edhe tek institucionet publike që KLSH-ja auditon. Kemi vite që jemi përqendruar dhe do të vazhdojmë të përqendrohemi edhe brenda institucionit. Asnjë institucion në botë, sepse në Shqipëri është e theksuar edhe më tepër, nuk është imun ndaj korrupsionit në radhët e tij apo edhe më gjerë. Konkluzionet edhe rekomandimet e rezultuara nga procesi i aplikimit të instrumentit INTOSAI në mënyrë të përmbledhur janë:

Konkluzion i përgjithshëm: në analizën e fakteve që u realizua nëpërmjet INTOSAI-it si metodologji vetëvlerësimi dhe vetëdiagnostikimi, konkludohet se aplikimi i këtij instrumenti rezulton tepër i dobishëm në drejtim të matjes së nivelit të maturisë të kontrollit të përgjithshëm dhe të integritetit në veçanti, qasje, e cila thekson trajtimin e çështjeve jo thjesht si pengesa, por më tepër si mundësi për të fokusuar zhvillimet drejt së ardhmes. Rezultatet e arritura treguan për një përmbushje të kënaqshme të objektivave, por të analizuara nën frymën INTOSAI, dhe këtu është dobia e kësaj metode. Ata nxorën në pah vështirësi, mangësi dhe fushat vulnerabël, të cilat në raportin e vetëvlerësimit janë trajtuar me kujdes, duke analizuar nën dritën e perspektivës, duke u mbështetur fort në atë çfarë kemi bërë, por nga ana tjetër, reflektojmë rritjen e përpjekjeve sesi mund ta çojmë edhe më përpara zhvillimin e këtij institucioni.

Unë jam i hapur që raportin tonë të vetëvlerësimit, ku ne kemi analizuar mangësitë, në çdo kohë që ju mund ta kërkoni, t'jua vendosim në dispozicion.

KLSH-ja ka hartuar, vendosur dhe zbatuan politikat që i shërbejnë përmbushjes së detyrimeve të saj kushtetuese, të cilat i monitoron dhe i përditëson në vijimësi, duke reflektuar në to praktikat më të mira të fushës. Nga procesi i vetëvlerësimit rezultoi se cilësia e auditimit mbetet një nga elementet më të rëndësishme në përmbushjen e këtyre përgjegjësive. Ndaj, zbatimi në pajtueshmëri të plotë me SAI-n 40, sipas të cilit SAI duhet të vendosë politika dhe procedura të projektuara për të nxitur një kulturë të brendshme, e cila pranon se cilësia është esenciale për gjithë punën e saj, tregon angazhimin real të këtij institucioni, pra të KLSH-së, në drejtim të politikave institucionale me në fokus cilësinë.

Për sa më sipër, konkludohet se objektivat e vendosura në strategjinë e zhvillimit për periudhën 2013-2017, strategji e cila u ripunua për vitet 2015-2017, pra u përditësua duke ruajtur të gjitha kolonat e saj, se ndryshe nuk mund të quhet

strategji 4-vjeçare, janë në interpretim të plotë në përputhje të plotë, me objektivat strategjikë të INTOSAI-t, të përshtatura këto me kushtet dhe me fazën e zhvillimit të KLSH-së.

Frekuenca e aplikimit të instrumentit INTOSAI. Vetëvlerësimi i integritetit nëpërmjet aplikimit të instrumentit INTOSAI në KLSH do të jetë i përhershëm dhe do të aplikohet në mënyrë periodike çdo fundvit në nivel institucional dhe individual, pasi vetëm duke u trajtuar në këtë mënyrë do të arrihen rezultate të pritshme dhe të kërkuara për mbajtjen e një niveli të lartë integriteti në institucionin e KLSH-së dhe krijimin e profilit të audituesit profesional dhe me integritet jo vetëm brenda institucionit, por edhe në optikën e palëve të treta, parlamentit dhe sidomos publikut.

Si kolonë të dytë të raportit tonë, e cila natyrisht është më e shkurtër, kemi statusin e zbatimit të rezolutës së Kuvendit, datë 26 qershor 2014 “Për vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2013”. Këtë status zbatimi unë jua kam paraqitur në një material, që është i disponueshëm për të gjithë ju. Dua të theksoj që në bazë të rekomandimeve tuaja ne hartuam një plan për zbatimin e masave për rezolutën e 6 qershorit 2014, i cili mori formën zyrtare më 6 korrik 2014 dhe gjithë këtë vit, pra deri në datën 13 apo 14 korrik, të cilën dje unë e kam përcjellë edhe zyrtarisht te kryetari i Komisionit të Ekonomisë. Ne jemi përpjekur të implementojmë detyrimet e këtij planveprimi që dalin nga rezoluta juaj. Te materiali që ju keni janë paraqitur besoj qartë edhe arritjet që ne kemi, por edhe mosarritjet, të cilat pjesa më e madhe kanë hasur për rrjedhojë të faktit që projekti IPA 2013 do të implementohet me vonesë në KLSH. Ne mendonim se do të fillonte në fillim të vitit 2015, por fillon në shtator të vitit 2015, por janë probleme burokratike, nuk janë problemet tona.

Rezoluta ka kërkuar angazhim maksimal në zbatimin e politikave antikorrupsion në funksion të detyrimeve kushtetuese, ligjore dhe të kërkesave të organizatave ndërkombëtare, rekomandimeve të progresraporteve të Komisionit Europian, me qëllim mbrojtjen e fondeve shtetërore të taksapaguesve shqiptarë. Aty keni të përshkruara të gjitha masat që ne kemi marrë. Është kërkuar ndjekje rast pas rasti e ecurisë së kallëzimeve penale, duke ridimensionuar komunikimin ridimensional me organet e drejtësisë dhe me institucionet e hetimit, si edhe kërkimet për shpërblimet e dëmit të shkaktuar ndaj fondeve buxhetore për shlyerjen e dëmeve dhe ndëshkimin e personave përgjegjës. Përsëri i kemi të gjitha proceset që ne kemi zhvilluar.

Rezoluta e 26 qershorit ka kërkuar hartimin e programit të punës për rritjen e eficiencës së veprimtarisë së audituese në drejtim të auditimit të performancës, auditimit financiar dhe atij tematik, si edhe garantimin e veprimtarisë audituese me cilësi të lartë dhe efektivitet, sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të auditimit. Edhe për këtë jemi përpjekur ta realizojmë, kemi shpjeguar edhe statusin e zbatimit, kohën e zbatimit, treguesit e saj, madje këtu dua të theksoj se përpjekjet tona të këtyre vjetëve kanë arritur atë që ne kemi siguruar, ndoshta nga fundi i këtij viti do të realizojmë një preview, dhe kjo do të realizohet me Institucionet Supreme të Auditimit të Austrisë për sa i përket pavarësisë së institucionit, i cili gëzon edhe pozicionin e sekretarit permanent të Organizatës Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI. Mendoj se kjo do të jetë shumë e mirë pas një sërë procesesh mini preview që ne do të zhvillojmë. Një proces i tillë rishikimi nga një institucion prestigjioz si AKA, Gjykata Austriake e Auditimit, do të jetë tejet i dobishëm për ne.

Rekomandimi juaj i fundit ka qenë strukturimi i raportit vjetor në aspektin informal dhe të përmbajtjes, sipas përcaktimeve kushtetuese ligjore dhe standardeve të aplikueshme nga institucionet homologe të auditimit të jashtëm. Edhe këtë jemi përpjekur ta plotësojmë, qoftë me kontaktet, bisedat e punës që kemi zhvilluar me

kryetarin e Komisionit të Ekonomisë, me projektin pilot me kornizën e matjes së performancës të SAI-ve, që ne po e aplikojmë në mënyrë vullnetare dhe me paraqitjen e dokumenteve shtesë që ne kemi sjellë sot tek ju.

Në kolonë të tretë të kësaj paraqitjeje kemi menduar, dhe unë po ju përmend shkurtimisht një analizë Swot, një analizë të fuqive, të dobësive, të oportuniteteve, të mundësive dhe të kërcënimeve. Për sa u përket fuqive dhe dobësive, janë faktorë të brendshëm që varen nga ne dhe ne po përpiqemi vazhdimisht, duke qenë egzigjent ndaj vetes, duke kërkuar zbatimin e kornizave ligjore, duke kërkuar zbatimin e standardeve INTOSAI, besoj jemi përpjekur që dobësitë t'i shndërrojmë në fuqi dhe fuqitë t'i konsolidojmë.

Për sa u përket oportuniteteve, mundësive dhe kërcënimeve, janë faktorë të jashtëm, të cilët nuk varen nga ne, varen nga faktorë të tjerë, megjithatë edhe te këto faktorë ne përpiqemi, me sa mundemi, të ndikojmë gjithmonë duke respektuar veten, por duke respektuar edhe institucionet e tjera. Në një analizë thuhet që ne i kemi bërë institucionit të KLSH-së, kemi renditur si fuqi të institucionit, mandat i qartë kushtetues.

E dyta, pavarësia e sanksionuar përmes një mandati të qartë dhe të fuqishëm në bazë të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ligji i ri i KLSH-së i plotëson më së miri ato; vizion dhe plan strategjik të miratuar dhe të implementuar në kohë; kornizë rregullative dhe udhëzuese në frymën e INTOSAI për të promovuar integritetin, si karakteristikë kyçe e besimit të perceptuar nga Kuvendi dhe palët e interesit; lidership nëpërmjet shembujve transformues dhe kërkues në rang institucional dhe departamental; strukturë e qartë formale dhe e shtresëzuar optimalisht në dy linja autoriteti dhe tri nivele vendimmarrjeje. Ne kemi dy linja vertikale hierarkike; një për funksionet primare audituese, kryetari, drejtor departamenti, auditues, dhe një për funksionet

mbështetëse, sekretar i Përgjithshëm, Drejtori Mbështetëse, audituesit dhe drejtuesit e tyre. Në veçanti drejtuesit i kemi në dy grupe, drejtues të lartë të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të departamenteve, të cilët janë ose me grada shkencore, ose me përvojë të gjatë në auditim. Të gjithë drejtuesit që zhvillojnë karrierën në Kontrollin e Lartë të Shtetit janë me përvojë mbi 15-vjeçare në Kontrollin e Lartë të Shtetit apo me gradën shkencore "Doktor", apo "Prof. as".

Standardet ndërkombëtare të auditimit që aplikohen drejtpërsëdrejti në punën audituese, edhe kjo është të treguesit e fuqive tona, audites me përvojë dhe formim të larmishëm akademik, kryerja e auditiveve të përbashkëta dhe paralele me Institucionet Supreme të Auditimeve dhe me përvojë në fushën e auditimeve në fushën e performancës dhe të tjera. Ne po e zhvillojmë me sukses të plotë dhe jemi kontributor në auditimet që zhvillon SNAO-ja suedeze, bashkë me zyrën e Kosovës apo me SAI-et e Mqedonisë, apo të Malit të Zi; trajnim dhe edukim i vazhdueshëm me theks praktik i stafit; shkëmbim i përvojave të auditimit dhe praktikave më të mira, nëpërmjet promovimit dhe analizës së vazhdueshme; mentorimi i struktura për audituesit e rinj me kolegët me përvojë, ndjekja në vijimësi e tyre; testime periodike të strukturave për rifreskimin dhe shtimin e njohurive audituese, me synim mbajtjen e postit aktual të punës apo avancimin në karrierë; shtim i botimeve profesionale dhe shkencore në lëmin e auditimit, si edhe prania e rritur në medien e shkruar. Ndërsa dobësitë që kemi, dhe këtu është shumë e rëndësishme të përmendim: vështirësi në implementimin e SAI-ve; implementimi i standardeve ndërkombëtare të auditimit mbetet sfidë, pasi jo të gjithë audituesit, jo të gjitha strukturat tona e kuptojnë rëndësinë e këtij problemi apo kufizimet e mëparshme në njohuritë që audituesit kanë; vështirësi në dhënien e opinioneve mbi pasqyrat financiare të subjekteve të audituara, kjo edhe për shkak të profesionalizimit të kufizuar të audituesve; dobësi tjetër që kemi ne si rrjedhojë e resurseve, e burimeve të kufizuara, delegimi i dy apo më shumë detyrave paralele te vartësit,

duke sjellë shfokusim nga puna audituese dhe perceptim jo i plotë nga të gjithë i vizionit dhe strategjisë institucionale në frymën e kuadrit të irregullator; studimi i pamjaftueshëm i dokumenteve audituese dhe qasja jo e plotë ndaj problemeve të konstatuara; mungesë e aplikimit të auditimit me bazë risku dhe mangësi në metodologjinë audituese; siguri e pamjaftueshme e kontrollit të cilësisë, pavarësisht që ne e ndiejmë se kemi shumë për të bërë për sa i përket kontrollit të cilësisë; mangësi në formulimin logjik të gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve; kapacitete të pamjaftueshme në përpunimin elektronik të të dhënave; mospërputhja e konstatuar e trajnimeve me nivelin dhe prespektivën e audituesve; bazë të dhënash jo tërësisht të besueshme dhe të trajnimeve të stafit; komunikim i izoluar i stafeve mbështetëse me stafet audituese.

Unë po përmend mundësitë, oportunitetet ose edhe sfidat e së ardhmes: promovimi i faktorëve motivues në vendin e punës; rritja e frymës së grupit në vendimmarrje; perceptimi unik i zinxhirit të vlerës në administratën publike. Për shkak të mandatit ligjor dhe eksesit në informacion, KLSH-ja ka një mundësi unike në përfitimin e një panorame të plotë të aktiviteteve ekonomiko-publik. Kjo panoramë i krijon mundësi KLSH-së të ngrejë një bazë të dhënash në nivel kombëtar, të bëjë analiza makroekonomike dhe faktorizohet në dhënien e konsulencës gjatë vendimmarrjes publike. Kjo është një detyrë e jona. Rritja e impaktit në publik për shkak të kufizimit të ndikimit nga ndërhyrjet e jashtme; implementimi i projektit IPA 2013; mbështetje për modernizimin institucional, por edhe një sfidë për KLSH-në. Pritshmëritë nga implementimi i projektit të binjakëzimit do të shtrihen në këta komponentë: rishikimi dhe përmirësimi i kuadrit rregullativ për veprimtarinë audituese institucionale; zhvillimi i metodologjive të auditimit dhe kapacitetet e raportimit dhe konkretisht zhvillimi manual i auditimit të mashtrimit dhe korrupsionit, zhvillimi manual i auditimit financiar, i ligjshmërisë dhe kryerjen e arkëtimeve pilot, këto i kishim për në

muajt maj-qershor, por i kemi shtyrë dhe brenda muajit nëntor, besoj, se do t'i realizojmë. Zhvillimi manual i auditimit financiar, ligjshmërisë dhe kryerja e auditimeve pilot; përmirësimi i metodologjisë të auditimit të performancës dhe kryerja e auditimeve pilot; zhvillimi i metodologjisë së auditimit të IT-së dhe kryerja e auditeve pilot; përmirësimi i raportit të auditimit të kontrollit dhe sigurimit të cilësisë; forcimi i kapaciteteve institucionale dhe rritja e ndikimit nëpërmjet komunikimit. Këto janë të gjitha ato çka presim të përfitojmë nga IPA, projekt të cilin do ta zhvillojmë me Institucionin Suprem të Auditimit të Polonisë dhe Kroacisë.

Së gjashti, jemi përsëri tek oportunitetet, inkurajimi i institucioneve homologe dhe organizatave shoqatave të ndryshme, si edhe njësive akademike për aktivitetet e përbashkëta të trajnimit dhe shkëmbimit të eksperiencës.

Së shtati, inkurajimi i pjesëmarrjes së ekspertëve të fushës dhe OJF-ve në probleme specifik lidhur me auditimin.

Së teti, monitorimi i instrumenteve financiare, të njohura në sektorin privat, por ende të pazhvilluara dhe të parregulluara në sektorin publik.

Kërcënimet për institucionin tonë, KLSH-në. Perceptimi i dobët nga publiku dhe palët e interesit, pavarësisht investimit në komunikim që KLSH–ja ka bërë gjatë viteve të fundit, ka ende shumë për të bërë në këtë drejtim. Mosperceptimi apo perceptimi i dobët i punës së KLSH-së kërkon arritjen e një sërë objektivash të në planin strategjik.

Kërcënim tjetër në punën tonë, për fat të keq, është konsolidimi i mëtejshëm i kulturës së mosndëshkueshmërisë midis zyrtarëve të nivelit të lartë, apo thënë ndryshe, antikultura e pandëshkueshmërisë.

Mbetet ende problem zbatimi dhe ndjekja e rekomandimeve që KLSH-ja u ngarkon institucioneve qeveritare. Edhe pse organizmat ndërkombëtarë e kanë ngritur shpeshherë këtë problem, kërcënimi vazhdon ende të sabotojë punën e audituesve të KLSH-së. Ne patjetër do ta shikojmë edhe te vetja jonë dhe rritja e bashkëpunimit me komisionin tuaj dhe me komisionet e tjera të Kuvendit.

3. Kërcënim tjetër. Risku në rritje për shkak të numrit të lartë të auditimeve dhe zgjerimit të spektrit të tyre bazuar në ligjin e ri institucional. Natyrisht, zhvillimi i auditimeve të mira të performancës, dhënia e opinionit për pasqyrat financiare, kërkon të përkthehet me punë në përmirësim të veprimtarisë audituese dhe kjo përbën një risk të lartë, të cilin ne jemi të detyruar ta përballojmë.

4. Pamjaftueshmëria e kapaciteteve njerëzore dhe logjistike për të mbuluar me auditim shumicën e institucioneve publike. Është e pamundur që KLSH-ja të mbulojë me auditim të gjitha institucionet, prandaj duhet një rakordim me institucionet, me drejtoritë e auditit të brendshëm. Por është edhe tjetra që, ne si KLSH përpiqemi ta ndërtojmë punën tonë dhe e kemi ndërtuar këto tre vjetët e fundit, mbi bazën e filozofisë si institucion auditimi, jo institucion inspektimi, dhe ia kemi arritur. Mund të jenë raste shumë të veçanta ato kur ne shkojmë të kryejmë verifikime të drejtpërdrejta. Ne të gjitha verifikimet dhe denoncimet i kryejmë kur vjen auditimi i radhës. E tillë është puna. Në rast se ne do të gabonim edhe të merreshim me këto, do të habisnim shumë nga profili ynë si institucion auditimi dhe do të kishim kthim prapa.

Unë kam edhe diçka tjetër, por nuk desha të zgjatem. Ju falënderoj për kohën dhe vëmendjen!

Erion Braçe – Faleminderit, zoti Leskaj!

Fjalën e ka zoti Ervin Koçi, si relator i komisionit.

Ervin Koçi – Faleminderit, kryetar!

Në zbatim të Kushtetutës, Rregullores së Kuvendit si dhe ligjit organik për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së", kryetari i KLSH-së ka paraqitur në Kuvendin e Shqipërisë, "Raportin vjetor të veprimtarisë së institucionit gjatë vitit 2014", të cilin Kuvendi ka detyrimin ligjor që ta shqyrtojë dhe të miratojë një rezolutë vlerësimi për aktivitetin vjetor.

Kryetari i KLSH-së ka paraqitur një raport të detajuar, i cili përmban veprimtarinë audituese dhe dobinë e rezultateve' gjetjet kryesore të auditimeve, burimet njerëzore të institucionit dhe përdorimi i tyre' bashkëpunimin ndërinstitucional shoqëruar me vlerësimin e aktiviteteve të organeve audituese.

Njëkohësisht në raport paraqitet veprimtaria botuese social-kulturore e institucionit, shoqëruar kjo edhe me fokusin ndaj së ardhmes, ku është perspektiva dhe sfida për vitin 2015, bashkë me analizën e buxhetit të KLSH-së dhe pasojat financiare për vitin 2014.

Ky raport i detajuar ka ardhur i shoqëruar edhe me raportin e auditimit të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, të vlerësimit të sistemeve, marzhi-financiar, shoqëruar dhe me statusin e zbatimit të planveprimit të rekomandimit dhe rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, i cili përbën një risi në marrëdhënie me institucionet epavarura kushtetuese në Republikën e Shqipërisë.

Lidhur me veprimtarinë audituese të vitit 2014, rezulton se janë planifikuar rreth 159 audiditime për evadim dhe, në fakt, janë ushtruar 192 auditime, ku 19 auditime janë mbartur nga viti 2013 dhe gjatë vitit 2014, janë përfunduar plotësisht dhe evaduar 160 auditime dhe janë në proces përfundimi, për të evaduar 4 auditime. Në proces auditimi janë 28.

Rezultatet e auditimeve, që kanë ardhur nga ushtrimi i kontrollit, ka një shumë totale të dëmit efektiv të përgjithshëm, të zbuluar për parregullsi dhe shkelje financiare në të ardhura dhe shpenzime, rreth 11,2 miliardë lekë, ku dëmi ekonomik në të ardhurat është rreth 3,36 miliardë lekë dhe dëmi ekonomik në shpenzime është rreth 7,8 miliardë lekë. Rekomandimet që ka dhënë KLSH-ja të dëmit efektiv të zbuluar për t'u zhdëmtuar, është në masën 98,9 % të tij.

Indikatori i dobisë së rezultateve të auditimit për vitin 2014 rezulton të jetë që për çdo lek të shpenzuar nga buxheti i shtetit për KLSH-në, janë kërkuar për t'u zhdëmtuar 38 lekë. Llojet e auditimeve të kryera gjatë vitit 2014 janë sipas kësaj strukture: auditime përputhshmërie 131, auditime financiare 12; auditime përformance 8 dhe auditime tematike 9.

Konstatohet një rritje e ndjeshme e auditimeve të ligjshmërisë dhe rritje e auditimeve të performancës, përkatësisht në 11% dhe 33%, krahasuar me vitin 2013. Ky rezultat vjen si përmbushje e objektivit strategjik dyvjeçar që ka të bëjë me konsolidimin e auditimeve të ligjshmërisë dhe rritjen e auditimeve të performancës. Lidhur me auditimet financiare, konstatohet një ulje e dukshme e numrit të tyre krahasuar me vitin 2013.

Veprimtaria audituese e KLSH-së, e strukturuar sipas nocioneve gjatë vitit 2014 rezulton: në institucionet e administratës së qeverisjes vendore dhe në në njësitë e tjera të nivelit vendor janë ushtruar 39% e auditiveve; në ministritë dhe institucionet qendrore 26% e auditiveve; në drejtoritë e doganave dhe degëve të tatimtaksave 14% e auditimeve' në institucionet financiare dhe shoqëritë me kapital të përbashkëta shtetëror 11%; në njësitë dhe projektet me financime të huaja 6% dhe në subjektet e mbrojtjes së mjedisit 4%.

Rekomandime për zhdëmtim dhe shkalla e zbatimit të tyre për dëmet ekonomike gjatë vitit 2014 rezulton: nga rekomandimi për zhdëmtim për 11 miliardë lekë janë zbatuar 3,9 miliardë lekë, që vlen të theksohet se është një përmirësim i ndjeshëm i zbatimit të rekomandimeve për zhdëmtim, krahasuar me vitet e mëparshme.

Për veprimtaritë audituese, gjatë vitit 2014 rezulton se totali i dëmit ekonomik në ministritë dhe institucionet e nivelit qendror është rreth 3 miliardë lekë, duke financuar shprehje të ligjshmërisë nga shitja e pasurisë dhe dhënia e objekteve me qira dhe me koncesion të pronës shtetërore me rreth 70% firo ose rreth 2 miliardë lekë. Për pagat, shpërblimet, shpenzimet dhe prokurimet është pjesa tjetër, e cila është në masën 30%. Dëmi ekonomik në fushën doganave dhe tatim taksave është rreth 1 miliard lekë nga të cilat rreth 91% përfaqësojnë dëmin e konstatuar në organet e doganore. Dëmi total i zbuluar në fushën e auditimit të investimeve dhe projekteve me financime të huaja shoqërive publike dhe mbrojtjes së mjedisit është rreth 5,7 miliardë lekë, ku 93% përfaqësojnë dëmi i zbuluar nga auditimi i kryer në shoqëritë jopublike.

Nga auditivet e kryera në fushën e auditimit të buxhetit të pushtetit vendor, kontrollit të territorit dhe administrimit të aseteve të qëndrueshme, vlera e dëmit ekonomik rezulton të jetë në shumën rreth 1,4 l miliardë lekë, nga të cilat rreth 50% e vlerës totale përfaqësojnë vlerën e evidentuar nga tri drejtoritë rajonale të ALUIZNI-t kategorizues të mungesës së të ardhurave në buxhetin e shtetit.

Gjatë kryerjes së auditimeve KLSH-ja ka nxjerrë rekomandimet. Dhënia e rekomandimeve, shkalla e zbatimit të tyre dhe ndjekja e zbatimit nga KLSH-ja janë detyrime ligjore të dyanshme, për KLSH-në në përputhje me dispozitat ligjore, dhe për subjektin e audituar, sipas kërkesave të ligjit.

Nga auditimet e realizuara gjatë vitit 2014 krahasuar me vitin 2013 rezulton që KLSH-ja të ketë dhënë rekomandime dhe të ketë zbatuar një pjesë të konsiderueshme të rekomandimeve të dhëna. Konstatohet se nga analiza e të dhënave, në vitin 2014, indikatori i propozimit të rekomandimeve është më i madh në të gjitha llojet e tyre duke rezultuar 882 rekomandime më shumë sesa në vitin 2013. Indikatori i performancës, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, për vitin 2014 ka një trend në rritje për të gjitha kategoritë e rekomandimeve. Po ashtu, si në vitin e kaluar, vijon të jetë problematikë për zgjidhje shkalla e zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna. Niveli i zbatueshmërisë në vite ka ardhur duke u përmirësuar, por ende mbetet larg zgjidhja përfundimtare e këtij problemi.

Për ndryshimet në legjislacion gjatë vitit 2014 KLSH-ja ka paraqitur në Kuvend 8 rekomandime, të cilat konstatojnë: propozime për ndryshime në Kushtetutë, ku të vendoset indikatori i borxhit publik ndaj prodhimit të brendshëm bruto në masën 60%; propozim për hartim të ri legjislacioni në ndryshimin e kuadrit ligjor ekzistues, që ka të bëjë me ngritjen e një këshilli fiskal; hartimin e ligjit për përgjegjësinë materiale; ndryshime në strategjinë për menaxhimin e financave publike, si edhe ndryshimin në menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.

Lidhur me kallëzimet penale, në kuadër të luftës ndaj korrupsionit dhe shfaqjeve që rrezikojnë standardet e qeverisjes gjatë vitit 2014, rezulton që janë bërë gjithsej 41 kallëzime, ku janë kallëzuar 149 persona. Konstatohet se ka një rritje të lehtë të numrit të çështjeve të kallëzuara, krahasuar me vitin 2013, dhe ka një rritje të ndjeshme të numrit të personave të kallëzuar. Numrin më të lartë të kallëzimeve, të personave të kallëzuar, e kanë ministritë institucionet qendrore, si dhe niveli i qeverisjes vendore.

Në total dëmi ekonomik që i është shkaktuar buxhetit të shtetit, si pasojë e shkeljeve të kallëzuara në këto kallëzime, arrin në masën 5 miliardë lekë. Njëkohësisht konstatohet se nuk jepen të dhëna pse çështjet dhe personat kanë pasur procedim penal, sa çështje janë pushuar, sa janë dërguar në gjykatë dhe sa janë rrëzuar.

Lidhur me rekomandimet e masave me karakter parandalues dhe shkallën e zbatimit të tyre konstatohet se: masat disiplinore të propozuara; vërejtje me shkrim 80%, dhe vërejtje me paralajmërim 90%, kanë përqindjen më të lartë të zbatueshmërisë. Masat disiplinore të propozuara, pezullim ngritjeje në detyrë, kalimi në një nivel më të ulët, largimi nga shërbimi civil, largim nga detyra largimi nga puna, kanë një përqindje të ulët zbatueshmërie.

Gjatë vitit 2014 KLSH-ja ka realizuar dhe evaduar 8 auditime performance, i cili është dhe një objektiv kryesor i KLSH-së edhe për vitin 2015, si dhe ka iniciuar 4 auditime të reja. Rezulton se në raport me vitin paraardhës, është reflektuar një rritje e numrit të auditimeve të performancës prej 2 auditimesh.

Për vitin 2014, në fokus të veprimtarisë audituese ka qenë adresimi nga institucioni i KLSH-së së çështjeve jetike dhe të rëndësishme për taksapaguesin, në drejtim të rritjes së mirëqenies, përmirësimit të parametrave të shërbimeve publike dhe interesave të tjera të popullatës. Konstatohet se ka ardhur duke u rritur numri i gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve për çdo auditim performance, si dhe numri i subjekteve të përfshira, por, gjithashtu, konstatohet edhe një moskuptim nga ana e institucioneve të rolit dhe misionit të këtij auditimi, i cili çon në uljen e nivelit të bashkëpunimit mes subjekteve të audituara dhe KLSH-së që duhet në sasinë dhe cilësinë e informacionit të vënë në dispozicion të auditimit. Kjo, ka sjellë një rezultat deformues të auditimit të performancës dhe vështirësi në zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Megjithatë, sërish duhet punuar për të rritur numrin e auditimeve të performancës, pasi ky lloj auditimi vlerëson nëse programet, organizimi i punës dhe i proceseve dhe veprimtaritë e sistemin e menaxhimit të subjekteve të sektorit publik operojnë në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit.

Lidhur me menaxhimin institucional të vitit 2014, rezulton se në kuadër të strategjisë që ka KLSH-ja, gjatë vitit 2014 ajo vendosi një risi në veprimtarinë e saj duke bërë një analizë të vetëvlerësimit të integritetit të saj. Rezulton që për vitin 2014 KLSH-ja të ketë adoptuar metodologjinë e vetëvlerësimit, integritetit në Institucionet Supreme të Auditimit, të konsideruar si metodë inovative dhe e efektshme, me impakt rritjen e pritshmërisë në zhvillimin e politikave të integritetit. Kjo analizë është aplikuar, me qëllim promovimin e integritetit dhe parandalimin e korrupsionit në sektorin publik për KLSH-në. Kjo analizë duhet të vijojë të kryhet në vazhdimësi të plotë të punës së këtij institucioni.

Një vend të rëndësishëm në raport i kushtohet menaxhimit institucional, i cili përfshin ecurinë e reformës në institucion lidhur me rritjen e kapaciteteve profesionale, etike dhe të performancës së burimeve njerëzore të KLSH-së. Ndër të tjera, raporti informon edhe për strukturën e re organizative të KLSH-së, e cila është përshtatur me objektivat strategjikë të institucionit, sipas strategjisë së zhvillimit dhe standardeve ndërkombëtare të auditimit. Tashmë, në kohën e modernizimit të teknologjisë dhe informacionit dhe pas krijimit të drejtorisë së auditit të IT-së, aplikimi i auditimeve të IT-së përbën një nga sfidat me të cilat KLSH-ja ka vendosur që të përballet gjatë vitit 2014. Gjatë vitit 2014, në kuadër të rritjes së transparencës institucionale të KLSH-së rezulton se i është kushtuar vëmendje e veçantë përmbushjes së objektivit të rritjes së ndikimit të KLSH-së përmes komunikimit dhe bashkëpunimit. Në këtë aspekt konstatohet një veprimtari e gjerë për sa u përket botimeve të KLSH-së në zbatim të standardeve profesionale INTOSAI, publikimeve informuese për raportet vjetore të institucionit, udhëzuesit e

auditimeve të ndryshme dhe çështje të tjera, që kanë të bëjnë me aktivitetin e këtij institucioni.

Raporti pasqyron veprimtarinë e KLSH-së gjatë vitit 2014 dhe në marrëdhëniet me partnerët ndërkombëtarë INTOSAI dhe ISSAI. Në kuadër të projekteve IPA, KLSH-ja fitoi projektin IPA-2013, "Forcimi i kapaciteteve të auditimit të jashtëm". Ky projekt i financuar nga BE-ja, me kohëzgjatje 2- vjeçare, është një nga sfidat e KLSH-së për të ecur në rrugën modernizimit, të realizimit të auditimeve, në përputhje të plotë me standardet INTOSAI, dhe praktikat më të mira të vendeve anëtare të BE-së.

Gjatë vitit 2014 ne miratuam ligjin e ri "Për organizmin dhe funksionimin e KLSH-së", i cili ka hyrë në fuqi në mars të vitit 2015. Ligji i ri, ndër të tjera, ka adoptuar standarde bashkëkohore të reja për sa i përket aktivitetit me të cilin KLSH-ja do t'u drejtohet subjekteve audituese në raportet e auditimit. Ligji i ri me ndryshimet e atij të mëparshëm, i cili parashikonte vetëm mundësinë e paraqitjes së rekomandimeve për kontrollin dhe drejtimin kontrollit të revizionimit të brendshëm, për herë të parë ka zgjeruar kompetencat dhe përgjegjësinë e KLSH-së për hartimin rekomandimeve në raportimet, si dhe ka parashikuar, si risi, detyrimet për subjektet e audituara që brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit t'i raportojë KLSH-së për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna. Pjesë e raportit vjetor është edhe raporti i auditimit të brendshëm të KLSH- së për vitin 2015, i kryer mbi bazën e kërkesave të ligjit "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, si edhe ligjit "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, kuadrin ligjor për prokurimin publik e kontabilitetin dhe pasuritë financiare".

Ky raport është pjesë e transparencës institucionale kur në kuadër të reformës institucionale konstatohet përgjegjshmëria e lartë për modernizimin dhe rritjen e efikasitetit të të gjithë veprimtarisë audituese institucionale.

Në lidhje me rezolutën e Kuvendit, KLSH-ja ka vlerësuar maksimalisht rëndësinë rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit për veprimtarinë e KLSH-së për vitin 2013. Në zbatim të kërkesave të rezolutës për vitin 2014 KLSH-ja hartoi planin e veprimit për implementimin rekomandimeve, një pjesë e të cilave përputhet tërësisht me objektivat e strategjikë të zhvillimit të institucionit për periudhën 2013-2017.

Rezulton që KLSH-ja të ketë plotësuar kërkesat që Kuvendi i ka adresuar për vitin 2014. Është për t'u vlerësuar se KLSH-ja ka sjellë para Kuvendit zbatimin e planit të veprimit mbi rekomandimet e rezolutës, të cilën sot e ka përpara çdo deputet në këtë komision.

Në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet e progresraportit të vitit 2014 të Komisionit Euripian, i cili ka përcaktuar, ndër të tjera, se parlamenti ka vazhduar të monitorojë punën e institucioneve të pavarura dhe do të diskutojë raportet e tyre më shpesh, nevojiten masa të mëtejshme për të garantuar ndjekjen e duhur të konstatimeve të rekomandimeve të tyre.

Pavarësia dhe performanca e këtyre institucioneve duhet të përforcohet përmes masave në procesin reformues gjithëpërfshirës. Çështjet e abuzimit me detyrën apo me tenderët publikë, të referuar nga KLSH-ja, kanë rezultuar me shumë pak hetime dhe asnjë dënim. Duhet të garantohet zbatimi i barabartë në të gjitha institucionet shtetërore të auditimit të jashtëm që kryen KLSH-ja.

Në fushën e auditimit të jashtëm u miratua plani strategjik i zhvillimit 2013-2017 të KLSH- së. Kapaciteti funksional i KLSH-së duhet të forcohet më tej për të siguruar mbulimin e plotë të auditimit. Shqyrtimi i raportit të KLSH-së nga parlamenti mbetet i kufizuar, nuk ka ndjekje sistematike parlamentare të raporteve të KLSH-së. Kuvendi dhe KLSH-ja janë angazhuar bashkërisht dhe kanë punuar për përmbushjen

e këtyre rekomandimeve, veçanërisht për miratimin e ligjit të ri, si dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit për planin e zhvillimit strategjik dhe strukturën e re organizative.

Mbetet ende për t'u bërë në mënyrë interaktive lidhur me ndjekjet parlamentare të raportit të KLSH-së dhe garantimin e zbatimit të rekomandimeve të këtij institucioni.

Duke u nisur nga fjala që mbajti kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, raportimi vjetor dhe analiza që i kemi bërë, ne rekomandojmë që Kontrolli i Lartë i Shtetit, si institucion kushtetues, që ka për mision mbrojtjen e fondeve shtetërore të taksapaguesve shqiptarë, duhet të fokusohet në luftën kundër korrupsionit, me qëllim intensifikimin e punës audituese për të parandaluar, zbuluar e denoncuar aktet korruptive në publik, medie, prokurori e më gjerë.

Në drejtim të veprimtarisë audituese, Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të vijojë me konsolidimin e auditimit të përgjithshëm të përputhshmërisë dhe atij financiar, shtimit të numrit dhe rritjes së vazhdueshme të cilësisë në auditimet e performancës, si dhe të fillojë përgatitjet për aplikimin e auditimit të teknologjisë së informacionit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të kryejë një vlerësim të plotë performance për privatizimet e kryera njëzet vitet e fundit në vendin tonë në fusha të tilla, si sistemi bankar, telekomunikacioni, energji, hidrokarbure, sigurim, turizëm, mbrojtje, bujqësi dhe industri, si dhe të monitorojë procedurat e koncesioneve me interes publik.

Kontrolli i Lartë i Shtetit në ushtrim të kërkesave të ligjit dhe standardeve ndërkombëtare të auditimit duhet të rrisë forcën e rekomandimeve të adresuara subjekteve të audituar dhe të kërkojë ndjekjen e zbatimit të tyre në mënyrë të vazhdueshme.

Rekomandimet duhet të kenë një ndikim të ndjeshëm në përmirësimin e gjendjes së subjekteve të audituara në funksion të miradministrimit të fondeve në dispozicion, por edhe në qeverisje sa më të mirë.

Për të realizuar objektivat strategjikë dhe institucionalë, me synim realizimin dhe konsolidimin e reformave, Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të punojë për përsosjen e mënyrës së organizimit dhe drejtimit të institucionit, për të përçuar praktikat më të mira të institucioneve simotra europiane në këto fusha.

Me miratimin e ligjit të ri "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" duhet të hartohen programe për fillimin e zbatimit të tij dhe për nxjerrjen e rregulloreve, manualeve, vendimeve, udhëzimeve dhe Kodit të Etikës, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në menaxhimin e procesit të auditimit, përcaktimin e përgjegjësive të reja në fushën e auditimit, si dhe në cilësinë e të drejtave dhe detyrimeve të institucionit bazuar në standardet e INTOSAI-t.

Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të vijojë me përmbushjen e objektivave për rritjen e kapaciteteve audituese të burimeve njerëzore dhe forcimin e kapaciteteve institucionale, duke përqasur metodologji moderne për auditimin për t'iu përgjigjur nivelit të parametrave të kërkuara nga INTOSAI. Këto kërkojnë menaxhimin e duhur të burimeve njerëzore dhe trajnime të vazhdueshme të orientuara drejt përmirësimit të cilësisë së auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të bashkëpunimit institucional, për intensifikimin e luftës kundër korrupsionit dhe formave të shfaqjes së tij, duhet të rishikojë marrëveshjet dhe memorandumet e bashkëpunimit me institucionet dhe organet ligjzbatuese që u ka tejkaluar afati i kohëzgjatjes për t'iu përgjigjur sfidave dhe kërkesave të kohës.

Për respektimin në vijimësi të parimit të transparencës institucionale, Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të çojë më tej përvojën pozitive të fituar në komunikim me publikun, organet e administratës, organizatat e shoqërisë civile, medien e të tjerë.

Në përmbushje të rekomandimeve, adresuar në kuadër të procesit të integrimit europian, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Kuvendi duhet të rrisin shkallën e ndërveprimit gjithëpërfshirës me institucionet ligjzbatuese, me qëllim përmbushjen e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së.

Për rekomandimet në aspektin e përmirësimit të legjislacionit, Kuvendi dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të organizojnë të paktën dy herë në vit seanca dëgjimore me institucionet përkatëse dhe grupet e interesit, me qëllim vlerësimin e situatës ligjore dhe finalizimin e nismave ligjvënëse.

Së fundi, Kuvendi, në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe në ushtrim të kontrollit parlamentar, duhet të angazhohet që të realizojë auditimin e llogarive financiare të KLSH-së dhe t'i bëjë ato publike.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zoti Koçi! Kalojmë në pyetje.

Kush ka pyetje?

Urdhëroni, zoti Shehu!

Sherefedin Shehu – Zoti kryetar, në raportin tuaj ne pamë shumë arritje lidhur me numrin e auditimeve të kryera, lidhur me numrin e rekomandimeve, propozimeve që keni bërë, por të gjitha këto mbeten sasiore, në kuptimin që, edhe po t'i kishit dyfishuar këto arritje, mua më intereson më shumë të di se cili ka qenë impakti i veprimtarisë suaj në forcimin e disiplinës financiare. Pra, a është konsideruar nga

qeveria kjo rritje e numrit të auditimeve tuaja? A ka pyetur qeveria për ju, apo ju ka bërë presione që të ulni gjetjet? Pra, si është e vërteta ose cili është ajo që ne quajmë outcome? Pra, të dalim përtej zyrave të institucionit, sepse kjo është edhe pjesa që na intereson neve dhe kjo është arsyeja pse Kuvendi ka një institucion, siç është Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Së dyti, problemi më i madh, siç ka dalë dhe siç është relatuar historikisht, por ju e keni identifikuar më qartë, janë tenderët publikë (62% e gjetjeve, e rekomandimeve dhe e dëmeve ka të bëjë me tenderët publikë).

Po kështu, unë jam përpjekur të gjej informacion në website-et e qeverisë, por nuk ka asnjë informacion lidhur me tenderimin: kush janë konkurruesit? Kush janë fituesit? Ka vendime që shpallin fituesit, por ky është i vetmi informacion që mund të gjesh lidhur me tenderimet.

Tani, unë dua të di pak më shumë nga ju se si do të vazhdojë kjo histori: ju do të konstatoni, do të vini të raportoni, do të themi se ka shkelje? Shkeljet rriten. Në gjashtëmujor kemi gati dyfishin e vitit të kaluar, nga 11 bëhen 16 miliardë lekë, sipas raportit tuaj. Si do ta mbyllim këtë shteg? A keni identifikuar faktin që, për shembull, mbaj mend që në gjysmën e vitit të kaluar rreth 2400 tenderime ishin të drejtpërdrejta? Pra, përsëri në kontekstin e impaktit, ku do të shkojmë ne? Si do ta mbyllim këtë shteg? Sepse, duke e përsëritur vit pas viti dhe duke u kthyer mbrapsht, se këtu shikoj një përkeqësim, të paktën në shifrat për dy vjetët që keni raportuar ju (2014 dhe gjysmën e vitit 2015), por janë disa fenomene. Nuk ka transparencë këtu.

Në Dibër ka fituar oferta e shtatë në ndërtimin e një ure atje. Pra, oferta më e shtrenjtë. Besoj se ju i keni konstatuar, por si e shikoni rrugëdaljen? Se flasim për performancë, teknologjia është shumë e mirë, gjërat thuhen dhe bëhen. Si mund të

krijojmë mekanizma që ato që konstatoni ju, fenomenet negative që ndodhin, t'i eliminojmë që të mos përsëriten? Pra, të forcojmë përgjegjshmërinë institucionale, nga Kryeministri e deri te nëpunësi më i vogël i shtetit.

Më tej, qeveria ka dy vjet që bën lojën e detyrimeve të prapambetura. Ndër to, për shembull, "7 miliardë lekë janë detyrimet në industrinë farmaceutike", thotë.

Së fundi, kemi gati 5 miliardë lekë ose 50 milionë dollarë të vjedhura me importe ose me subvencione fiktive. FMN-ja ka kërkuar auditim dhe, me sa dimë ne, ka bërë auditimin e detyrimeve të prapambetura. A jeni përfshirë ju në këtë proces? A jeni informuar? A keni marrë pjesë? A keni ndikuar në auditimin e këtij procesi, sepse janë dhënë para për miq, janë dhënë para që kanë shkuar jashtë shtetit. "Janë rritur transfertat tri herë", ka thënë Banka e Shqipërisë. Pra, transferimi i parave jashtë shtetit është rritur tri herë. Nga dolën këto para? Janë paratë e subvencioneve farmaceutike, janë paratë e të ashtuquajturave borxhe, se, po të ishin shlyer borxhet, borxhet do të shkonin për bizneset dhe bizneset do t'i investonin përsëri. Ndërsa ne këtu, qeveria thotë: shlyej borxhe, kurse, nga ana tjetër, rriten kreditë e këqija. Atëherë, do të thotë që paratë fluturojnë. Për ju a ka qenë ky shqetësim? E keni adresuar? Jeni marrë me të?

Tjetër çështje përveç tenderëve, qeveria 50 milionë dollarë në fund të vitit të kaluar,pagesat me letër kredi i transferoi për llogari të klientëve nga buxheti i shtetit. Ka pasur përsëri tenderë ditën e fundit ose javën e fundit të vitit. Pra, këtu nuk kemi standarde. A kanë qenë objekt i punës suaj këto? Nuk kemi dëgjuar, sepse ju keni bërë edhe publikime, që thatë ju, audituesit në shtypin e përditshëm.

Nga ju ose nga audituesit tuaj nuk kam dëgjuar, të paktën për këtë problem, meqenëse është edhe pjesa sensibilizuese që njerëzit duhet të ndiejnë që këtu ka zë që flet për shkeljet që bën qeveria. Pra, paratë vidhen në tenderë, paratë

shkojnë në llogaritë e kontraktorëve të qeverisë, kontraktorët janë të preferuar të qeverisë. Ju thoni: "Po, janë vjedhur 60 miliardë lekë të reja ose 150 milionë dollarë", por problemi është: si t'i adresojmë dhe si t'u japim përgjigje këtyre fenomeneve që vazhdojnë të përkeqësohen.

E fundit, në vitin 2013, por edhe në vitin 2014, që besoj se ju do të na sillni edhe raportin e auditimit, qeveria ka shkelur ligjin "Për menaxhimin financiar". Merr para borxh për shpenzime administrative. Niveli i investimeve publike të buxhetuara, por edhe të realizuara, është më i vogël sesa niveli i huamarrjes, gjë që ndalohet me ligjin e menaxhimit financiar. Pra, kjo është një shkelje e hapur që "unë nuk pyes as për ligjin", thotë qeveria. Cili ka qenë pozicioni juaj, qëndrimi juaj lidhur me këtë shkelje?

Faleminderit!

Erion Braçe – Ligji i ka mbajtur në vitin 2012, kur kjo gjëja e fundit që po thua ti nuk

ndodhte.

Zoti Leskaj, a mund t'u përgjigjeni pesë pyetjeve të zotërisë? Natyrisht, duke i marrë me radhë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tani, zotëria ishte shumë i thellë në ato që tha. Kështu që kërkon me patjetër përgjigjen tuaj.

Bujar Leskaj – Po, faleminderit!

(Deputeti Shehu ndërhyn pa mikrofon.)

Erion Braçe – Unë ta kam dhënë përgjigjen ty, Sherefedin, atje në Peshkopi!

(Deputeti Shehu ndërhyn pa mikrofon.)

Po, tek ajo ura.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sherefedin, tek ajo ura.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, tek ajo ura dhe po kërkon transparencën ti që të thuhet tani nëpër website-e sesi është bërë tenderi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sherefedin Shehu – ...pesë kandidatë. Një nga ato është ai i urës.

Erion Braçe – Ulu, o Sherefedin, ulu!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ulu, ulu!

Bujar Leskaj – Unë, në fakt...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Erion Braçe – Po, Sherefedin, po.

Bujar Leskaj – Së pari, unë ju falënderoj, sepse më jepni edhe mua mundësinë të ekspozoj qëndrimin dhe punën tonë!

Në fakt, deputeti bëri një sërë pyetjesh dhe, në mos gaboj, çdo grupim pyetjesh ka disa pyetje.

Grupimi i parë: impakti juaj në forcimin e disiplinës financiare, a ka pyetur qeveria për ju? A ju ka bërë presione? A ka pranuar rekomandimet tuaja? Unë mendoj që impakti i punës dhe i veprimtarisë së KLSH-së në forcimin e disiplinës financiare, nga viti në vit, vjen në rritje.

Vetë fakti që po të shikosh nga viti në vit ka një sensibilizim të të gjithë aktorëve dhe faktorëve në Shqipëri që vijnë edhe nga presioni qytetar, kuptohet, ka reagime dhe ka impakt edhe nga institucionet qeveritare.

Në këto momente, edhe për faktin që auditimet tona janë në proces dhe në mes të shtatorit ne vijmë në Kuvendin e Shqipërisë për të realizuar detyrimin kushtetues dhe për të raportuar për zbatimin e raportit të buxhetit faktik të vitit 2014, unë nuk mund të jap shifra, ashtu siç dhashë shifra për gjetjet dhe rekomandimet tona. Përgjithësisht, për sa i përket pranimit ose vërtetësisë së tyre, gjetjet dhe zbulimet tona nuk vihen në dyshim.

Duke ruajtur edhe kornizën tonë ligjore kushtetuese, por duke ruajtur edhe parimet klasike të auditimit të jashtëm publik, të cilat unë besoj që ju i dini po aq mirë sa unë, ne jemi institucion i jashtëm auditimi që, si të gjitha institucionet, siç është auditimi i jashtëm, japim rekomandime. Nuk janë detyrime dhe në këtë drejtim ne insistojmë për zbatimin e rekomandimeve. Për fatin tonë, kemi mbështetjen e qytetarëve, kemi mbështetjen përgjithësisht të Kuvendit apo edhe pjesërisht të komisionit tuaj, kemi mbështetjen e organizmave dhe të forumeve ndërkombëtare që të rrisim trysninë tonë për zbatimin e rekomandimeve, por, në asnjë rast, për vetë strukturën që ka Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe parimet që kanë institucionet supreme të auditimit, këto nuk janë detyruese.

Natyrisht, i mendoj gjërat si te vetja ime, si te zyrtarët e ndershëm të këtij vendi, që nuk ka munguar dhe nuk mungojnë, unë besoj që qeveritarët e lartë i lexojnë auditimet tona, rekomandimet tona, dhe përpiqen të reflektojnë.

Personalisht nuk jam i shqetësuar të kontaktoj me asnjë prej tyre, as nuk më impresionon, as nuk më surprizon, as nuk më afekton që të kem kontakte “si ju

duket kjo?" apo "si e vlerësoni këtë?". Kontakti im më i mirë është me qytetarët shqiptarë dhe me ju, si deputetë të Kuvendit.

Lidhur me pyetjen: a keni pasur presione nga qeveria?, jo, nuk kemi pasur. Duhet të jemi të ndershëm. Nuk kemi pasur dhe unë nuk e mendoj që mund të më bëjnë presion. Nuk e konceptoj dot. Për fat të mirë, ne jemi në Europë, ne aspirojmë për të hyrë në BE, të gjitha Institucionet Supreme të Auditit janë të pavarura dhe në ligjet organike të Institucioneve Supreme të Auditimit po aq sa i mëshohet pavarësisë së Institucioneve Supreme të Auditimit, po aq i mëshohet edhe mandatit të kryetarit dhe pavarësisë së tij.

Unë e ndiej veten tërësisht të pavarur dhe të lirë, dhe nuk e besoj tani që, të mos bëj thënie patetike, të mund të ndodhin këto gjëra.

Çdo gjë varet nga puna, nga kontributi...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Urdhëroni?

Erion Braçe – Ju lutem, mos ndërhyni! Mos ndërhyni, zotëri!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Bujar Leskaj – Jo, jo, shikoni!

Erion Braçe – Mos ndërhyni! Ka përgjigjen e tij zotëria, nuk mund t'ia bësh ti përgjigjen tani.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, edhe kjo ishte antikushtetuese.

Zoti Leskaj, atëherë, a ka mundësi t'ia tregoni këtij zotërie sesi është ajo histori, që ta marrë vesh njëherë e mirë? Tregojani pak atij zotërie!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tregojani faktin që e keni kërkuar vetë atë gjë, bashkë me atë tjetrin, që ka ky për President!

Bujar Leskaj – Këtu u tha..

Sherefedin Shehu – Nuk më duhet kush e kërkon, mua më duhet...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Erion Braçe – Lëre atë zotërinë të përgjigjet atje dhe boll! Boll, edhe një herë tjetër!

Të mbarojë zotëria!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të mbarojë zotëria!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të mbarojë, se të kam parë unë ty kur ke qenë në pushtet, çfarë ke bërë ti! Të kam parë ty fare mirë se ç'ke bërë ti kur ke qenë në pushtet dhe si e trajtoje Kontrollin e Lartë të Shtetit ti kur ishe në pushtet!

Edmond Spaho – A mund të bëj një ndërhyrje për procedurë?

Erion Braçe – Zoti Leskaj, vazhdoni përgjigjen tuaj!

Bujar Leskaj – Të jemi të qartë, kthimi që i bëri Presidenti...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Presidenti e ktheu ligjin për të...

(Deputeti Shehu vazhdon të flasë pa mikrofon.)

Jo, jo. Nuk më shqetëson.

Zoti deputet, mua ajo nuk më shqetëson, por qysh ia bëjnë këta shqiptarët e tjerë, gazetarët...

(Deputeti Shehu vazhdon të flasë pa mikrofon.)

Unë jam i pavarur, nuk ka çfarë më bën njeri mua.

Problemi është këtu, që të jemi të qartë, presidenti e ktheu me të drejtë në respektim të Gjykatës Kushtetuese. Në gjithë atë mori diskutimesh prej një viti, të stërzgjatura, të tejlodhura, unë kisha gjetur mirëkuptimin me ju që ajo nuk ishte problematike për mua si person dhe jua kam theksuar.

(Deputeti Shehu vazhdon të flasë pa mikrofon.)

I gjithë diskutimi dhe ideja ishte që ne të kalonim një ligj në përputhje me standardet e INTOSAI-t, një ligj që të garantonte pavarësinë e saj, një ligj që të garantonte edhe mandatin e kryetarit. Kjo e fundit nuk ishte shqetësuese për mua, se, në rast se unë do të përqendrohesha te kjo, do të hiqej...

Sherefedin Shehu – Mos diskutoni individualisht këtu!

Bujar Leskaj – Jo, more, por...

(Audioja ka probleme.)

Jo, more deputet, ligjin e solla unë dhe...

(Deputeti Shehu vazhdon të flasë pa mikrofon.)

Nuk jam fare tolerant për të drejtat e mia, si kryetar i KLSH-së, se atë nuk e kam unë në dorë. Nuk jam tolerant për këto dhe unë i kërkoj deri në fund pavarësinë e KLSH-së, pavarësinë time, ushtrim mandati të plotë pa presion e të gjitha. Në atë mori diskutimesh të stërzgjatura prej një viti, që ne me zor u dakordësuam, dhe ishte pjesa juaj më e madhe që më mbështetën, ashtu siç e kam theksuar. Ka pasur edhe segmente nga kjo maxhorancë, që nuk kanë dashur dhe mund të kenë ushtruar trysni e presion, por nuk kanë qenë te Komisioni i Ekonomisë.

Ne kaluam një ligj që ishte në përputhje me standardet INTOSAI. Unë e vlerësova së tepërmi kthimin e ligjit që i bëri presidenti, po për faktin e isha në konflikt interesi dhe bëhej fjalë për një siguresë shtesë të mandatit tim, nuk mund të investohesha kundër Kuvendit, kundër jush që kaluat ligjin. Kjo është e thjeshtë. Nuk shqetësohem. Unë edhe sot jam i pavarur. Në rast se unë nuk do ta bëj punën, nuk do ta bëj punën se do të thyhem, por jo se më mungon pavarësia me ligj. Për këtë, unë ju garantoj me integritetin tim. Ne, për fat, te ligji i ri kemi vendosur një nen, që është shumë kuptimplotë. Unë e theksova pak, por nuk doja të zgjatesha.

Brenda një periudhe të caktuar prej njëzet ditësh, subjektet dërgojnë masat e marra për realizimin e rekomandimeve tona dhe mbas gjashtë muajsh janë të detyruar të raportojnë me shkrim. Pas gjashtë muajsh, mendoj unë, kjo do të jetë një pikë kruciale. Mbas gjashtë muajsh, të gjithë ata zyrtarë të rangut të lartë, të cilët nuk do të zbatojnë ato rekomandime të drejta, të konsiderueshme, të konsoliduara, të Kontrollit të Lartë të Shtetit, dhe do të evidentojmë me fakte qëndrimin e tyre në favor, po them, në përkrahje të heshtur të qëndrimeve korruptive, do të marrin përgjigjen e merituar. Ato janë veprime, të cilat unë do t'i marr në cilësinë e

kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, por, natyrisht janë të hapura, që të mund të ndërmerrni veprime edhe ju si deputetë, edhe qytetarët shqiptarë.

Ne, përgjithësisht i kemi dhënë rekomandimet tona, kemi qenë të qartë në rekomandimet tona. Unë e theksova: janë rekomandime që u qëndrojnë dhe do t'u qëndrojnë kohës. Dhe, me luftë e me presion, por gjithmonë me luftë e presion gjithmonë pozitive, ne do të synojmë t'i implementojmë e t'i përmirësojmë këto rekomandime. Unë e kam theksuar, ne e kemi theksuar, në rast se do të lexoni raportin tonë për performancën e vitit 2014. Ne insistojmë që qeveria të nënshkruajë një dokument apo të nxjerrë një urdhër, në vijim të urdhrit numër 70 të vitit 2006, të Kryeministrit të asaj kohe, Profesor Doktor Sali Berisha "Për detyrimin për zbatim të rekomandimeve tona dhe të departamentit antikorrupsion në kryeministri". Natyrisht, kjo është e drejtë dhe atribut i Kryeministrit të Shqipërisë, nuk është e imja. Detyrë e imja është ta kujtoj këtë gjë: tenderët publikë, për sa u përket informacioneve në uebe, që janë informacione të mangëta, zbulimet që kemi bërë ne, sa do të vazhdojë kjo histori, shkaqet e tyre e të tjera; ju keni konstatuar në 2014-ën njëqind tenderë të drejtpërdrejtë.

Unë dua të theksoj një gjë dhe t'i garantoj të gjithë se të gjitha ato auditime që ne kemi zhvilluar në institucionet qendrore apo në institucionet vendore, në SHA apo institucione të tjera publike, atje ku kemi konstatuar shkelje dhe mangësi, ne i kemi evidentuar. Dokumentimi i kësaj që thoni ju, paraqitja apo jo, unë jam në dijeni, ju sqarova edhe më përpara, e theksova. Auditimi është ai çka unë vërtetoj me letra, me të shkruar. Nuk është auditimi ajo çka unë dëgjoj me fjalë. Kur them "unë", kuptoj audituesin e jashtëm publik. Këtë parim, unë do të përpiqem të mos e shkel në asnjë rast. Ne, madje, në këto momente jemi duke zhvilluar një auditim IT në Agjencinë e Prokurimit Publik. Do të jetë ky auditim, apo auditivi që ne zhvilluam në drejtorinë e tenderëve të përqendruar në Ministrinë e Brendshme, atje ku konstatuam shkelje, ne bëmë edhe kallëzim penal për shpërdorim detyre për

drejtuesin e agjencisë, drejtoren, në mos gaboj, dhe për dymbëdhjetë punonjës të rangut të mesëm të zyrës. Përveç këtij kallëzimi, kemi edhe një kallëzim tjetër, që e kemi kaluar si indicie në prokurori, me shkeljet. Të gjitha ato janë ato çka ne mund t'i vërtetojmë, po e theksoj këtë. ne nuk mund të shkruajmë ato gjëra që nuk i vërtetojmë.

Nisur edhe nga treguesit që ne dhamë, unë mendoj se puna jonë flet në këtë drejtim, sepse në 70 auditime që ne kemi zhvilluar për gjashtëmujorin, të kryesh 26 kallëzime, unë nuk mendoj se janë pak. Por ne problemin e kemi se të gjithë duhet të kontribuojmë, edhe qeveria, edhe opozita, edhe deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, edhe shoqëria civile, edhe media, për ta thelluar luftën kundër antikulturës së pandëshkueshmërisë.

Personalisht, po të mendoj në raport me ju, e theksova: në raport me ju, si deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, qoftë të pozitës, qoftë të opozitës dhe ministrat e kësaj qeverie, ju shikoj drejt e në sy; mendoj se e kam bërë detyrën, dhe e kam bërë shumë mirë. Apo në raport me paraardhësit e mi, paraardhësin tim.

Në raport me qytetarët shqiptarë, në raport me atë çka presin qytetarët e ndershëm, taksapaguesit shqiptarë, mendoj se ne kemi shumë për të bërë.

Ne, për sa u përket tenderëve publikë, këtë problem do ta trajtojmë – ne po i vazhdojmë auditimet tona – në raportin që do të sjellim në shtator për zbatimin e buxhetit të vitit 2014.

Në vijim të kësaj – po kaloj këtu te pyetja pesë, është...

Erion Braçe – Më fal, zoti Leskaj.

Me ju gazetarët e kam: a mundet që të mos bëni si deputetët? Mundet? Po flet kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Bujar Leskaj – Unë fola edhe mirë për këta.

Erion Braçe – Edhe një herë tjetër: boll, se dilni edhe përjashta! Po, pra, boll! Muhabetet dilni e bëjini atje matanë.

Bujar Leskaj – E njëjta gjë është edhe për sa i përket pyetjes që ju bëtë për pagesat me LC. Në tre institucione qendrore që ne kemi audituar, e kemi trajtuar këtë problem. Do ta trajtojmë edhe te Ministria e Financave. Madje, edhe në njoftimin më të fundit që ne bëmë te Ministria e Arsimit, po ta lexoni me vëmendje, aty është trajtuar edhe ky problem.

Mendoj se te raporti që do të sjellim në shtator, kjo do të jetë e trajtuar. Ne këtu, ju lutem të më mirëkuptoni, raportojmë për performancën e institucionit për vitin 2014. Unë kam shtuar, për ta përditësuar, në respekt të opinionit publik, gjashtëmujorin e 2015-ës. Natyrisht, këtë problem e kemi trajtuar e do të vazhdojmë ta trajtojmë me profesionalizëm. Kemi marrë edhe përvojën e Gjykatës Europiane të Audituesve. Në këto momente që ne flasim, kemi tre auditues, që janë gjashtë muaj në trajnime atje. Për parimin e anualitetit të buxhetit. Do ta trajtojmë.

Loja e detyrimeve të prapambetura. Ishte dëshira e mirë e FMN-së, dhe orientimi i saj, që në auditimin e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura të përfshihej edhe Kontrolli i Lartë i Shtetit, edhe për faktin se ata si FMN, si ekip drejtues, vlerësuan punën tonë të mëparshme. Për të qenë të sinqertë, ne e kemi ngritur këtë problem, kur qeveria aktuale ishte në opozitë.

Tani, për sa i përket shlyerjes së tyre, në këto momente që ne po flasim, ne kemi që prej tre muajsh një grup auditimi në Ministrinë e Financave, me objekt auditivin e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura.

Në auditimet e mëparshme që kemi bërë, para tetë muajsh, ato problematika që ne kemi konstatuar, mospërcaktim të saktë të këtyre detyrimeve, ne i kemi evidentuar. Këto detyrime janë pranuar nga institucionet qeveritare. Madje, nga informacionet që kam unë, janë pranuar edhe në një audit të fundit, që ka bërë një institucion i BE-së, me porosi të BE-së.

Raporti i parë ka dalë dhe ne e kemi evidentuar mosrakordësinë në shifra. Sa i takon raportit të dytë, ne jemi duke punuar. Kemi gjetur shkelje. ideja e FMN-së, që për të qenë transparent u reflektua edhe në një vendim të qeverisë, ishte që ne të auditonim paralelisht, vitin e kaluar, zhvillimin e këtij procesi. Nuk patëm mundësi. Pati një skepticizëm, mosdakordësi nga Ministria e Financave, që ne të auditonim paralelisht. Nuk dëshironin të nënshkruanin një marrëveshje, madje para një viti. Unë atë nuk e kam bërë publike, se ishte në kohën kur ne kishim ato debatet për sa i përket qasjeve të kufizuara apo të pakufizuara në informacion.

Nuk kisha pse ta bëja publike, por nga ana tjetër nuk kisha pse të nënshkruaja një marrëveshje të mangët. Unë nuk mund të pranoja të nënshkruaja marrëveshje që, po, do të auditojmë detyrimin e borxheve të prapambetura, por te Tatimet duhet t'i marrësh leje X-it apo Y-nit. Nuk arritëm. Ne po kryejmë auditimin e zakonshëm post factum. Besoj se kemi gjetje. Në kohën e duhur, natyrisht do t'i sjellim në këtë komision. Unë jam gati edhe të raportoj në mënyrë të veçantë, përveç asaj të shtatorit.

Pyetja e gjashtë ishte konstatime. Unë nuk besoj se ju keni ndonjë dyshim se, në rast se unë personalisht, Bujar Leskaj, në cilësinë e kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, do të konstatoj veprime apo mosveprime të qeverisë, që kanë shkelur ligjin për buxhetin, ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë apo ligje të tjera nga institucione qendrore, do të hezitoj t'i bëj publike. Nuk e besoj që, të paktën ju deputetët e PD-së të keni ndonjë dyshim. Po të jetë se keni, jeni të

lirë t'i shfaqni ato në forumet tuaja. Nuk e mendoj. Mendoj se puna jonë – e me thënë të drejtën gjithmonë kufizohem kur vi në Komisionin e Ekonomisë; jo s'e kufizohem se kam droje të deklaroj arritjet tona, por kufizohem kur mendoj ata që na shikojnë, qytetarët shqiptarë, të cilët presin shumë nga ne – pra mendoj se puna jonë flet vetë.

Unë e theksoj këtë: me qytetarët shqiptarë nuk jemi në rregull. Duhet të bëjmë më shumë. Edhe KLSH-ja, edhe ju si deputetë, edhe qeveria, edhe opozita, si dhe të gjitha institucionet. Kurse, me ato detyra që unë kam si kryetar i KLSH-së me ju si komision, me institucionet, me ata që kanë qenë ministra apo ish-ministra, jam shumë në rregull.

Këto janë burimet njerëzore, treguesit tanë. Madje unë përfitoj nga fakti, duke falënderuar deputetin Koçi, do ta kërkoja përsëri auditimin e financave të institucionit tonë, se kjo u bë legjendë. Është e pakuptimtë. Ne kemi ndërtuar një marrëdhënie shumë konstruktive, mos të auditojmë pasqyrat financiare të KLSH-së. Kjo, më tepër është një shenjë besimi reciprok, dhe mesazhi që ne duam t'i japim qytetarëve, por unë jam gati që ju, si komision, të zgjidhni edhe një përfaqësues, një ekspert tuajin, i cili të asistojë Kontrollin e Lartë të Shtetit, të jetë në cilësinë e avokatit të Komisionit të Ekonomisë apo të jetë në cilësinë e një eksperti të avokatit të qytetarëve. Jam gati që të përcaktohet nga ju, ashtu siç jam duke menduar që, në bashkëpunim me forumet e biznesit apo me Komisionin e Ekonomisë, do të konsultohem me ju, që të përcaktojmë një pozicion si avokat të tatimpaguesve.

Ne tani po përpiqemi dhe duhet të jemi të kujdesshëm në të gjitha auditimet tona. Unë e thashë: si të gjitha institucionet në Shqipëri, asnjë nuk është imun ndaj problematikës. Jo më kot e kam orientuar institucionin, prej më se dy vjetësh, dhe në janar të këtij viti ai u dokumentua drejt INTOSAI-t, auditimit të integritetit. Jam

gati që edhe në këto dy pozicione të jenë njerëz të përcaktuar nga ju, si Komision i Ekonomisë.

Pra, për të bërë një sintezë të pyetjeve tuaja, më duhet t'ju garantoj, t'ju siguroj, që ne po vazhdojmë të auditojmë, dhe në raportin e zbatimit të buxhetit faktik të vitit 2014, që ne do të sjellim në Kuvend, do të kemi po ato probleme që ne kemi konstatuar. Jemi të hapur edhe për sugjerime. ne përpiqemi t'ju ndjekim juve. Natyrisht, ajo është te ato kufizimet kryesore që kemi ne. Ne duhet të ndajmë atë pjesën racionale nga pjesa politike, që shpeshherë në Shqipëri, në këto njëzet vite, është në të gjitha deklarimet,q ë bëni ju, që kam bërë edhe unë në ato katër vite që kam qenë deputet, pozita e opozita në pozicione të ndryshme.

Ju faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zoti Leskaj!

Zoti Koçi. Pastaj zoti Mima.

Ervin Koçi – Faleminderit, kryetar!

Në fjalën që mbajtët ju sot, në strukturën e dëmit ekonomik për vitin 2015, keni nxjerrë një zë nga Tatim-Taksat, 11. 7 miliardë lekë, që përbëjnë edhe 70% të totalit të dëmit që keni gjetur gjashtëmujorin e parë. U vumë në dijeni sot, sepse sot na u paraqit edhe botimi juaj për performancën e KLSH-së për këtë gjashtëmujor.

Doja të dija se ku konsiston ky dëm, sipas fushave, për shkak se është një shumë e konsiderueshme.

Pyetja e dytë ka të bëjë me një mosarkëtimin e garancisë bankare të privatizimit të shoqërisë "Albpetrol", Fier nga VETRO ENERGY, Faktikisht, këtë e keni nxjerrë si

dëm, edhe në raportin e vitit 2013, por në këtë raport që keni paraqitur për vitin 2014, rezulton se kjo garanci është sërish e papaguar.

(Diskutime pa mikrofon)

Është përsëri e papaguar. Nuk është paguar, nuk është arkëtuar.

Çfarë veprimesh konkrete keni ndërmarrë ju si KLSH, për zbatimin e rekomandimeve që keni dhënë për këtë çështje? A keni bërë padi penale për mosveprim, si institucion?

Pyetja e fundit, faktikisht ka të bëjë me institucionet e pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, si dhe pushtetit gjyqësor e prokurorisë, lidhur me auditimet. A keni kryer auditime në ndonjë prej këtyre institucioneve të pavarura kushtetuese e të krijuara me ligj? Si kanë rezultuar auditimet? A keni bërë rekomandime për to, dhe në se ju do ta gjykonit të arsyeshme, a do të ishte më mirë që në raportin tuaj vjetor të kishte një strukturim të posaçëm vetëm në lidhje me institucionet e pavarura kushtetuese, duke qenë se ato kanë një vëmendje të posaçme edhe nga ana jonë, për të qenë jo vetëm të pavarura, por një kohësisht edhe se si administrohen buxhetet e tyre.

Faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër incizimi.)

Bujar Leskaj – Faleminderit!

Në auditimin që zhvilluam në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është një dëm shumë i konsiderueshëm, i cili në fakt, me një ngjyrë letrare mund të konsiderohet një gropë e zezë, që i takon Kuvendit, i takon qeverisë apo organeve ligjzbatuese, që të vazhdojë investigimin e mëtejshëm të kësaj problematike që ne

kemi konstatuar, e kjo është e vërtetë. Në këtë zë, në këtë auditim, në AKBN, ne kemi nxjerrë një shkelje me dëm ekonomik, në vlerën 11 miliardë lekë, nga të cilat 316 milionë lekë shmangen nga skema e TVSH-së në mënyrë të parregullt e të paargumentuar, për punime e shërbime nënkontraktore në marrëveshjet hidrokarbure, dhe 11 miliardë lekë evazion fiskal nga mosdeklarimi i prodhimit të shtuar të naftës bruto, si pasojë e përdorimit të holluesit diesel 1000 PPM në shtresë.

Dua të theksoj një herë, se në këtë auditim ne jemi penguar në mënyrë permanente, dhe falë kalimit të ligjit të ri na u mundësua. Ne pengoheshim me arsyetime nga më absurdet, që në rast se ndonjë ditë do të hapen ato letra, do të jetë turpi i atyre që kanë penguar. Kuptohet, ne kemi insistuar. Ky është dëm i shtrirë në vitet 2012, 2013, 2014. Për vetë specifikat që kanë raportet e këtyre marrëveshjeve, këto kompani që operojnë në këtë treg – po ju jap një fakt, që është tronditës, po themi, për sa i përket faktorit R, asnjëherë ky faktor nuk ka arritur të jetë më i madh se një, arritje e cila do të bënte që detyrimi i X kompanie ndaj buxhetit të shtetit të ishte 500 milionë dollarë.

Vetë problematika që marrëveshjet e nënshkruara në vitet e mëparshme, rishikimi i këtyre marrëveshjeve, kushtet dhe kondicionet që janë vendosur në këto marrëveshje, ndërmjet drejtuesve të AKBN-së apo të ALBPETROL-it e të ministrisë në vite e këtyre kompanive, bëjnë që ne të jemi të kufizuar në informacion. Për rezultatet e këtij auditimi, unë kam informuar me shkrim Presidentin e Republikës, Kryetarin e Këshillit të Ministrave, natyrisht ministrin e Ekonomisë, Industrisë dhe Energjetikës, që është ministër përgjegjës, kryetarin e Komisionit të Ekonomisë dhe disa zyrtarë të tjerë të lartë. Gjithashtu, gjithë këtë dosje e kam dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme, për të hetuar veprimet dhe mosveprimet, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi drejtuesit aktualë dhe drejtuesit e mëparshëm, si dhe i

kam propozuar ministrit aktual që të shkarkojë të tre drejtuesit aktualë të Hidrokarbureve.

Në këto kushte, mendoj se deklarimet e mia duhet të jenë të kujdesshme. Po, është e vërtetë, ky dëm është. Është një gjë: në rast se ne nuk do të ishim penguar në punën tonë, ky dëm ekonomik i zbuluar do të ishte trajtuar me të dhënat tona të vitit 2014.

Unë jam i gatshëm, në rast se ju kërkoni një seancë të mbyllur ku të vazhdoj t'i paraqes ato. Nuk mund të gaboj në këto momente dhe të përmend emra të kompanive, sepse nuk do të ishte serioze nga ana ime.

Erion Braçe – Pa asnjë lloj diskutimi, ne nuk duam të prishet hetimi penal lidhur me këtë çështje. Nisur nga pyetja që bëri zoti Koçi, dua të jem i qartë, në tabelën që kemi përpara për vitin 2015, shifra prej 11,7 miliardë lekësh të reja dëm nga Tatim-Taksat i referohet këtij raporti?

Bujar Leskaj – Po, këtij raporti, pasi aty është evidentuar pjesa më e madhe, sepse ishte detyrim që këto kompani duhet ta paguanin.

Erion Braçe – Jam shumë i qartë.

Bujar Leskaj – Përjashtimi pa të drejtë nga TVSH-ja në masën 316 milionë lekë dhe pjesa tjetër te faktori "R". Po e theksoj këtë, pasi në fakt kam dërguar edhe një raport të vitit të kaluar, kemi bërë një auditim në Albpetrol, ku me koshiencë të plotë...

Erion Braçe – Po, te dëmi i shkaktuar gjatë vitit 2014.

Bujar Leskaj – Unë me koshiencë të plotë, në kallëzimin penal, ka qenë i vetmi rast që i kam paditur si grup i strukturuar kriminal. Hetimet i vazhdon prokuroria dhe jo

unë. Unë i qëndroj asaj që kam shkruar. Këto auditime janë në vijim dhe problemi kryesor, është që këto gropa, kjo situatë në këtë sektor, ky mosrakordim apo thënë ndryshe çorganizim i organizuar që e përdorim shpesh ne shqiptarët shtyn në këtë evazion kaq të lartë dhe në këto dëme ekonomike. Në rekomandimet kryesore ato janë po aq të rëndësishme sa konstatimi që bëjmë, apo sa gjetja që bëjmë. Me një ligj të ri kjo agjenci të kalojë në varësi të drejtpërdrejtë të Kryeministrit ose të jetë agjenci e zgjedhur nga Kuvendi.

Te ligji i ri të rifutet, riorganizohet dhe ristrukturohet Instituti Shkencor i Naftës. Kjo është pasuri e qindra dhe mijëra punëtorëve që kanë punuar në Patos, Kuçovë, Vlorë dhe Gorisht. Të ringrihet ky institut që t'i shikojmë më mirë këto gjëra.

Kam rekomanduar që të shihen problemet e largimeve të punësimeve në kompaninë "Albpetrol" në vite, nuk bëhet fjalë për 1-2 vjet, siç duan ta personalizojnë. Ne vazhdojmë auditimet dhe në këto tre vjet në këtë sektor nga viti në vit e kemi rritur cilësinë tonë të auditimeve. Nga këta drejtues të papërgjegjshëm ne jemi penguar prej më se një viti, për të mos thënë pjesën tjetër sesi reagojnë ndaj raportit tonë, gjë që nuk më shqetëson.

Unë ju falënderoj ju që e ngritët këtë pyetje, se ai material që unë u kam dërguar drejtuesve më të lartë të shtetit, duhet të bëhet objekt studimi dhe pune. Kjo nuk mund të lihet në dëshirën e një ministri. Ideja është që, analiza e kësaj gjendjeje nuk mund të lihet në dëshirën apo vullnetin e ministrit, cilido qoftë ai.

Për sa i përket problemit të mosarkëtimi të garancisë së kompanisë "Vetro", dua të them se është një sektor strategjik dhe ne e kemi evidentuar, në mos gaboj në vitin 2013 si dëm ekonomik, mospagimin e kësaj garancie dhe kemi lënë detyrat përkatëse.

Në këto momente jemi duke auditur edhe te MEI edhe tek Avokati i Shtetit që kanë edhe detyrat kryesore, të cilat janë lënë nga KLSH-ja për të kërkuar arkëtimin e këtij detyrimi. Nga rezultatet e auditimit do të shikojmë dhe mund ta përcjellim edhe në prokurori me emra konkretë për veprime apo mosveprime. Auditimi është në proces dhe unë nuk mund të shprehem. Përderisa nuk ka ecje në këtë drejtim, kjo tregon për një mosveprim. Ne theksojmë se nuk e kemi nxjerrë, nuk kemi si ta nxjerrim si shifër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ajo nuk është arkëtuar dhe për sa kohë nuk do të arkëtohet, çdo vit në raportet e KLSH-së do të dalë që ajo nuk është arkëtuar. Personat përgjegjës edhe ata të asaj kohe, edhe këta tani, duhet të mbajnë përgjegjësi. Ne jemi marrë gjithmonë dhe merremi. Mos e keni për institucione të tjera. Unë jam përpjekur dhe besoj se ky auditim që kemi bërë edhe para dy vjetësh ka qenë serioz në nxjerrjen dhe konfirmimin e këtij dëmi në insistimin për t'u paguar dhe do të vazhdojmë ta kërkojmë këtë gjë.

Pyetja tjetër që kishit ju ishte auditimi i institucioneve kushtetuese, dua të them se ne zhvillojmë auditimin e tyre, auditimin financiar ose auditim përputhshmërie. Në rast se ju e kërkoni që ta vendosim si kolanë, rubrikë të veçantë auditimin e institucioneve kushtetuese, e vendosim. Vetë fondet që kanë këto institucione kushtetuese si: Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme dhe Avokati i Popullit janë më tepër fonde të natyrës së shpenzimeve operative. Shpenzimet e tjera për investime, me thënë të drejtën, në të gjitha këto institucione kanë qenë të pakta. Përgjithësisht, ka rezultuar një rregullsi në këto institucione, ose ndoshta nuk e kuptova pyetjen. Nuk janë këto subjekte me shkallë të lartë materialiteti që mund të zbulojmë, por kemi në planin vjetor, sepse ecim me planin vjetor të vitit, një auditim që do ta zhvillojmë, për shembull te KQZ-

ja në muajin shtator apo tetor, ashtu siç kemi audituar Avokatin e Popullit, Prokurorinë e Përgjithshme, gjykatat, të gjitha institucionet dhe më saktë nuk kemi konstatuar shkelje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ervin Koçi – Më falni për ndërhyrjen!

Edhe institucionet e krijuara me ligj, jo vetëm ato kushtetuese, pra që mund të kenë aktivitet financiar, duke qenë shumë të rëndësishme, sepse ne diskutojmë pavarësinë e institucioneve, por shikojmë dhe si administrohen, mendoj të ishin në një kapitull të veçantë, pasi edhe ne krijojmë një ide jo vetëm për aktivitetin ligjor të tyre, por edhe për miradministrimin e financave publike.

Bujar Leskaj – Po, ne do t'i auditojmë, kemi një auditim shumë të rëndësishëm pas disa keqkuptimeve në Agjencinë e Prokurimeve Publike. Do ta vazhdojmë këtë auditim. Kryetarin para dy-tri vjetëve e kemi përcjellë në prokurori për shkelje.

Po e mbaj shënim këtë. Do të plotësojmë programin tonë të këtij viti, por edhe për vitin e kaluar. Mund të bëjmë edhe një auditim të përgjithshëm.

Erion Braçe – Faleminderit! Po, zoti Mima.

Florion Mima – Faleminderit!

Zoti Leskaj, unë kam vetëm një pyetje, por nëse më lejoni dua ta nis me një konsideratë, pasi u njohëm me të gjitha produktet që ju keni vënë sot në dispozicion të komisionit, kam bindjen dhe besoj se ndaj të njëjtën bindje edhe me kolegët se sot secili nga ne me gojën plotë mund të thotë se kemi një institucion auditi modern dhe perëndimor. Ju dhe ekipi juaj duhet të ndiheni krenarë për transformimin rrënjësor që i keni bërë një trupi që dikur merrej vetëm me kontroll-

revizione të tipit sovjetik, tashmë është një ent i jashtëm i kontrollit të parave publike dinjitoz dhe perëndimor.

Ka pak muaj që ka hyrë në fuqi ligji i ri, ndoshta është shpejt që e bëj këtë pyetje, por si një makineri që sapo vihet në prizë fillon dhe tregon se ku janë valvulat që kanë defekte, ingranazhet që nuk punojnë mirë, a keni vënë re ndonjë fushë që nuk është shkruar siç duhet, që mund të ishte rishkruar më mirë, që duhet të rishkruhet nga e para?

Faleminderit!

Erion Braçe – Urdhëroni, zoti Leskaj!

Bujar Leskaj – Së pari, ju falënderoj për vlerësimin, pasi edhe ne si njerëz prej mishi dhe prej gjaku kemi nevojë për vlerësime pozitive!

Asnjëherë nuk kam menduar, sidomos kur flas në Komisionin e Ekonomisë të bëj falënderime me hipokrizi, dëshiroj sinqerisht t'ju falënderoj!

Për ligjin e ri, jemi të ndërgjegjshëm se kaloi përmes vështirësive dhe po të hapim atë kapitull, unë personalisht e ndjej për ofezë, se është tentuar, u ka kaluar nëpër mendje segmenteve të caktuara të më bëjnë dhe presione, por falë mbështetjes suaj, të kryetarit të Komisionit, këtë e them me plotë gojën, të gjithëve ju deputetët e pozitës dhe të opozitës, ky ligj, siç e thatë shumë mirë, mund të ketë gjëra që duhet të ndërhyjmë, por të jem i sinqertë me ju, tani që ligji kaloi, pas tensioneve, jam kaq i lodhur. Ne u tërhoqëm te certifikimi i audituesve të jashtëm publikë.

Unë u tërhoqa me koshiencë pas diskutimeve me kryetarin, me sekretarin dhe me ju të gjithë, e përsëris falënderimin, por ai ishte i nevojshëm. Problemi është të ndërtosh një sistem modern. Sistemi modern i auditimit publik në Shqipëri ka dy shtylla kryesore: auditimin e brendshëm dhe atë të jashtëm. Ne kemi certifikim të

audituesve të brendshëm në sektorin publik dhe nuk kemi në këtë tjetrin. Për të mos e dramatizuar, ndoshta ishte edhe problem xhelozie për mua personalisht, por nuk shqetësohem. Për fat, me kryetarin kemi vënë një fjalë, dhe procesin e certifikimi, që unë po përpiqem dhe po e ushtroj një trysni pozitive drejt audituesve për të konsoliduar edukimin e vazhdueshëm profesional, për të vazhduar me trajnime dhe me testime.

Unë jam i hapur, nëse ju e keni atë vullnet, ajo është pjesë shumë modeste, në raport me ligjin që kaloi, që ta rishikojmë, por kryesorja për mua është që të gjithë, unë kërkoj mirëkuptimin dhe solidaritetin tuaj që nuk më ka munguar, të punojmë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së. Ne do t'i ruajmë parimet standarde të auditimit të jashtëm publik, por duhet të intensifikojmë kërkesën e llogarisë për zbatimin e tyre.

Unë e theksova edhe tek analiza, personalisht ndihem i qetë dhe i sigurt nga të gjitha pikëpamjet, por edhe i mbështetur nga ju. Në rast se do të intensifikojmë dhe jo më kot nga gjithë moria e thënieve unë zgjodha atë të Dodaros: "Në rast se do të arrijmë të bëjmë 20% të asaj që të ndërtojmë ato raporte kontakti, informimi do të jetë shumë më ndryshme". Duhet të heqim dorë nga politizimet.

Unë i kuptoj të gjitha pyetjet dhe i përkthej shumë mirë në çfarëdolloj gjuhe të bëhen, por detyra ime kryesore është të vazhdoj dhe sfida kryesore është që të konsolidohet si një institucion modern auditimi, por që ky institucion të jetë i depolitizuar dhe i departizuar. Asnjëherë nuk mund të jenë qëndrimet e mija me qëndrimet tuaja, si forca politike, kam parasysh të katër- pesë krahët politike.

Erion Braçe – Faleminderit, zoti Leskaj!

Zonja Kushi e ka fjalën.

Evis Kushi – Faleminderit, zoti kryetar!

Kam dy pyetje, por për procedurë do t'i lutesha shumë kryetarit të KLSH-së të jetë pak më konciz në përgjigjet e veta, në mënyrë që t'u japim mundësi të gjithë kolegëve të bëjnë pyetje dhe të marrin përgjigje.

Unë i vlerësoj shumë përgjigjet tuaja, por ju lutem, pak më konciz!

Pyetja e parë lidhet me privatizimet e bëra në Shqipëri gjatë 20 vjetëve të fundit. Në një nga rekomandimet e relatorit theksohet që KLSH-ja duhet të bëjë një vlerësim të plotë të performancës për të gjitha privatizimet që janë bërë në Shqipëri në 20 vjetët e fundit në të gjitha fushat si: në energji, në telekomunikacion, në bujqësi e kështu me radhë. Qëllimi është të evidentohen problematikat, rastet e dështimit dhe dëmet që i janë shkaktuar buxhetit të shtetit. Si e vlerësoni ju këtë rekomandim? A do ta merrni në konsideratë në punën tuaj në vazhdim?

Pyetja e dytë lidhet me auditimet që ka realizuar KLSH-ja jashtë programit vjetor të miratuar. Gjatë vitit 2014 a janë kryer auditime jashtë programit? Ku bazohen ato? Cilat janë kriteret, sepse nuk janë paraqitur në raport?

Ligji e lejon këtë gjë, në nenin 25, te përgjegjësitë e kryetarit. Përveç planit vjetor të miratuar, kryetari ka të drejtë të autorizojë edhe auditime jashtë këtij programi, por desha të di, nëse kjo lejon hapësira për abuzime apo jo?

Erion Braçe – Po, zoti Leskaj.

Bujar Leskaj – Si do të pyesësh, edhe do të përgjigjesh. Ju bëtë pyetje të vështira dhe kërkoni të jem konciz. Në rast se doni të jem konciz, po them një fjali. Unë flas dhe ngadalë. Them një fjali dhe e mbyllim këtu. Problemi është që ajo detyrë që ju do të na lini mendoj se është shumë e vështirë. T'i kërkosh KLSH-së të bëjë auditimin e privatizimeve të 20 vjetëve të fundit, të paktën ju si Kuvend, duhet të

shtoni 40 auditues në KLSH. Në rast se do të shtoni 40 auditues, të cilët unë jam gati që t'i zgjidhni ju, ne mund ta realizojmë këtë detyrë. Në rast se ju do ta lini si detyrë, ne do të përpiqemi, por është shumë e vështirë. Në rast se do të përqendrohemi te performanca e këtyre privatizimeve, ne mund të zhvillojmë një auditim të tillë.

Ju besoj se e njihni po aq mirë sa edhe unë, një figurë interesante të ekonomisë dhe të tregut të lirë Milton Friedman. Ai ka botuar një vepër: "Kapitalizmi dhe liria", botimin e parë mund ta ketë rreth viteve 1950-1960 dhe e ka ribotuar 10-15 herë. Është një libër që i ka rezistuar kohës prej 50 vjetësh, gjysmë shekulli, jo më kot mbahet si dekan i ekonomisë së tregut të lirë. Në vitet 1990 M. Fridman shkruante: "Këshilla ime për vendet ish-socialiste që u kthyen në demokracinë e lirë dhe në ekonominë e tregut ishte: privatizoni, privatizoni dhe privatizoni". Në parathënien e vitit 2006, në mos gaboj dhe nuk besoj se mbaj përgjegjësi nëse lëviza te viti, shkruante: "Në vitin 1990 unë dhashë këtë këshillë, i orientuar drejt ekonomisë së tregut të lirë. Doli që këshilla ime ishte gabim. Këshilla më e mirë do të ishte të ndërtoni shtetin ligjor, pastaj të privatizoni". Ky është një mësim, aq më tepër kur e thotë M. Friedman. Pra, në rast se do të auditojmë privatizimet e 20 vjetëve në Shqipëri, unë nuk mund ta mbaj këtë përgjegjësi. Në rast se ju si Kuvend do të gjykoni thellë dhe nëse do ta orientoni, do të jepni dhe resurset shtesë, unë do ta mbaj mbi kurriz. Ne jemi dështmitarë të shumë privatizimeve të korruptuara. Ne jemi dështmitarë të shumë koncesioneve të gabuara, të shumë koncesioneve abuzive, ju i denonconi më mirë sesa unë.

Unë kam detyrën që në këtë vend dhe në pozicionin që jam të jem i kufizuar në fjalë. Duket sikur them shumë, por në thelb flas pak. Përpiqem të jem i kujdesshëm dhe për median për mesazhet që mund të jap.

Në rast se ju për pyetjen e dytë do të më jepni në këto tri vjet e gjysmë që drejtoj KLSH- në më shumë se gishtat e një dore auditime me tendencë jashtë planit,

atëherë jam gati të merrni çdo masë që mendoni. Asnjëherë nuk ka qenë në filozofinë e punës sime. Pse? Filozofia e punës sime ishte të orientoj një institucion auditimi dhe jo inspektimi. Në tërësi këtë nuk mund ta zerosh. E shumëzon me zero. Normal që është e drejtë e ligjit dhe ne jemi treguar të kujdesshëm. Unë madje, ndoshta dhe ju mund të më falënderoni, por mos i ka lënë për në fund kryetari, periudhën e fushatës zgjedhore ne si KLSH me vendimin tim, të Kryetarit të KLSH-së nuk kemi nxjerrë asnjë njoftim. Domethënë nuk interferuam në fushatë. Janë dy fushata zgjedhore që ne po mbajmë këtë qëndrim, se bëhet ndonjë paragjykim që mund të ishte për mua personalisht. Domethënë është marrë vendim zyrtar pasi ne mund të dëmtonim njësi të caktuara vendore apo kandidat të caktuar. Janë me raste shumë të pakta që nuk meritojnë vëmendje.

Erion Braçe – Po, zonja Gjylameti.

Blerina Gjylameti – Faleminderit!

Duke e falënderuar Kryetarin e KLSH-së dhe për mënyrën për të qenë sa më konciz, meqenëse një nga qëllimet kryesore të KLSH-së, sidomos të viteve të fundit ka qenë dhe rritja e numrit të auditimeve të performancës duke synuar që të vlerësohen nëse programet, organizimi apo shpenzimet publike janë duke ndjekur parimet e ekonomicitetit, efektivitetit dhe eficiencës, unë dua të di nëse këto auditime kanë arritur të realizojnë qëllimin e tyre apo ndikimin e tyre në uljen e korrupsionit apo dëmit që i shkaktohet buxhetit të shtetit. Nga ana tjetër cili ka qenë reagimi i drejtuesve të institucioneve lidhur me këto auditime dhe a ka pasur mirëkuptim, meqenëse shpeshherë, sipas raportit që ju keni dërguar, thuhet që nuk kanë arritur të kuptojnë realisht se cili është qëllimi i tyre.

Pjesa tjetër që dua të shtoj te pyetja ime është: Duke iu bashkangjitur pyetjes së zotit Koçi te pjesa e dëmit ekonomik sipas fushave përkatëse kur ju folët mbi pjesën

e tatim-taksave, doganat, dëmi në Albpetrol, shoh tek tabela që keni sjellë në raport një ndryshim. Unë dua që të ma shpjegoni pak më mirë. Në vitin 2014 dëmi nga Albpetrol është 5 miliardë e 186 milionë e 275, ndërkohë në 6-mujorin e parë të vitit 2015 nuk ka një shifër përkatëse.

Dhe nga ana tjetër, zërat kanë një ndryshim relativisht të madh. Çfarë ka ndryshuar?

Faleminderit!

Bujar Leskaj – Po e filloj nga kjo e fundit. Nuk ka shifër për Albpetrolin te 6-mujori i parë i 2015-s për arsye se nuk kemi audituar në Albpetrol. Në këto momente jemi duke audituar. Ka shifra për atë auditim që ne zhvilluam në agjenci kombëtare të burimeve natyrore. Ne auditojmë në AKBN dhe del që është evazion fiskal apo është dëm i shkaktuar si rrjedhojë e evazionit fiskal, e vendosim në atë kolonë. Albpetrolin jemi duke e audituar dhe prandaj kemi ato shifra vetëm të auditimit të

2014-s. Paraqitja që i bëra unë në grafik 2014-s dhe disa me 6-mujorin e parë të 2015-s është për ta bërë më atraktiv për publikun, qytetarët, taksapaguesit shqiptarë. Pse? Në fakt unë mendoj që ne këtu duhet të vijmë në muajin mars ose në muajin prill. Pra, që të jemi afër vitit. Duke ardhur në korrik ishte fati i mirë në kuptimin që ju e vendosët datën 15 korrik që mua m'u krijua mundësia, kemi punuar intensivisht, që vendosëm të dhënat e 6-mujorit.

(Flet një deputete pa mikrofon.)

Bujar Leskaj – Ne rekomandimet që bëjmë kuptohet i përcjellim te subjekti i audituar dhe te subjekte që lidhen drejtpërdrejt me eprorët e tij apo subjekte të lidhura. Në rastin konkret, por dhe në përgjithësi atje ku ne konstatojmë që është problematikë e lidhur me drejtorinë e tatim-taksave, përcjellim dhe raportin dhe

rekomandimet tona. Ne përpiqemi të mos ndërhyjmë në punët e këtyre institucioneve. Për këtë gjë ne kemi informuar edhe ministrin e Financave. Kuptohet ministri i MEI- t është anëtar i kabinetit, si dhe drejtoresha e Përgjithshme të Tatimeve, dhe është detyra e tyre. Unë ua theksova në rast se më keni dëgjuar me vëmendje. Ne te ligji i ri kemi vendosur edhe një gjë, që pas 6 muajsh shikohet ecuria e këtyre. Unë pas 6 muajsh që jam i vendosur që në këto auditime të rëndësishme me vlera të konsiderueshme, me gjetjen për ata drejtues që nuk kanë marrë masa do të bëj propozimet e mia. Mendojmë që pas atij bllokimi bashkëpunimi do të vazhdojë normalisht dhe me këtë institucion. Nuk kam asnjë gjë personale. Pengesa që ata i bënë nga tetori i vitit 2013 që vendimi i Gjykatës së Apelit ishte në favorin tonë derisa ne kaluam ligjin e ri, është pengesë në kundërshtim me ligjin, por ndoshta aq e kuptonin. Se vendimi i Gjykatës së Apelit ishte i formës së prerë.

Për sa u përket auditimeve të performancës. Reagimi i drejtorive. Auditimi i performancës, si çdo gjë e re në Shqipëri, kuptohet pritet me një farë skepticizmi. Ne jemi përpjekur te këto auditime të ruajmë këtë kornizën që çfarë nuk është bërë mirë, çfarë duhej bërë më mirë, por po ruajmë mbi të gjitha atë që në fund të këtyre auditimeve ne nuk bëjmë kallëzime penale për të ndërtuar një partneritet të drejtë me subjektin që auditojmë. Ka subjekte që janë shumë dashamirës, i mirëkuptojnë rekomandimet tona dhe u vlejnë në punën e tyre. Madje dhe e shfaqin dhe e shprehin. Ashtu sikundër ka subjekte që dhe nuk i kuptojnë. Ndrec Ndue Gjoka bëri kurse kundër analfabetizmit. Ka dhe drejtues të lartë. Një sekretar i Përgjithshëm i një ministrie na dërgoi një herë një shkresë dhe argumentonte që ne si KLSH nuk kemi të drejtë të auditojmë prokurimet publike. Të mendosh që kjo shkresë ka ardhur në vitin 2015! Apo ka drejtues që nuk e njohin ligjin e KLSH-së. Në këtë drejtim ndoshta dhe ne të gjithë kemi shumë për të bërë.

Por ne përgjithësisht gjejmë mirëkuptim te këto auditime. Dhe ekipin e kemi ndërtuar të tillë dhe jemi të orientuar drejt mirëkuptimit. Në auditimet e performancës ne fusim ekspertë të jashtëm. Presim shumë dhe kontributet tuaja personale, mund të na orientoni. Ne po përgatisim kështu në planin për 2016. Ky do të jetë auditimi i performancës mendoj unë që do t'i japë fytyrën qytetare dhe moderne KLSH-së. Janë shumë gjëra që në rast se auditimi i brendshëm do të ishte shumë i rregullt, do të ishte strikt do të ishte profesional ne mund të mos merreshim dhe madje unë e kam vënë në shumë raste. Ne njohim gjetjet e auditimit të brendshëm. Jo se i certifikojmë, por njohim dhe vlerësojmë punën e atyre, por kemi shumë për të bërë. Ka drejtues që tregojnë mirëkuptim, ka dhe drejtues që tregojnë indiferencë. Natyrisht në këto auditime, pavarësisht mënyrës se si i trajtojmë ne, ka interesa që persona të caktuar dhe i shpërdorojnë dhe nuk dëshirojnë t'i marrin ato rekomandimet tona. Detyra jonë është t'i përsërisim.

Ne, shumë shpejt, në përfundim të muajit korrik ose në shtator, kur ju të vini, do t'ju sjellim dhe një material të plotë të auditimeve të performancës që ne kemi bërë në këto 3 vjet, rekomandime që ne kemi dhënë. Ndoshta do të bëjnë dhe një përmbledhje ato që nuk janë zbatuar. Natyrisht dhe në respekt të këtyre gazetarëve që normalisht u urtësuan pas kryetarit, se urtësohemi ne jo këta. Megjithëse kryetari nuk bën presione për punën, se është demokrat.

Ne kemi bërë një auditim shumë të mirë për librin. Një nga rekomandimet e atij auditimi ka shumë gjëra të përditshme, por një nga rekomandimet e atij është që të dyja ministritë përgjegjëse dhe Ministria e Kulturës dhe Ministria e Ekonomisë të marrin të gjitha masat, të gjitha procedurat që të gjitha ambientet në ndërtesën e Bibliotekës Kombëtare dhe Teatrit të Operës dhe Baletit të vihen në funksion të librit dhe të Teatrit të Operës dhe Baletit. Po të shikoni kur kaloni, si ju që jeni deputetë, si ne që jemi në këto pozicione dhe qytetari i thjeshtë, e kupton. Po mirë iku viti 1992, viti 1994, viti 1997, viti 2000, por dhe tani të mos kthehen? Ka shqiptar

që ta arsyetojë atë që është e nevojshme të ketë klube te Pallati i Kulturës? Jo. Ka intelektual këtu në Tiranë, që është zemra e Shqipërisë, që nuk e kupton që këto ambiente duhet të vihen në funksion të Bibliotekës Kombëtare? Jo. Ka njeri që është marrë me librin, merret me politikën, me shoqërinë, që nuk e di që Biblioteka Kombëtare ka nevojë për ambiente? Jo. Këto natyrisht janë problem i atyre që ne japim rekomandime dhe sa do të insistojmë ne. Edhe ne si institucion suprem auditimi duhet të ruajmë një kufi. Në të gjithë pozicionin tonë, unë e theksoj këtë, ne jemi midis Shilës dhe Karibdës si institucion dhe ne gremë problematika, ne prekim plagë të shoqërisë. Natyrisht që duhet të bëjmë më shumë, por nuk duhet të kalojmë atë kufirin e masës. Kufiri i masës është një kufi normal që e vë drejtuesi. Ai thotë se do të zbatojë ligjin. Ato që kanë kompetenca ligjore më tej se ligji...

Erion Braçe – Po.

Andrea Marto – Faleminderit!

Falënderoj Kryetarin e KLSH-së për sqarimin që u bëri kolegëve këtu. Unë kam një pyetje të thjeshtë. A keni ndonjë vlerësim mbi zbatueshmërinë e rekomandimeve për vitin 2014, se 6-mujori sapo u mbyll. Sa nga këto rekomandime që keni bërë, janë marrë parasysh?

Bujar Leskaj – Në të gjitha pasqyrat, po të shikoni te masat organizative, masat disiplinore, përmirësim legjislacioni, shpërblim dëmi ne grafikun përkatës e keni. Nuk e di ndoshta i kaloni dhe një herë, kemi grafikun rekomandimet e dhëna nga ne dhe sa janë zbatuar. Dhe unë prandaj e theksova, për të mos u lodhur. Në rast se ne kemi në masën 60% deri në 70% zbatim –rekomandime për masa disiplinore, kemi treguesin e ulët, largim nga detyra për drejtuesit e lartë. Përgjithësisht ky tregues është. Si tregues nuk është se është dobët. Në të gjitha ato tabelat, nuk e di keni këtë të performancës, këtë si libër të vogël që kemi. Për shembull në faqen 32 po të

shikojmë masat disiplinore për vitin 2014, janë masat disiplinore të rekomanduara 2943, masat disiplinore të zbatuara 2021. Zbatimi i masave administrative dhe disiplinore në përqindje. Ky është një grafik tjetër. Tabela në faqen 30. Po ju lexoj: "Vërejtje me shkrim, përqindja e zbatimit 67,6%. Vërejtje me paralajmërim 86%. Pezullim ngritjeje në detyrë - vizë. Kalim në një nivel më të ulët, 31% Këtu ka një gabim. Duhet të jetë 9. Largim nga shërbimi civil, 58,3%, largim nga detyra, 23%, largim nga puna, 50,8%. Në kompetencë të institucionit që kemi filluar me 22%. Masa administrative, gjoba, 71%. Në kompetencë të Agjencisë së Prokurimit Publik gjoba është 54,5%.

Pra, po t'i shikosh këta tregues dhe simotrat tona në rajon apo dhe sa jetë moderne, kuptohet ato në vendet më të konsoliduara lëvizin nga 70% deri në 80%. Duhet të më mirëkuptoni për një gjë, që arritja e këtyre treguesve kërkon punë pa fund të audituesve. Meqenëse ju më falënderuat, në fakt përfitoj dhe unë nga ky rast kryetar të falënderoj audituesit e KLSH-së të vjetër dhe të rinj.

Të bëj një sqarim? Në mos gaboj te kjo që tha deputeti Koçi, ai ishte vlerësimi i punës sonë. Ne kodin e ri të etikës e kemi përgatitur, se aty del sikur nuk është përgatitur.

Dhe e dyta, në raportet tona ka evidencë të kallëzimeve penale në masën mbi 99% . Kallëzimet tona penale janë regjistruar. Te informacioni, plani i veprimit të zbatimit të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, të qershorit të vitit 2014 ne kemi dhënë dhe shpjegimet përkatëse. Të gjitha çështjet tona janë në hetim. Madje kur çështje të caktuara kthehen, pushohen, ne kemi gjetur mbështetjen e prokurorit të Përgjithshëm që rihap hetimet dhe drejtoria e hetimit në prokurori. Tregues të tjerë nuk kemi, por çështjet janë në hetim edhe te informacioni që kemi bërë për performancën e vitit 2014 kjo është. Një saktësim ndoshta. Unë nuk e kam dëgjuar mirë kur e kam mbajtur shënim.

Faleminderit!

Ervin Koci – ... të kodit të etikës ka qenë në proces e keni mbaruar shumë mirë, por më shumë e kisha marrëdhënien me prokurorinë për shkak sepse çdo ditë nuk dilni të paktën në media dhe deklaroni për persona që keni çuar për ndjekje penale, për shkelje të ligjshmërisë. Problemi është që deri tani nuk kemi parë nga prokuroria të dënohet qoftë dhe një person. Ne duam si Kuvend, kur të vijë raporti, të kemi një evidencë të qartë. Kemi çuar 30 çështje në prokurori. Nga 30 çështje janë hapur 30. Nga 30, 5 çështje janë pushuar, 25 janë në gjykim. Në mënyrë që dhe ne të dimë si janë marrëdhëniet institucionale. Kuvendi prandaj është që të ndërhyjë dhe në këto marrëdhënie që të zbatohet sa më mirë ligji. Njëkohësisht ajo punë që bëni ju të ketë efektin e duhur në administrimin e buxhetit të shtetit.

Erion Braçe – Ka opinione të tjera? Jo.

Zoti Leskaj faleminderit për raportimin tuaj pranë këtij komisioni dhe për komunikimin e vazhdueshëm pothuajse gjatë gjithë vitit qoftë për detyrat të vendosura nga Kuvendi për realizimin e tyre, qoftë dhe për informacionin që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me punën, veprimtarinë e KLSH-së në proces.

Dua të falënderoj, gjithashtu, edhe të gjithë kolegët që morën pjesë jo vetëm në bërjen e pyetjeve, por dhe në komente të tjera shtesë lidhur me gjithë sa u relatua këtu sot.

Ndërkohë komisioni do të përgatisë rezolutën përkatëse dhe vlerësimin e punës së KLSH-së, një draft paraprak të së cilës do t'jua dërgojmë dhe juve për të rakorduar deri në fund dhe këto mosrakordime, siç është për shembull çështja e kodit të etikës apo dhe ndonjë detyrë që kolegët deputetë e mendojnë se duhet të jetë pjesë e punës në bazë të ligjit të ri të KLSH-së dhe që duhet programuar brenda atyre burimeve të kufizuara që KLSH-ja vetëm ka. Fjala bie në referencë të asaj që

zoti Koçi kërkoi pak më herët, që ka të bëjë me privatizimet, mund të kufizohemi thjesht dhe vetëm te privatizimi strategjik në këtë vend dhe jo te çdo magazinë e privatizuar apo objekte të tjera. Është me radhë ashtu siç mundet që të kufizohemi thjesht dhe vetëm tek ato koncesione që kanë impakt të ndjeshëm të shërbimit publik përkundrejt qytetarëve, sepse ka ndodhur që edhe shërbimet publike në këtë vend të jenë dhënë me koncesion, madje dhe me kosto të cilat konsiderohen relativisht të larta. Kjo është një çështje në diskutim, të cilën mund ta kemi në proces gjatë vitit apo gjatë vitit të ardhshëm.

Ndërkohë duhet të bëni gati projektbuxhetin e KLSH-së ku të përfshini dhe nevojat tuaja për t'u bërë sa më funksionale jo vetëm institucionin, por për të bërë edhe sa më eficiente shërbimet që KLSH-ja duhet të ushtrojë gjatë vitit në funksion dhe të ligjit të ri për KLSH-në. Do të ishte mirë që në shtator të kemi një draft paraprak të buxhetit të vetë KLSH-së me qëllim që t'i paraprijmë të gjitha veprimeve të tjera buxhetore në funksion të ligjit për KLSH-në dhe të garancive maksimale për funksionimin dhe zbatimin në mënyrë të pavarur të buxhetit të shtetit dhe të KLSH-së në kuadër të buxhetit të shtetit për vitin 2016.

Relatori merr detyrën për të bërë gati draft-rezolutën, e cila natyrisht nuk ju prezantohet juve dhe komisionit javën tjetër dhe pastaj t'ia paraqesim dhe Kuvendit të Shqipërisë për miratim.

Faleminderit!

Seanca mbyllet.

MBYLLET MBLEDHJA

Shënim: Materiali është renditur sipas Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit për Ekonominë dhe Financat, të datës 15/07/2015.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROJEKTREZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT PËR VITIN 2014

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke njohur dhe vlerësuar rolin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, si institucioni kushtetues i pavarur i kontrollit të jashtëm, që përgjigjet për menaxhimin me kujdes të fondeve publike, pronës publike dhe shtetërore, në përputhje kuadrin ligjor në fuqi dhe praktikat më të mira të BE-së e standarteve ndërkombëtare INTOSAI;

- Duke nënvizuar rëndësinë funksionimit të këtij institucioni mbi bazë të garantimit të parimeve të pavarësisë, integritetit, objektivitetit, përgjegjshmërisë, interesit të publikut, profesionalizmit, bashkëpunimit dhe transparencës;

- Duke mbështetur dhe nxitur Kontrollin e Lartë të Shtetit për të punuar dhe kontribuar për një qeverisje të mirë, nëpërmjet parandalimit dhe luftës pa kompromis kundër korrupsionit dhe abuzimeve në administrimin e pronës publike,

rritjes së besimit të publikut dhe nxitjes së përdorimit me ekonomi, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike;

- Duke pranuar se përmbushja e prioriteteve dhe objektivave të procesit të integrimit në Bashkimin Europian, kërkojnë standarde edhe më të larta dhe rezultate më të qëndrueshme e në rritje progresive edhe për Kontrollin e Lartë të Shtetit;

- Duke besuar se analiza vjetore e veprimtarisë së këtij institucioni, në funksion të ushtrimit të rolit mbikëqyrës të Kuvendit, i shërben vlerësimit të arritjeve dhe evidentimit të mangësive, me qëllim përcaktimin e objektivave të qarta për të ardhmen, në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të KLSH-së;

- Duke vlerësuar Planin e Masave të hartuar nga KLSH në zbatim të rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Qershorit 2014,

Pas analizës, shqyrtimit dhe diskutimit të Raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, për vitin 2014, konstaton se:

- Për veprimtarinë audituese, ka planifikuar dhe realizuar një numër më të lartë auditimesh, krahasuar me vitin 2013.

- Shuma totale e dëmit efektiv të përgjithshëm të zbuluar për parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet është 11 198 404 000 lekë.

- Rekomandimet e bëra nga KLSH për zhdëmtimin e dëmit të shkaktuar janë në masën 98.9% të tij.

- Indikatori i dobisë së rezultateve të auditimit, për vitin 2014 rezulton të jetë: për çdo një lek të shpenzuar nga buxheti i shtetit, nga ana e KLSH-së janë kërkuar për t'u zhdëmtuar 38 lekë, shifër kjo më e lartë se në vitet 2012, 2013.

- Ka një rritje të ndjeshme të auditimeve të ligjshmërisë dhe rritje e auditimeve të performancës, krahasuar me vitin 2013.

- Lidhur me rekomandimet, në vitin 2014 indikatori i propozimit të rekomandimeve është më i madh në të gjitha llojet e tyre, duke reflektuar në total 882 rekomandime më shumë se viti 2013.

- Indikatori i performancës në lidhje me zbatimin e rekomandimeve për vitin 2014 ka një trend në rritje për të gjitha kategoritë e rekomandimeve.

- Vijon të përbëjë problematikë për zgjidhje shkalla e zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna.

- Lidhur me kallëzimet penale, në kuadër të luftës ndaj korrupsionit dhe shfaqjeve që rrezikojnë standardet e qeverisjes, gjatë vitit 2014 ka një rritje të lehtë të numrit të çështjeve të kallëzuara (41) nga 38 në vitin 2013 dhe ka një rritje të ndjeshme të numrit të personave të kallëzuar (149) nga 94 në vitin 2013;

- Në total, dëmi ekonomik që i është shkaktuar buxhetit si pasojë e shkeljeve të trajtuara në këto kallëzime arrin në 5.069.494.000 lekë;

- Nuk jepen të dhëna për sa çështje dhe persona ka filluar procedimi penal, sa çështje janë pushuar, sa janë dërguar në gjykatë dhe sa janë dënuar.

- Lidhur me rekomandimet për masat me karakter parandalues dhe shkallën e zbatimit të tyre, masat disiplinore të propozuara: “vërejtje me shkrim” (80%) dhe vërejtje me paralajmërim” (98%) – kanë përqindjen më të lartë të zbatueshmërisë, ndërsa masat disiplinore të propozuara: “pezullim ngritje në detyrë” (17%), “kalim në një nivel më të ulët”, “largim nga shërbimi civil”, “largim nga detyra” (23%), largim nga puna” – kanë përqindje të ulët zbatueshmërie.

- Gjatë vitit 2014, KLSH ka realizuar dhe evaduar 8 auditime performance, si edhe ka iniciuar 4 auditime të reja.

- Ka ardhur duke u rritur numri i gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve për çdo auditim performance, si dhe numri i subjekteve të përfshira.

- Një risi në veprimtarinë administrative të KLSH-së përbën analiza e Vetëvlerësimit të Integritetit INTOSAINT. KLSH ka adoptuar metodologjinë e vetëvlerësimit të integritetit në Institucionet Supreme të Auditimit (INTOSAINT), e konsideruar si një metodë inovative dhe e efektshme, me impakt rritjen e pritshmërive në zhvillimin e politikave të integritetit.

- Lidhur me menaxhimin institucional, i cili përfshin ecurinë e reformës në institucion lidhur me rritjen e kapaciteteve profesionale, etike dhe të performancës së burimeve njerëzore të KLSH-së, pasqyrohen rezultatet e reformës administrative, duke përfshirë trajnimet e posaçme brenda dhe jashtë vendit të të gjithë stafit, me qëllim zhvillimin e kapaciteteve organizative dhe profesionale. Struktura e Re organizative e KLSH-së, u përshtat me objektivat strategjikë të institucionit, sipas Strategjisë së Zhvillimit 2013-2017 dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI).

- Në kuadër të rritjes së transparencës institucionale të KLSH-së, rezulton se i është kushtuar vëmendje e veçantë përmbushjes së nën-objektivit: “Rritja e ndikimit të KLSH-së përmes komunikimit dhe bashkëpunimit”. Në këtë aspekt konstatohet një veprimtari e gjerë sa i përket botimeve të KLSH-së në zbatim të standardeve profesionale INTOSAI, publikimeve informuese për raportet vjetore të institucionit, udhëzuesit e auditimeve të ndryshme etj.

- Konstatohet një shkallë e lartë bashkëpunimi i këtij institucioni me median e shkruar dhe atë vizive me qëllim informimin dhe sensibilizimin e opinionit publik për rezultatet e auditimeve të ushtruara nga KLSH dhe veprimtaritë e zhvilluara, marrëveshjet e lidhura me institucione homologe, brenda dhe jashtë vendit, me shoqatat e profesionistëve të fushës së financave dhe të auditimit, organizatat e shoqërisë civile aktive në luftën kundër korrupsionit, etj.

- KLSH, gjatë vitit 2014, ka vijuar t’i kushtojë rëndësi marrëdhënieve me partnerët ndërkombëtarë INTOSAI dhe EUROSAI. Në kuadër të projekteve IPA, KLSH fitoi projektin IPA 2013 “Forcimi i kapaciteteve të auditimit të jashtëm”. Ky projekt i

financuar nga BE, do t'i shërbejë KLSH-së, për të ecur në rrugën e modernizimit, të realizimit të auditimeve të tij në përputhje të plotë me standardet INTOSAI dhe praktikat më të mira të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian.

- Marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë, gjatë vitit 2014 në kuadër të bashkëpunimit institucional dhe ligjor kanë përfshirë punën për miratimin e Ligjit të Ri të KLSH-së, raportime dhe informacione të raporteve zyrtare për Komisionet e Kuvendit, si dhe implementimin e kërkesave të rezolutës së Kuvendit për veprimtarinë e këtij institucioni.

Për vitin 2015, Kuvendi kërkon nga Kontrolli i Lartë i Shtetit fokusimin, në mënyrë të veçantë në këto drejtime:

1. Kontrolli i Lartë i Shtetit, duhet të fokusohet në luftën kundër korrupsionit, me qëllim intensifikimin e punës audituese për të parandaluar, zbuluar dhe denoncuar aktet korruptive në publik, media, prokurori e më gjerë.
2. Në drejtim të veprimtarisë audituese, Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të vijojë me rritjen e cilësisë dhe konsolidimin e mëtejshëm të auditimeve të përputhshmërisë, të teknologjisë së informacionit, financiar dhe veçanërisht në auditimet e performancës.
3. KLSH, në ushtrim të kërkesave të ligjit dhe standardeve ndërkombëtare të auditimit, duhet të rrisë forcën e rekomandimeve të adresuara subjekteve të audituara si dhe të kërkojë ndjekjen e zbatimit të tyre në mënyrë konsistente. Rekomandimet duhet të kenë një ndikim të ndjeshëm në përmirësimin e gjëndjes së subjekteve të audituara në funksion të mirëadministrimit të fondeve në dispozicion, por dhe të një qeverisjeje sa më të mirë.
4. KLSH duhet të programojë punën që për 2 vjet të kryejë një auditim performance për privatizimet dhe kontratat koncensionare të realizuara në 20 vitet e fundit në vendin tonë në sektorët strategjikë, me qëllim ndikimin e tyre në buxhetin e shtetit.

5. Për të realizuar objektivat strategjikë dhe institucionalë, me synim realizimin dhe konsolidimin e reformave, KLSH duhet të punojë për përsosjen e mënyrës së organizimit dhe drejtimit të institucionit, për të përçuar praktikat më të mira të institucioneve simotra evropiane në këto fusha.

6 Ne vijim të punës së bërë deri tani në zbatim të kërkesave të Ligjit të Ri të Organizimit dhe Funksionimit të KLSH-së për hartimin e dokumenteve bazikë si: Hartimi i Strategjisë Zhvillimit Institucional 2013-2017 (e ripunuar për periudhën 2015-2017), i Kodit Etik te ri Etik të KLSH-së, i Strategjisë së Implementimit të Standarteve Ndërkombëtare të Auditimit 2015-2016, i Rregullores se Brendshme te Institucionit etj, KLSH duhet të angazhohet me nxjerrjen e manualeve, metodikave dhe udhëzuesve të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në menaxhimin e procesit të auditimit, përcaktimin e përgjegjësive të reja në fushën e auditimit, dhe kryerjen e veprimtarisë audituese në një linje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI.

7. KLSH duhet të vijojë me përmbushjen e objektivave për rritjen e kapaciteteve audituese të burimeve njerëzore dhe forcimit të kapaciteteve institucionale, duke përqasur metodologji moderne për auditim, për t'iu përgjigjur nivelit të parametrave të kërkuar nga INTOSAI. Këto kërkojnë menaxhimin e duhur të burimeve njerëzore dhe trainime të vazhdueshme, të orientuara drejt përmirësimit të cilësisë së auditimit.

8. KLSH, në kuadër të bashkëpunimit institucional, për intensifikimin e luftës kundër korrupsionit dhe formave të shfaqjes së tij, duhet të rishikojë marrëveshjet/memorandumet e bashkëpunimit me institucionet dhe organet ligjzbatuese, që i kanë tejkaluar afatet e kohëzgjatjes të tyre, për t'iu përgjigjur sfidave dhe kërkesave të kohës.

9. Për respektimin në vijimësi të parimit të transparencës institucionale, KLSH duhet të çojë më tej përvojën pozitive të fituar në komunikimin me publikun, organet e administratës, organizatat e shoqërisë civile, median, etj.

10. Në përmbushje të rekomandimeve, adresuar në kuadër të procesit të integrimit evropian, KLSH dhe Kuvendi duhet të rrisin shkallën e ndërveprimit gjithëpërfshirës me institucionet ligjzbatuese, me qëllim përmbushjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

11. Për rekomandimet në aspektin e përmirësimit të legjislacionit dhe rekomandimet për masa disiplinore ndaj drejtuesve të nivelit të lartë dhe të mesëm menaxherial, Kuvendi dhe KLSH të organizojnë, të paktën 2 herë në vit, seanca dëgjimore me institucionet përkatëse dhe grupet e interesit, me qëllim vlerësimin e situatës ligjore dhe finalizimin e nismave ligjvënëse dhe forcimin e luftës ndaj korrupsionit.

12. Kuvendi, në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe në ushtrim të kontrollit parlamentar, duhet të angazhohet që të realizojë auditimin e llogarive financiare të KLSH-së dhe t'i bëjë ato publike.

Shënim: *"Raporti Vjetor i Performancës, KLSH 2014" u botua jashtë kohës së parashikuar, për shkak se Kuvendi i Shqipërisë për arsye teknike nuk ka miratuar në seancë plenare Rezolutën lidhur me vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2014.*

Projektrezoluta është përgatitur nga relatori, deputeti Ervin Koçi, dhe pavarësisht faktit që nuk është miratuar, ne do ti referohemi rekomandimeve të saj përgjatë periudhës në vijim, duke i konsideruar si objektiva parësorë dhe duke i integruar në planin e veprimtarisë së zhvillimit të institucionit për periudhën në vijim.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 96/4 Prot. Tiranë, më 31/07/2015

Lënda: **Lidhur me miratimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për "Vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2014"**

Drejtuar: **Z. Erion BRAÇE**
Kryetar i Komisionit për Ekonominë dhe Financat

Në datën 15 qershor, Kontrolli i Lartë të Shtetit raportoi pranë Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, lidhur me "Performancën e KLSH-së për vitin 2014".

Duke përfituar nga ky komunikim, dëshiroj t'Ju falënderoj Juve personalisht, si Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave në Kuvendin e Shqipërisë për vëmendjen që na kushtuat dhe mbështetjen që na dhatë për të realizuar misionin tonë si agjent i publikut dhe i Kuvendit të Shqipërisë për mirë-administrimin e parasë publike.

Kuvendi i Shqipërisë nuk ka dalë ende me një Rezolute lidhur me "Vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2014" dhe në këto kushte do të dëshironim të dinim nëse do të ketë një dokument të tillë për aktivitetin e institucionit tonë për vitin 2014. Nëse Kuvendi do të miratojë Rezolutën për aktivitetin tonë për vitin 2014, ne do të hartojmë menjëherë Planin e Veprimit për zbatimin e saj.

Duke Ju falënderuar dhe duke vlerësuar maksimalisht bashkëpunimin me Komisionin e Ekonomisë dhe Financave dhe Kuvendin e Shqipërisë.

Bujar LESKAJ

KRYETAR

EVIDENCA PËRMBLEDHËSE E SHKELJEVE ME DËM EKONOMIK TË KONSTATUAR GJATË AUDITIMEVE TË USHTRUARA PËR TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET, GJATË VITIT 2014

Nr.	EMËRTIMI I SUBJEKTEVE	SHKELJE TË LIGJSHMËRISË ME EFEKTE FINANCIARE (DËM EKONOMIK)											Rekomanduar	
		Në sektorin e tatim taksave	Në sektorin e doganave	Nga dividendi	Nga shitja dhe dhënia me qera e pasurisë	Në sistemin e pagave	Në fushën e shpërblimeve	Në shpenzime operative	Në fushën e urbanistikës	Në fushën e prokurimeve	Në mungesë materiali e inventari	Të tjera	Gjithsej	Për zhdëmtim
a	b	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
1	Ish-MBU&MK, Tiranë							865		12 945			13 810	13 810
2	Ministria e Energjetikës & Industrisë Koncensione				955 661								955 661	955 661
3	DP Arkivit Shtetit									739	1 678		2 417	2 417
4	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit							216					216	216
5	Komuna Qendër, Mallakastër									3 737			3 737	3 737
6	Universiteti Bujqësor, Tiranë				1 744		1 417	1 775		3 534		5 421	13 891	13 891

Nr.	EMËRTIMI I SUBJEKTEVE	SHKELJE TË LIGJSHMËRISË ME EFEKTE FINANCIARE (DËM EKONOMIK)											Rekomanduar	
		Në sektorin e tatim taksave	Në sektorin e doganave	Nga dividendi	Nga shitja dhe dhënia me qera e pasurisë	Në sistemin e pagave	Në fushën e shpërblimeve	Në shpenzime operative	Në fushën e urbanistikës	Në fushën e prokurimeve	Në mungesë materiali e inventari	Të tjera	Gjithsej	Për zhdëmtim
a	b	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
7	Spitali "Shefqet Ndroqi", Tiranë				259			61					320	320
8	Universiteti Politeknik, Tiranë							2 031					2 031	2 031
9	Muzeu "Gjergj Kastrioti Skënderbeu", Krujë											105	105	105
10	Drejtoria e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit				183						700		883	883
11	Instituti i Shëndetit Publik					6 297		2 937			314	461	10 009	10 009
12	Instituti i Sigurimeve Shoqërore							495		134		308 013	308 642	308 642
13	Autoriteti Rrugor Shqiptar									24 479	16 536		41 015	16 875

Nr.	EMËRTIMI I SUBJEKTEVE	SHKELJE TË LIGJSHMËRISË ME EFEKTE FINANCIARE (DËM EKONOMIK)											Rekomanduar	
		Në sektorin e tatim taksave	Në sektorin e doganave	Nga dividendi	Nga shitja dhe dhënia me qera e pasurisë	Në sistemin e pagave	Në fushën e shpërblimeve	Në shpenzime operative	Në fushën e urbanistikës	Në fushën e prokurimeve	Në mungesë materiali e inventari	Të tjera	Gjithsej	Për zhdëmtim
a	b	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
14	Drejtoria Rajonale e ISSH, Tiranë					226		3 674		2 218		1 390	7 508	7 508
15	Fondi Shqiptar i Zhvillimit									14 573			14 573	14 573
16	Banka e Shqipërisë											356 867	356 867	356 867
17	Ministria e Shëndetësisë, Tiranë							9 083		244			9 327	9 327
18	AKBN, Tiranë				1 125 644		350	97 369				4 133	1 227 496	1 138 316
19	QSU, "Nënë Tereza", Tiranë				4 436			158		30 956			35 550	35 550
20	Ministria e Financave							499					499	499
21	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Tiranë							127					127	127
22	Zyra Shqiptare e të Drejtave të							1 172				800	1 972	1 972

Nr.	EMËRTIMI I SUBJEKTEVE	SHKELJE TË LIGJSHMËRISË ME EFEKTE FINANCIARE (DËM EKONOMIK)											Rekomanduar	
		Në sektorin e tatim taksave	Në sektorin e doganave	Nga dividendi	Nga shitja dhe dhënia me qera e pasurisë	Në sistemin e pagave	Në fushën e shpërblimeve	Në shpenzime operative	Në fushën e urbanistikës	Në fushën e prokurimeve	Në mungesë materiali e inventari	Të tjera	Gjithsej	Për zhdëmtim
a	b	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
	Autorit													
23	Komisioni i Prokurimit Publik	17										15	32	32
24	Universiteti "A. Moisiu", Durrës				168	9 026		1 260		3 941			14 395	14 395
25	Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë	263								1 854			2 117	2 117
26	Qendra Kombëtare e Regjistrimit							770		8 748			9 518	9 518
27	DP. Arkivit të Shtetit, Tiranë							335			10 724		11 059	11 059
28	Bashkia Rrogozhinë	2 296						1 889		1 639			5 824	5 824
29	Bashkia Laç	883				207		132		233			1 455	1 455
30	Bashkia Shijak	2 217			11 474					399			14 090	14 090

Nr.	EMËRTIMI I SUBJEKTEVE	SHKELJE TË LIGJSHMËRISË ME EFEKTE FINANCIARE (DËM EKONOMIK)											Rekomanduar	
		Në sektorin e tatim taksave	Në sektorin e doganave	Nga dividendi	Nga shitja dhe dhënia me qera e pasurisë	Në sistemin e pagave	Në fushën e shpërblimeve	Në shpenzime operative	Në fushën e urbanistikës	Në fushën e prokurimeve	Në mungesë materiali e inventari	Të tjera	Gjithsej	Për zhdëmtim
a	b	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
31	Bashkia Peqin	25				585		244		1 051			1 905	1 905
32	Komuna Pezë, Tiranë	79											79	79
33	Komuna Gjepalaj, Durrës	579											579	579
34	Komuna Shënkoll, Lezhë	1 318						655	2 373	14 420			18 766	18 766
35	Komuna Remas, Lushnjë									14 833			14 833	14 833
36	Komuna Qendër Çlirim, Fier							230					230	230
37	Komuna Tomin, Dibër	138				183		180		174			675	675
38	Komuna Udenisht, Pogradec								228	2 076			2 304	2 304
39	Këshilli i Qarkut, Dibër					708		544	18				1 270	1 270
40	Aluizni Rajonal, Elbasan 1											412 633	412 633	412 633

Nr.	EMËRTIMI I SUBJEKTEVE	SHKELJE TË LIGJSHMËRISË ME EFEKTE FINANCIARE (DËM EKONOMIK)											Rekomanduar	
		Në sektorin e tatim taksave	Në sektorin e doganave	Nga dividendi	Nga shitja dhe dhënia me qera e pasurisë	Në sistemin e pagave	Në fushën e shpërblimeve	Në shpenzime operative	Në fushën e urbanistikës	Në fushën e prokurimeve	Në mungesë materiali e inventari	Të tjera	Gjithsej	Për zhdëmtim
a	b	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
41	Aluizni Rajonal, Durrës					2 017		645				93 110	95 772	95 772
42	Bashkia Berat	27 027			3 604	11 150	40	1 818	1 696	11 605			56 940	56 940
43	Bashkia Vlorë				5 262		371	854	3 999	71 922			82 408	82 408
44	Bashkia Ura-Vajgurore	1 588				86							1 674	1 674
45	Bashkia Elbasan				236			458	196	29 953			30 843	30 843
46	Komuna Golem, Kavajë	6 308				1 204				78 799			86 311	86 311
47	Komuna Labinot Mal, Elbasan	173						58		50			281	281
48	Komuna Rashbull, Durrës	51 684			100				3 120	4 342			59 246	59 246
49	Komuna Qendër, Librazhd	855			6	43		288		1 670			2 862	2 862

Nr.	EMËRTIMI I SUBJEKTEVE	SHKELJE TË LIGJSHMËRISË ME EFEKTE FINANCIARE (DËM EKONOMIK)											Rekomanduar	
		Në sektorin e tatim taksave	Në sektorin e doganave	Nga dividendi	Nga shitja dhe dhënia me qera e pasurisë	Në sistemin e pagave	Në fushën e shpërblimeve	Në shpenzime operative	Në fushën e urbanistikës	Në fushën e prokurimeve	Në mungesë materiali e inventari	Të tjera	Gjithsej	Për zhdëmtim
a	b	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
50	Komuna Farkë, Tiranë									3 023			3 023	3 023
51	Komuna Miras, Devoll	100						70	2 350				2 520	2 520
52	ZVRPP, Kavajë											23 384	23 384	23 384
53	Agjencia Zhvillimit Bujqësor e Rural (Ministria e Bujqësisë)							118		5 433			5 551	5 551
54	Bashkia Shkodër									114			114	114
55	Bashkia Sarandë	11 095			3 172	1 121				6 706			22 094	22 094
56	Bashkia Rëshen				47					4 366			4 413	4 413
57	Bashkia Prrenjas	215				78				19 592			19 885	19 885
58	Bashkia Burrel							330		3 921			4 251	4 251
59	Bashkia Korçë					323		371		2 913			3 607	3 607

Nr.	EMËRTIMI I SUBJEKTEVE	SHKELJE TË LIGJSHMËRISË ME EFEKTE FINANCIARE (DËM EKONOMIK)											Rekomanduar	
		Në sektorin e tatim taksave	Në sektorin e doganave	Nga dividendi	Nga shitja dhe dhënia me qera e pasurisë	Në sistemin e pagave	Në fushën e shpërblimeve	Në shpenzime operative	Në fushën e urbanistikës	Në fushën e prokurimeve	Në mungesë materiali e inventari	Të tjera	Gjithsej	Për zhdëmtim
a	b	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
60	Komuna Kodër, Thumanë, Krujë				252	70				2 068			2 390	2 390
61	Komuna Bicaj, Kukës	554						2 185		35			2 774	2 774
62	Komuna Lurë, Dibër					124		737					861	861
63	Komuna Margegaj, Tropojë									4 393			4 393	4 393
64	Komuna Lekbibaj, Tropojë							1 620		2 045			3 665	3 665
65	Komuna Kashar, Tiranë				5 824			1 073	1 442	6 751			15 090	15 090
66	Komuna Ksamil, Sarandë	49 913			1 262	208		662	1 135	438		22 650	76 268	76 268
67	ALUIZNI, Berat					233		39				17 565	17 837	17 837
68	ALUIZNI Tirana1					570			267			162 642	163 479	163 479
69	Ujësjellës Ura-Vajgurore	24			672		84	459		218			1 457	1 457

Nr.	EMËRTIMI I SUBJEKTEVE	SHKELJE TË LIGJSHMËRISË ME EFEKTE FINANCIARE (DËM EKONOMIK)											Rekomanduar	
		Në sektorin e tatim taksave	Në sektorin e doganave	Nga dividendi	Nga shitja dhe dhënia me qera e pasurisë	Në sistemin e pagave	Në fushën e shpërblimeve	Në shpenzime operative	Në fushën e urbanistikës	Në fushën e prokurimeve	Në mungesë materiali e inventari	Të tjera	Gjithsej	Për zhdëmtim
a	b	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
70	Komuna Voskopojë, Korçë	438			505	270			5 294	14 880			21 387	21 387
71	Bashkia Lushnjë	8 830				373			772	1 591			11 566	11 566
72	Bashkia Bajram Curri	1 548			587				11 888	1 717			15 740	15 740
73	Bashkia Peshkopi	1 198			897	1 677		564	20	2 484			6 840	6 840
74	Komuna Bërxull	1 980				336		198	3 634	762			6 910	6 910
75	Drejtoria Rajonale Rrugore Qendrore, Tiranë									13 778			13 778	13 778
76	Drejtoria Qendrore e ALUIZNIT							603		138			741	741
77	Drejtoria Rajonale Rrugore Gjirokastër									12 041			12 041	12 041

Nr.	EMËRTIMI I SUBJEKTEVE	SHKELJE TË LIGJSHMËRISË ME EFEKTE FINANCIARE (DËM EKONOMIK)											Rekomanduar	
		Në sektorin e tatim taksave	Në sektorin e doganave	Nga dividendi	Nga shitja dhe dhënia me qera e pasurisë	Në sistemin e pagave	Në fushën e shpërblimeve	Në shpenzime operative	Në fushën e urbanistikës	Në fushën e prokurimeve	Në mungesë materiali e inventari	Të tjera	Gjithsej	Për zhdëmtim
a	b	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
78	Prefektura Fier							258					258	258
79	Drejtoria Rajonale Rrugore Veriore, Shkodër							254		11 496			11 750	11 750
80	Bashkia Krujë	1 486								507			1 993	1 993
81	Bashkia Vorë	28				476		835		1 573			2 912	2 912
82	Komuna Paskuqan									2 709			2 709	2 709
83	Komuna Fshat Tropojë	27						600		20 166			20 793	20 793
84	Prefektura Vlorë					1 933							1 933	1 933
85	ZVRPP, Elbasan	20											20	20
86	Projekti "Zhvillimi i rrugëve Bashkiake	7 550						207		390			8 147	8 147

Nr.	EMËRTIMI I SUBJEKTEVE	SHKELJE TË LIGJSHMËRISË ME EFEKTE FINANCIARE (DËM EKONOMIK)											Rekomanduar	
		Në sektorin e tatim taksave	Në sektorin e doganave	Nga dividendi	Nga shitja dhe dhënia me qera e pasurisë	Në sistemin e pagave	Në fushën e shpërblimeve	Në shpenzime operative	Në fushën e urbanistikës	Në fushën e prokurimeve	Në mungesë materiali e inventari	Të tjera	Gjithsej	Për zhdëmtim
a	b	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
	Tiranë"													
87	Projekti "Mbi menaxhimin e mbetjeve të ngurta të Tiranës", DPUK Tiranë									4 385		47 983	52 368	52 368
88	Autoriteti Aviacionit Civil	8 153								300	544		8 997	8 997
89	Autoriteti Portual, Durrës				91	139				8 489	937	112 077	121 733	121 733
90	DSHP, Tiranë				16	271		72		84			443	443
91	Agjencia Kombëtare Mjedisit							246		1 687			1 933	1 933
92	KESH sh.a., Tiranë					34 356	1 939	2 637		9 155		5 797	53 884	53 884
93	OST, sh.a., Tiranë						185	7 963		2 840			10 988	10 988
94	Ujësjellës Kanalizime,						642	748		615		4 021	6 026	6 026

Nr.	EMËRTIMI I SUBJEKTEVE	SHKELJE TË LIGJSHMËRISË ME EFEKTE FINANCIARE (DËM EKONOMIK)											Rekomanduar	
		Në sektorin e tatim taksave	Në sektorin e doganave	Nga dividendi	Nga shitja dhe dhënia me qera e pasurisë	Në sistemin e pagave	Në fushën e shpërblimeve	Në shpenzime operative	Në fushën e urbanistikës	Në fushën e prokurimeve	Në mungesë materiali e inventari	Të tjera	Gjithsej	Për zhdëmtim
a	b	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
	Tiranë													
95	Porti Detar, Sarandë				2 433	535				960			3 928	3 928
96	Ujësjellës Kanalizime, Durrës						439	209				9 592	10 240	10 240
97	Projekti "Programi rural i furnizimit me ujë"											3 369	3 369	3 369
98	INSIG, sh.a., Tiranë	980						293				32 619	33 892	33 892
99	Albpetrol, sh.a., Fier	7 433			1 044	303	534			1 863	100 691	5 074 407	5 186 275	5 186 275
100	Projekti "Ndërtimi i aksit													
	rrugor Tiranë-Elbasan"					114		1 702		16 150			17 966	17 966
101	Drejtoria Shërbimit Pyjor, Shkodër					345							345	345

Nr.	EMËRTIMI I SUBJEKTEVE	SHKELJE TË LIGJSHMËRISË ME EFEKTE FINANCIARE (DËM EKONOMIK)											Rekomanduar	
		Në sektorin e tatim taksave	Në sektorin e doganave	Nga dividendi	Nga shitja dhe dhënia me qera e pasurisë	Në sistemin e pagave	Në fushën e shpërblimeve	Në shpenzime operative	Në fushën e urbanistikës	Në fushën e prokurimeve	Në mungesë materiali e inventari	Të tjera	Gjithsej	Për zhdëmtim
a	b	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
102	Qendra e Trajtimit të studentëve Nr.1 sh.a., Tiranë				8 881			1 327		13 312			23 520	23 520
103	Qendra e Trajtimit të studentëve Nr. 2 sh.a., Tiranë							1 000					1 000	1 000
104	Ujësjellës-Kanalizime, Mirditë							759		3 521			4 280	4 280
105	Ujësjellës-Kanalizime, Shkodër						2 565	263		500	85		3 413	3 413
106	Ujësjellës-Kanalizime, Gjirokastër					34	3 324	50		72			3 480	3 480
107	Projekti "Furnizimi me ujë dhe shërbimet sanitare Orikum,Vlorë"							17 436		18 318			35 754	35 754

Nr.	EMËRTIMI I SUBJEKTEVE	SHKELJE TË LIGJSHMËRISË ME EFEKTE FINANCIARE (DËM EKONOMIK)											Rekomanduar	
		Në sektorin e tatim taksave	Në sektorin e doganave	Nga dividendi	Nga shitja dhe dhënia me qera e pasurisë	Në sistemin e pagave	Në fushën e shpërblimeve	Në shpenzime operative	Në fushën e urbanistikës	Në fushën e prokurimeve	Në mungesë materiali e inventari	Të tjera	Gjithsej	Për zhdëmtim
a	b	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
108	Projekti "Administrimi dhe menaxhimit tokës, Komponenti D. Ndërhyrje emergjente në zonën Shkodër-Lezhë"									3 622			3 622	3 622
109	Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, Tiranë							1 862					1 862	1 862
110	Projekti "Ndërtimi i rrugës Levan-Tepelenë"									104 729			104 729	104 729
111	DTTV, Bashkia Tiranë	14 247						2 923					17 170	17 170

Nr.	EMËRTIMI I SUBJEKTEVE	SHKELJE TË LIGJSHMËRISË ME EFEKTE FINANCIARE (DËM EKONOMIK)											Rekomanduar	
		Në sektorin e tatim taksave	Në sektorin e doganave	Nga dividendi	Nga shitja dhe dhënia me qera e pasurisë	Në sistemin e pagave	Në fushën e shpërblimeve	Në shpenzime operative	Në fushën e urbanistikës	Në fushën e prokurimeve	Në mungesë materiali e inventari	Të tjera	Gjithsej	Për zhdëmtim
a	b	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
112	Degën e Doganës Rinas		2 531										2 531	2 531
113	Degën e Doganës Fier		144 147					1 749					145 896	145 896
114	Dega e Doganës Tiranë		68 143										68 143	68 143
115	Dega e Doganës Durrës		478 216										478 216	478 216
116	Dega e Doganës Vlorë		86 873					749					87 622	87 622
117	Dega e Doganës Kapshticë		57 142										57 142	57 142
118	Dega Doganës, Qafe-Bote, Sarandë		9 361										9 361	9 361
119	DTTV, Bashkia Fier	27 090											27 090	27 090
120	Dega e Doganës, Bllatë		10 020										10 020	10 020
121	DTTV, Bashkia Shkodër	13 539											13 539	13 539
122	DTTV, Bashkia, Korçë	14 872											14 872	14 872

Nr.	EMËRTIMI I SUBJEKTEVE	SHKELJE TË LIGJSHMËRISË ME EFEKTE FINANCIARE (DËM EKONOMIK)											Rekomanduar	
		Në sektorin e tatim taksave	Në sektorin e doganave	Nga dividendi	Nga shitja dhe dhënia me qera e pasurisë	Në sistemin e pagave	Në fushën e shpërblimeve	Në shpenzime operative	Në fushën e urbanistikës	Në fushën e prokurimeve	Në mungesë materiali e inventari	Të tjera	Gjithsej	Për zhdëmtim
a	b	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
123	DP Tatimeve, Tiranë							214					214	214
124	DP Doganave, Tiranë						190						190	190
125	Dega e Doganës, Kakavijë		45 167									21 162	66 329	66 329
126	Dega e Doganës, Berat		25 490										25 490	25 490
127	Dega e Doganës, Morinë-Kukës		3 713					812				26	4 551	4 551
128	DTTV,Bashkia, Elbasan	7 928											7 928	7 928
129	DTTV,Bashkia, Lezhë	3 926											3 926	3 926
130	DTTV, Bashkia, Vlorë	165											165	165
131	Dega e Doganës tre-Urat, Përmet		4 583		990			802					6 375	6 375

Nr.	EMËRTIMI I SUBJEKTEVE	SHKELJE TË LIGJSHMËRISË ME EFEKTE FINANCIARE (DËM EKONOMIK)											Rekomanduar	
		Në sektorin e tatim taksave	Në sektorin e doganave	Nga dividendi	Nga shitja dhe dhënia me qera e pasurisë	Në sistemin e pagave	Në fushën e shpërblimeve	Në shpenzime operative	Në fushën e urbanistikës	Në fushën e prokurimeve	Në mungesë materiali e inventari	Të tjera	Gjithsej	Për zhdëmtim
a	b	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
132	Dega e Doganës Elbasan		6 144					112					6 256	6 256
	TOTALI - 2014	278 789	941 530		2 135 450	75 621	12 080	185 933	38 432	678 118	132 209	6 720 242	11 198 404	11 085 084

EVIDENCA E KALLËZIMEVE PENALE TË DËRGUARA NGA KONTROLLI I LARTË I SHTETIT, PËR VITIN 2014

Nr.	Subjekti ndaj të cilit është bërë kallëzimi	Nr. prot., data e kallëzimit	Numri i personave të kallëzuar, cilësimi i veprës	Dëmi i shkaktuar në 000/lekë	Gjendja e kallëzimit	Departamenti që ka konstatuar veprën penale
1	Komuna Qendër, Mallakastër	Nr. 868/8 11.04.2014	**3** persona për shpërdorim detyre, neni 248 i kodit penal	3 737	Në hetim	Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm
2	Universiteti Bujqësor, Tiranë	Nr. 956/10 16.05.2014	**4** persona për shpërdorim detyre, neni 248 i kodit penal	1 709	Në hetim	
3	Universiteti Bujqësor, Tiranë	Nr. 956/11 16.05.2014	**1** person për shpërdorim detyre, neni 248 i kodit penal	425 550	Në hetim	
4	Drejtoria e Arkivit Shtetëror, Vlorë	Nr. 175/11 16.06.2014	**1** person për shpërdorim detyre, neni 248 i kodit penal	33 736	Në hetim	
5	Instituti i Shëndetit Publik, Tiranë	Nr. 275/12 31.07.2014	**1** person për shpërdorim detyre dhe shkelje të pabarazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike, neni 248 dhe 258 i kodit penal	1 585	Në hetim	

Nr.	Subjekti ndaj të cilit është bërë kallëzimi	Nr. prot., data e kallëzimit	Numri i personave të kallëzuar, cilësimi i veprës	Dëmi i shkaktuar në 000/lekë	Gjendja e kallëzimit	Departamenti që ka konstatuar veprën penale
6	Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Tiranë	Nr. 177/11 15.09.2014	**1** person për mashtrim dhe falsifikim të dokumenteve, neni 143 dhe 186 i kodit penal	-	Në hetim	Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm
7	Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Tiranë	Nr. 177/10 15.09.2014	**11** persona për mashtrim dhe falsifikim të dokumenteve, neni 143 dhe 186 i kodit penal	12 850	Në hetim	
8	Autoriteti Rrugor Shqiptar	Nr. 246/17 03.09.2014	**1** person për shpërdorim detyre, neni 248 i kodit penal	232 300	Në hetim	
9	Autoriteti Rrugor Shqiptar	Nr. 246/18 03.09.2014	**2** persona për shpërdorim detyre, neni 248 i kodit penal	24 139	Në hetim	
10	Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Tiranë	Nr.524/8 15.09.2014	**6** persona për mashtrim dhe falsifikim të dokumenteve, neni 143 dhe 186 i kodit penal	1 390	Në hetim	

Nr.	Subjekti ndaj të cilit është bërë kallëzimi	Nr. prot., data e kallëzimit	Numri i personave të kallëzuar, cilësimi i veprës	Dëmi i shkaktuar në 000/lekë	Gjendja e kallëzimit	Departamenti që ka konstatuar veprën penale
11	Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë	Nr. 221/14 24.09.2014	**4** persona për shpërdorim detyre dhe për shkelje të pabarazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike, neni 248 dhe 258 i kodit penal	30 956	Në hetim	Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm
12	Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë	Nr. 221/15 24.09.2014	**4** persona për shpërdorim detyre dhe për shkelje të pabarazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike, neni 248 dhe 258 i kodit penal		Në hetim	
13	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Tiranë	Nr. 502/27 21.10.2014	**6** persona për shpërdorim detyre, neni 248 i kodit penal	7 240	Në hetim	
14	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Tiranë	Nr. 502/28 21.10.2014	**2** persona për shpërdorim detyre dhe për shkelje të pabarazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike, neni 248 dhe 258 i kodit penal	89 180	Në hetim	

Nr.	Subjekti ndaj të cilit është bërë kallëzimi	Nr. prot., data e kallëzimit	Numri i personave të kallëzuar, cilësimi i veprës	Dëmi i shkaktuar në 000/lekë	Gjendja e kallëzimit	Departamenti që ka konstatuar veprën penale
